UDHËZIM
Nr.24, datë 2.9.2008

PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(ndryshuar me udhëzimin nr.37, datë 1.9.2009, nr.6, datë 19.2.2010, nr.13, datë 14.4.2010, nr.27, datë 18.8.2010, nr.32, datë 21.9.2010, nr.34, datë 6.10.2010, nr. 17, datë 3.6.2013, nr. 4, datë 25.1.2014, nr. 4/1, datë 23.5.2014, nr. 26, datë 16.12.2014, nr. 14, datë 13.5.2015, nr. 14/1 , datë 4.9.2015, nr. 14/2, datë 8.10.2015, nr. 31/datë 27.11.2015, nr. 7, datë 10.1.2017, nr. 13 datë 13.4.2017, nr. 10, datë 15.3.2019, nr. 23, datë 13.8.2019, nr. 12, datë 4.3.2020, nr. 44, datë 9.11.2020, nr. 45, datë 26.11.2020)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Ministri i Financave

UDHËZON:

QËLLIMI I UDHËZIMIT

Ky udhëzim ka për qëllim që, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të vendosë rregulla dhe procedura për administrimin e detyrimeve tatimore, si dhe parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë. Udhëzimi synon unifikimin dhe vendosjen e standardeve bashkëkohore për të garantuar konkurrencë të ndershme, trajtim të barabartë e të paanshëm, dhe transparence në zbatimin korrekt dhe në mënyrë uniforme të procedurave dhe të rregullave të vendosura, duke ruajtur njëkohësisht ekuilibrin e duhur ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve të tatimpaguesve dhe të administratës tatimore.

Rregullat dhe procedurat e administrimit tatimor të vendosura në këtë udhëzim synojnë qartësimin e kuptimit të dispozitave të ligjit për të garantuar një zbatim korrekt dhe uniform të tyre, për të siguruar administrimin e tatimeve dhe taksave me një kosto sa më të ulët për administratën tatimore dhe për tatimpaguesin, nëpërmjet nxitjes së vetëvlerësimit e plotësimit vullnetar të detyrimeve nga tatimpaguesit, nëpërmjet edukimit të tatimpaguesve dhe nëpërmjet kontrolleve të paanshme të bazuara në analizën e riskut.

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i ligjit dhe udhëzimit për procedurat tatimore

1.1 Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", në vijim i referuar "ligji i procedurave" ose shkurt "ligji", dhe dispozitat e këtij udhëzimi "Për procedurat tatimore", në vijim i quajtur shkurt "udhëzimi", rregullojnë procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Administrimi i të gjitha llojeve të tatimeve, taksave kombëtare apo vendore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë bazohet në Ligjin e Procedurave, në këtë udhëzim, në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore lidhur me tatimet.

1.2 Dispozitat e ligjit dhe udhëzimit zbatohen për të gjitha llojet e tatimeve dhe të detyrimeve tatimore, përfshirë tatimet dhe taksat kombëtare dhe vendore, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me përjashtim të rasteve kur me ligje të veçanta është parashikuar ndryshe.

2. Fusha e veprimit

2.1 Ligji "Për procedurat tatimore" dhe ky udhëzim zbatohen për:

a) tatimpaguesit e regjistruar ose të detyruar për t'u regjistruar në administratën tatimore, agjentët tatimorë, agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, si dhe për persona të tjerë, të përcaktuar nga legjislacioni tatimor;

b) personat e ngarkuar për të llogaritur, paguar, mbajtur, deklaruar dhe transferuar në Buxhetin e Shtetit kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;

c) personat e paregjistruar në organet tatimore të detyruar të deklarojnë dhe paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore apo tatim mbi të ardhurat, për detyrimet e tyre lidhur me dhënien e informacionit, llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve dhe tatimit;

ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore për procedurat, të drejtat dhe përgjegjësitë tatimore, të cilat nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet që i janë bërë ose mund t'i bëhen atij ligji në të ardhmen.

3. Legjislacioni tatimor

Legjislacioni tatimor përbëhet nga:

a) marrëveshjet ndërkombëtare, që Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, organet e qeverisjes vendore, apo institucione të tjera qendrore apo vendore nënshkruajnë me shtete të tjera, apo institucione qendrore apo vendore të atyre shteteve, me kusht që këto marrëveshje të jenë të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë;

b) ligjet tatimore specifike që rregullojnë administrimin e tatimeve dhe taksave qendrore dhe vendore, përfshirë legjislacionin lidhur me mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

c) aktet nënligjore, përfshirë vendimet e Këshillit të Ministrave, udhëzimet dhe urdhrat e Ministrit të Financave, rregulloret dhe udhëzimet teknike të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, të miratuara në mbështetje të ligjeve tatimore.

4. Llojet e tatimeve dhe të taksave

Emërtimet dhe përkufizimet lidhur me tatimet dhe taksat kombëtare dhe vendore jepen në dispozitat e legjislacionit tatimor, siç referohen në pikën 3 më lart.

5. Përkufizime

5.1 Administrimi i të gjitha llojeve të tatimeve, taksave kombëtare apo vendore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të akcizës që prej 1 tetorit 2012, bazohet në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", në këtë udhëzim, në aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji, në ligjet e veçanta tatimore dhe në aktet nënligjore në zbatim të këtyre ligjeve. Administrata tatimore, në marrëdhëniet e saj me tatimpaguesit dhe me persona të tjerë të tretë, gjatë gjithë procesit të administrimit të tatimeve dhe të taksave mban parasysh përdorimin e termave unike, siç përcaktohet në nenin 5 të ligjit, si dhe përkufizimet specifike të bëra në marrëveshjet ndërkombëtare tatimore, ligjet specifike tatimore dhe ligjin për taksat vendore.

5.1.1 Në zbatim të germës "g" të nenit 5 të ligjit, termi "tatimpagues", përfshin personin e tatueshëm apo individin, i cili detyrohet nga ligji të paguajë tatime, taksa ose kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe agjentin e mbajtjes së tatimit në burim.

5.1.2 Në zbatim të germës "gj" të këtij neni, me "vend kryesor të biznesit" do të kuptohet vendi ku tatimpaguesi është i regjistruar, ka selinë qendrore dhe ku bëhet administrimi efektiv i biznesit. Nëse vendi i regjistrimit nuk përputhet me vendin ku efektivisht administrohet biznesi, vend kryesor i biznesit do të konsiderohet ky i fundit. Vendi i administrimit efektiv të biznesit është vendi ku në të vërtetë menaxhohet biznesi, ku mblidhen organet drejtuese dhe ku merren vendimet e biznesit.

6. Detyrimi tatimor

6.1 Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa apo bëhet pronar i një pasurie, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor.

6.2 Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa, në forme të

jashtëligjshme, apo bëhet zotërues i një sendi, në forma të jashtëligjshme. Detyrimi tatimor lind nga momenti i realizimit të të ardhurave, kryerjes së pagesës apo zotërimit të sendit, pavarësisht nga koha e konstatimit nga organet tatimore. Kur personi bëhet zotërues i një sendi në forma të jashtëligjshme, ky detyrim përllogaritet për të gjithë periudhën në të cilën personi ka gëzuar frytet e kësaj pasurie.

6.3 Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat dhe gjobat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore dhe legjislacionit për taksat vendore.

6.4 Detyrimi tatimor për individë të vdekur ose shoqëri të likuiduara përcaktohet si me poshtë:

a) në rastin e një individi apo personi fizik tregtar të vdekur, detyrimi tatimor pushon në datën e vdekjes dhe trashëgimtaret ligjore janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tatimeve të këtij personi;

b) në rastin e një personi juridik të likuiduar, detyrimi tatimor pushon në datën e likuidimit dhe likuidatori ose përfaqësuesi, i caktuar ligjërisht, është përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tatimit të këtij personi.

6.5 Detyrimet tatimore llogariten dhe paguhen në lekë, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

7. Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit

7.1 Agjenti i mbajtjes së tatimit ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me një tatimpagues, me përjashtim të rastit kur ky ligj apo ligjet tatimore specifike dhe legjislacioni i taksave vendore e përcaktojnë ndryshe.

7.2 Krahas detyrimeve të tjera si tatimpagues, agjenti i mbajtjes së tatimit ka edhe detyrat që vijojnë lidhur me llogaritjen, mbajtjen dhe transferimin në organet tatimore të tatimit të mbajtur:

a) të llogarisë dhe të mbajë tatimin, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësorë, për punonjësit apo persona të tretë, në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor;

b) të paguajë tatimin dhe kontributet e mbajtura në llogaritë përkatëse të organeve tatimore, në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor;

c) të mbajë regjistrime për tatimet e mbajtura, për personat të cilëve i është mbajtur tatimi dhe për pagesat e tatimit në llogaritë e organeve tatimore në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor;

ç) t'i japë administratës tatimore informacione lidhur me llogaritjen, mbajtjen dhe pagesën e tatimit, përfshirë informacione të tjera që lidhen me tatimpaguesit të cilëve i është mbajtur tatimi, në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor;

d) të informojë tatimpaguesit të cilëve i është mbajtur tatimi, lidhur me llogaritjen, mbajtjen dhe pagesën e tatimit, në përputhje me depozitat e legjislacionit tatimor.

8. Personi i tatueshëm rezident dhe jorezident

8.1.1 Në nenin 8 të Ligjit jepen kriteret e përcaktimit të rezidencës tatimore për individët, për personat juridikë dhe për personat fizikë tregtarë. Rezidenca tatimore është vendi ku tatimpaguesi ka përgjegjësi tatimore të plota lidhur me deklarimin e të ardhurave, pagesave dhe pasurive objekt tatimi në bazë të legjislacionit tatimor në fuqi. Pra tatimpaguesi rezident tatimor shqiptar gëzon të gjitha të drejtat dhe mban të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga dispozitat e legjislacionit tatimor shqiptar, përfshirë detyrimin për regjistrimin, mbajtjen e dokumentacionit, llogaritjen, deklarimin dhe pagimin e tatimeve, dhënien e informacionit për çdo pasuri apo të ardhur që realizon nga burime në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor në fuqi.

8.1.2 Individët konsiderohen rezidentë shqiptarë për qëllime tatimore, kur:

a) Kanë vendbanimin në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil, pra, kanë një banesë të përhershme, kanë familjen, kanë interesa jetësore dhe ekonomike në Shqipëri (vendi i interesave jetike), pavarësisht se mund të punojnë në periudha të ndryshme

jashtë vendit apo mund të kenë nënshtetësi të huaj.

b) Kanë nënshtetësi shqiptare dhe ushtrojnë funksione në emër të Republikës së Shqipërisë si funksionare diplomatike apo punonjës të caktuar nga shteti në ambasada, konsullata apo organizma të tjerë të ngjashëm ndërkombëtarë jashtë vendit.

c) Qëndrojnë në Shqipëri në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, në total me tepër se 183 dite, gjatë një viti tatimor, pavarësisht nga nënshtetësia apo vendi ku kanë interesat e tyre jetike. Në llogaritjen e kohëgjatësisë së qëndrimit në Shqipëri përfshihen ditët e pranisë fizike, pra, jo vetëm ditët e punës por edhe ditët e mbërritjes, ditët e largimit dhe ditët e pushimit.

Konsiderohen rezidentë tatimorë shqiptarë të gjithë individët që plotësojnë të paktën njërin nga kriteret e mësipërme.

8.1.3 Personat juridikë konsiderohen së janë rezidentë shqiptarë për qëllime tatimore kur:

a) janë regjistruar si persona juridikë shqiptarë dhe kanë selinë qendrore në Republikën e Shqipërisë;

b) Kanë vendin e menaxhimit efektiv të biznesit në Republikën e Shqipërisë.

Konsiderohen rezidentë tatimorë shqiptarë të gjithë personat juridikë që plotësojnë të paktën njërin nga kriteret e mësipërme.

8.1.4 Personat fizikë tregtarë konsiderohen së janë rezidentë shqiptarë për qëllime tatimore, kur janë regjistruar si të tillë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe kanë vendin kryesor të ushtrimit të biznesit në Shqipëri.

8.1.5 Të gjithë tatimpaguesit që nuk plotësojnë të paktën një nga kriteret e përmendura në pikat 8.1.1 - 8.1.4 më sipër, konsiderohen tatimpagues jorezident.

9. Caktimi i një përfaqësuesi tatimor nga personat jorezidentë

9.1 në zbatim të nenit 9 të Ligjit, tatimpaguesi jorezident emëron një përfaqësues tatimor rezident, kur kjo i kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Përfaqësuesi tatimor rezident mund të jetë një individ, një person fizik tregtar ose një person juridik. Personi i emëruar si përfaqësues tatimor ka të drejtë të veprojë në emër të kryesorit të tij (personit jorezident) për të gjitha qëllimet që lidhen me tatimet. Ai është njëkohësisht përgjegjës për të përmbushur të gjitha detyrimet e tatimpaguesit jorezident që ai përfaqëson. Përfaqësuesi tatimor duhet të kërkojë të regjistrohet pranë drejtorisë rajonale tatimore, në bazë të prokurës së lëshuar nga tatimpaguesi jorezident që do të përfaqësojë, siç përcaktohet në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", duke respektuar procedurën e parashikuar në paragrafin e mëposhtëm të kësaj pike. Kur i njëjti person është emëruar me prokurë të veçantë për të qenë përfaqësues tatimor i disa tatimpaguesve jorezidentë njëkohësisht, ai detyrohet të regjistrohet në mënyrë të veçantë për secilin prej tyre. Regjistrimi si përfaqësues tatimor i një tatimpaguesi jorezident, është i ndarë nga regjistrimi që mund të ketë bërë ky përfaqësues për aktivitetin e tij. Qëllimi i caktimit të përfaqësuesit tatimor është që të sigurohet llogaritja, deklarimi dhe pagesa e tatimit në emër të kryesorit (personi fizik ose juridik jorezident), i cili, në bazë të legjislacionit tatimor shqiptar, nuk është i detyruar të regjistrohet në Shqipëri, por për shkak të biznesit, pasurive apo transaksioneve që kryen në Shqipëri, i lindin detyrime tatimore të cilat përmbushen nëpërmjet përfaqësuesit tatimor.

9.1.1 Personi i cili do të regjistrohet si përfaqësues tatimor duhet të regjistrohet me emrin e tij dhe në emrin e përfaqësuesit të tij tatimor brenda 5 (pesë) ditëve pas emërimit si përfaqësues tatimor dhe para fillimit të detyrimit ligjor të këtij personi si përfaqësues tatimor në Shqipëri.

Shembull. "Kompania A" - kompani jorezidente detyrohet të paguajë TVSH në Shqipëri në bazë të dispozitave ligjore përkatëse. Për të përmbushur këtë detyrim ligjor, emëron si përfaqësues tatimor një tatimpagues shqiptar, i cili është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me emërtimin "kompania B" dhe numër identifikimi të personit L00000000X. "Kompania B", jo më vonë së 5 ditë pas emërimit si përfaqësues tatimor nga "kompania A" do të paraqitet në drejtorinë rajonale tatimore në të cilën është regjistruar për të aplikuar për regjistrimin e përfaqësuesit tatimor dhe pajisjen e tij me një numër identifikimi të personit të tatueshëm për TVSH-në me emërtimin: "kompania B" për "kompaninë A", me statusin

“përfaqësues tatimor”.

Brenda 5 ditëve pasi të jetë caktuar, përfaqësuesi tatimor duhet të dorëzojë aplikimin për regjistrim në drejtorinë e shërbimit dhe të regjistrimit të tatimpaguesit në drejtorinë rajonale tatimore, ku është regjistruar si tatimpagues ose në rastin e individit, aty ku ka vendin e zakonshëm të rezidencës.

Në formularin “Kërkesë për regjistrim” shënohet në një kuti të veçantë regjistrimi i përfaqësuesit tatimor.

Së bashku me aplikimin për regjistrim, i cili, bëhet me plotësimin dhe paraqitjen e formularit “Kërkesë për regjistrim”, personi i caktuar si përfaqësues tatimor duhet të paraqesë gjithashtu:

- vendimin ose prokurën e caktimit apo emërimit të përfaqësuesit tatimor, të nënshkruar nga personi përgjegjës i personit të tatueshëm jorezident që ka emëruar përfaqësuesin. Vendimi i emërimit të përfaqësuesit tatimor duhet të tregojë veprimet që përfaqësuesi tatimor është i autorizuar të kryejë në emër të personit që përfaqëson;

- një kopje të vërtetuar të marrëveshjes së përfaqësimit tatimor ndërmjet aplikuesit për përfaqësues tatimor dhe personit që ai përfaqëson;

- një kopje të vërtetuar nga autoritetet tatimore të shtetit përkatës, të certifikatës së regjistrimit tatimor të personit jorezident në vendin e tij të rezidencës, e lëshuar jo më përpara së 3 muaj nga data e aplikimit për regjistrim të përfaqësuesit, ku të vërtetohet së personi jorezident është person aktiv.

9.1.2 Në marrëveshje duhet të specifikohen qartë të gjitha aktivitetet, të cilat mund të ushtrohen nga përfaqësuesi tatimor.

Përfaqësuesi tatimor, të paktën, duhet të jetë i autorizuar:

- të plotësojë faturat në emër të personit që përfaqëson, për transaksionet për të cilat përfaqësuesi tatimor është autorizuar;

- të pranojë faturat për transaksione për të cilat përfaqësuesi tatimor është i autorizuar;

- të dorëzojë deklaratat e TVSH-së në Shqipëri në emër të personit që përfaqëson, si dhe deklarata të tjera tatimore kur ato i kërkohen nga legjislacioni tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

- të paguajë detyrimet tatimore dhe të marrë rimbursimet tatimore nëse ka të tilla në emër të personit jorezident që përfaqëson.

- të mbajë regjistrimet e transaksioneve për të cilat përfaqësuesi tatimor është caktuar dhe t’ia vendosë, ato në dispozicion me kërkesë të administratës tatimore;

- të veprojë në emër dhe për llogari të personit jorezident dhe ta përfaqësojë atë në kontrollet e mundshme të administratës tatimore;

- të plotësojë të gjitha detyrimet që lidhen me TVSH-në në importe, eksporte dhe detyrime doganore, nëse ka të tilla.

9.1.3 Drejtoria e regjistrimit dhe shërbimit të tatimpaguesit në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse brenda dy (2) ditëve të punës, kur janë plotësuar të gjitha kërkesat sa më sipër, regjistron përfaqësuesin tatimor dhe e pajis atë me certifikatën e regjistrimit të përfaqësuesit tatimor, ku tregohet emri dhe numri i identifikimit të përfaqësuesit tatimor dhe të dhëna të tjera që përmban kjo certifikatë, e cila për nga përmbajtja është e njëjtë me certifikatën e NIPT-it.

9.1.4 Çdo person, i cili është regjistruar si përfaqësues tatimor, për çdo ndryshim të kryer apo që do të kryejë, që ka të bëjë me ndryshimin e informacionit fillestar të dhënë nga përfaqësuesi tatimor në momentin e aplikimit për regjistrim ose ndryshim të mëpasshëm, apo çdo ngjarje tjetër që ka të nevojshme ndryshimin e regjistrimit fillestar apo ndryshimeve të mëpasshme, brenda 5 ditëve do të njoftojë me shkrim dhe do të paraqitet për ndryshimin përkatës në drejtorinë e regjistrimit dhe shërbimit të tatimpaguesit në drejtorinë rajonale tatimore. Ky ndryshim evidentohet me formularin “Njoftim i ndryshimeve në regjistrim”. Si çdo tatimpagues tjetër ndryshimet shoqërohen ose jo me lëshimin e një certifikatë të re tatimore, duke ruajtur të njëjtin numër të identifikimit të përfaqësuesit tatimor.

9.1.5 Detyrime të tjera të përfaqësuesit tatimor

Përfaqësuesi tatimor detyrohet të paguajë dhe është përgjegjës për të gjitha detyrimet apo borxhet tatimore për të cilat personi jorezident që e ka emëruar detyrohet dhe që lidhen me përmbushjen e detyrimeve për personin që përfaqëson në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe i nënshtrohet çdo procedure dhe afati ligjor të parashikuar nga ky ligj si për dokumentimin, deklarimet për të cilat përfaqësuesi detyrohet, vlerësimet tatimore, kontrollet tatimore, mbledhjen e detyrimeve tatimore, ankimin etj. Detyrimi i përfaqësuesit tatimor mund të ekzistojë edhe pse ka pushuar të jetë përfaqësues tatimor.

Edhe pse personi që caktohet si përfaqësues tatimor është person i regjistruar dhe ka një numër identifikimi dhe certifikatë regjistrimi të TVSH-së, ai duhet të regjistrohet veçmas për çdo përfaqësues tatimor që është caktuar dhe të marrë një numër të ri identifikimi për TVSH-në, në emër të personit për të cilin ai vepron, i cili nuk është themeluar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kur përfaqësuesi tatimor pushon aktivitetin e tij të përfaqësimit, sikurse është parashikuar edhe në marrëveshjen e përfaqësimit, pasi ka përmbushur detyrimet tatimore, ai duhet të njoftojë me shkrim drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar, së nuk do të veprojë si përfaqësues tatimor. Njoftimi duhet të bëhet të paktën 15 ditë para së ai të pushojë të veprojë si përfaqësues tatimor. Përfaqësuesi tatimor duhet që në të njëjtën kohë të njoftojë edhe personin, i cili e ka caktuar si përfaqësues tatimor.

Përfaqësuesi tatimor nuk çlirohet nga përgjegjësia e tij personale për shkak të pushimit së vepruari si përfaqësues tatimor i personit jorezident. Ai është personalisht përgjegjës dhe duhet të paguajë të gjitha detyrimet tatimore që lindin si rezultat i deklarimeve, vlerësimeve ose kontrolleve tatimore, për periudhat tatimore gjatë së cilës ai ka vepruar si përfaqësues tatimor.

Drejtoria rajonale tatimore, pas paraqitjes së kërkesës për çregjistrim të përfaqësuesit tatimor, menjëherë, pavarësisht procedurave të brendshme të parashikuara për ushtrimin e kontrollit për subjekte të tjera, menjëherë brenda 10 ditëve verifikon situatën tatimore të përfaqësuesit dhe kur e gjykon të arsyeshme dhe në përputhje me procedurat sipas këtij ligji, planifikon për verifikim apo kontroll tatimor përfaqësuesin tatimor.

Në përputhje me nenin 45 pika 1/c të ligjit, procedura për çregjistrimin e përfaqësuesit tatimor përfundon nga drejtoria rajonale tatimore përkatëse brenda 30 ditëve pune.

9.2 Në qoftë se të gjithë të ardhurat me burim në Shqipëri janë objekt i mbajtjes përfundimtare të tatimit në burim, tatimpaguesi jorezident mund të mos emërojë përfaqësues tatimor. Në rastin e individit jorezident, ai mund të mos emërojë gjithashtu përfaqësues tatimor, edhe në qoftë se arrin që të dorëzojë vetë deklaratat tatimore, të cilat, sipas ligjeve të veçanta tatimore, është i detyruar t'i paraqesë në administratën tatimore.

10. Udhëzimet teknike

10.1 Në bazë të nenit 10, paragrafi 1 i ligjit, Ministri i Financave nxjerr këtë udhëzim të përgjithshëm i cili përfshin çdo dispozitë specifike të përcaktuar nga dispozita të tjera të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur ato rregullohen me dispozita të posaçme.

10.2.1 Në zbatim të nenit 10 të ligjit, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, ka të drejtën që, kur e sheh të nevojshme ose me kërkesën e personave të tatueshëm ose të strukturave të administratës tatimore, të nxjerrë vendime që shprehin qëndrimin zyrtar të administratës tatimore, në zbatim të legjislacionit tatimor, për rrethana specifike të tatimpaguesit. Vendimi ka efekt detyrues për administratën tatimore, dhe personin e tatueshëm që ka bërë kërkesën dhe publikohet në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve brenda 5 ditëve kalendarike nga dalja e tij. Vendimi bëhet detyrues për tatimpaguesin në datën kur ai merr njoftim për të. Vendimet e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve proceduralisht nxirren në përputhje me "Kodin e Procedurës Administrative" dhe publikimi i tyre bëhet në formë të tillë që të mos identifikohen tatimpagues të veçantë, por të jetë shprehur qartë rasti/ngjarja për të cilën është nxjerrë vendimi teknik. Vendimi zbatohet njëlloj nga strukturat e administratës tatimore qendrore, për raste të tjera të ngjashme.

10.2.2 Udhëzimet teknike të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të konsiderohen për t'u përfshirë në të ardhmen në udhëzimin e përgjithshëm në zbatim të këtij ligji, në udhëzimet specifike në zbatim të ligjeve të veçanta tatimore apo në manualet porcedurale tatimore.

10.2.3 Vendimet teknike sipas përcaktimeve në pikën 10.2.1, mund të hartohen dhe t'i propozohen drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nga çdo drejtori pjesë përbërëse e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas funksioneve, detyrave dhe përgjegjësive që ka për administrimin tatimor, në përputhje me procedurat që ndjek bazuar në trajtimin e rasteve specifike të ndeshura gjatë punës, ose të paraqitura prej tatimpaguesve, ose prej strukturave të administratës tatimore në varësi, sipas natyrës së çështjeve, të tilla si: procedura të regjistrimit, çregjistrimit, shërbimit të tatimpaguesit, vlerësimit dhe kontrollit, analizës së riskut, mbledhjes së borxhit, rimbursimit, çështjet që kanë të bëjnë me plotësimin e deklaratave, deklarimin apo sistemin tatimor, marrëveshjet tatimore, pagesat e tatimeve, dokumentimin, çështje teknike tatimore etj.

Në fund të muajit korrik dhe dhjetor të çdo viti, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përgatit komentarë përmbledhës të vendimeve teknike, në lidhje me mënyrën e trajtimit tatimor të rasteve specifike, duke i grupuar ato sipas natyrës së tyre. Këta komentarë përmbledhës publikohen në faqen zyrtare të DPT-së brenda muajit pasardhës, në një rubrikë të posaçme për këtë qëllim.

11. Negocimi, nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

11.1 Negocimi i marrëveshjeve ndërkombëtare tatimore dhe nënshkrimi i tyre bëhet nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për lidhjen e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare".

11.2 Zbatimi i dispozitave tatimore të marrëveshjeve apo konventave dypalëshe dhe shumëpalëshe, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (shkurt "DPT") dhe jo nga degët rajonale të tatimeve. Kërkesat e tatimpaguesve për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare drejtohen në DPT. Në rastet kur tatimpaguesit paraqiten në drejtoritë rajonale të tatimeve dhe kërkojnë përjashtime, lehtësira fiskale, vërtetime rezidence apo dokumentacione dhe udhëzime që lidhen me zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të përfunduara nga vendi ynë, ato [kërkesat] duhet t'i kalohen për shqyrtim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ky rregull do të zbatohet edhe për marrëveshjet dypalëshe për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal, të përfunduara nga vendi ynë, si dhe për dispozitat tatimore që mund të përmbajnë marrëveshje të tjera, të tilla si marrëveshjet për transportin ndërkombëtar, marrëveshjet e ndihmave, marrëveshjet e kredive, marrëveshjet koncensionare, marrëveshjet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, etj.

11.3 Drejtoritë rajonale të tatimeve veprojnë drejtpërdrejt sipas dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare vetëm kur dispozitat ligjore e nënligjore tatimore e parashikojnë një gjë të tillë ose në rastet kur marrin përgjigje apo udhëzime zyrtare me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

11.4 Për sa i përket aplikimit të dispozitave të marrëveshjeve dypalëshe për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe shmangien e evazionit tatimor, tatimpaguesit dhe drejtoritë rajonale tatimore ndjekin procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim dhe/ose procedurat e përcaktuara në udhëzimin e posaçëm për zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Në çdo rast kur drejtoritë rajonale tatimore nëpërmjet kontrolleve në kompetencën e tyre, kryejnë verifikimin në vend të çështjeve mbi zbatimin e marrëveshjeve tatimore për eliminimin e tatimit të dyfishtë, kanë të drejtë që përveç së të kryejnë vlerësim tatimor nëse konstatojnë shkelje të dispozitave të këtyre marrëveshjeve, kur e gjykojnë kërkojnë qëndrimin e strukturës përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ose i kërkojnë kësaj strukture edhe shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve kompetente të shteteve palë në marrëveshje

KREU II
PARIMET, ORGANIZIMI DHE PERSONELI I ADMINISTRATËS TATIMORE

12. Parimet e administrimit tatimor

Në administrimin e sistemit tatimor të Republikës së Shqipërisë administrata tatimore qendrore dhe vendore udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

a) Zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore, që do të thotë që legjislacioni tatimor, dispozitat nënligjore, përfshirë udhëzimet teknike dhe manualet tatimore, zbatohen në mënyrë uniforme dhe të logjikshme për çdo tatimpagues në rrethana të njëjta dhe të ngjashme;

b) Nxitja e vetëvlerësimit dhe vetëdeklarimit të detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesit, që nënkupton të drejtën e tatimpaguesit për llogaritur dhe përmbushur në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi detyrimet e tyre tatimore;

c) nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore, që nënkupton detyrimin e administratës tatimore për të informuar tatimpaguesit, agjentët tatimorë dhe përfaqësuesit tatimorë me të gjitha mjetet dhe mënyrat që disponon, përfshirë publikimet elektronike, në median e shkruar dhe audio vizive, publikimin në Fletoren Zyrtare, botimin e fletëpalosjeve etj.

ç) Hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe planeve operacionale për të garantuar zbatimin e legjislacionit tatimor dhe luftimin e shmangieve tatimore dhe të evazionit tatimor;

d) Bashkëpunimi me organet tatimore vendase dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit në funksion të zbatimit të legjislacionit tatimor dhe parandalimit dhe luftimit të shmangieve tatimore dhe evazionit tatimor;

dh) Ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, si dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e efiçencës dhe të efektivitetit të duhur;

e) Nxitja e shërbimeve elektronike tatimore, sidomos të deklarimit dhe pagesës elektronike të detyrimit tatimor;

f) Rekrutimi, trajnimi dhe ngritja në detyrë e punonjësve tatimore, të ndershëm, të sjellshëm dhe të drejtë dhe që, për çdo rast, zbatojnë ligjin, aktet nënligjore dhe vendimet, në bazë të fakteve objektive.

13. Organizimi i administratës tatimore

13.1 Administrata tatimore përbëhet nga:

a) administrata tatimore qendrore, ku përfshihen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të saj;

b) administrata tatimore vendore, ku përfshihen zyrat tatimore, nën autoritetin e qeverisjes vendore.

13.2 Administrata tatimore qendrore është institucion qendror, në varësi të Ministrit të Financave.

14. Administrimi tatimor

14.1 Në zbatim të pikës 1 të nenit 14 të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bashkë me drejtoritë rajonale të saj, është autoriteti i vetëm tatimor qendror në Republikën e Shqipërisë. Si e tillë, ajo është i vetmi autoritet që pranon deklaratat tatimore për tatimet dhe taksat kombëtare, përfshirë deklaratat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vlerëson detyrimet tatimore, kontrollon saktësinë e deklarimit dhe, mbi këtë bazë, përcakton detyrimet tatimore shtesë të një tatimpaguesi dhe rimbursimin apo kthimin e tatimeve të paguara tepër, nëse ka të tilla. Asnjë organ tjetër, përfshirë këtu Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe strukturat e tjera të auditimit të jashtëm, nuk ka të drejtë të kontrollojë, të përcaktojë apo ndryshojë shumën e detyrimeve tatimore të tatimpaguesve të veçantë.

14.2 Përgjegjësitë dhe funksionet kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë:

1. Të përgatisë dhe të miratojë planin strategjik të objektivave dhe synimeve kryesore të

administratës tatimore për një periudhe afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe të monitorojë zbatimin rigoroz të tij nga të gjitha drejtoritë e DPT-së dhe nga të gjitha drejtoritë rajonale të tatimeve.

2. Të evidentojë, në bazë të eksperiencës së zbatimit praktik të kuadrit ligjor dhe nënligjor tatimor në fuqi, nevojat për ndryshime dhe të paraqesë propozimet përkatëse në Ministrinë e Financave lidhur me ndryshimet në ligjet tatimore dhe në aktet nënligjore në zbatim të tyre.

3. Të përgatisë dhe miratojë procedura standarde pune operative. Në këtë drejtim, DPT sigurohet së këto procedura promovojnë transparencën e duhur në marrëdhëniet e administratës tatimore me tatimpaguesit, krijojnë sisteme të kontrollit të brendshëm që minimizojnë rrezikun e korrupsionit, sigurojnë trajtim të paanshëm për të gjithë tatimpaguesit, reduktojnë subjektivitetin e punonjësve tatimore dhe krijojnë raste të dokumentuara, duke bërë të mundur kontrollin e tyre dhe mbajtjen e përgjegjësisë për të gjitha veprimet e kryera.

4. Të ofrojë asistencë për të siguruar zbatimin korrekt të ligjeve tatimore, akteve nënligjore dhe manualeve në drejtoritë rajonale të tatimeve.

5. Të përcaktojë, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil, masa uniforme për matjen e performancës së punonjësve të administratës tatimore dhe të krijojë raporte standarde për të kontrolluar vlerësimin e performancës në nivel kombëtar, si dhe për çdo drejtori rajonale të tatimeve.

6. Të sigurojë shpërndarje të drejtë të burimeve në çdo drejtori rajonale të tatimeve.

7. Të bashkëpunojë me të gjitha drejtoritë rajonale të tatimeve për të përgatitur plane vjetore pune, bazuar në numrin e personelit që është përcaktuar për çdo drejtori dhe në objektivat funksionalë të performancës për çdo drejtori rajonale të tatimeve. Këto objektiva përcaktohen bazuar në përmirësimin e produktivitetit. Ato duhet të jenë një kombinim i sasisë së punës së kryer (pra, i të ardhurave të gjeneruara) dhe i cilësisë së proceseve të kryera të punës.

8. Të hartojë dhe zbatojë një program vjetor të vizitave në çdo drejtori rajonale të tatimeve për të ofruar asistencë dhe për të kryer vlerësime, lidhur me efikasitetin dhe cilësinë e punës së bërë. Këto vlerësime, përveç arritjeve dhe synimeve numerike, përfshijnë edhe efektivitetin e punës së drejtuesve, lidhur me kualifikimin e punonjësve dhe me kryerjen e detyrave sipas procedurave të përcaktuara. Raportet e vlerësimit të punës përcaktojnë edhe veprimet që duhen ndërmarrë për të korrigjuar mangësitë duke përcaktuar gjithashtu dhe afatet e përshtatshme për realizim.

9. Të përgatisë raporte të vlerësimit të punës për secilën drejtori rajonale të tatimeve. Një kopje e këtij raporti i jepet drejtorit të Drejtorisë rajonale të vlerësuar.

10. Të miratojë planin vjetor të punës dhe planin e të ardhurave tatimore për çdo drejtori rajonale të tatimeve.

11. Të përcaktojë planin e buxhetit të çdo drejtorie rajonale të tatimeve dhe të kontrollojë zbatimin e tij.

12. Të përgatisë marrëveshje të përbashkëta për të koordinuar punën me shoqatat e biznesit dhe me autoritete të tjera shtetërore, të tilla si Doganat, Thesari, Inspektorati i Lartë i Punës, njësitë e qeverisjes vendore, etj., në mënyrë që të krijojë mundësitë e duhura për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit në interes të administrimit tatimor.

13. Të koordinojë marrëdhëniet ndërkombëtare për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni me administratat tatimore të shteteve të tjera.

14. Të zbatojë një politikë rekrutimi të punonjësve për administratën tatimore qendrore në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil dhe në përputhje me strukturat e miratuara.

15. Të përgatisë, të miratojë dhe të kontrollojë zbatimin e Kodit të Etikës për punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me rregullat e etikës së administratës publike.

16. Njësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në asnjë rast, nuk lejohet të kontrollojnë direkt tatimpaguesit.

17. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton rregulloren e brendshme të institucionit, e cila detajon rastet e shkeljeve disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14.3 Përgjegjësitë dhe funksionet kryesore të drejtorive rajonale të tatimeve janë:

1. Sigurohen që të gjithë veprimet që ato ndërmarrin në aktivitetin e tyre janë në përputhje dhe çojnë në zbatimin rigoroz të planit strategjik të administratës tatimore.

2. Gjenerojnë shumën e të ardhurave tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, me koston me të ulet të mundshme, nëpërmjet nxitjes së vetëvlerësimit e plotësimit vullnetar të detyrimeve nga tatimpaguesit dhe nëpërmjet kontrolleve të paanshme për të gjithë tatimpaguesit, për të zbuluar dhe korrigjuar rastet e moszbatimit të ligjeve tatimore.

3. Bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të punësuar personel cilësor, me integritet moral, me trajnim dhe kualifikim të përshtatshëm tatimor, me njohuritë e nevojshme mbi procedurat funksionale dhe aftësitë e duhura personale për të nxitur sjellje pozitive nga tatimpaguesit.

4. Përgatisin, në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse në DPT, planin operacional në përputhje me objektivat e vendosura në planin strategjik të DPT.

5. Përcaktojnë objektiva vjetorë me shkrim për çdo funksion dhe punonjës.

6. Bashkëpunojnë me strukturat përkatëse në DPT për trajnimin e punonjësve.

7. Hartojnë dhe zbatojnë programe për të gjithë drejtuesit, në mënyrë që këta të fundit të përgatisin raporte me shkrim për vlerësimin e punës së kryer gjatë vitit nga punonjësit nën varësinë e tyre.

8. Ndjekin të gjitha procedurat standarde të punës, të përcaktuara nga drejtoritë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

9. Japin sugjerime dhe të bëjnë propozime në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve lidhur me mënyrën sesi mund të përmirësohen procedurat standarde të punës.

14.4 Përgjegjësitë dhe funksionet e administratës tatimore

Përgjegjësitë dhe funksionet e drejtorive dhe sektorëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në drejtoritë rajonale tatimore përcaktohen në rregulloren e brendshme të DPT-së.

15. Zyrat tatimore të qeverisjes vendore

15. Zyrat tatimore të qeverisjes vendore funksionojnë dhe zbatojnë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" dhe administrojnë taksat, detyrimet tatimore dhe pagesat publike vendore me përjashtim të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore vlerëson, mbledh, kontrollon dhe arkëton tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

16. Struktura e administratës tatimore qendrore

16.1. Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës tatimore qendrore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, pas bashkërendimit me Drejtorinë a Administratës Publike, pranë Ministrisë së Brendshme (DAP).

16.2. Organigrama e detajuar e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe e drejtorive rajonale tatimore miratohet nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Organigrama i paraqitet ministrit të Financave për miratim nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, e shoqëruar me rregulloren e brendshme të Administratës Tatimore Qendrore. Në rastet kur propozohen ndryshime në strukturën organizative të administratës tatimore qendrore përveç rregullores, struktura organizative duhet të shoqërohet me një analizë të detajuar të çdo ndryshimi të propozuar.

16.3. Administrata tatimore qendrore është e organizuar në drejtori dhe njësi të tjera sipas funksioneve të mëposhtme:

a) funksionet bazë dhe operacionale, ku bëjnë pjesë: i) shërbimi, regjistrimi dhe edukimi i tatimpaguesit; ii) menaxhimi i riskut, rimbursimi i tatimeve, kontrolli tatimor; iii) mbledhja e detyrimeve tatimore/zbatimi i masave shtrënguese; iv) hetimi tatimor; v) investigimi i brendshëm antikorrupsion, auditi i brendshëm.

b) funksionet mbështetëse, ku bëjnë pjesë: financa, statistikat dhe analiza, teknologjia e informacionit, shërbimi ligjor e teknik, shërbimet administrative, burimet njerëzore dhe marrëdhëniet institucionale.

16.4 Shfuqizuar.

16.5. Funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të drejtorive të saj, drejtorive rajonale përcaktohen me rregullore të brendshme, e cila propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe miratohet nga Ministri i Financave.

16.6 Ministri i Financave mund të vendosë që, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të nënkontraktohen subjekte private, të specializuara, për realizimin e funksioneve të parashikuara në nenin 16 të ligjit.

17. Marrëdhënia e punës për Drejtorin e Përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorët e përgjithshëm të tatimeve

17.1 Organ drejtues i administratës tatimore qendrore është drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

17.2 Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Financave.

17.3 Zëvendësdrejtorët e përgjithshëm të tatimeve janë nëpunës civilë dhe emërohen e lirohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil, sipas propozimit të ministrit të Financave.

18. Struktura e apelimit tatimor

18.1 Drejtoria e Apelimit Tatimor që nga 1 janari 2017 bëhet pjesë përbërëse e strukturës organike të Ministrisë së Financave. Drejtoria e Apelimit Tatimor administron ankimet administrative tatimore për vlera deri në një shumë të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Ajo shqyrton dhe merr vendim për ankimet nëpërmjet gjykimit dhe vendimmarrjes së pavarur, bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi. Vendimet e Drejtorisë së Apelimit Tatimor nënshkruhen nga drejtori i Drejtorisë së Apelimit Tatimor, i cili emërohet dhe lirohet sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.

18.2 Në Ministrinë e Financave, për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e apelimeve tatimore, për vlera mbi shumën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, prej 20 milionë lekë dhe sipas procedurave të përcaktuara me VKM për këtë qëllim, ngrihet Komisioni për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor.

18.3 Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe Komisioni për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor (KSHAT), për shqyrtimin dhe vendimmarrjen për ankimin administrativ tatimor i nënshtrohen dispozitave për këtë qëllim të parashikuara në ligj, këtë udhëzim dhe vendimin e Këshillit të Ministrave.

19. Marrëdhënia e punës për personelin e administratës tatimore qendrore

19.1 Marrëdhënia e punës për nëpunësit e administratës tatimore qendrore rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.

19.2 Për çdo punonjës tjetër, marrëdhëniet e punës të të cilit nuk i nënshtrohen legjislacionit për nëpunësin civil, këto marrëdhënie rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

20. Punësimi dhe kategoritë e punësimit

20.1 Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve merr masat për respektimin e dispozitave ligjore për procedurat e punësimit e të rekrutimit të personelit të administratës tatimore qendrore, sipas pikës 2, të nenit 19, të këtij ligji, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet në përputhje me Kodin e Punës.

20.2 Në organikë personeli ndahet sipas detyrave në punonjës të nivelit të lartë, të mesëm, të ulët drejtues dhe në punonjës ekzekutues në përputhje me strukturën organizative me qëllim realizimin e funksioneve sipas nenit 16 të ligjit dhe këtij udhëzimi. Për nëpunësit civil, procedurat e punësimit, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë të tyre kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit për nëpunësin civil.

20.3. Nivelet e pagave për çdo kategori miratohen sipas legjislacionit të fushës në fuqi.

21. Shpërblimet e personelit

21.1 Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i lihet deri në 2 për qind të të ardhurave

tatimore të mbledhura, për t'u përdorur për investime për përmirësimin dhe për modernizimin e infrastrukturës së mbledhjes së të ardhurave dhe për shpërblime stimuluese, të personelit të administratës tatimore.

21.2 Personelit të administratës tatimore i jepen shpërblime stimuluese, për:

a) efektivitetin e shërbimit të kryer në organet tatimore;

b) kryerjen e një shërbimi me rrezikshmëri të veçantë.

22. Procedura disiplinore

22.1 Procedurat për shkeljet dhe masat disiplinore të nëpunësve të administratës tatimore qendrore që janë nëpunës civilë, bëhen në përputhje me ligjin për nëpunësin civil. Për ushtrimin e këtij funksioni në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ngrihet një Komision Disiplinor në përbërje të të cilit janë 4 anëtarë nga administrata tatimore dhe një anëtar nga Departamenti i Administratës Publike. Funksionet, kompetencat dhe procedura e funksionimit të këtij Komisioni janë në përputhje me dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil.

22.2 Për punonjësit e administratës tatimore qendrore, për të cilët zbatohen dispozitat e Kodit të Punës, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton një rregullore të brendshme të institucionit, në të cilën detajohen rastet e shkeljeve disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

22.3Masat disiplinore, që zbatohen për nëpunësit civil të administratës tatimore, duhet të jenë në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil, përveç masave disiplinore që merren ndaj punonjësve që nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, të cilat duhet të jenë në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit dhe dispozitat e Kodit të Punës

KREU III
DISPOZITA të PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

23. Komunikimi me personat e tatueshëm

23.1 Në zbatim të pikës 1 të nenit 23 të Ligjit, për të komunikuar me administratën tatimore lidhur me përmbushjen e detyrimeve tatimore, tatimpaguesit do të përdorin formularët e përcaktuar në udhëzimet e Ministrit të Financave në zbatim të ligjeve të veçanta tatimore. Në këto udhëzime përcaktohen gjithashtu edhe të dhënat që do të përmbajnë këta formularë, afatet e plotësimit dhe mënyrat e paraqitjes së tyre në administratën tatimore.

23.2 Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesve, u dërgohen atyre në adresën e deklaruar nga vetë ato. Këto njoftime u dërgohen tatimpaguesve në rrugë elektronike, në rastin kur ai ka dhënë pëlqimin për pranimin e komunikimit në rrugë elektronike dhe është regjistruar si përdorues i shërbimit të sistemit të komunikimit elektronik tatimor, dhe nëpërmjet shërbimit postar rekomande. Pavarësisht komunikimit elektronik, aktet administrative tatimore të cilat njoftojnë tatimpaguesin për një vlerësim të kryer, ose vendime të cilat ndikojnë apo ndryshojnë situatën financiare të tatimpaguesit, pasi nënshkruhen, i dërgohen tatimpaguesit edhe në formë të shkruar.

23.3 Akti apo çdo korrespondencë tjetër zyrtare e administratës tatimore, mund të merret edhe dorazi nga tatimpaguesi, nëse ky i fundit e dëshiron një gjë të tillë. Në këtë rast, data e marrjes së aktit konsiderohet data kur akti i dorëzohet tatimpaguesit dhe konfirmohet nga ky i fundit. Nga ana tjetër, në raste të veçanta, administrata tatimore mund të dërgojë dorazi tek tatimpaguesi çdo akt apo korrespondence tjetër zyrtare. Edhe në këtë rast, data e marrjes së aktit konsiderohet data kur akti i dorëzohet tatimpaguesit dhe konfirmohet nga ky i fundit. Në rastin e dorëzimit të akteve apo çdo korrespondence tjetër dorazi, kur tatimpaguesi refuzon marrjen në dorëzim të tyre, datë e marrjes së aktit, konsiderohet data kur tatimpaguesi ka refuzuar marrjen në dorëzim të aktit.

23.3.1 Një komunikim zyrtar me shkrim, i nisur nga administrata tatimore, nëpërmjet shërbimit postar rekomande, në adresën e tatimpaguesit, por i pambërritur ose i mbërritur me vonesë tek ky i fundit, për çfarëdo arsye, është nën përgjegjësinë e vetë tatimpaguesit. Data e

marrjes dijeni nga tatimpaguesi, për çdo akt dhe korrespondencë tjetër të nisur nga administrata tatimore, konsiderohet dita e dhjetë pas datës së dërgimit të aktit apo korrespondencës. Data e dërgimit është data e pranimit të aktit apo korrespondencës në shërbimin postar. Kështu, në qoftë së një akt i nxjerrë nga ana e administratës tatimore, apo një korrespondencë tjetër çfarëdo, është pranuar në shërbimin postar më datë 1 të muajit, ai konsiderohet së është marrë, dhe i është bërë i ditur tatimpaguesit me datë 11 të muajit.

Për qëllime të përcaktim it të fillimit të afatit për marrjen e akteve tatimore, në llogaritjen e afateve në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative nuk përfshihet dita në të cilën del akti ose dita e pranimit të aktit në shërbimin postar.

Për llogaritjen e afatit edhe për qëllime të ankimit administrativ, llogaritja e afatit fillon nga e nesërmja e ditës kur akti është marrë ose konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi. Në rastin kur akti që ka nxjerrë administrata tatimore mban datën 1 shtator dhe pranohet nga shërbimi postar për t'iu dërguar tatimpaguesit më datë 2 shtator dhe nga ky i fundit provohet së është marrë më datë 7 shtator, llogaritja e afatit fillon nga data 8 shtator ose në rastet kur akti konsiderohet të jetë marrë në ditën e dhjetë pas datës së dërgimit të tij, atëherë afati fillon në datën 13 shtator.

23.3.2 Tatimpaguesi, është i detyruar t'i njoftojë administratës tatimore në rrugë elektronike, apo nëpërmjet dërgimit të një shkrese këtij organi, çdo adresë ku ai ushtron veprimtarinë, si dhe adresën e selisë së tij, ku kjo e fundit konsiderohet si adresë e vlefshme për të bërë komunikimet zyrtare të administratës tatimore me tatimpaguesin. Tatimpaguesi është i detyruar gjithashtu t'i njoftojë administratës tatimore, në momentin kur ai regjistrohet si përdorues i sistemit elektronik tatimor të shërbimit, edhe çdo adresë të postës së tij elektronike, apo të personave përfaqësues të tij, duke specifikuar adresën së ku duhet t'i dërgohen njoftimet apo komunikimet e administratës tatimore. Nëse nga ana e tatimpaguesit nuk është dhënë ndonjë adresë e vlefshme e postës së tij elektronike, njoftimet e administratës tatimore do t'i komunikohen në llogarinë e tatimpaguesit, të hapur nga ana e sistemit elektronik tatimor të shërbimit, në rastin kur tatimpaguesi apo përfaqësuesi i tij, është regjistruar si përdorues këtij shërbimi. Administrata tatimore është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e këtyre të dhënave dhe në asnjë rast nuk mund t'ua japë ato personave të tretë, pa një autorizim me shkrim nga tatimpaguesi. Përjashtohet nga ruajta e konfidencialitetit të të dhënave, kur detyrimi, për t'ua dhënë të tretëve këto të dhëna, është i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

23.3.3 Komunikimi i vlerësimeve, njoftimeve, vendimeve dhe çdo akti tjetër zyrtar, nga ana e administratës tatimore, bëhet me postë elektronike ose në rrugë elektronike, nëpërmjet dërgimit të tyre në llogarinë e tatimpaguesit të hapur në sistemin elektronik të shërbimit tatimor, ose nëpërmjet dërgimit në adresën e postës elektronike (e-mail) të tatimpaguesit, kur një adresë e tillë i është njoftuar nga vetë tatimpaguesi administratës tatimore, sipas udhëzimit për pëlqimin e formës elektronike. Në zbatim të nenit 23, pika 3, të ligjit, rregulla të hollësishme për përdorimin e sistemit elektronik tatimor përcaktohen me udhëzimin e ministrit të Financave "Për kushtet dhe kriteret e përdorimit të sistemit elektronik tatimor të shërbimit".

23.3.4 Administrata tatimore pranon, pa asnjë kufizim, të gjitha veprimet e dërguara apo të transmetuara, nëpërmjet komunikimit elektronik të tatimpaguesit me administratën tatimore, duke i konsideruar këto komunikime me të njëjtën vlefshmëri, sikurse komunikimet të ishin kryer me metodat tradicionale të dorëzimit të tyre në mënyrë personale tek administrata tatimore, apo nëpërmjet shërbimit postar. Tatimpaguesi, i regjistruar si përdorues i sistemit elektronik tatimor të shërbimit, është i detyruar të pranojë pa asnjë kufizim, çdo vlerësim tatimor, aktet e kontrollit tatimor, duke përfshirë projekt-raporte kontrolli, raporte përfundimtare të kontrollit etj., vendimet e nxjerra nga Drejtoria e Apelimit dhe çdo dokument tjetër, apo çdo akt administrativ të nxjerrë nga administrata tatimore kundrejt tatimpaguesit, të cilat i komunikohen në rrugë elektronike. Komunikimi i akteve apo dokumenteve sa më sipër do të konsiderohen me të njëjtën vlerë, sikurse ato t'i ishin komunikuar tatimpaguesit me metodat tradicionale të dorëzimit në mënyrë personale, ose nëpërmjet shërbimit postar.

23.3.6 Konsiderohet si moment i dërgimit të dokumentit elektronik, koha kur dokumenti elektronik del nga sistemi kompjuterik i dërguesit. Konsiderohet si moment i marrjes së dokumentit elektronik, koha kur dokumenti elektronik hyn në sistemin kompjuterik të marrësit dhe/ose në sistemin kompjuterik të personit të autorizuar prej tij, që është ose jo nën kontrollin e marrësit, apo nën kontrollin e një personi të autorizuar prej tij, dhe që është dërguar në llogarinë e tatimpaguesit apo në postën elektronike të tij (e-mail).

23.3.7 Konfirmimi i marrjes së dokumentit në rrugë elektronike nga ana e administratës tatimore dhe tatimpaguesit, do të konsiderohet momenti, kur pasi dokumenti është dërguar në sistemin elektronik tatimor të shërbimit, apo pasi veprimi është dërguar në llogarinë e tatimpaguesit të hapur në këtë shërbim, apo të postës elektronike të tij, ai është konfirmuar si i marrë nëpërmjet konfirmimit automatik të marrjes nga sistemi kompjuterik, por në çdo rast si afat i vlefshëm, për të konsideruar si të marrë dokumentin, do të jetë dita e 10-të nga data e dërgimit të dokumentit. Në rast së veprimi është dërguar nga ana e administratës tatimore në orën 12:00 të datës 1 të muajit, do të konsiderohet së është marrë nga tatimpaguesi në orën 12:00 të datës 11 të po atij muaji. Si kohë e vlefshme, do të merret data dhe ora e sistemit elektronik tatimor sipas standardit të matjes së orës zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

23.4 Tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë të dhëna të plota identifikuese, përfshirë adresën, numrin e telefonit dhe faksit dhe adresën elektronike (nëse ka), në mënyrë që të sigurojë marrjen në kohe të njoftimeve.

23.5 Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, miraton llojet, formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit tatimor.

24. Dhënia e informacionit tatimor

24.1 Në zbatim të nenit 24 të ligjit, administrata tatimore është e detyruar t'i përgjigjet pa pagese çdo kërkese me shkrim të autoriteteve zyrtare shqiptare ose të huaja të përmendura në atë nen. në zbatim të shkronjë "c" të këtij nenit të Ligjit, administrata tatimore, në bazë të kërkesës me shkrim, është e detyruar t'i japë informacione edhe Kontrollit të Lartë të Shtetit vetëm për rastet kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga këto institucion ndaj administratës tatimore dhe të përgatitjes së rekomandimeve që ato do të bëjnë për të. Informacioni që i këtyre institucioneve nuk përfshin dokumentacionin e deklaruar apo paraqitur nga tatimpaguesi, dokumentacion i cili ndodhet në dosjen e tij dhe që, sipas nenit 25 të Ligjit, është konfidencial. Këto institucione nuk kanë të drejtë të vendosin, ndryshojnë apo heqin detyrime tatimore ndaj tatimpaguesve. Në zbatim të pikës 1 të nenit 14 të Ligjit, administrata tatimore është autoriteti i vetëm tatimor në Republikën e Shqipërisë.

25. Konfidencialiteti

25.1 në zbatim të nenit 25 të Ligjit, të dhënat tatimore dhe financiare të çdo tatimpaguesi, që disponohen nga administrata tatimore, janë konfidenciale. Çdo punonjës i administratës tatimore që ka akses në këto të dhëna, që është njohur me këto të dhëna gjatë dhe për shkak të kryerjes së detyrave të tij funksionale apo për çfarëdo arsye tjetër, është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e tyre përkundrejt çdo personi të tretë. Të dhëna konfidenciale konsiderohen të gjitha të dhënat me natyre tatimore dhe financiare që kanë të bëjnë me deklarimet e tatimpaguesit, me vlerësimet tatimore që janë bërë për të, me kontrollet tatimore të ushtruara, me informacionet e ardhura apo të marra nga burime të ndryshme, etj. Nuk konsiderohen të dhëna konfidenciale vetëm të dhënat identifikuese të tatimpaguesit dhe të dhënat që kanë të bëjnë me detyrimet e tij tatimore të papaguara, për të cilat kanë filluar procedurat e mbledhjes me forcë.

25. 2 Detyrimi për të ruajtur konfidencialitetin vazhdon edhe pasi punonjësi i administratës tatimore është larguar për çfarëdo arsye nga kjo administrate.

25.3 Informacioni i lidhur me tatimpagues të veçantë përdoret brenda administratës tatimore, vetëm në masën e kërkuar për administrimin e tatimeve, dhe vetëm nga punonjësit që kanë lidhje direkte me vlerësimin apo kontrollin e detyrimeve tatimore të atyre tatimpaguesve. Shkeljet e kësaj dispozite i paraqiten për shqyrtim Komitetit të Disiplinës nga eprori direkt i

punonjësit që ka kryer shkeljen.

25.4 Kushti i ruajtjes së konfidencialitetit përfundon në rastet kur tatimpaguesi heq dorë, me shkrim, nga e drejta e tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për aq sa është e lejuar në deklarimin e bërë nga tatimpaguesi.

25.5 Shkëmbimi i informacionit, i bërë në ekzekutim të marrëveshjeve ndërkombëtare apo brenda vendit të lidhura nga administrata tatimore, bëhet me kushtin e ruajtjes së konfidencialitetit për institucionet dhe individët, që marrin dijeni për të dhënat tatimore, në përputhje me dispozitat përkatëse të atyre marrëveshje dhe dispozitave të këtij udhëzimi dhe udhëzimeve specifike tatimore.

26. Shmangia e konfliktit të interesit

26.1 Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore zbatojnë, në mënyrë të drejtë e të paanshme, ligjet tatimore dhe nuk administrojnë, ndikojnë apo orientojnë tatimpaguesin në veprimtarinë e tij. Inspektorët tatimorë duhet të deklarojnë tek eprori direkt dhe të mos përfshihen në vlerësime tatimore, kontrolle apo investigime tatimore, etj., ndaj tatimpaguesve me të cilët kanë lidhje direkte ose indirekte në kuptim të këtij udhëzimi. Shkeljet e kësaj dispozite i paraqiten për shqyrtim Komitetit të Disiplinës nga eprori direkt i punonjësit që ka kryer shkeljen.

26.2 Nëpunësit e administratës tatimore nuk mund të kontrollojnë apo vlerësojnë tatimet e veta apo të personave të lidhur me ta, me përjashtim të rasteve të vetëvlerësimit të detyrimeve të veta kur një gjë e tillë i kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Deklarimi i rasteve të tilla si dhe dënimet në raste shkeljesh bëhen në përputhje me dispozitat e pikës 26.1. më lart.

26.3 Nëpunësit e administratës tatimore nuk mund të punësohen, me kohë të pjesshme apo të plotë, në veprimtari të tjera me pagesë, me përjashtim të veprimtarisë së mësimdhënies, apo punësimit të pjesshëm apo pjesëmarrjes në grupe pune në institucione shkencore e arsimore publike e jopublike, me qëllim të vetëm kryerjen e studimeve shkencore apo mësimdhënies, duke patur parasysh edhe dispozitat e pikave 26.1 dhe 26.2 më lart.

26.4 Nëpunësi i administratës tatimore qendrore dhe vendore, që gëzon statusin e nëpunësit civil, ndalohet që të ketë zyrë të kontabilitetit apo të konsulencës fiskale në pronësi të tij apo të afërmve të tij, deri në shkallën e dytë, sipas Kodit Civil, dhe personave të lidhur, sipas ligjit për konfliktin e interesave. Kjo situatë përbën konflikt interesi dhe ndaj nëpunësit të administratës tatimore qendrore dhe vendore, që gëzon statusin e nëpunësit civil, merren masat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për shmangien e konfliktit të interesave, si dhe masa e largimit nga puna me pa të drejtë punësimi në administratën tatimore.

27. Publikimi i informacionit tatimor

27.1 Administrata tatimore mund të publikojë informacione të përmbledhura të të ardhurave tatimore, kontrolleve tatimore, etj., gjatë veprimtarisë së saj, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe publikut, dhe përdorimin e të dhënave tatimore në hartimin e statistikave.

27.2 Publikimi bëhet në mënyrë dhe formë të tillë, që nuk lejon identifikimin e tatimpaguesit të veçantë dhe siguron ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të tatimpaguesve të veçantë. Përjashtim nga ky rregull bëjnë rastet e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore dhe rastet e personave që ushtrojnë aktivitete të paligjshme ose që nuk janë regjistruar në organet tatimore, si dhe rastet kur sipas legjislacionit tatimor parashikohet dhe kërkohet publikimi i të dhënave të tatimpaguesit.

28. Informimi i publikut për ndryshimet në legjislacionin tatimor dhe në procedurat tatimore

28.1 Administrata tatimore ka për detyrë që, duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit, përfshirë median e shkruar dhe atë elektronike, të informojë publikun për përmbajtjen, rolin dhe rëndësinë e legjislacionit tatimor. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon materiale sqaruese, komentare dhe materiale të tjera shpjeguese në lidhje me legjislacionin tatimor dhe ndryshimet që mund të bëhen në dispozitat ligjore e nënligjore tatimore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duke ruajtur të dhënat konfidenciale të tatimpaguesit, për qëllime të informimit, publikon në faqen e saj zyrtare të internetit opinionet e nxjerra prej saj, që japin qëndrime për zbatimin e legjislacionit tatimor. Për këtë qëllim krijohet një rubrikë e veçantë e ndryshme nga rubrika e vendimeve teknike, ku pasqyrohen opinionet e administratës tatimore me qëllim informimin e tatimpaguesve. Gjithashtu, në këtë rubrikë (link) mund të pasqyrohen edhe informacione për zbatimin e legjislacionit të formës pyetje–përgjigje.

Shembull - Pyetje:

Unë jam një avokat i ri, që sapo kam marrë licencën për ushtrimin e profesionit të avokatit. Duke filluar që nga muaji janar i vitit 2017 dua të ushtroj profesionin si avokat. Ju lutem mund të më informoni së si duhet të veproj pasi të regjistrohem në QKB, në lidhje me deklarimet që detyrohem pranë administratës tatimore, si dhe për pajisjen time me informacionin e duhur ,si dhe mbi aksesin në llogarinë "Tatimet e mia".

Përgjigje: I nderuar avokat,

Së pari, nëse ju keni zgjedhur të ushtroni profesionin si person fizik, atëherë ju duhet të paraqiteni në QKB për regjistrimin tuaj si profesionit i vetëpunësuar avokat. Nëse ju do të punoni i vetëm, pra nuk do të keni të punësuar të tjerë ose persona të papaguar të familjes, atëherë për qëllime të pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësorë do të zgjidhni të regjistroheni "si i vetëpunësuar i vetëm" në profesionin avokat. Si i vetëpunësuar i vetëm paga minimale e detyrueshme mbi të cilën do të llogarisni dhe paguani sigurimin shoqëror është ..... lekë sipas ligj/VKM nr. ....., datë..... dhe paga e detyrueshme mbi të cilën llogarisni dhe paguani sigurimin shëndetësor është ..... lekë sipas ligj/VKM nr..... ,datë..... (ligji/ VKM-ja duhet të jetë aktive, pra nëse klikohet mbi të hapet neni përkatës i ligjit/VKM-së).

Ndërkohë paraprakisht ju duhet të bëni një parashikim mbi qarkullimin që parashikoni të kryeni gjatë vitit 2017. Ky parashikim është i rëndësishëm, pasi nëse ju parashikoni që të realizoni qarkullim vjetor mbi 8 milionë lekë atëherë do të regjistroheni si subjekt i tatimit mbi fitimin sipas nenit ..... të ligjit..... (ligj/VKM-ja duhet të jetë aktive, pra nëse klikohet mbi të hapet neni përkatës i aktit). Në të kundërt do të regjistroheni si subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

Pavarësisht qarkullimit, në çdo rast ju duhet të regjistroheni si tatimpagues i TVSH-së bazuar në nenin ..... të VKM-së nr....., datë ..... .(VKM-ja duhet të jetë aktive, pra nëse klikohet mbi të hapet neni përkatës i VKM-së). Gjithashtu nëse ju aktivitetin tuaj e ushtroni në një ambient me qira, ambient të cilin e keni marrë nga një person i paregjistruar (individ) atëherë duhet të aktivizoheni edhe për tatimin në burim mbi qiranë sipas ligj/VKM..... (VKM-ja duhet të jetë aktive, pra nëse klikohet mbi të hapet neni përkatës i VKM-së).

Pasi të pajiseni me NUIS/NIPT në QKB, të dhënat tuaja të regjistrimit transferohen automatikisht në sistemin e administratës tatimore. Nëse ju regjistroheni në 5 janar deklarimi juaj i parë për TVSH-në duhet të kryhet brenda datës 14 të muajit pasardhës, ndërsa për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është i detyrueshëm që deklarimi të bëhet një herë në 3 muaj. Nëse keni mundësi mund ta kryeni edhe për çdo muaj. Megjithatë nëse deklarimin për sigurimet do ta bëni 3-mujor, atëherë keni kohë deri më 17 prill (3 ditë përpara datës 20 Prill) të kryeni regjistrimin si i vetëpunësuar në mënyrë elektronike në sistemin tatimor. ……..etj.

28.2 Për qëllime të informimit të publikut, për ligjet e reja tatimore, ndryshimet e bëra në legjislacionin tatimor dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, bëhet publikimi nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj elektronike, si dhe përmes faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, jo më vonë se 15 ditë nga data e publikimit të tyre në Fletoren Zyrtare.

Për çdo ndryshim në legjislacionin tatimor, përfshirë aktet ligjore dhe nënligjore, administrata tatimore, përveç së mban të përditësuar legjislacionin, në faqen e saj zyrtare, për njohje nga tatimpaguesit evidenton dukshëm në mënyrë të përmbledhur ndryshimet përkatëse ligjore dhe nënligjore rast pas rasti. Administrata tatimore publikon dhe mban të përditësuara aktet ligjore dhe nënligjore tatimore edhe në gjuhën angleze. Përveç publikimit të legjislacionit të përditësuar, në faqen zyrtare publikohet edhe çdo akt ligjor dhe nënligjor ndryshues.

28.3 Me qëllim mbajtjen të informuar të tatimpaguesve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet strukturave të saj që ndjekin çështjet tatimore pranë organeve gjyqësore, publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës

Kushtetuese për çështjet tatimore. Publikimi i këtyre buletineve bëhet duke respektuar rregullat për publikimin e informacionit, në mënyrë që tatimpaguesit të jenë të informuar mbi praktikën gjyqësore për çështjet tatimore. Bazuar në këto vendime të gjykatave, kur konstatohen vendime të njëjta për raste të njëjta të unifikuara, duke u bazuar në pjesën arsyetuese të vendimit të gjykatës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve standardizon qëndrimin e saj teknik dhe/ose procedural dhe reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme nga administrata dhe tatimpaguesit.

29. Dosja e detyrimeve tatimore

29.1 Drejtoritë rajonale të tatimeve hapin dosje për çdo person të tatueshëm të regjistruar në juridiksionin e tyre. Dosja e personit të tatueshëm është konfidenciale. Çdo e dhënë apo informacion që lidhet me personin e tatueshëm futet në dosjen e tij. Dosja e personit të tatueshëm duhet të azhurnohet në mënyrë të vazhdueshme.

29.2 Administrata tatimore është e detyruar të vërë në dispozicion të personave të tatueshëm, të dhënat e dosjes së detyrimeve tatimore të tij. Këto të dhëna, kur është e mundur për personin e tatueshëm, bëhen të aksesueshme për të, në rrugë elektronike. Në të kundërt, këto të dhëna i vihen në dispozicion personit të tatueshëm nëpërmjet kopjeve në letër të dokumenteve të dosjes, sipas kërkesës me shkrim të tij.

29.3 Dosja e tatimpaguesit ruhet përgjithmonë. Ato ruhen sipas renditjes alfabetike. Udhëzime me të hollësishme në lidhje me formën, mënyrën dhe afatin e ruajtjes së të dhënave të dosjes përcaktohen me rregullore të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

KREU IV
TE DREJTAT E TATIMPAGUESIT

30. E drejta për informim dhe asistencë

30.1 Tatimpaguesit kanë të drejtë të marrin në kohë të gjithë informacionin e duhur, i cili mundëson njohjen, kuptimin dhe zbatimin në mënyrë korrekte nga ana e tyre të legjislacionit tatimor dhe të detyrimeve të tyre tatimore. Ata kanë të drejtë, gjithashtu, të asistohen pa pagesë, për të njohur të drejtat dhe për të plotësuar detyrimet, për situatat konkrete të tyre. Kjo asistencë i sigurohet atyre në mënyrë të detyrueshme nga administrata tatimore nëpërmjet drejtorive të shërbimeve për tatimpaguesit, të krijuara në çdo drejtori rajonale të tatimeve, si dhe nëpërmjet informimit publik të detyrueshëm, sipas nenit 28 të Ligjit. Informimi publik përfshin detyrimin e administratës tatimore për të vënë në dispozicion të tatimpaguesve, në rrugë elektronike, nëpërmjet medias së shkruar, fletë-palosjeve, publikimeve të ndryshme dhe në mënyra të tjera informimi, legjislacionin tatimor, udhëzimet e dala në zbatim të tij, komentarët, urdhëresat dhe manualet tatimore.

30.2 Administrata tatimore ka detyrimin të trajtojë të gjithë tatimpaguesit në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe me profesionalizëm.

31. E drejta për konfidencialitetin e të dhënave

31.1 Në bazë të nenit 31 të Ligjit administrata tatimore duhet të sigurojë dhe mbroje konfidencialitetin e të dhënave tatimore personale dhe financiare që i janë besuar asaj apo që ajo ka mundur të sigurojë në rrugë të ndryshme. Të dhënat e tatimpaguesve do të përdoren nga administrata tatimore vetëm për qëllime të lejuara nga ligji. Vetëm punonjësit e administratës tatimore që duhet të konsultojnë të dhënat e tatimpaguesit për qëllime të kryerjes së funksioneve të tyre ligjore, do të kenë akses në këto të dhëna. Për të kontrolluar zbatimin në mënyrë korrekte të kësaj të drejtë të tatimpaguesve, drejtoritë rajonale të tatimeve duhet të mbikëqyrin në vazhdimësi proceset e brendshme të punës së tyre.

31.1.1 Në komunikimet elektronike, të cilat dërgohen apo transmetohen nëpërmjet sistemit elektronik tatimor të shërbimit, duhet të ruhet ekuilibri ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve të tatimpaguesve dhe administratës tatimore. Administrata tatimore është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave me natyrë tatimore dhe financiare, vlerësimet

tatimore, që janë kryer, kontrollet e ushtruara, si dhe çdo informacion tjetër të marrë nga vetë tatimpaguesi apo nga burime të tjera. Administrata tatimore nuk konsideron si të dhëna konfidenciale, ato të dhëna që nuk konsiderohen të tilla sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të dhënat, që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat ka filluar mbledhjen me forcë të tyre.

31.2 Në zbatim të pikës 2 të nenit 31 të Ligjit, konsiderohen konfidenciale, të dhënat me natyre tatimore dhe financiare që sigurohen nëpërmjet deklaratave të tatimpaguesve, kontrolleve tatimore të ushtruara, vlerësimeve tatimore të bëra për këto tatimpagues dhe informacioneve të ardhura ose të marra nga persona të tretë apo nga burime të tjera të ndryshme.

32. E drejta për njoftim

32. Tatimpaguesit kanë të drejtë të njoftohen në kohë, për çdo akt administrativ të administratës tatimore të nxjerrë kundrejt tyre dhe që prek pasurinë, apo për detyrimet tatimore të tyre. Ata kanë të drejtë që të njihen me arsyet dhe bazën ligjore të nxjerrjes së aktit administrativ, që i drejtohet tatimpaguesit. Nga ana tjetër, administrata tatimore, bazuar në nenin 69 të ligjit, ka detyrimin të dërgojë në kohë çdo vendim administrativ të nxjerrë prej saj kundrejt tatimpaguesit, si dhe të japë bazën ligjore dhe çdo shpjegim tjetër të duhur, duke e informuar njëkohësisht tatimpaguesin edhe për të drejtat dhe detyrimet, që lidhen me këtë vendim. Ky detyrim nuk respektohet nga administrata tatimore, vetëm kur ajo zotëron prova konkrete dhe të besueshme së tatimi është në rrezik për t'u mbledhur. Njoftimet sa më sipër, i dërgohen tatimpaguesit në adresën e deklaruar nga vetë ai. Këto njoftime i dërgohen tatimpaguesit në rrugë elektronike, në rastin kur tatimpaguesi është regjistruar si përdorues i sistemit elektronik tatimor të shërbimit, ose nëpërmjet shërbimit postar rekomande. Në njoftimet dhe komunikimet me tatimpaguesit, administrata tatimore mban në konsideratë rregullat e përcaktuara në nenin 23 të ligjit, si dhe parashikimet e bëra me udhëzimin e ministrit të Financave për kushtet dhe kriteret e përdorimit të sistemit elektronik tatimor të shërbimit.

33. E drejta për kontrolle të arsyeshme

33. Në rastin e një kontrolli tatimor të administratës tatimore, tatimpaguesi ka të drejtën të njoftohet paraprakisht për kohën kur do të fillojë kontrolli, vendin ku ai do të kryhet, llojet e tatimeve që do të kontrollohen, periudhat tatimore që do të përfshijë kontrolli, etj. Tatimpaguesi ka të drejtë e gjithashtu të presë të trajtohet në mënyrë të sjellshme dhe të respektueshme gjatë të gjithë kohës, përfshirë këtu periudhën kur i kërkohet informacion, kur intervistohet apo kur kontrollohet. Integriteti moral, profesionalizmi, respekti dhe kooperimi janë vlerat kryesore të administratës tatimore që duhet të shohë tatimpaguesi gjatë një kontrolli tatimor. Këto cilësi duhet të manifestohen nga administrata tatimore për të reflektuar përkushtimin e saj për t'i dhënë tatimpaguesve shërbimin më të mirë të mundshëm.

34. E drejta për informim

34.1 Tatimpaguesit kanë të drejtë të presin nga administrata tatimore zbatimin korrekt të ligjit, në mënyrë që çdonjëri prej tyre të marrë të drejtat që i takojnë dhe të paguajë shumën e duhur të detyrimit tatimor. Ata kanë të drejtë të pretendojnë të shikojnë tek administrata tatimore një administratë të besueshme për atë që bën. Tatimpaguesit kanë të drejtë të paraqesin të gjitha pretendimet e tyre në lidhje me një vlerësim tatimor të administratës tatimore. Tatimpaguesit, të cilët nuk janë dakord me një vlerësim tatimor të administratës tatimore, kanë të drejtë të marrin përgjigje me shkrim për pretendimet e tyre, ku jepen të gjitha arsyet e vlerësimit tatimor, mënyra e vlerësimit dhe të drejtat e detyrimet lidhur me këtë vlerësim.

34.2 Me kërkesën me shkrim të tatimpaguesit, administrata tatimore është e detyruar që brenda një afati prej jo më shumë së 5 ditë punë nga data e protokollimit të kërkesës në organin tatimor, të lëshojë vërtetime që konfirmojnë situatën tatimore të tatimpaguesit lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, të ardhurat e tatueshme, detyrimet tatimore të papaguara, etj.

35. E drejta për përfaqësim

35.1 Tatimpaguesi ka të drejtë të emërojë me prokurë, përfaqësuesin e tij. Përfaqësuesi i tatimpaguesit është një person që një tatimpagues e zgjedh për ta përfaqësuar në lidhje me

çështjet tatimore. Përfaqësuesi i tatimpaguesit merr përsipër të drejta dhe detyrime të tatimpaguesit dhe administrata tatimore është e detyruar të bashkëpunojë dhe operojë me përfaqësuesin e tatimpaguesit të caktuar prej tij.

35.2 Emërimi i një përfaqësuesi të tatimpaguesit nuk e shkarkon këtë të fundit nga përgjegjësia tatimore. Ai mbetet ligjërisht përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve tatimore të tij. Fakti që përfaqësuesi i tatimpaguesit mund të bëjë një gabim në deklarimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore, nuk e shkarkon këtë të fundit nga përgjegjësia për gabimin.

36. E drejta për të kërkuar evidenca me shkrim apo në rrugë elektronike

Bazuar në nenin 36 të Ligjit, tatimpaguesi ka të drejtë, në çdo moment, t'i kërkojë administratës tatimore, kopje elektronike apo me shkrim, të njësuar me origjinalin, të çdo dokumenti që ndodhet në dosjen e tij individuale. Përveç kësaj, ai ka të drejtë të kërkojë kopje të printuara të të dhënave elektronike që lidhen me situatën e tij. Kopjet e printuara të të dhënave elektronike, nëse i nevojiten tatimpaguesit, duhet të certifikohen nga ana e administratës tatimore. Administrata tatimore, bazuar në nenin 29 të Ligjit, ka detyrimin krijimin dhe përditësimin e dosjes së detyrimeve tatimore të tatimpaguesit, e cila duhet të jetë e aksesueshme në rrugë eletronike për tatimpaguesin. Në pamundësi të aksesit elektronik në dosjen e tij, tatimpaguesi ka të drejtë t'i kërkojë me shkrim administratës tatimore që t'i vërë në dispozicion kopje të dokumenteve të dosjes.

37. E drejta për t'u dëgjuar

Përpara marrjes së një vendimi ekzekutiv nga ana e administratës tatimore, tatimpaguesi ka të drejtë të presë nga kjo e fundit që të dëgjohet me vëmendje për të dhënë sqarimet e nevojshme, për të parashtruar pretendimet që ka, për të shpjeguar rrethanat konkrete, etj. Ai ka të drejtë gjithashtu të sigurohet se shpjegimet dhe pretendimet e tij do të shqyrtohen me vëmendje e ndershmëri nga administrata tatimore në funksion të marrjes së vendimeve të drejta dhe në konformitet me ligjet tatimore.

38. E drejta për t'u ankimuar

38.1 Në çdo rast kur tatimpaguesi nuk është dakord me një akt administrativ dhe beson së administrata tatimore nuk e ka zbatuar në mënyrë korrekte ligjin, ai ka të drejtën e ankimimit në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, ose në Komisionin e Shqyrtimit të Apelimit Tatimor në Ministrinë e Financave duke kërkuar rishqyrtimin e pavarur administrativ të çështjeve që lidhen me këtë akt. Nëse tatimpaguesi nuk do të jetë i kënaqur edhe nga vendimi i Drejtorisë së Apelimit, ose Komisionit të Shqyrtimit të Apelimit Tatimor, ai ka të drejtë të vazhdoje ankimimin e tij në gjykate.

38.2 Tatimpaguesi ka të drejtë gjithashtu të ankohet në rrugë administrative në Drejtorinë Rajonale apo në DPT për çdo veprim apo mosveprim të zyrtarëve tatimore, që mund të shkelin të drejtat e tatimpaguesit.

KREU V
DETYRIMI I PERSONAVE TË TATUESHËM PËR REGJISTRIM

39. Regjistrimi i individëve

39.1 Sipas ligjeve të veçanta tatimore në fuqi, përgjegjës për të paguar detyrimet tatimore në administratën tatimore, në mënyrë direkte (jo duke iu mbajtur tatimin në burim), në kushte e rrethana të caktuara janë edhe individët. Këtu është fjala për tatimin mbi të ardhurat personale që paguhet për disa lloje të ardhurash, për të cilat nuk mbahet tatim në burim. Individët që sigurojnë këto të ardhura kanë detyrimin për të bërë vetëdeklarimin e tyre. Në këtë rast, këta individë, në mënyrë që të mund të identifikohen për pagesat e kryera, deklarojnë në administratën tatimore numrin e tyre personal të identifikimit, i cili është numri unik i lëshuar nga autoritetet e sigurimeve shoqërore për individët.

39.2 Sipas pikës 2 të nenit 39 të ligjit, për evidentimin e individëve tatimpagues të cilët paguajnë tatim mbi të ardhurat personale që vetedeklarohen, administrata tatimore hap një

regjistër të veçantë, ku regjistron të gjithë të dhënat identifikuese të individëve. Ky regjistër do të përpilohet dhe prodhohet nga DPT, në formën e një database, sipas modelit të miratuar nga drejtori i DPT.

40. Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

40.1 Çdo person që do të kryejë një veprimtari ekonomike tregtare, është i detyruar të bëjë regjistrimin fillestar të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9723, datë, 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" (QKR). Regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKR-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit. Regjistrimi kryhet nëpërmjet dorëzimit të aplikimit përkatës, të cilit i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që regjistrohen. Një individ me të njëjtin numër të identifikimit personal, mund të regjistrohet vetëm një herë si person fizik tregtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe pajiset vetëm me një numër unik të identifikimit të tatimpaguesit, në vijim NUIS/NIPT. Atij i lind e drejta të regjistrohet dhe të pajiset me një NUIS/NIPT të ri, nga QKB-ja, vetëm mbas çregjistrimit të NUIS/NIPT - in ekzistuese. Për çdo vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit të ndryshëm nga adresa kryesore, personi fizik duhet të pajiset me një certifikatë me numër unik të identifikimit të tatimpaguesit të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes së re.

40.2 Regjistrimi, në përputhje me ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" shërben njëkohësisht si regjistrim në tatime, në skemat e sigurimit, shoqëror dhe shëndetësor në inspektoratet e punës dhe organet doganore.

40.2.1 Për subjektet që e ushtrojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet ndërmjetësit në vendin e biznesit të këtyre të fundit, të identifikuar me numër identifikimi tatimor të një adresë dytësore, e njëjtë me adresën e ndërmjetësit, nuk gjenerohen detyrime tatimore vendore për këtë adresë për sa kohë detyrimi për të paguar taksat vendore i mbetet vetëm ndërmjetësit, sipas adresës së tij të regjistruar të biznesit, ku ushtron aktivitetin e tij si i pavarur dhe si ndërmjetës.

Subjektet të tilla janë për shembull, subjekte të licencuara për organizimin e Lotarisë Kombëtare, që e ushtrojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet ndërmjetësit në vendin e biznesit të këtyre të fundit të regjistruar në QKR, për sa kohë detyrimi për të paguar taksat vendore i mbetet vetëm ndërmjetësit sipas adresës së tij të regjistruar të biznesit ku ushtron aktivitetin e tij si i pavarur dhe si ndërmjetës.

40.3 Në momentin e regjistrimit e të pajisjes me certifikatën e regjistrimit fillestar, personat e tatueshëm deklarojnë në formularin për regjistrim, krahas të tjerave, edhe të dhënat e detyrueshme sipas legjislacionit tatimor dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Regjistrimi i personave të tatueshëm në regjistrin tregtar është njëkohësisht regjistrim në administratën tatimore për efekt të detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Të dhënat e regjistrit tregtar i transferohen periodikisht administratës tatimore, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Mbas regjistrimit në QKR dhe në vijim të aktivitetit tatimpaguesi është i detyruar informojë dhe rakordojë me administratën tatimore llojet e tatimeve e taksave që duhet të deklarojë, të paguajë, të mbajë në burim dhe të transferojë në llogaritë përkatëse.

40.4 Çdo person i tatueshëm, në momentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pajiset me Certifikatën e Regjistrimit e cila përmban edhe numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT). Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm është unik. Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka të njëjtin NIPT unik.

Certifikata e regjistrimit përmban emrin e personit të tatueshëm, emrin tregtar të tij (nëse ka), Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT) dhe datën kur regjistrimi hyn në fuqi.

Të gjitha deklaratat e bëra për organet tatimore, të gjitha faturat e lëshuara nga personi i regjistruar dhe të gjitha dokumentet e përdorura prej tij në veprimtarinë e tij ekonomike e tregtare, duhet të përmbajnë numrin e identifikimit të personit të tatueshëm. Certifikatat e Regjistrimit të Personit të Tatueshëm duhet të ekspozohen në të gjitha adresat ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij ekonomike e tregtare. Këto certifikata merren në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike tregtare dhe janë të vlefshme përgjithmonë, deri në momentin e çregjistrimit të personit të tatueshëm.

Pas regjistrimit të tyre, personat e tatueshëm, si rregull, do të jenë nën juridiksionin e drejtorisë rajonale të tatimeve ku kanë selinë e tyre qendrore.

40.5 Procedurat e regjistrimit të subjekteve/personave që ushtrojnë veprimtari tregtare përcaktohen në ligjin "Për regjistrimin e biznesit" dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të këtij ligji. Regjistrimi bëhet në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në degët e saj në rrethe.

Subjektet që nuk janë objekt i ligjit "Për regjistrimin e biznesit", si: "Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant"; "Trupat diplomatikë"; "Përfaqësuesi tatimor"; "Fermeri" dhe "Kryefamiljari" regjistrohen në administratën tatimore pranë drejtoritë rajonale tatimore përkatëse (DRT).

Regjistrimi i këtyre subjekteve mund të bëhet edhe online nëpërmjet faqes së shërbimeve elektronike e-albania. Në këtë rast, kërkesa e plotësuar dhe dokumentacioni përkatës do të dërgohen në mënyrë elektronike në sistemin elektronik të tatimeve të adresuara për DRT-në përkatëse, e cila do të bëjë shqyrtimin e aplikimit për regjistrim dhe do të vendosë sipas rastit refuzimin ose aprovimin e aplikimit të regjistrimit.

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim është si më poshtë:

a) Përfaqësuesit tatimorë:

- formularin e aplikimit "Kërkesë për regjistrim" të plotësuar nga përfaqësuesi tatimor;
- marrëveshjen origjinale apo kopje të vërtetuar midis palëve (përfaqësues – i përfaqësuar);
- vendimin ose prokurën e caktimit apo emërimit të përfaqësuesit tatimorë, të nënshkruar nga personi përgjegjës i personit të tatueshëm jorezident që ka emëruar përfaqësuesin tatimor në zbatim të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar";
- kopje të vërtetuar me origjinalin të certifikatës së regjistrimit tatimor të personit jorezident në vendin e tij të rezidencës, e lëshuar jo më përpara se 3 muaj nga data e aplikimit për regjistrim të përfaqësuesit;
- kopje të vërtetuar me origjinalin të kartës së identitetit ose të pasaportës të administratorit të shoqërisë jorezidente;
- kopje të vërtetuar me origjinalin të kartës së identitetit ose të pasaportës të përfaqësuesit për regjistrim;
- ekstrakti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të personit fizik apo juridik të caktuar si përfaqësues tatimor. Ky dokument do të gjenerohet nga vetë punonjësi i tatimeve dhe do të jetë pjesë e dosjes së regjistrimit.

Administrata tatimore në certifikatën e NIPT-it që i lëshon përfaqësuesit tatimorë është e detyruar që përpara emrit të vendosë fjalën "Përfaqësues tatimor X për Y", ku në vend të X shënohet emri i përfaqësuesit dhe në vend të Y shënohet emri i shoqërisë së huaj që përfaqëson.

b) Trupat diplomatikë:

- formularin e aplikimit "Kërkesë për regjistrim" të plotësuar nga ana e tij;
- autorizimin për personin e ngarkuar për të kryer regjistrimin;
- fotokopje të dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit për regjistrim;
- dokument mbi vendin e rezidencës/selisë.

c) Personat e vetëpunësuar në veprimtari, si shitës ambulant, sipas përkufizimit të dhënë në shkronjën "j", të nenit 5 të ligjit, paraqesin:

- formularin e aplikimit "Kërkesë për regjistrim" të plotësuar nga ana e tij;
- kopje të vërtetuar me origjinalin të kartës së identitetit të personit ambulant;

- lejen nga bashkia nën juridiksionin territorial dhe administrativ, që personi lejohet të tregtojë në vende publike të përcaktuara dhe që ushtron aktivitetin në njësi tregtimi të vetme dhe të lëvizshme sipas përcaktimeve të ligjit.

Është kusht që ambulanti të mos këtë një vend fiks biznesi dhe nuk mund të ushtrojë veprimtari në më shumë së një njësi tregtare. I vetëpunësuari, i cili e zhvillon tregtinë në kushte të tilla, që nuk i japin mundësinë të jetë i lëvizshëm gjatë ditës, nuk konsiderohet ambulant. Administrata tatimore në certifikatën e NIPT-it që i lëshon ambulantit është e detyruar që përpara emrit të tatimpaguesit të vendosë fjalën "Ambulanti". Për shembull "Ambulanti emër mbiemër". Ambulanti pasi regjistrohet ka detyrimin për të paguar sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

d) Fermerët;

- formularin e aplikimit "Kërkesë për regjistrim" të plotësuar nga ana e tij me të gjitha të dhënat e detyrueshme të kërkuara, nënshkruar nga fermeri;

- kopje të vërtetuar me origjinalin të dokumentit të identifikimit, i cili i bashkëlidhet aplikimit për regjistrim;

- vërtetimin origjinal lëshuar për fermerin prej drejtorisë/agjencisë rajonale përkatëse përgjegjëse për bujqësinë, në bazë të të cilit vërtetohet aktiviteti prodhues bujqësor i fermerit.

DRT-ja përkatëse para miratimit të regjistrimit të fermerit verifikon dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë", për sa ky regjistrim është i detyrueshëm për fermerët që zbatojnë skemën e kompensimit të prodhuesve bujqësorë.

e) Kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie:

- formularin e aplikimit "Kërkesë për regjistrim" të plotësuar nga ana e tij;

- kopje të vërtetuar me origjinalin të kartës së identitetit ose të pasaportës së kryefamiljarit;

- marrëveshjen e punës së nënshkruar ndërmjet palëve, ku përveç të tjerave shënohet detyrimisht, numri i sigurimit shoqëror të personit të punësuar, koha e fillimit të punës, zgjatja e saj "me ose pa afat", si dhe paga mujore bruto.

Drejtoria rajonale tatimore përkatëse për të gjitha kategoritë e përmendura më sipër, pasi bën verifikimin e të dhënave të dorëzuara, brenda 2 ditëve pune aprovon regjistrimin dhe gjeneron NIPT-in përkatës duke lëshuar certifikatën e regjistrimit. Certifikata e regjistrimit i dërgohet personit menjëherë në llogarinë e tij elektronike në e-albania ose në një nga mënyrat e tjera ligjore të komunikimit me tatimpaguesin. Certifikata e regjistrimit, përmban emrin dhe formën, numrin unik të identifikimit, datën e regjistrimit fillestar dhe adresën e vendit kryesor të ushtrimit të veprimtarisë.

40.6 Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

41. Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar

41.1.1. Një person, i cili nuk pajiset me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë dhe ka ushtruar në fakt veprimtari, nuk është i përjashtuar nga përgjegjësia tatimore. Përgjegjësia tatimore fillon që nga momenti kur personi ka filluar veprimtarinë e tij. Kjo përgjegjësi përfshin si personat e tatueshëm që ushtrojnë veprimtari ekonomike e tregtare, ashtu dhe çdo organizatë jofitimprurëse, fondacion, ent publik kombëtar apo vendor, njësi zbatimi projektesh të veçanta, organizatë politike dhe organe të tjera të ngjashme që kryejnë veprimtari fetare, humanitare, bamirëse, publike, edukative, shkencore ose arsimore.

41.1.2 Administrata tatimore qendrore dhe vendore ka detyrimin ligjor për të identifikuar personat, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike e tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administrata tatimore qendrore ka gjithashtu detyrimin ligjor për të identifikuar të gjithë personat e tjerë si organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të

ngjashme me to, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa qenë të regjistruar në administratën tatimore. Të gjithë personat e identifikuar si të paregjistruar, përveç personave të identifikuar si të tillë, që në kuptim të nenit 41 të ligjit ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar, brenda 15 ditëve nga data e identifikimit si të paregjistruar, janë të detyruar të regjistrohen.

41.1.3 Kur administrata tatimore identifikon persona që ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, vendos masën e bllokimit të mallrave dhe detyron personin të regjistrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit si tatimpagues i tatimit mbi vlerën e shtuar. Masa e bllokimit vendoset ose në vendin e konstatimit të shkeljes kur veprimtaria zhvillohet në një adresë fikse, ose mallrat bllokohen dhe transportohen pranë ambienteve të administratës tatimore, nëse nuk është e mundur të vendoset masa e bllokimit në vendin e konstatimit të shkeljes. Nëse mallrat janë duke u transportuar ose janë të ngarkuara në një mjet, masa e bllokimit vendoset, gjithashtu, edhe për mjetin.

Masa e bllokimit për mallin edhe për mjetin hiqet pas kryerjes së regjistrimit për veprimtarinë ekonomike, duke aplikuar masat dhe dënimin, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 121, të ligjit dhe përcaktimeve të këtij udhëzimi. Në rast së një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve, përveç vendosjes së masës së bllokimit në vendin (adresën) ku konstatohet shkelja, u propozohet organeve kompetente pezullimi i lejes /licencës/autorizimit për ushtrim të veprimtarisë për një periudhë 6-mujore. Në rastin kur personi regjistrohet në QKB si tatimpagues i TVSH-së, menjëherë sapo konstatohet si i paregjistruar, kjo i bëhet me dije organit kompetent përkatës, i cili e merr në konsideratë si fakt pozitiv në favor të tatimpaguesit, përgjatë shqyrtimit të propozimit për pezullimin e lejes/licencës/autorizimit.

Në momentin e konstatimit mbahet akti i konstatimit dhe procesverbali përkatës sipas të cilit vendoset masa e bllokimit. Në aktin e konstatimit shënohet çdo e dhënë identifikuese dhe përshkrim i qartë i rastit, përfshirë datën e identifikimit, të dhënat identifikuese të personit, adresa e plotë të tij, numri i telefonit dhe çdo e dhënë tjetër e disponueshme. Bëhet inventarizimi i mallrave dhe evidentohet në procesverbalin përkatës. Bazuar në të dhënat e procesverbalit të inventarizimit të mallrave, menjëherë pasi regjistrohet tatimpaguesi pajiset me faturat tatimore me TVSH nga administrata tatimore dhe plotëson faturën sipas nenit 53 të ligjit dhe pikës 53 të këtij udhëzimi, e ngjashme me procedurën e lëshimit të faturës nga blerësi. Në rast së nuk është i mundur regjistrimi i menjëhershëm në QKB në momentin e konstatimit të personit që ushtron veprimtari ekonomike pa u regjistruar, masa e bllokimit nuk hiqet deri në momentin e regjistrimit në QKB.

Akti i konstatimit, procesverbali përkatës, një kopje e faturës së lëshuar për dokumentimin e inventarit të mallit i përcillet për ndjekje të mëtejshme strukturës përkatëse në Drejtorinë Rajonale Tatimore me qëllim kryerjen e vlerësimit dhe aplikimin e dënimit përkatës"

Nëse tatimpaguesit i është vendosur masa e bllokimit dhe ai prish shenjat dalluese të vendosura për bllokim të veprimtarisë, ndaj tij merret masa e konfiskimit ndaj gjithë sasisë së mallit siç përcaktohet në nenin 122 pika 4 të ligjit.

41.1.4 Administrata tatimore ka të drejtë të regjistrojë një organizatë jofitimprurëse, fondacion, ent publik kombëtare apo vendor, njësi zbatimi projektesh të veçanta, organizatë politike dhe organe të tjera të ngjashme që kryejnë veprimtari fetare, humanitare, bamirëse, publike, edukative, shkencore ose arsimore, e cila nuk ka për qëllim fitimin, është identifikuar si e paregjistruar dhe, e cila, edhe pse e detyruar, nuk kërkon të regjistrohet. Regjistrimi bëhet në drejtorinë rajonale të tatimeve të juridiksionit. Regjistrimi nga administrata tatimore bëhet duke plotësuar, në emër të personit të tatueshëm, formularin për regjistrim. Në momentin e regjistrimit, për këta persona, nga ana e degës rajonale të tatimeve të juridiksionit lëshohet certifikata e regjistrimit, e cila përmban edhe numrin unik të identifikimit të organizatës jofitimprurëse. Pas regjistrimit, drejtoria rajonale e tatimeve të juridiksionit njofton organizatën jofitimprurëse, sipas rregullave të njoftimit të përcaktuara në këtë udhëzim. Njoftimi, përveç të tjerave, përfshin vlerësimin e detyrimit tatimor të organizatës jofitimprurëse për të gjithë periudhën, nga momenti i fillimit të veprimtarisë deri në datën e regjistrimit të detyruar.

41.1.5 Personat që ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare të identifikuar si të paregjistruar, në mënyrë që të lejohen të kryejnë veprimtari ekonomiko-tregtare, detyrohen të regjistrohen menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Regjistrimi në QKR nënkupton në të njëjtën kohë edhe regjistrimin në administratën tatimore. Ndaj këtyre personave të tatueshëm zbatohen të gjitha procedurat e përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim, si për të gjithë personat e tjerë të tatueshëm të regjistruar në mënyrë të rregullt.

41.2 Në rast së një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve pa u regjistruar si tatimpagues person fizik ose juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit, strukturat e administratës tatimore i propozojnë strukturave kompetente pezullimin e lejes apo licencës/autorizimit për ushtrim veprimtarie për një periudhe 6-mujore. Institucionet përkatëse njoftojnë brenda 30 ditëve administratën tatimore për masat e marra në lidhje me ekzekutimin e propozimit të bërë nga administrata tatimore.

41.3 Personat tregtarë të identifikuar si të paregjistruar, nga organet tatimore dhe të regjistruar më pas në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ndaj të cilëve organet kompetente nuk kanë marrë masë, pavarësisht propozimit nga organet e administratës tatimore për pezullimin e lejes/licencës/autorizimit për një periudhë 6-mujore, lejohen të ushtrojnë veprimtari, ndërsa për mallrat dhe materialet e bllokuara për arsye të mosregjistrimit të veprimtarisë tregtare, veprohet në përputhje me procedurat e parashikuara për mallrat e bllokuara sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 121, të ligjit për procedurat tatimore

41.4 Administrata tatimore llogarit, vlerëson dhe mbledh detyrimet tatimore, duke aplikuar edhe masat shtrënguese në përputhje me legjislacionin tatimor, gjatë periudhës deri në përfundimin e procesit të regjistrimit nga personi. Mosregjistrimi nuk pengon administratën tatimore në mbledhjen e detyrimeve tatimore që lindin nga legjislacioni tatimor në fuqi.

41.5 Përcaktimet e nenit 41 dhe pikës 41 të këtij udhëzimi aplikohen në rastet kur konstatohen persona të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare pa u regjistruar. Nëse konstatohet së një tatimpagues i regjistruar ushtron veprimtari në një adresë dytësore të paregjistruar në QKR, atëherë në këtë rast nuk konsiderohet së tatimpaguesi kryen veprimtari ekonomike tregtare pa u regjistruar, por aplikohen dënimet për mospërditësim të të dhënave, adresës etj., siç përcaktohet në nenin 43 të ligjit dhe pikën 43 të këtij udhëzimi. Për mallin vendoset masa e bllokimit, dhe nëse pas kryerjes së inventarit edhe në pikat/adresat e tjera nëse konsiderohet e nevojshme, konstatohet së malli i bllokuar është i padokumentuar aplikohet dënimi dhe procedura e parashikuar sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 121, të ligjit për procedurat tatimore.

42. Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse, enteve publike, si dhe personave të tjerë të ngjashëm me to

42.1.1 Organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve të veçanta, entet publike kombëtare apo vendore, organizatat politike, organizatat fetare, humanitare, bamirëse, shkencore, arsimore, e të tjera të ngjashme me to, të cilat nuk kanë për qëllim fitimin, regjistrohen në administratën tatimore.

Regjistrimi i këtyre personave mund të bëhet edhe *online* nëpërmjet faqes së shërbimeve elektronike e-albania. Në këtë rast kërkesa e plotësuar dhe dokumentacioni përkatës do të dërgohen në mënyrë elektronike në sistemin elektronik të tatimeve të adresuara për DRT-në përkatëse, e cila do të bëjë shqyrtimin e aplikimit për regjistrim dhe do të vendosë sipas rastit refuzimin ose aprovimin e aplikimit.

42.1.2 Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse, fondacioneve, organizatave politike, fetare dhe persona të tjerë të ngjashme me to, bëhet pas depozitimit në administratën tatimore të dokumentacionit të mëposhtëm:

- formularin e aplikimit "Kërkesë për regjistrim" të plotësuar nga ana e tyre;
- kopje të vërtetuar me origjinalin të vendimit të Gjykatës, statutit dhe aktthemelimit;

- kopje të vërtetuar me origjinalin të kartës së identitetit të administratorit apo përfaqësuesit ligjor;
- autorizimin për personin e ngarkuar për të kryer regjistrimin (nëse bëhet me autorizim);
- dokumenti për selinë/vendin e biznesit (kontratë qiraje ose akt pronësie).

Ndërsa entet publike qendrore e vendore dhe njësitë e zbatimit të projekteve, paraqesin:
- formularin e aplikimit "Kërkesë për regjistrim" të plotësuar nga ana e tyre;
- dokumentin apo aktin e krijimit;
- dokumentin e emërimit të administratorit apo përfaqësuesit ligjor dhe fotokopje të kartës së identitetit të tij;
- autorizimin për personin për të kryer regjistrimin (nëse bëhet me autorizim);
- dokumenti për selinë/vendin e biznesit (kontratë qiraje ose akt pronësie).

42.1.3 Drejtoria rajonale tatimore përkatëse për të gjitha kategoritë e përmendura më sipër, pasi bën verifikimin e të dhënave të dorëzuara, brenda 2 ditëve pune aprovon regjistrimin dhe gjeneron NIPT-in përkatës duke lëshuar certifikatën e regjistrimit. Certifikata e regjistrimit i dërgohet personit menjëherë në llogarinë e tij elektronike në e-albania ose në një nga mënyrat e tjera ligjore të komunikimit me tatimpaguesin. Certifikata e regjistrimit, përmban emrin dhe formën, numrin unik të identifikimit, datën e regjistrimit fillestar dhe adresën e vendit kryesor të ushtrimit të veprimtarisë. Këta persona marrin një numër të vetëm identifikimi, sado që të jetë numri i degëve që ato kanë.

Në rastet kur organizatat jofitimprurëse ushtrojnë veprimtari në më shumë se një adresë, administrata tatimore lëshon një certifikatë regjistrimi për çdo adresë të ushtrimit të veprimtarisë, e cila ka të njëjtën numër NIPT-i si adresa kryesore, por me numër serial të ndryshëm.

42.1.4 Të gjitha deklaratat e bëra për administratën tatimore dhe të gjitha dokumentet e përdorura prej organizatave jofitimprurëse dhe personat e tjerë në veprimtarinë e tyre, duhet të përmbajnë numrin unik të identifikimit të personit. Certifikata e regjistrimit në administratën tatimore lëshohet në një kopje origjinale për çdo adresë të veçantë të ushtrimit të veprimtarisë. Në rast humbje apo dëmtimi të certifikatës së regjistrimit të personit, ajo zëvendësohet me një dublikatë të lëshuar nga administrata tatimore. Certifikatat e regjistrimit duhet të ekspozohen në të gjitha adresat ku këto organizata ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Këto certifikata merren në momentin e fillimit të veprimtarisë dhe janë të vlefshme përgjithmonë, deri në çregjistrimin e personit.

42.2 Administrata tatimore mban një regjistër elektronik për organizatat jofitimprurëse, përfshirë fondacionet dhe institucionet buxhetore, siç listohen në pikën 42.1.1.

Në regjistrin elektronik regjistrohen këto të dhëna:
a) NIPT-i dhe emri;
b) objekti i veprimtarisë;
c) vendi i ushtrimit të veprimtarisë;
d) kohëzgjatja, nëse kjo është e përcaktuar;
e) emri i drejtuesit apo të përfaqësuesit ligjor të organizatës;
f) numri i të punësuarve.

43. Ndryshimet në regjistrim

43.1 Sipas nenit 43 të ligjit, personat e tatueshëm që ushtrojnë veprimtari ekonomike e tregtare, janë të detyruar të deklarojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, çdo ndryshim të mëvonshëm që lidhet me emrin, adresën e selisë dhe të degëve, formën juridike, krijimin e mbylljen e degëve, ndryshimin e llojit të veprimtarisë, etj., siç përcaktohet në dispozitat ligjore për QKR.

Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë

lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.

Në rastin kur një veprimtari nga i njëjti tatimpagues, ushtrohet në të njëjtën adresë pavarësisht së ka disa ambiente të ndryshme, si p.sh.: bar, hotel, restorant, pishinë etj., por ambientet e saj janë të lidhura apo ndërveprojnë me njëra-tjetrën, për qëllime të pajisjes me numër identifikimi kjo vendndodhje biznesi do të konsiderohet një e tillë dhe pajiset me një certifikatë, pavarësisht numrit të ambienteve, pasi biznesi konsiderohet së kryen veprimtarinë në një vendndodhje, pavarësisht llojshmërisë së veprimtarive që kryen. Këtu bëjnë përjashtim rastet e parashikuara në nenin 59 të ligjit dhe pikën 59 të këtij udhëzimi, si dhe çdo rast i veprimtarive për të cilat kërkohet nga legjislacioni në fuqi pajisja me certifikatën e NIPT-it për qëllime identifikimi më vete, si p.sh. lojërat e fatit.

43.1.1 Për çdo vend tjetër të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga vendi kryesor i ushtrimit të aktivitetit, personi fizik, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re.

43.1.2 Individët me të njëjtin numër të identifikimit personal, të cilët janë të pajisur me disa numra unik të identifikimit të tatimpaguesit (NUIS/NIPT), duhet që brenda datës 31.8.2019, të sistemojnë situatën e tyre, duke aplikuar në QKB për mbylljen e NIPT-ve të tjera dhe mbajtjen e një NIPT-i kryesor. Nëse do të vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet në adresat që do të mbyllen duhet të aplikojnë në QKB për hapjen e tyre si adresa dytësore të NIPT-it aktiv kryesor.

43.1.3 Nëse pas përfundimit të këtij afati konstatohet që një individ me të njëjtin numër të identifikimit personal nuk ka zbatuar pikën 43.1.2 të këtij udhëzimi, administrata tatimore do të aplikojë vlerësimin alternativ të tatimpaguesit sipas nenit 71 pika "f") të ligjit për procedurat tatimore.

43.2.1 Në rastet kur përgjegjësia tatimore pas regjistrimit fillestar ndryshon, personi i tatueshëm është i detyruar të njoftojë drejtorinë tatimore rajonale të juridiksionit për ndryshimet e ndodhura.

Deklarimi i ndryshimit të përgjegjësisë tatimore për të gjithë kategorinë e tatimpaguesve që regjistrohen nga QKB-ja dhe nga AT, mund të bëhet edhe *online* nëpërmjet faqes së shërbimeve elektronike e-albania, pa qenë e nevojshme që tatimpaguesi të paraqitet në sportelet e shërbimit në DRT.

Formulari i plotësuar do të dërgohet në mënyrë elektronike në sistemin elektronik të tatimeve, të adresuar për DRT-në përkatëse e cila do të bëjë aprovimin e ndryshimit të përgjegjësisë.

Drejtoria rajonale tatimore përkatëse, pasi bën verifikimin e të dhënave të dorëzuara, brenda 2 ditëve pune aprovon ndryshimin e përgjegjësisë dhe njofton tatimpaguesin menjëherë në llogarinë e tij elektronike në e-albania ose në një nga mënyrat e tjera ligjore të komunikimit me tatimpaguesin.

Drejtoria rajonale tatimore i reflekton këto ndryshime në sistemin tatimor, duke bërë sistemimet e duhura në dosjen elektronike të personit të tatueshëm.

Për shembull, rast i ndryshimit të përgjegjësisë tatimore mund të jetë tejkalimi i volumit të qarkullimit prej 8 milionë lekësh. Në këtë rast, përgjegjësia tatimore e personit të tatueshëm ndryshon, domethënë nga person i tatueshëm për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël duhet të kalojë në tatimpagues i tatimit mbi fitimin.

Rast tjetër i ndryshimit të përgjegjësisë tatimore mund të jetë shtimi i përgjegjësisë tatimore për tatimin në burim, shtimi i përgjegjësisë për TVSH-në apo dhe ndryshimi i përgjegjësisë për kontributet e sigurimeve shoqërore, p.sh., nga person i vetëpunësuar i vetëm, ai mund të kalojë në person i vetëpunësuar me punëmarrës etj. Edhe në këtë rast, tatimpaguesi është i detyruar të njoftojë administratën tatimore për çdo ndryshim, e cila reflekton këto ndryshime në sistemin e administrimit tatimor.

43.2.2 Personi i tatueshëm që plotëson kushtet e mësipërme, për të bërë ndryshimin e duhur, duhet të plotësojë brenda 15 ditëve nga momenti që përgjegjësia e tij tatimore ka ndryshuar, formularin e ndryshimeve në regjistrim dhe ta dërgojë atë në drejtorinë rajonale të tatimeve të juridiksionit, për të bërë ndryshimin e kërkuar, në dosjen e tatimpaguesit në sistemin tatimor.

43.2.3 Në rastet kur një person i tatueshëm nuk ka njoftuar administratën tatimore për ndryshimin e ndodhur, megjithëse ka detyrim ligjor për ta bërë një gjë të tillë, dhe një gjë e tillë konstatohet dhe verifikohet nëpërmjet një kontrolli nga administrata tatimore, kjo e fundit bën menjëherë ndryshimin e duhur dhe njofton personin e tatueshëm. Kështu, për shembull, në bazë të një kontrolli tatimor të kryer në vend te personi i tatueshëm apo në bazë të të dhënave të importeve të marra nga dogana rezulton se një tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, ka plotësuar kushtet për të qenë person i regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, por vetë personi i tatueshëm, megjithëse i detyruar sipas ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, nuk ka bërë regjistrimin si tatimpagues TVSH-je. Në këtë rast, administrata tatimore gëzon të drejtën, për të plotësuar në emër të personit të tatueshëm, formularin përkatës të ndryshimeve në regjistrim, ta hedhë atë në sistemin elektronik dhe të njoftojë njëkohësisht për këtë personin e tatueshëm.

43.3 Organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve të veçanta, entet publike kombëtare apo vendore, organizatat politike, organizata fetare, humanitare, bamirëse, shkencore, arsimore, e të tjera të ngjashme me to, janë të detyruara të njoftojnë administratën tatimore (drejtorinë rajonale përkatëse të tatimeve), për çdo ndryshim të mëvonshëm që lidhet me:

a) ndryshimin e emrit;

b) ndryshimin e adresës së veprimtarisë ose kontaktit;

c) ndryshimin e statusit ligjor;

d) krijimin/mbylljen e degëve, sektorëve ose njësive të reja;

e) ndryshimin e llojit të veprimtarisë ekonomike;

g) çdo ndryshim tjetër, të parashikuar në aktet nënligjore, të dala në zbatim të legjislacionit tatimor.

Deklarimi i këtyre ndryshimeve për tatimpaguesit që regjistrohen në AT, bëhet edhe *online* nëpërmjet faqes së shërbimeve elektronike e-albania, pa qenë e nevojshme që tatimpaguesi të paraqitet në sportelet e shërbimit në DRT. Tatimpaguesi do të ketë mundësi të plotësojë Formularin e aplikimit "Për ndryshimin e të dhënave të regjistrimit" dhe bashkë me dokumentacionin përkatës do ta dërgojë në mënyrë elektronikë në sistemin elektronik të tatimeve, të adresuar për DRT-në përkatëse e cila do të bëjë aprovimin e këtij ndryshimi.

Drejtoria rajonale tatimore përkatëse, pasi bën verifikimin e të dhënave të dorëzuara, brenda 2 ditëve pune aprovon ndryshimin e kërkuar, hedh ndryshimin në sistem dhe njofton tatimpaguesin menjëherë në llogarinë e tij elektronike në e-albania ose në një nga mënyrat e tjera ligjore të komunikimit me tatimpaguesin.

Sipas rastit është e nevojshme të ndryshojë dhe certifikata e regjistrimit. Certifikata e regjistrimit i dërgohet personit menjëherë në llogarinë e tij elektronike në e-albania ose në një nga mënyrat e tjera ligjore të komunikimit me tatimpaguesin. Të gjithë tatimpaguesit e kësaj kategorie, të cilët do të marrin një certifikatë të re të ndryshuar janë të detyruar të dorëzojnë menjëherë në DRT-në përkatëse certifikatën ekzistuese të regjistrimit.

43.4 Mjetet e transportit të mallrave ose udhëtarëve gjatë kryerjes së veprimtarisë ekonomike për transportimin e mallrave ose pasagjerëve për vete ose për të tretë duhet të jenë pajisur me dokumentin përkatës identifikues për qëllime tatimore sipas rasteve të mëposhtme:

43.4.1 Për mjetet e transportit të mallrave, qëllimi i përdorimit të të cilëve është:

a) transporti i mallrave për lëvizje të brendshme, si ato nga magazina në magazinë, nga magazina në dyqan apo anasjelltas, nga qendra në filial, nga vendi i prodhimit në magazinë, nga vendi i prodhimit në dyqan, nga dogana ku zhdoganohet malli në drejtim të magazinës së personit të tatueshëm importues;

b) transporti i mallrave me destinacion nga një tatimpagues të një tjetër, i kryer me mjetet e njërit prej tatimpaguesve shitësit ose blerësit;

Dokumenti që përdoret për të vërtetuar përdorimin e mjetit në funksion të veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit, është vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku tatimpaguesi është i regjistruar. Tatimpaguesi pajiset me vërtetim për çdo mjet që ai ka në pronësi dhe ka në grupin e aktiveve të pasurisë, sipas pasqyrave financiare deklaruar prej tij.

43.4.2. Me vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore do të pajiset dhe tatimpaguesi, të cilit, automjeti i përdorur sipas shkronjës a) dhe b) të pikës 43.4.1, i është furnizuar sipas një kontratë leasing/qira. Në këtë rast ky tatimpagues do të paraqesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore kontratën e leasing/ qirasë (të noterizuar) dhe faturën e leasing/qirasë të lëshuar nga shoqëria që e ka furnizuar, si dhe pagesën e tatimit në burim (qirasë) në rastin kur është i detyruar ligjërisht.

-Vërtetimi lëshohet nën emrin tregtar dhe Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm, për çdo mjet në veçanti, me të dhënat si lloji i mjetit, kapaciteti i mjetit, targa e mjetit, të dhëna këto të paraqitura në lejen e qarkullimit të çdo mjeti. Në rastin kur vërtetimi është lëshuar për një mjet të furnizuar sipas një kontratë leasing, në vërtetim do të specifikohet ky fakt.

-Për çdo ndryshim të të dhënave përkatëse, të qëllimit të përdorimit, të pronësisë mbi mjetin etj., tatimpaguesi është i detyruar të njoftojë menjëherë Drejtorinë Rajonale Tatimore që ka lëshuar vërtetimin.

43.4.3 Për mjetet e transportit të mallrave, qëllimi i lëvizjes së të cilëve është shitja derë më derë, mjetet e transportit të mallrave, si dhe mjetet e transportit të udhëtarëve që i përkasin personave të regjistruar për kryerje aktiviteti transport mallrash apo udhëtarësh, duke u konsideruar adresa ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij, si dokument vërtetues i përkatësisë së mjetit është Certifikata e Regjistrimit të Personit të Tatueshëm, me numër të ndryshëm serial (ose quajtur ndryshe "NIPT-i sekondar"), e lëshuar për çdo mjet që kryen veprimtari në të tilla kushte.

44. Kalimi në regjistrin pasiv

44.1.1 Administrata tatimore ka të drejtë të kalojë regjistrimin e një personi të tatueshëm nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv të personave të tatueshëm. Administrata tatimore kalon regjistrimin e tatimpaguesit nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv që mbahet nga administrata tatimore, në rast së përmbushet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) nuk ushtron më veprimtari tregtare për një periudhë tatimore prej 12 muaj të njëpasnjëshëm;

b) nuk dorëzon deklaratën tatimore për një periudhë tatimore prej 12 muaj të njëpasnjëshëm;

c) deklaron në QKR pezullim veprimtarie tregtare dhe kjo e fundit e ka miratuar pezullimin, i cili i është njoftuar edhe administratës tatimore. Qendra Kombëtare e Biznesit pranon pezullimin e aktivitetit të subjektit/tatimpaguesit vetëm kur nga ana e tij janë paguar të gjitha detyrimet tatimore në momentin e aplikimit për pezullimin e aktivitetit.

Në kuptimin e shkronjës "a", tatimpaguesi kalohet automatikisht nga sistemi, nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, në rast së për 12 periudha tatimore mujore të njëpasnjëshme ka dorëzuar të gjitha deklaratat tatimore, për llojet e tatimeve për të cilat është regjistruar, duke zgjedhur rubrikën "8" pa veprimtari të deklaratës. Ky kalim automatik nuk i heq detyrimin tatimpaguesit për të deklaruar dhe dorëzuar deklaratën vjetore të tatim fitimit apo tatimit të fitimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël, për periudhën përkatëse. Pa veprimtari konsiderohen edhe tatimpaguesit që kanë plotësuar të gjitha rubrikat e deklaratës me "0".

Në kuptimin e shkronjës "b", të gjithë tatimpaguesit të cilët për 12 periudha tatimore mujore të njëpasnjëshme, nuk kanë dorëzuar të gjitha deklaratat tatimore, për llojet e tatimeve për të cilat janë regjistruar, me përjashtim të deklaratës vjetore të tatim fitimit apo tatimit të fitimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël, kalohen automatikisht nga sistemi, nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv. Numërimi i 12 periudhave tatimore të njëpasnjëshme në këtë rast fillon nga muaji

i parë që tatimpaguesi ka ndërprerë deklarimin, pavarësisht së mund të jetë bërë vlerësim automatik nga sistemi.

Në kuptimin e shkronjës "c", të gjithë tatimpaguesit që kanë deklaruar pezullimin e veprimtarisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për një periudhë më shumë së 12 muaj të njëpasnjëshëm apo pa afat të përcaktuar, do të kalohen automatikisht nga sistemi, nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv.

Në momentin e aplikimit të subjektit/tatimpaguesit për pezullim aktiviteti, QKB-ja bën verifikimin e detyrimeve tatimore të subjektit /tatimpaguesit. Miratimi i pezullimit të aktivitetit nga ana e QKB-së për çdo subjekt/tatimpagues bëhet pasi është verifikuar më parë situata e detyrimeve tatimore të tij në momentin e aplikimit për pezullim dhe ka rezultuar një nga rastet si më poshtë:

a) Subjekti/tatimpaguesi nuk ka detyrime;

b) Subjekti/tatimpaguesi ka paguar detyrimet tatimore, fakt i cili vërtetohet nga mandati i bankës, të cilit duhet ti bashkëlidhet edhe urdhërpagesa. Shuma e detyrimeve në mandat pagesë, duhet të përputhet me shumën e detyrimit në urdhërpagesë. Urdhërpagesa duhet të jetë e printuar dhe të jetë paguar shuma totale e detyrimit, jo më parë së 3 ditë kalendarike nga data e aplikimit për pezullim.

Subjekti/tatimpaguesi që ka lidhur marrëveshjeje për pagesë me këste të detyrimit tatimor, nuk mund të pezullojë veprimtarinë ekonomike.

Verifikimi i detyrimeve tatimore nga ana e QKB-së do të bëhet sipas procedurës së përcaktuar në marrëveshjen dhe protokollin e komunikimit midis DPT-së dhe QKB-së.

Të gjithë tatimpaguesit që regjistrohen në administratën tatimore, për të kaluar nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, duhet të plotësojnë një nga kushtet, ashtu si është trajtuar më lart, për kategorinë e tatimpaguesve që regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Kalimi i tatimpaguesit nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, për tatimpaguesit që regjistrohen në administratën tatimore dhe përmbushin kushtin e pezullimit, bëhet rast pas rasti nga punonjësi i ngarkuar i organeve tatimore.

Tatimpaguesit, të cilët në momentin e implementimit të sistemit të ri informatik të tatimeve plotësojnë një nga kushtet e mësipërme, migrohen në këtë sistem si tatimpagues pasiv.

44.1.2 Shfuqizohet.

44.1.3 Pasi një person i tatueshëm kalon në regjistrin pasiv, drejtoria rajonale e tatimeve të juridiksionit nuk e konsideron me atë si mosdeklarues. për pasoje, që nga ky moment dhe gjatë gjithë periudhes që personi i tatueshëm mbetet në regjistrin pasiv, për këtë person nuk vendosen me gjoba për mosdeklarim për të gjitha llojet e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Mosvendosja e gjobave nuk përfshin periudhen e fundit prej 12 muajsh para kalimit në regjistrin pasiv. Për të gjithë këtë periudhë dhe për çdo periudhë tjetër para kësaj, detyrimet e mundshme tatimore të papaguara, përfshirë këtu edhe çdo gjobë apo kamatëvonesë mbeten në fuqi dhe për mbledhjen e tyre vazhdohet të ndërmerren të gjitha masat e mbledhjes me forcë të përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim. Po kështu, për këtë periudhë dhe për çdo periudhë tjetër para kësaj, drejtoria rajonale e tatimeve mund të bëjë në çdo kohë vlerësime tatimore ndaj personit të tatueshëm të kaluar në regjistrin pasiv.

44.1.4 Pasi personi i tatueshëm kalon në regjistrin pasiv, ai do të jetë nën mbikëqyrjen e administratës tatimore. Mbikëqyrja në këtë rast nënkupton verifikimin e të dhënave të doganës, të të dhënave të mundshme nga kontrollet e ushtruara në subjekte të tjera, të të dhënave të verifikimeve të mundshme në vend, etj. Në rast së nga këto të dhëna rezulton së tatimpaguesi ka kryer aktivitet, ai kalohet në regjistrin aktiv të personave të tatueshëm dhe ndaj tij merren të gjitha masat e duhura ligjore. Për këtë njoftohet menjëherë personi i tatueshëm dhe njoftimi shoqërohet edhe me Njoftim-Vlerësimin Tatimor përkatës.

44.1.5 Kalimi në regjistrin pasiv të Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", nuk është kusht për kalimin e këtij

personi në regjistrin pasiv të administratës tatimore për efekte tatimore. Edhe për personat e tatueshëm të kaluar në regjistrin pasiv të Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas procedurave të saj, nga drejtoritë rajonale të tatimeve zbatohen të njetat rregulla të përcaktuara më sipër në këtë Udhëzim.

44.1.6 Të njëjtat rregulla për kalimin nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, veprojne edhe për organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to.

44.2 Shfuqizohet.

44.3 Drejtoria rajonale e tatimeve të juridiksionit njofton me shkrim personin e tatueshëm për kalimin në regjistrin pasiv brenda 10 ditëve nga data e kalimit të tij në këtë regjistër, duke i kujtuar gjithashtu tatimpaguesit detyrimin për njoftimin e menjëhershëm të administratës tatimore dhe kërkesën për kalimin në regjistrin aktiv, nëse tatimpaguesi do të rinisë aktivitetin. Për periudhën e qëndrimit në regjistrin pasiv, tatimpaguesi nuk paraqet deklarata periodike tatimore dhe ndaj tij nuk llogariten gjoba për mosdeklarim tatimor

44.4 Transferimi i regjistrimit tatimor nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv nuk eliminon detyrimin tatimor ekzistues dhe nuk e ndalon administratën tatimore për vlerësimin ose mbledhjen e detyrimit tatimor, pas transferimit në regjistrin pasiv.

44.5 Personat e tatueshëm të kaluar në regjistrin pasiv, nëse do të rifillojnë aktivitetin ekonomik, në çdo kohë mund të kërkojnë të kalojnë në regjistrin aktiv. Aktivizimi i tatimpaguesit dhe kalimi i tij nga regjistri i tatimpaguesve pasiv në regjistrin e tatimpaguesve aktivë bëhet me kërkesë të tatimpaguesit, por edhe nga administrata tatimore bazuar në të dhëna të konstatuara dhe informacione të administruara nga ana e saj.

Në të gjitha rastet dhe për të gjitha kategoritë e tatimpaguesve, kalimi nga regjistri pasiv në regjistrin aktiv (riaktivizimi) bëhet menjëherë, pa u kushtëzuar nga detyrimet tatimore të papaguara dhe/ose deklarata të padorëzuara të tatimpaguesit. Për detyrimet e papaguara dhe/ose deklaratat e padorëzuara zbatohen të gjitha procedurat dhe ndërmerren të gjitha hapat ligjore deri në përmbushjen e këtyre detyrimeve.

44.5.1 Për tatimpaguesit që riaktivizohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si rezultat i heqjes dorë nga pezullimi i veprimtarisë, kalimi nga regjistri (statusi) pasiv në regjistrin (statusin) aktiv të administratës tatimore bëhet automatikisht nga sistemi elektronik i QKB-së në sistemin e DPT-së. Si datë e aktivizimit të tatimpaguesit në administratën tatimore do të jetë data e miratimit të aktivizimit në QKB. Përgjegjësitë tatimore do të jenë ato që ka pasur ky tatimpagues në datën kur ka kaluar në statusin pasiv.

44.5.2 Për tatimpaguesit që kërkojnë të riaktivizohen pranë DRT-ve, si rezultat i rifillimit të veprimtarisë/aktivitetit (këtu hyjnë të gjithë tatimpaguesit që janë aktivë në QKB dhe kanë kaluar në pasiv nga DRT-të si mosdeklarues apo deklarues pa aktivitet, si dhe gjithë tatimpaguesit që regjistrohen pranë administratës tatimore), aktivizimi do të bëhet menjëherë në sistem nga Drejtoria Rajonale Tatimore përkatëse, sipas procedurave të miratuara nga DPT-ja. Si datë e aktivizimit të tatimpaguesit do të jetë data e kërkesës për riaktivizim dhe përgjegjësitë tatimore do të jenë ato që ka pasur tatimpaguesi në datën kur ka kaluar në statusin pasiv.

44.5.3 Për tatimpaguesit që riaktivizohen nga administrata tatimore, në kushtet kur ai ka kryer shkelje tatimore, bazuar në të dhëna të konstatuara në vendin e biznesit apo/dhe informacione që administrohen nga ana e saj, aktivizimi do të bëhet menjëherë në sistem nga DRT-ja përkatëse sipas procedurave të miratuara nga DPT-ja. Si datë e aktivizimit të tatimpaguesit do të jetë data e konstatuar nga administrata tatimore. Përgjegjësitë tatimore do të jenë ato që ka pasur ky tatimpagues në datën kur ka kaluar në statusin pasiv.

44.5.4 Për të gjitha rastet e aktivizimit, i dërgohet njoftim edhe tatimpaguesit në llogarinë/adresën e tij elektronike apo në një nga mënyrat e komunikimit të përcaktuara në ligj.

Gjatë periudhës që tatimpaguesi është në statusin/regjistrin pasiv atij nuk mund t'i shtohen apo t'i ndryshohen përgjegjësitë tatimore

44.6 Shfuqizohet.

44.7 Në faqen e zyrtare të administratës tatimore, www.tatime.gov.al, publikohet dhe përditësohet çdo ditë pune, lista e tatimpaguesve që kanë kaluar në regjistrin pasiv. Gjithashtu, tatimpaguesi duhet të konsultohet me regjistrin tregtar të publikuar në faqen zyrtare të QKB-së, www.qkb.gov.al. Çdo tatimpagues përpara së të hyjë në një transaksion me një tatimpagues tjetër, duhet të verifikojë statusin e tij dhe të sigurohet që blerësi apo shitësi është tatimpagues me status "Aktiv" dhe mund të kryejë transaksione.

Do të konsiderohet shkelje administrative, çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, të cilët në datën e kryerjes së transaksionit, rezultojnë të jenë me statusin pasiv, dhe dënohen si më poshtë vijon:

a) Për shitësin, i cili është në regjistrin pasiv, bëhet vlerësim tatimor pasi të jetë aktivizuar më parë (kaluar në status aktiv) kryesisht nga DRT-ja e juridiksionit përkatës dhe vendoset dënim, në përputhje me nenin 116 të ligjit. Ky aktivizim bëhet nga data e kryerjes të transaksionit.

b) Për blerësin, vlerësim tatimor për mosnjohjen e TVSH-së së zbritshme dhe të shpenzimit.

Me përjashtim të transaksioneve të kryera nga subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e telekomunikacionit, shitjes së energjisë dhe ujit për konsumatorët finalë, sigurimeve, si dhe në rastet kur janë lidhur kontrata afatgjata leasing, do të konsiderohet shkelje administrative, çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit aktiv, persona fizikë apo juridikë tregtarë, me tatimpaguesit që janë në regjistrin pasiv, dhe dënohet, si më poshtë vijon:

a) shitësi aktiv, në përputhje me pikën 2, të nenit 128, të ligjit. Ky dënim nuk aplikohet vetëm për ditët gjatë cilave lista e tatimpaguesve në regjistrin pasiv nuk është përditësuar nga administrata tatimore për arsye teknike dhe;

b) blerësi në regjistrin pasiv, me vlerësim tatimor të detyrimit, pasi është aktivizuar më parë (kaluar në status aktiv) kryesisht nga DRT-ja e juridiksionit përkatës dhe vendoset dënim, në përputhje me nenin 116 të ligjit. Ky aktivizim bëhet në datën e konstatimit të transaksionit.

45. Çregjistrimit i tatimpaguesve/subjekteve

45.1 Subjektet/tatimpaguesit, personat fizikë dhe juridikë, që regjistrohen sipas dispozitave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe organizatat jofitimprurëse ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, organizatat politike, organizatat që kryejnë veprimtari fetare, humanitare, bamirëse, publike, shkencore, arsimore etj., të cilat nuk kanë për qëllim fitimin të cilat regjistrohen në përputhje me legjislacionin e fushës, çregjistrohen nga regjistri i administratës tatimore vetëm pas çregjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose në gjykatë.

Subjektet/tatimpaguesit e regjistruar në organin tatimor si me poshtë, çregjistrohen nga drejtoritë rajonale tatimore, të juridiksionit përkatës:

a) persona juridikë, të cilët nuk regjistrohen në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si përfaqësi e ambasada të huaja, entet publike kombëtare apo vendore, njësitë e zbatimit të projekteve të veçanta dhe persona të tjerë të ngjashëm me to;

b) përfaqësuesit tatimorë të tatimpaguesve jorezidentë;

c) të vetëpunësuarit në veprimtari, si shitës ambulant të cilët janë persona fizikë që tregtojnë mallra ose shërbime për publikun pa pasur një vend biznesi fiks, që ushtrojnë aktivitetin në njësi të vetme tregtimi të lëvizshme dhe lejohet të tregtojë në ambiente publike pasi janë pajisur me leje nga bashkia nën juridiksionin territorial dhe administrativ;

d) kryefamiljari, që punëson individë, si punëtorë shtëpie, kujdestarë dhe persona të tjerë të kësaj natyre;

e) fermeri.

Data e çregjistrimit të tatimpaguesit në administratën tatimore është data e çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në gjykatë, për të gjitha subjektet që çregjistrohen pranë tyre.

Data e çregjistrimit të personave juridikë publikë apo të ngjashme me to, si dhe të

institucioneve e organizatave ndërkombëtare, është data e aktit/vendimit të mbylljes nga institucioni përkatës.

Datë e çregjistrimit për subjektet / tatimpaguesit e tjerë është data e miratimit të çregjistrimit të tyre nga administrata tatimore.

45.2 Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve, që janë pjesë e regjistrit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Të gjithë tatimpaguesit persona fizik apo juridik, të regjistruar sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, në QKB, çregjistrohen nga regjistri i administratës tatimore mbas çregjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

45.3 Çregjistrimi i tatimpaguesve persona fizikë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

a) Tatimpaguesi person fizik, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, që kërkon të çregjistrohet, për çfarëdo arsye, është i detyruar të paguajë më parë të gjitha detyrimet tatimore të papaguara dhe të dorëzojë deklaratat përkatëse, deri në datën e kërkesës/aplikimit për çregjistrim. Kërkesa për çregjistrim paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas procedurave ligjore përkatëse. Qendra Kombëtare e Biznesit, me pranimin e kërkesës/aplikimit për çregjistrim duhet të njoftojë menjëherë organin tatimor në rrugë elektronike, mbi datën e kërkesës/aplikimit për çregjistrimin e tij. Me marrjen e njoftimit mbi datën e aplikimit për çregjistrim, administrata tatimore ndërpret gjenërimin e deklaratave tatimore dhe tatimpaguesi nuk ka asnjë detyrim të mëtejshëm për deklarim.

b) Drejtoria Rajonale e Tatimeve e juridiksionit përkatës, brenda 10 ditëve pune nga data e aplikimit për çregjistrim, kryen të gjitha verifikimet dhe vlerësimet e duhura dhe pasqyron situatën tatimore në llogarinë elektronike të tatimpaguesit. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore, detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat aktuale të lidhura me këto detyrime, si dhe deklaratat tatimore të padorëzuara. Për tatimpaguesit persona fizikë të regjistruar për përgjegjësinë tatimore Tatim Fitimi, kur administrata tatimore, sipas analizës së riskut, gjykon të nevojshme të ushtrojë kontroll tatimor në mjediset e veprimtarisë së subjektit, ky kontroll dhe pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit nuk mund të zgjasë më shumë së 30 ditë pune. Ky afat fillon nga data e aplikimit për çregjistrim.

c) Qendra Kombëtare e Biznesit, verifikon elektronikisht shumën e detyrimeve tatimore të papaguara apo deklaratave të padorëzuara të subjektit/tatimpaguesit, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe në protokollin elektronik të komunikimit me DPT-në.

Për subjektet/tatimpaguesit që nuk janë të regjistruar për përgjegjësinë tatimore Tatim Fitimi, verifikimi bëhet pas mbarimit të afatit 10 ditë pune.

Për subjektet/tatimpaguesit e regjistruar për përgjegjësinë tatimore Tatim Fitimi, verifikimi bëhet pas mbarimit të afatit 30 ditë punë, bazuar në pikën 3 të nenit 45 të ligjit.

Në raste të veçanta, kur deklaratat/pasqyrat financiare janë dorëzuar nga subjektet manualisht pranë DRT-së përkatëse por në sistem rezultojnë si të padorëzuara ose kur tatimpaguesi ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, por pagesa nuk është shfaqur në llogarinë e tij, si dhe në raste të tjera të kësaj natyre, komunikimi ndërmjet DRT-ve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, mund të bëhet me shkresë zyrtare ose me postë elektronike (e-mail).

d) Nëse pas afateve të sipërpërmendura, QKB-ja konstaton së tatimpaguesi nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit, duke njoftuar në rrugë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

e) Kur pas afateve të sipërpërmendura, QKB-ja konstaton së tatimpaguesi ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit, (kur tatimpaguesi është subjekt i tatim fitimit), nuk mund të kryejë çregjistrimin e tij.

45.4 Çregjistrimi i tatimpaguesve persona juridikë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

a) Tatimpaguesit persona juridikë, që kryejnë veprimtari ekonomike fitimprurëse

çregjistrohen sipas dispozitave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, dhe pas kryerjes prej tyre të procedurave të likuidimit të njohura nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Aplikimi për fillimin e procedurës të likuidimit paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit. QKB-ja njofton menjëherë organin tatimor për miratimin e aplikimit për fillimin e procedurës së likuidimit dhe në vijim kur shoqëria dorëzon raportin përfundimtar të likuidimit dërgon në organin tatimor datën e paraqitjes së këtij raporti. Administrata tatimore e pasqyron këtë njoftim (dorëzimin e raportit përfundimtar) si kërkesë për çregjistrim të personit juridik në dosjen elektronike të tij dhe në vijim nuk i gjenërohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse.

b) Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së raportit përfundimtar të likuidimit është e detyruar të kryejë të gjitha verifikimet dhe vlerësimet e duhura dhe pasqyron situatën tatimore në llogarinë elektronike të tatimpaguesit. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore, detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat aktuale të lidhura me këto detyrime, si dhe deklaratat tatimore të padorëzuara. Kur administrata tatimore, sipas analizës së riskut, gjykon të nevojshme të ushtrojë kontroll tatimor në mjediset e veprimtarisë së subjektit, ky kontroll dhe pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit nuk mund të zgjasë më shumë së 30 ditë pune. Ky afat fillon nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar të likuidimit.

c) Qendra Kombëtare e Biznesit, verifikon elektronikisht shumën e detyrimeve tatimore të papaguara apo deklaratave të padorëzuara të subjektit/tatimpaguesit, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe në protokollin elektronik të komunikimit me DPT-në. QKB-ja nuk mund të verifikojë situatën tatimore të tatimpaguesit para mbarimit të afatit 30 ditë punë.

Në raste të veçanta, kur deklaratat/pasqyrat financiare janë dorëzuar nga subjektet manualisht pranë DRT-së përkatëse por në sistem rezultojnë si të padorëzuara ose kur tatimpaguesi ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, por pagesa nuk është shfaqur në llogarinë e tij, si dhe në raste të tjera të kësaj natyre, komunikimi ndërmjet DRT-ve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, mund të bëhet me shkresë zyrtare ose me postë elektronike (e-mail).

d) Nëse pas afatit të sipërpërmendur, QKB-ja konstaton së tatimpaguesi nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, si dhe ka paraqitur pasqyrat financiare, kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit, duke njoftuar në rrugë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

e) Kur pas afatit të sipërpërmendur, QKB-ja konstaton së tatimpaguesi ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit, nuk mund të kryejë çregjistrimin e tij.

45.5 Qendra Kombëtare e Biznesit ka detyrimin ligjor të njoftojë administratën tatimore, menjëherë me paraqitjen e aplikimit për riorganizimin e shoqërive (bashkim/ndarje) të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, i cili ka si pasojë çregjistrimin pa likuidim të shoqërive që përthithen/ndahen.

Administratori/Eksperti i caktuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ose personi i autorizuar sipas ligjit, është i detyruar të njoftojë dhe dorëzojë në administratën tatimore raportin e bashkimit, si dhe dokumentacionin përkatës. Para së të regjistrojë bashkimin/ndarjen e shoqërive, duhet të ketë paguar detyrimet tatimore të shoqërive që do të çregjistrohen pa likuidim.

Administrata tatimore brenda 30 ditëve pune nga data e marrjes dijeni për aplikimin për bashkim/ndarje, është e detyruar të kryejë të gjitha verifikimet dhe vlerësimet e duhura për situatën tatimore të tatimpaguesve të cilët bashkohen/ndahen. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore, detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat aktuale të lidhura me këto detyrime, si dhe deklaratat tatimore të padorëzuara.

Kur administrata tatimore, sipas analizës së riskut, gjykon të nevojshme të ushtrojë kontroll tatimor në mjediset e veprimtarisë së subjektit që do të përthithet/ndahet ky kontroll dhe pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit nuk mund të zgjasë më shumë së 30 ditë pune. Ky afat fillon nga data e

marrjes së njoftimit për paraqitjen e aplikimit për riorganizimin e shoqërive (bashkim/ndarje).

Nëse çregjistrimi pa likuidim është kryer pa u shlyer më parë detyrimet tatimore të subjektit që riorganizohet (bashkohet/ndahet), këto detyrime do të vazhdojnë të qëndrojnë në llogarinë e tij/tyre deri në pagimin e detyrimeve nga shoqëria përthithëse apo shoqëritë pritëse në rastin e ndarjes. Këto detyrime tatimore do të jenë të kërkueshme në mënyrë solidare kundrejt çdo subjekti që mbetet aktiv pas riorganizimit të shoqërive. Kjo nënkupton të drejtën e administratës tatimore, që detyrimet tatimore t'ia kërkojë çdo subjekti, që mbetet aktiv pas riorganizimit të shoqërive pavarësisht marrëveshjes që mund të kenë këto subjekte gjatë procesit të riorganizimit.

Afatet dhe procedura e shkëmbimit zyrtar të informacioneve midis QKB-së, gjykatës dhe administratës tatimore për çregjistrimin e shoqërive pa likuidim, janë ato të përcaktuara si më sipër.
Përveç respektimit të afateve dhe procedurës së shkëmbimit të informacionit midis këtyre institucioneve, Drejtoria Rajonale Tatimore përkatëse ndjek dhe procedon si vijon:
Drejtoria Rajonale Tatimore, duhet të depozitojë në dosjen elektronike të secilit tatimpagues, i cili përfshihet në këtë proces ndryshimet dhe dokumentacionin përkatës ligjor për sa u përket vendimeve të organeve vendimmarrëse të personave juridikë, si dhe dokumentacionin ekonomik që lidhet me pasqyrat financiare përkatëse apo aktet e ekspertëve kontabël nëse ka të tilla, sikurse parashikohet në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe çdo dokumentacion që shoqëron bashkimin/ndarjen.
Drejtoria Rajonale Tatimore harton një pasqyrë përmbledhëse të detyrimeve tatimore debitore dhe kreditore të shoqërive të përfshira në këtë proces, të cilën e depoziton në dosjen e tatimpaguesit.
Nëse pas përfundimit të verifikimeve përkatëse nga Drejtoria Rajonale Tatimore, shoqëria që do të përthithet/ndahet është kreditore në organin tatimor për ndonjë lloj tatimi, atëherë teprica kreditore:

a) Do të përdoret për kompensim të detyrimeve tatimore të tjera të tatimpaguesit, nëse ka të tilla;

b) Do t'i kthehet/rimbursohet tatimpaguesit nëse plotësohen kushtet sipas procedurave të përcaktuara në nenin 75 dhe 75/1 të ligjit "Për procedurat tatimore në RSH", të ndryshuar ose nenin 77 të ligjit "Për TVSH-në", i ndryshuar;

c) Do ta kalojë nëpërmjet transferimit të shoqëria përthithëse (në rastin e bashkimit) apo shoqëria/shoqëritë e reja që krijohen (në rastin e ndarjes).

Në rastin kur tatimpaguesit e përfshirë në proces bashkimi/ndarjeje të shoqërive, administrohen nga dy drejtori të ndryshme rajonale tatimore, drejtoria rajonale, e cila çregjistron pa likuidim tatimpaguesin, njofton dhe shkëmben informacion për tepricat kreditore përkatëse të tatimpaguesit që do të çregjistrohet, pasi kanë ndjekur radhën e veprimeve të përcaktuara më sipër.

Për kalimin e tepricës kreditore të çdo lloj tatimi në rastet sa më sipër, organi tatimor realizon transferimin e tepricës nëpërmjet procedurës informatike të transferimit të kredisë nga një person i tatueshëm në një tjetër person të tatueshëm, sipas formularit përkatës.

Për realizimin e transferimit të kredisë, inspektori përkatës i drejtorinë rajonale, i bashkëngjit formularit të transferimit të kredisë një procesverbal ose akt rakordimi, si dhe të gjithë dokumentacionin shoqërues për të vërtetuar arsyet e këtij transferimi të kredisë.

Teprica kreditore që i rezulton tatimpaguesit për një tatim të caktuar në organin tatimor mbartet në periudhat në vijim dhe shoqëron situatën e personit derisa të ekzistojë kjo tepricë. Detyrimi tatimor që një shoqëri ka ndaj organit tatimor, i cili përket një periudhe të caktuar tatimore, një vlerësimi të caktuar tatimor, nuk mund të mbartet në vijueshmëri në periudhat pasuese, dhe tatimpaguesi është përgjegjës për të deri sa ta shlyejë.

Bazuar në dispozitat e nenit 224 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si shoqëria përthithëse, administratorët e saj etj., në rastin e bashkimit të shoqërive, ashtu edhe shoqëritë pritëse, administratorët e tyre etj., në rastin e ndarjes së shoqërive, përgjigjen për detyrimet e shoqërive debitore.

Nëse këto detyrime nuk paguhen, procedurat e mbledhjes do të ndiqen ndaj shoqërive përthithëse/pritëse ose shoqërive të reja të krijuara, si përgjegjëse për këto detyrime në bazë të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në të kundërt, ashtu sikurse parashikon ligji "Për

tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, brenda 6 muajve nga publikimi i projekt-marrëveshjes së bashkimit, organi tatimor në rolin e kreditorit paraqet me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimit të tyre dhe shoqëria duhet t'i japë garanci të mjaftueshme për kreditë e tij. Nëse detyrimet nuk paguhen ose nuk jepet garanci e mjaftueshme nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, organi tatimor mund t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë lëshimin e garancive të mjaftueshme apo anulimin e vendimit të bashkimit. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që bashkohen, përgjigjen në mënyrë solidare për të gjitha dëmet e shkaktuara ndaj organit tatimor, si pasojë e pasaktësisë së deklaratës së mësipërme.

Në rastin kur ndonjëra nga shoqëritë që do të çregjistrohet pa likuidim si pasojë e procesit të bashkimit/ndarjes së shoqërive është debitore, administrata tatimore mbledh detyrimin tatimor sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar.

QKB-ja njofton organin tatimor për dorëzimin e raportit përfundimtar të bashkimit/ndarjes dhe dërgon elektronikisht datën e paraqitjes së këtij raporti. Administrata tatimore e pasqyron këtë njoftim (dorëzimin e raportit përfundimtar) si kërkesë për çregjistrim të personit juridik në dosjen elektronike të tij dhe në vijim nuk i gjenërohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse.

QKB-ja duhet të dërgojë në organin tatimor vendimin përfundimtar të bashkimit/ndarjes dhe datën e miratimit të aplikimit për depozitimin e këtij vendimi. Administrata tatimore pas plotësimit të kushteve ligjore kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit. Data e çregjistrimit të tatimpaguesit është data e çregjistrimit të tij pa likuidim në QKB.

45.6 Çregjistrimi/likuidimi i tatimpaguesve / subjekteve në gjykatë

45.6.1 Organizatat jofitimprurëse ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, organizatat politike, organizatat që kryejnë veprimtari fetare, humanitare, bamirëse, publike, shkencore, arsimore etj. dhe organet e tjera të ngjashme me to, çregjistrohen sipas legjislacionit përkatës. Subjektet/ tatimpaguesit e sipërpërmendur që kërkojnë të çregjistrohen për çfarëdo arsye, paraprakisht janë të vdetyruar që të paguajë të gjithë detyrimet tatimore të papaguara.

Çregjistrimi fillon në gjykatë nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së likuidimit. Gjykata, me marrjen e kërkesës për çregjistrim prej subjektit/tatimpaguesit, njofton menjëherë me shkrim organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit. Ky njoftim administrohet si informacion nga DRT-të në dosjen e tatimpaguesit. Me paraqitjen e raportit përfundimtar nga OJF-të në gjykatë, kjo e fundit njofton me shkrim DRT-së përkatëse, e cila e pasqyron këtë njoftim si kërkesë për çregjistrim të OJF-së në dosjen elektronike të saj dhe në vijim nuk i gjenërohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse.

Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit për paraqitjen në gjykatë të raportit përfundimtar të likuidimit, është e detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve dhe njofton gjykatën dhe subjektin mbi këtë situatë. Verifikimi përfshin të gjitha llojet e detyrimeve tatimore të subjektit, përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe gjobat e kamatëvonesat eventuale të lidhura me këto detyrime, si dhe deklaratat e padorëzuara. Kur organi tatimor, sipas analizës së riskut, gjykon së është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti/tatimpaguesi, atëherë ky afat nuk mund të jetë më shumë së 30 ditë kalendarike, përfshirë kryerjen e kontrollit.

Nëse nga këto verifikime apo nga kontrolli rezulton se, subjekti ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve duhet të paraqesë në gjykatë kundërshtimin e saj me shkrim për çregjistrimin e tij brenda afatit 30 ditor (kalendarike). Në kundërshtimin e çregjistrimit, tregohet shuma e detyrimeve tatimore të papaguara dhe fakti që nuk ka dorëzuar deklarata tatimore apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit përfundimtar. Pas kundërshtimit me shkrim të organit tatimor të dërguar brenda 30 ditëve kalendarike, gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin.

Nëse organi tatimor nuk i përgjigjet gjykatës brenda afatit 30-ditor (kalendarike), gjykata çregjistron subjektin/tatimpaguesin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe tatimpaguesin.

Në këtë rast, përgjegjësia është e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, drejtori i së cilës nxjerr përgjegjësinë personale të punonjësve dhe propozon masat përkatëse disiplinore ndaj tyre.

Kur subjekti paguan detyrimet e papaguara dhe dorëzon deklaratat e padorëzuara, si dhe pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit, administrata tatimore njofton menjëherë gjykatën për situatën e tij tatimore. Vërtetimi i lëshuar nga organi tatimor që konfirmon shlyerjen e detyrimeve nga subjekti, mund të paraqitet në gjykatë edhe nga vetë ai. Në këto raste gjykata kryen çregjistrimin dhe dërgon në administratën tatimore dokumentin e çregjistrimit të subjektit, përfshirë datën e çregjistrimit.

45.6.2 Në rastet e likuidimit të thjeshtëzuar, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nr. 9901, datë 14.4.2008, i ndryshuar, gjykata njofton menjëherë organin tatimor kompetent (DRT ku është regjistruar tatimpaguesi) për fillimin e kësaj procedure dhe datën e zhvillimit të seancës për shqyrtimin e kësaj kërkese. Administrata tatimore e pasqyron këtë njoftim si kërkesë për çregjistrim të personit juridik në dosjen elektronike të tij dhe në vijim nuk i gjenërohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse. Administrata tatimore, brenda datës së caktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore është e detyruar të njoftojë gjykatën për situatën tatimore të tatimpaguesit. Gjykata me marrjen e vendimit për çregjistrimin e subjektit/tatimpaguesit, njofton në të njëjtën ditë DRT -në dhe tatimpaguesin.

45.6.3 Në rastet e fillimit të procedurës së falimentimit, gjykata njofton menjëherë organin tatimor kompetent (DRT-ja ku është regjistruar tatimpaguesi) për fillimin e kësaj procedure.
Gjykata me marrjen e vendimit për fillimin, pezullimin dhe përfundimin e procedurës së falimentimi së tatimpaguesit/subjektit, njofton në të njëjtën ditë DRT-në përkatëse dhe tatimpaguesin.

45.7 Çregjistrimi i tatimpaguesve që regjistrohen vetëm në administratën tatimore.
Të gjithë personat e tjerë (entet publike qendrore ose lokale, personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant, kryefamiljarët që punësojnë individë si punëtorë shtëpie, përfaqësuesit tatimorë etj.) të regjistruar në administratën tatimore, por që nuk kanë detyrimin për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në gjykatë, kur kërkojnë të çregjistrohen, për çfarëdo arsye qoftë, janë të detyruar të paguajnë më parë të gjithë detyrimet e tyre tatimore. Kërkesa për çregjistrim paraqitet në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku tatimpaguesi është regjistruar.

Me paraqitjen e kërkesës për çregjistrim të këtyre tatimpaguesve, administrata tatimore e pasqyron këtë aplikim si "Kërkesë për çregjistrim" në dosjen ekektronike të tij dhe në vijim nga kjo datë, atij nuk i gjenërohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse.

Në rastin e çregjistrimit të përfaqësuesve tatimorë, Drejtoria Rajonale e Tatimeve të juridiksionit përkatës, brenda 10 ditëve pune nga marrja e kërkesës për çregjistrim të tatimpaguesit, kryen të gjithë verifikimet e duhura lidhur me situatën tatimore të tij. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore, si dhe gjobat dhe kamatëvonesat të lidhura me këto detyrime. Drejtoria Rajonale e Tatimeve, përveç verifikimit të situatës tatimore të tatimpaguesit, kur e gjykon të nevojshme, mund të ushtrojë edhe një kontroll tatimor, në bazë të analizës së riskut, në mjediset ku tatimpaguesi ushtron veprimtarinë e tij. Ky kontroll nuk mund të jetë më shumë sesa 30 ditë pune.

Tatimpaguesit e tjerë të regjistruar në administratën tatimore, të cilët nuk kanë detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, çregjistrohen brenda 30 ditëve nga data e aplikimit të tyre për çregjistrim. Në këtë rast administrata tatimore pajis subjektin/tatimpaguesin me dokumentin e çregjistrimit.

Tatimpaguesit, të cilët nuk i kanë paguar detyrimet tatimore apo kanë deklarata tatimore të padorëzuara, çregjistrohen vetëm pas përmbushjes së këtyre detyrimeve. Pas çregjistrimit administrata tatimore pajis subjektin/tatimpaguesin me dokumentin e çregjistrimit.

Çregjistrimi i fermerit bëhet sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar.

45.8 Efektet e çregjistrimit

Subjektet që regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përpara çregjistrimit përfundimtar dorëzojnë certifikatën e regjistrimit në QKB. Subjektet që regjistrohen në gjykatë si dhe

ato që regjistrohen vetëm në administratën tatimore, pas çregjistrimit dorëzojnë certifikatën e regjistrimit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit.

Çregjistrimi i subjektit/tatimpaguesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, gjykatë apo administratë tatimore, nuk eliminon detyrimet tatimore të papaguara dhe nuk e ndalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë me forcë detyrimet tatimore.

KREU VI
MBAJTJA E TË DHËNAVE

46. Dokumentimi dhe mbajtja e llogarive për qëllime tatimore

46.1 Personi i tatueshëm është i detyruar të mbajë regjistrime dhe të përdorë dokumentacionin tatimor në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor.

46.1.1 Një person i tatueshëm që ushtron veprimtari ekonomike e tregtare dhe është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, kur kryen një furnizim mallrash apo shërbimesh, në momentin e furnizimit, është i detyruar të lëshojë faturë tatimore të TVSH-së në lidhje me atë furnizim për çdo person të tatueshëm që merr furnizimin. Personi i tatueshëm që merr furnizimin mund të jetë një person tjetër i tatueshëm subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, një person i tatueshëm subjekt i takses vendore mbi biznesin vogel si dhe një organizatë jofitimprurëse, fondacion, njësi zbatimi projektesh, ent publik kombëtar apo vendor, organizatë politike apo çdo organ tjetër i ngjashem me to. Forma dhe përmbajtja e faturës tatimore të TVSH-së është siç përcaktohet në ligjin "Për TVSH" dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

46.1.2 Personi i tatueshëm shitës me pakicë, subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, është i detyruar gjithashtu, përveç kuponit tatimor, të lëshojë një faturë tatimore me TVSH, kur vlera e çdo furnizimi të kryer për blerësin, pavarësisht nga statusi i këtij të fundit, është më e madhe së 40 000 lekë, përfshirë TVSH. Për çdo furnizim të tillë të bërë për individët konsumatorë jotregtarë, në faturën e lëshuar nga shitësi paraqitet detyrimisht emri, mbiemri dhe adresa e blerësit.

46.1.3 Personi i tatueshëm shitës me pakicë, subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, është i detyruar gjithashtu që, përveç kuponit tatimor, të lëshojë një faturë tatimore me TVSH, pavarësisht nga vlera e furnizimit, në rastet kur marrësi i furnizimit është person i tatueshëm dhe kërkon faturë tatimore për nevoja biznesi apo kur marrësi i furnizimit, edhe kur nuk është personi i tatueshëm, e kërkon faturën.

46.1.4 Personi i tatueshëm, subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, është i detyruar të lëshojë faturë tatimore të TVSH-së edhe për çdo furnizim mallrash e shërbimesh të kryer për organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, që kryejnë veprimtari të ndryshme.

46.1.5 Kuponi tatimor lëshohet nga të gjithë personat e tatueshëm shitës me pakicë, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar të cilët sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007, janë të detyruar të pajisen me arkë regjistruese. Forma dhe përmbajtja e kuponit tatimor është përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007.

46.1.6 Dëftesa tatimore lëshohet nga të gjithë personat e tatueshëm shitës me pakicë, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin, të cilët nuk janë të pajisur me arkë regjistruese ose që, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007, në raste të veçanta mund të mos lëshojnë kupon tatimor. Rolin e dëftesës tatimore mund ta luajnë edhe dokumente të tjera të miratuara në akte të tjera ligjore apo nënligjore në fuqi, si për shembull biletat e transportit urban, interurban apo ndërkombëtar të udhëtarëve, kuponat e lëshuar nga makinat elektronike të fatit, biletat e lojerave të fatit të miratuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, etj.

46.1.7 Kuponi tatimor dhe dëftesa tatimore nuk mund të shërbëjnë si dokumente

justifikuese të shpenzimeve të zbriteshme të biznesit për blerësin, përveç rastit kur kuponi tatimor shoqërohet edhe me faturë tatimore të TVSH-së.

46.1.8 Në rastet e furnizimeve të marra nga individë të ndryshëm që nuk kanë cilësinë e tregtarit, personi i tatueshëm mund të lëshojë, për veten e tij një faturë tatimore në përputhje me dispozitat e pikës 53 të këtij udhëzimi. Kjo faturë duhet të vërtetohet nga individi furnizues nëpërmjet nënshkrimit dhe të dhënave të tjera identifikuese të tij si emër mbiemër, numër i pasaportes, etj. Personi i tatueshëm subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, si marrës i furnizimit është i detyruar që të shënoje në faturën e përgatitur për veten e tij edhe numrin e tij të identifikimit. Fatura e lëshuar si më sipër nga vetë blerësi, person i tatueshëm si subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, është dokument që justifikon shpenzimet e zbritshme të biznesit për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin.

46.1.9 Personi i tatueshëm, për çdo lëvizje të brendshme të mallrave nga magazina në magazinë, nga magazina në dyqan apo anasjelltas, nga qendra në filial, nga vendi i prodhimit në magazinë, nga vendi i prodhimit në dyqan, etj, është i detyruar të lëshojë faturën e shoqërimit të mallit. Fatura e shoqërimit të mallit lëshohet edhe në rastin e shitjeve derë më derë. Në këtë rast, në momentin e lëvizjes së mallit nga magazina e shitësit apo nga vendi i tij i prodhimit në mjetet e tij të transportit, nëpërmjet të cilëve do të realizohen shitjet derë më derë, personi i tatueshëm, subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, lëshon një faturë shoqërimi malli. Kurse në momentin e realizimit të çdo shitje të mallrave derë më derë, personi i tatueshëm lëshon për blerësin faturë tatimore të TVSH.

46.1.9.1 Në rastin kur një person i tatueshëm (shitësi) furnizon (shet) mallrat për një person tjetër të tatueshëm (blerës), por lëvizja e mallrave nëpërmjet transportit nuk kryhet në drejtim të personit të tatueshëm blerës-rishitës, por në drejtim të një personi të tretë (pritësi/blerësi i tretë), sipas kontratës së shitjes/porosisë së personit të tatueshëm blerës (rishitës), veprohet si më poshtë:

Personi i tatueshëm blerës është rishitësi i mallrave për personin e tretë (ose pritësin/blerësin e tretë). Në këtë rast personi i tatueshëm shitës në momentin që mallrat transportohen me destinacion personin e tretë lëshon fletën e shoqërimit të mallrave sipas formatit bashkangjitur këtij udhëzimi, në të cilën identifikon personin e tatueshëm blerës të mallrave dhe të dhënat identifikuese të tij, si dhe të dhënat e pritësit të mallrave, NIPT-in dhe adresën ku mallrat janë destinuar të transportohen. Kjo fletë shoqërimi e mallit duhet të shoqërojë mallrat gjatë transportit.

Fatura e shitjes së mallit lëshohet nga personi i tatueshëm furnizues (që shet) për personin e tatueshëm blerës (rishitës). Ky i fundit lëshon menjëherë faturën tatimore të shitjes dhe ia vë atë në dispozicion personit të tretë, i cili është blerësi përfundimtar, si dhe njëkohësisht pritësi i mallit, personi për të cilin mallrat janë destinuar. Fatura tatimore e shitjes e lëshuar nga blerësi- rishitës për pritësin e mallit, nga ky i fundit i bashkëngjitet fletës së shoqërimit, me anë të së cilës është transportuar dhe është bërë i disponueshëm malli. Në çdo rast transaksionet e kryera në mënyrën e mësipërme dokumentohen me kontratat përkatëse në të cilën evidentohet qartë së cili është shitësi, blerësi dhe pritësi i mallit.

Kjo procedurë zbatohet vetëm në rastet kur destinacioni i mallit është për një person të tatueshëm i tretë, pritësi i mallit, i ndryshëm ky nga personi i tatueshëm blerës – rishitës, të cilit shitësi i ka lëshuar faturën tatimore të shitjes, pavarësisht së cili është personi i tatueshëm që kryen transportin. Transportuesi mund të jetë vetë shitësi, rishitësi, blerësi ose një person i tretë transportues. Vetëm për qëllime të zbatimit të kësaj procedure lejohet të përdoret fleta e shoqërimit të mallit. Në çdo rast tjetër të parashikuar në këtë udhëzim përdoret fatura e shoqërimit sipas modelit standard. Fleta e shoqërimit të mallit hartohet në tre kopje, një prej të cilave e mban shitësi dhe dy kopje i merr transportuesi, i cili ia dorëzon pritësit të mallit. Ky i fundit një kopje e mban vetë dhe kopjen e tretë pasi e nënshkruan ia kthen transportuesit i cili ia dorëzon blerësit (rishitës).".

Shembull: Shoqëria "Alba" me adresë të ushtrimit të veprimtarisë në Tiranë ka një kontratë shitblerje

malli me shoqërinë "Agimi" me adresë të ushtrimit të veprimtarisë në Fier. Në kontratën e shitjes së mallit shoqëritë kanë rënë dakord që shoqëria "Alba" të lëshojë faturën e shitjes së mallit me TVSH për shoqërinë "Agimi" me adresë në Fier, por ndërkohë malli të transportohet me destinacion shoqërinë "Liqeni" me adresë në Pogradec. Transportuesi i mallit është , shoqëria "Trans", shoqëri transporti mallrash, e cila është kontraktuar nga shoqëria "Agimi", Fier për të lëvruar mallin nga adresa e shoqërisë "Alba" në Tiranë në adresën e shoqërisë "Liqeni" në Pogradec.

Shoqëria "Alba" në momentin që lëvron mallin nga magazina e saj lëshon fletën e shoqërimit të mallit në të cilën plotëson të dhënat identifikuese të saj si shitës, të dhënat e blerësit "Agimi" sh.p.k., të dhënat e pritësit të mallit shoqëria "Liqeni" sh.p.k., si dhe të dhënat e shoqërisë transportuese. Kjo fletë shoqërimi mbahet në tre kopje, njërën e mban shoqëria "Alba", dy kopjet i merr transportuesi i cili njërën nga kopjet pasi e nënshkruan pritësi ose blerësi i tretë ia kthen të nënshkruar nga ky i fundit shoqërisë "Agimi" sh.p.k., në rolin e rishitësit.

Nga ana tjetër shoqëria "Alba" në të njëjtën kohë që malli lëvrohet nga magazina e saj lëshon edhe faturën tatimore për blerësin – rishitës të mallit shoqërinë "Agimi" sh.p.k. Nga ana e saj shoqëria "Agimi" sh.p.k., i cili bazuar në kontratën përkatëse të shitjes me shoqërinë "Alba", si dhe në momentin që malli është lëvruar nga magazinat e "Alba" sh.p.k. ka përgjegjësinë dhe riskun mbi mallin lëshon faturën tatimore të shitjes për shoqërinë "Liqeni" sh.p.k. Shoqëria "Liqeni" sh.p.k. fletën e shoqërimit të mallit e ruan dhe kopjen e saj ia bashkëngjit faturës së shitjes së mallit, për të dokumentuar në çdo rast që ky transaksion është kryer dhe dokumentuar në kushtet e përcaktuara në pikën 46.1.9.1 të këtij udhëzimi.

46.1.10 Për mallrat e importuara nga jashtë vendit, që transportohen nga dogana ku zhdoganohet malli në drejtim të magazinës së personit të tatueshëm importues, si dokument për lëvizjen e mallit do të sherbëjë deklarata doganore e importit e lëshuar nga administrata doganore, shoqëruar edhe me faturën e lëshuar nga furnitori i huaj i mallit. Në raste furnizimesh të mëdha, ku për lëvizjen e mallit nga dogana në magazinen apo magazinat e personit të tatueshëm importues, kërkohen disa mjete dhe ngarkësa transporti, si dokument për lëvizjen e mallit do të sherbëjë një dokument shoqërimi i mallit si fatura e shoqërimit kur mund të lëshohet nga importuesi për çdo mjet transporti dhe për çdo ngarkësë ose një dokument i lëshuar nga agjencia spedicionere ose agjencia doganore për çdo mjet transporti dhe për çdo ngarkëse, së bashku me një foto kopje të deklarates doganore të importit dhe të faturës së lëshuar nga furnitori i huaj i mallit.

46.1.11 Gjatë ushtrimit të veprimtarisë për të cilën janë krijuar, organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, mund të kryejnë furrnizim mallrash apo shërbimesh si dhe të marrin pagesa për arsye të tjera të ndryshme. Në këto raste ato lëshojnë faturë të thjeshtë tatimore, me përjashtim të rasteve kur në bazë të legjislacionit tatimor në fuqi janë të detyruar të lëshojnë faturë me TVSH.

46.2 Tatimpaguesi, subjekt i TVSH-së, regjistron të gjitha transaksionet dhe veprimet financiare dhe përgatit e mban libra e regjistra kontabël, ku, pa u kufizuar vetëm në to, regjistrohen:

a) shitjet e përditshme të mallrave ose kryerja e punimeve apo e shërbimeve të tatueshme, përfshirë shumën e secilit veprim dhe shumën e tatimit të ngarkuar;

b) punimet apo shërbimet e përfunduara, por akoma të pafaturuara;

c) transaksionet e patatueshme;

ç) pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje apo pagesë, shumën e tatimit të paguar dhe emrin e adresën e furnizuesit;

d) arkëtimet dhe pagesat.

46.3 Çdo blerësi, person fizik, juridik ose individ, i lind e drejta të mos kryejë transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose kuponin tatimor, në përputhje me këtë ligj.

Për këtë qëllim, tatimpaguesi detyrohet të afishojë në një vend të dukshëm, në adresën ku kryen veprimtarinë, një njoftim për blerësin në përputhje me këtë nen.

47. Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave nga tatimpagueist e biznesit të vogël

47.1.1 Personi i tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe i tatimit mbi të ardhurat, kur kryen një furnizim mallrash apo shërbimesh, në momentin e furnizimit, është i detyruar të lëshojë faturë të thjeshtë tatimore në lidhje me atë furnizim për çdo person të tatueshëm që merr furnizimin, përveç rasteve kur, në bazë të legjislacionit tatimor në fuqi, është person i tatueshëm i TVSH-së dhe është i detyruar të lëshojë faturë me TVSH. Forma dhe përmbajtja e faturës së thjeshtë tatimore është përcaktuar në ligjin "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, dhe në udhëzimin në zbatim të këtij ligji "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël". Për blerësin, person i tatueshëm, subjekt i çfarëdolloj tatimi, kjo faturë shërben si dokument justifikues për shpenzimet e zbritshme të biznesit. Forma dhe përmbajtja e faturës së thjeshtë tatimore është përcaktuar në ligjin "Për sistemin e taksave vendore" dhe në udhëzimin në zbatim të këtij ligji. Për blerësin, person i tatueshëm, subjekt i çfarëdolloj tatimi, kjo faturë shërben si dokument justifikues për shpenzimet e zbritshme të biznesit.

47.1.2 Personi i tatueshëm, tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është i detyruar të lëshojë faturë të thjeshtë tatimore edhe për çdo furnizim mallrash e shërbimesh të kryer për organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, që kryejnë veprimtari të ndryshme.

47.1.3 Personi i tatueshëm shitës me pakicë, tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, për çdo shitje në njësitë e shitjes me pakicë, të kryer për individë konsumatorë finalë, është i detyruar të lëshojë kupon tatimor me arkë regjistruese dhe në mungese të saj dëftese tatimore.

47.1.4 Kuponi tatimor lëshohet nga të gjithë personat e tatueshëm tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël të cilët sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007, janë të detyruar të pajisen me arkë regjistruese. Forma dhe përmbajtja e kuponit tatimor është përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007.

47.1.5 Dëftesa tatimore lëshohet nga të gjithë personat e tatueshëm shitës me pakicë, tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të cilët nuk janë të pajisur me arkë regjistruese ose që, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 nuk janë të detyruar të pajisen me arkë regjistruese ose arka regjistruese e të cilëve për çfarëdo arsye nuk është në gjendje pune. Rolin e dëftesës tatimore mund ta luajnë edhe dokumente të tjera të miratuara në akte të tjera ligjore apo nënligjore, si për shembull biletat e transportit të udhetareve.

47.1.6 Kuponi tatimor i lëshuar me arkë regjistruese dhe dëftesa tatimore nuk mund të shërbëjnë si dokumente justifikuese të shpenzimeve të zbritshme të biznesit për blerësin, përveç rastit kur kuponi tatimor shoqërohet edhe me fature të thjeshtë tatimore.

47.1.7 Personi i tatueshëm, tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, për çdo lëvizje të brendshme të mallrave nga magazina në magazine, nga magazina në dyqan, apo anasjelltas, nga vendi i prodhimit në magazine apo nga vendi i prodhimit në dyqan, është i detyruar të lëshojë faturën e shoqërimit të mallit. Për lëvizjen e mallrave të importuara nga jashtë vendit do të veprohet siç është përcaktuar në pikën 46.1.10 më sipër, të këtij udhëzimi.

48. Afati i ruajtjes së dokumentacionit

48.1 Tatimpaguesi është i detyruar të mbajë regjistrat, librat dhe skedarë elektronikë ose manualë që përmbajnë informacionin financiar të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të veprimeve tregtare e biznesore të tatimpaguesit, në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe legjislacionin tatimor.

48.2 Sipas pikës 2 të nenit 48 të ligjit, të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga personat e tatueshëm, për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit ushtrimor, të cilit i përkasin dokumentet. Dokumentacioni bazë si faturat tatimore të TVSH-së dhe faturat e thjeshta tatimore, regjistrat dhe të gjitha regjistrimet e bëra në këto regjistra, librat kontabël dhe të gjitha regjistrimet e bëra në këto libra, të cilat mbahen siç përcaktohet në ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", raportet financiare, librat e shitjes dhe librat e blerjes, të

cilat mbahen siç përcaktohet në ligjin "Për TVSH-në" dhe në udhëzimin në zbatim të tij, ruhen për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit ushtrimor në të cilin ato janë lëshuar. Kjo do të thotë që, një faturë tatimore e lëshuar në muajin janar të vitit 2003, duhet të ruhet deri më 31 dhjetor 2008.

49. Fatura tatimore

49.1 "Faturë tatimore" konsiderohet fatura me TVSH, e cila lëshohet nga personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo subjekte të tatimit mbi fitimin dhe fatura e thjeshtë tatimore, e cila lëshohet nga persona të tatueshëm, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, kur nuk janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar, si dhe nga organizatat jofitimprurëse, fondacionet, institucionet buxhetore etj. Fatura tatimore përgatitet në jo me pak së dy kopje. Kur furnizuesi i mallrave apo shërbimeve e gjykon të nevojshme ose kur dispozitat e legjislacionit tatimor e kërkojnë një gjë të tillë, fatura lëshohet në më shumë së dy kopje. Kopjen origjinale të faturës tatimore të shitjes e merr dhe e ruan kurdohere blerësi, pasi vetëm kopja origjinale i jep të drejtë atij për të kredituar TVSH (kur është rasti) dhe për të justifikuar shpenzimet e zbritshme të biznesit për efekt të tatimit mbi fitimin apo të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të biznesit të vogël. Në rastin e humbjes së kopjes origjinale të faturës së blerjes, për efekt të njohjes së shpenzimeve të zbritshme të biznesit mund të sherbëjë edhe kopja e noterizuar e faturës, me kushtin që ajo, nga verifikimi të rezultojë e deklaruar nga shitësi.

49.2 Faturat tatimore për shitjen e sendeve apo kryerjen e punimeve e të shërbimeve janë dokumentet bazë ku bazohen regjistrimet e mëtejshme përllogaritjet e detyrimit tatimor.

49.3 Fatura tatimore përmban numrin rendor, numrin serial, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e transportit dhe emrin e transportuesit, emërtimin e mallit apo shërbimit, çmimin për njësi (kur është rasti) dhe vleftën e plotë të shitjes dhe, nëse është rasti, rritjet ose zbritjet e tjera të zbatuara, si dhe shumat e totale cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës.

49.4 Shfuqizuar.

50. Fatura tatimore me TVSH

50.1 Forma dhe përmbajtja e faturës tatimore me TVSH përcaktohen në përputhje me ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe udhëzimin përkatës në zbatim të atij ligji.

50.2 Personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin, janë të detyruar që për çdo furnizim mallrash apo shërbimesh të lëshojnë fature me TVSH. Në rastet kur një person i tatueshëm furnizon një sasi të konsiderueshme artikujsh në të njëjtën kohë e për të njëjtin klient dhe është i pamundur regjistrimi i këtyre artikujve në një faturë të vetme, ai mund t'i bashkëngjisë kësaj fature listën e artikujve të furnizuara, e cila përmban të dhënat e furnizuesit dhe blerësit, emërtimet, njësinë, sasinë dhe vleftën e çdo artikulli, datën e transaksionit dhe nënënshkrimin e palëve. Fatura tatimore e lëshuar në këtë rast përmban vleftën totale të transaksionit të kryer.

50.3 Faturë tatimore nuk lëshohet për çdo shitje me pakicë kur përdoret pajisja fiskale, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

50.4 Lëvizja e mallrave gjatë transportit shoqërohet me faturën origjinale të shitjes së mallit ose me faturë shoqëruese në rastet e lëvizjes së brendshme të mallrave, ose në rastin e lëvizjes së mallrave apo pajisjeve që janë pjesë e kryerjes së një shërbimi. Në rastin e shitjes së mallrave me destinacion një person të tatueshëm të ndryshëm nga vendndodhja e blerësit-rishitës siç përcaktohet në pikën 46.1.9.1 të këtij udhëzimi lëvizja e mallit gjatë transportit shoqërohet me dokumentin e emërtuar "Fletë shoqërimi malli", sipas formatit të miratuar me këtë udhëzim.

Shembull: Një shoqëri e vendosur në Tiranë ka fituar tenderin për rikonstruksionin e një spitali në Durrës. Për rikonstruksionin e spitalit shoqërisë i nevojiten materiale dhe pajisje që përdoren për rikonstruksionin. Sipas kontratës shoqëria do t'i faturojë çdo muaj spitalit për shërbimin e rikonstruksionit të kryer sipas situacioneve përkatëse. Në këtë rast në zbatim të pikës 50.4 të udhëzimit lëvizja e mallit gjatë transportit shoqërohet me faturë shoqërimi malli, pasi në këtë rast lëvizja e materialeve dhe pajisjeve nga Tirana

në Durrës në adresën të spitalit kryhet për qëllime të kryerjes së shërbimit të rikonstruksionit. Malli ose materialet të cilat përdoren për rikonstruksionin situacionohen dhe faturohen sipas punimeve të kryera.

50.5 Në rastet kur transporti kryhet me mjete të shitësit ose të blerësit, ky fakt shënohet në pjesën e faturës ku kërkohen të dhënat e transportuesit, si dhe jepen të dhënat identifikuese të mjetit të transportit, destinacionit dhe të shoferit. Këto të dhëna duhet të specifikohen edhe sipas çdo destinacioni të kryer nga mjeti, nëse e njëjta sasi malli e faturuar dhe e transportuar me mjetet e blerësit apo të shitësit, mund të kryhet prej tyre me më shumë së një mjet.

50.6 Normalisht data e lëshimit të faturës përputhet me datën e nisjes së transportit. Në rastet kur këto data nuk përputhen, pra kur transportimi i mallit bëhet pas datës së lëshimit të faturës së mallit, ky fakt nuk përbën arësye që malli të bllokohet apo konfiskohet dhe transportimi i mallit nuk pengohet. Kur gjykohet e arësyeshme mund të bëhen verifikime tek shitësi dhe/ose blerësi, ose të informohen drejtoritë rajonale të juridiksionit, të cilat e përdorin informacionin për verifikime apo kontrolle të mëvonëshme.

50.7 Në rastet kur transporti i mallrave kryhet nga palë të treta (shoqëri transporti), lëvizja e mallit shoqërohet me faturën e shitjes së mallit, e cila ka të dhëna edhe për transportuesin dhe datën e transportit. Transportuesi gjatë transportimit disponon kopien e parë të faturës me TVSH, e cila i dorëzohet blerësit. Kopja e dytë e faturës origjinale mbahet nga transportuesi.

50.8 Fatura e shërbimit të transportit (që lëshohet nga transportuesi) jo domosdoshmërisht duhet të mbajë datën e transportimit të mallit dhe jo domosdoshmërisht duhet të shoqërojë lëvizjen e mallit gjatë transportit. Fatura e shërbimit të transportit duhet të ketë të dhëna referuese të faturave të shitjes së mallrave për të cilat është kryer dhe faturohet shërbimi i transportit.

50.9 Në rastet kur arkëtimi i pagesës bëhet para lëvrimit të mallit ose kryerjes së shërbimit, shitësi lëshon faturë për arkëtimin e pagesës paradhënie (për efekt të pagimit të TVSH-së), e cila stornohet (anulohet, zbritet) pasi lëshohet fatura e shitjes së mallit.

50.10 Shfuqizuar.

51. Lëshimi i faturës tatimore

51.1 Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak së dy kopje, nga të cilat njërën e merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetrën e mban dhe e ruan shitësi.

51.2 Mallrat e shitura, transportuara, apo blera pa dokument tatimor (faturë tatimore ose faturë shoqërimi ose fletë shoqërimi) i nënshtrohen parashikimeve në përputhje me nenin 121 të ligjit dhe pikës 121 të këtij udhëzimi.

51.3 Vlera e tregut për mallrat e konstatuara pa dokument tatimor në zbatim të pikës 1 të nenit 121 të ligjit, përcaktohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore bazuar në:

a) të dhënat reale të çmimeve të shitjes për ato produkte të aplikuara nga shitësi dhe blerësi;

b) të dhënat reale të çmimeve të shitjes për ato produkte të paguar nga blerës të tjerë;

c) të dhënat reale të çmimeve të shitjes të të njëjtit produkt të përdorur nga operatorë të tjerë;

ç) çmimet e references së doganës;

d) të dhëna të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet strukturave të saj lidhur me çmimet;

e) rregulloren e Ministrit të Financave nr.1 datë 11.2.2002 "Për transferimin e çmimeve".

Kriteret e mësipërme zbatohen njëri pas tjetrit. Pra kalohet në kriterin vijues kur nuk disponohen të dhëna për zbatimin e kriterit paraardhës.

52. Prodhimi dhe shperndarja e dokumenteve tatimore

52.1 Prodhimi dhe shpërndarja e faturës tatimore me TVSH, faturës së thjeshtë tatimore, dëftesës tatimore dhe faturës shoqëruese bëhet ose autorizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e

Tatimeve. Këto dokumente duhet detyrimisht të jenë në formën dhe përmbajtjen e miratuar nga Ministri i Financave me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

52.2 Kriteret që duhet të plotësojnë personat, që licencohen për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor, kushtet e shtypjes, informacionin që duhet të përmbajnë, standardet e sigurisë, si dhe rregullat e shpërndarjes e të vënies në dispozicion të tatimpaguesve të faturave tatimore, përcaktohen në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

52.3 Në rastet kur shërbimi i shtypjes dhe shpërndarjes së dokumenteve tatimore bëhet nga subjekte tregtare private, autorizimi për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumenteve tatimore lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

52.4 Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me kërkesë të tatimpaguesit, pavarësisht nga numri i transaksioneve të kryera, lejon mospërdorimin e faturave tatimore të TVSH-së me numër serial të parashtypur, kur tatimpaguesi është i aftë të lëshojë fatura tatimore kompjuterike për çdo transaksion të tatueshëm, me numër serial unik dhe të papërsëritshëm, të printuara nga sistemi i tij i regjistrimeve.

Për të ushtruar këtë të drejtë tatimpaguesi paraprakisht duhet të disponojë miratimin e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe të jetë pajisur me diapazonin e numrave serial përkatës.

52.4.1 Për këtë qëllim tatimpaguesi paraqet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve:

a) Një kërkesë me shkrim të shoqëruar me deklaratën ose vërtetimin përkatës, në të cilin tregohet së sistemi i tij i regjistrimeve është i kompjuterizuar dhe i aftë të prodhojë fatura tatimore me numër serial unik dhe të papërsëritshëm për çdo transaksion.

b) Modelin e faturës kompjuterike që kërkon të përdorë, e cila duhet të përmbajë elementët dhe të dhënat e përcaktuara në ligjin për TVSH-në;

Tatimpaguesi tregon në kërkesën e paraqitur numrin e transaksioneve që parashikon të kryejë në një periudhë tatimore. Kjo e dhënë është e rëndësishme për të gjykuar në lidhje me planifikimin nga ana e organit tatimor të numrave serial që do t'i akordohen një tatimpaguesi.

52.4.2 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve brenda 15 ditëve, pas verifikimit nëse fatura tatimore kompjuterike që personi i tatueshëm kërkon të përdorë, përmban të gjithë të dhënat, elementet e nevojshme të kërkuara nga ligji në përputhje me veprimtarinë që kryen, pavarësisht numrit të transaksioneve të kryera nga tatimpaguesi, shprehet për miratimin e përdorimit të modelit të faturës tatimore kompjuterike, duke lëshuar miratimin përkatës për tatimpaguesin dhe njoftuar në të njëjtën kohë me shkrim tatimpaguesin dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore.

Pas miratimit të përdorimit të faturës tatimore kompjuterike të shitjes, tatimpaguesi menjëherë paraqitet dhe tërheq numrat serial në dispozicion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar.

Në çdo rast procedura sipas këtij udhëzimi që nga data e paraqitjes së kërkesës deri në pajisjen më numër serial nga Drejtoria Rajonale Tatimore nuk duhet të zgjasë më shumë së 30 ditë kalendarike.

52.4.3 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe drejtoritë rajonale tatimore evidentojnë në një regjistër të posaçëm tatimpaguesit që kanë miratimin e përdorimit të faturës kompjuterike dhe numrat serial përkatës të akorduar.

Çdo faturë e lëshuar sipas modelit të miratuar duhet të përmbajë detyrimisht shënimin "Përdorimi i kësaj fature është miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me shkresën nr……, datë……".

Për çdo ndryshim në modelin, përmbajtjen, formatin e faturës për të cilën është miratuar e drejta e përdorimit, personi i tatueshëm duhet të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pasi modeli i faturës së miratuar ruhet dhe bëhet pjesë e dosjes së tatimpaguesit. Nuk konsiderohet ndryshim përfshirja në sfondin e faturës ose në një sipërfaqe të caktuar të saj, e elementeve të reklamave, nëse ato nuk ndryshojnë formatin e faturës.

Në asnjë rast miratimi i faturës tatimore kompjuterike nuk u akordohet tatimpaguesve që janë në regjistrin pasiv të tatimpaguesve.

52.4.4 Kur konstatohet së personi i tatueshëm për transaksionet e kryera lëshon faturë

tatimore kompjuterike jo sipas modelit që i është miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, ose ka bërë ndryshime në faturë për të cilat nuk ka njoftuar ndryshimet, ose nëse faturat e lëshuara nuk përmbajnë numër serial të miratuar, apo nuk përmbajnë shënimin që tregon aktin referues të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me të cilin është miratuar fatura, dënohen sipas dispozitave të ligjit dhe të këtij udhëzimi.

Nëse konstatohet së personi i tatueshëm ka keqpërdorur miratimin për përdorim të faturës tatimore kompjuterike, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka të drejtë të rishqyrtojë miratimin e dhënë për një periudhe të paktën 2-vjeçare.

52.5 Në raste të veçanta, duke përdorur të njëjtat kritere të dhëna në pikën 52.4 më lart, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve autorizon përdorimin e faturave kompiuterike për faturat e shoqërimit dhe për faturat ë thjeshta tatimore, sipas rastit, për tatimpaguesit e tvsh-së, për tatimpaguesit e biznesit të vogël, organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to.

53. Faturat tatimore të përgatitura nga blerësi

53.1 Në rastin e shitjeve nga individët, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, fatura përgatitet nga blerësi, ushtrues i veprimtarisë tregtare, me kusht që dokumenti të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj dhe vërtetohet nga furnizuesi. Fatura e përdorur në këtë rast është fatura tatimore me numur serial që blerësi subjekt tregtar përdor në aktivitetin e tij.

Personi i tatueshëm si marrës i furnizimit është i detyruar që të shënojë në faturën e përgatitur për veten e tij të dhënat identifikuese të shitësit. Fatura e lëshuar si më sipër nga vetë blerësi, person i tatueshëm është një dokument që justifikon shpenzimet e zbritshme të biznesit për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin.

P.sh. një tatimpagues grumbullues produktesh bujqësore blen produkte bujqësore apo blektorale nga fermerë të vegjël të paregjistruar në tatime. Në këtë rast blerësi përpilon një faturë ku figuron si blerës dhe ku vendos të dhënat identifikuese të shitësit individ dhe sasinë dhe vleftën e mallit të blerë prej tij. Për këtë qëllim mund të shërbejë, sipas rastit, fatura tatimore me TVSH ose fatura e thjeshtë tatimore, të cilat tatimpaguesi i përdor normalisht në biznesin e tij në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këto fatura shënohet gjithashtu në një vend të dukshëm "Faturë e lëshuar nga blerësi".

Po kështu, një shoqëri tregtare paguan një individ vendas ose të huaj (që nuk është i regjistruar në organet tatimore shqiptare) për një shërbim rastësor konsulence, përkthimi, etj., Në këtë rast shoqëria përfituese e shërbimit përpilon një faturë, e cila përfshirë shënimin "Faturë e lëshuar nga blerësi", të dhënat identifikuese të individit shitës të shërbimit, vleftën e shërbimit dhe tatimin që mbahet në burim të llogaritur për pagesën e këtij shërbimi.

53.2 Ministri i Financave, me udhëzim, mund të parashikojë forma të posaçme dokumentesh, që zëvendësojnë faturën tatimore.

54. Kuponi tatimor i lëshuar nëpërmjet paisjeve fiskale

54.1 Kuponi tatimor është dokument i lëshuar me ane të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi. Forma dhe përmbajtja e kuponit tatimor është siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007 "Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

54.2 Subjektet e detyruara të lëshojnë kupona tatimorë duhet të lëshojnë edhe faturë tatimore me TVSH në rastet e parashikuara në pikat 46.1.2 dhe 46.1.3 të këtij udhëzimi.

54.3 Personat e tatueshëm që shesin mallra për konsum final apo ofrojnë shërbime, në njësi të përherëshme të hapura për publikun duhet të instalojnë paisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë. Kuponi tatimor lëshohet në dy kopje, një nga të cilat është kopje leter që i

jepet klientit konsumator të mallrave apo shërbimeve të blera dhe tjetra i mbetet vete personit të tatueshëm në shiritin e kontrollit të arkës regjistruese. Kuponi tatimor është dokumenti nëpërmjet të cilit realizohet transparenca e duhur në mardhenjet e çdo biznesi me klientet e tij.

Për personat e tatueshëm, të cilët kryejnë furnizime të shërbimeve të natyrës bar-kafe, restorant, mensa, ku konsumohen pije dhe ushqime, lëshimi i kuponit tatimor duhet të bëhet për çdo porosi të kryer. Me porosi të kryer nuk nënkuptohet porosia nga çdo person, por porosia e kryer për çdo tavolinë. Ndërkohë nëse e njëjta klientelë kryen një porosi të dytë, atëherë me dorëzimin e porosisë ajo pajiset me kuponin tatimor për porosinë e dytë.

54.4 Kuponat e kasës ose dëftesat tatimore nuk njihen si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin ushtrues veprimtarie tregtare, përveç rastit kur janë të shoqëruara me faturë tatimore.

54.5 Personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin që shesin mallra apo shërbime me pakicë por nuk janë të detyruar të pajisen me arkë regjistruese ose pajisje të tjera fiskale, si dhe personat e tatueshëm tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël që shesin mallra e shërbime me pakicë, por që gjithashtu nuk janë të detyruar të kenë arkë regjistruese ose pajisje të tjera fiskale, janë të detyruar të lëshojnë për çdo shitje që kryejnë dëftesa tatimore. Dëftesa tatimore është e detyruar të lëshohet edhe në çdo rast tjetër që arkat regjistruese apo pajisjet e tjera fiskale, për çfarëdo arsye qoftë, nuk janë në gjendje pune. Dëftesa tatimore lëshohet në dy kopje, një nga të cilat i jepet klientit konsumator të mallrave apo shërbimeve të blera dhe tjetra mbetet në bllokun e vete personit të tatueshëm.

54.6 Deri në datën 31.3.2016, tatimpaguesit që kryejnë shitje me shumicë të mallrave në adresa të identifikuara veçmas për shitje me shumicë në përputhje me përcaktimet e nenit 59 të ligjit, shitjet me kupon tatimor të lëshuar nga pajisja fiskale në këto vende biznesi, për blerës joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë), nuk duhet të tejkalojnë 10 për qind të vlerës së tatueshme të mallrave të shitura në të njëjtën periudhë tatimore të muajit të vitit të kaluar, pa përfshirë TVSH-në.

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, vetëm për tatimpaguesit të cilët, kanë filluar aktivitetin ekonomik gjatë këtij viti, shitjet me kupon të lëshuara nga pajisja fiskale nuk duhet të tejkalojnë 10 për qind të vlerës së tatueshme (pa përfshirë TVSH-në) të mallrave të shitura për periudhën tatimore gjatë së cilës kanë ushtruar aktivitet.

Për tatimpaguesit që kryejnë vetëm shitje me shumicë, shitjet me kupon tatimor të lëshuar nga pajisja fiskale, për blerës joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë), nuk duhet të tejkalojnë 10 për qind të vlerës së tatueshme të mallrave të shitura në të njëjtën periudhë tatimore të muajit të vitit të kaluar, pa përfshirë TVSH-në.

Për tatimpaguesit (prodhues, tregtues apo importues), të cilët tregtojnë edhe me shumicë për tatimpagues të tjerë të regjistruar, por njëkohësisht kanë si pjesë të biznesit të tyre në adresa të ndara nga njëri-tjetri, edhe njësitë e tregtimit me pakicë për publikun (rrjet dyqanesh) të pajisura me NIPT-e sekondare dhe pajisje fiskale me vete, ky kufizim nuk zbatohet për shitjet e kryera në adresat e identifikuara veçmas si njësi të shitjes me pakicë.

Automjetet e pajisur me NIPT sekondare, të cilat përdoren për shitjet me shumicë "derë më derë", nuk konsiderohen njësi të tregtimit me pakicë.

Nga data 1 prill 2016, tatimpaguesit që kryejnë shitje me shumicë të mallrave në adresa të identifikuara veçmas për shitje me shumicë në përputhje me përcaktimet e nenit 59 të ligjit, nuk lejohen në këto njësi të tregtimit me shumicë të shesin tek blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë).

55. Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale dhe për vendosjen e sistemeve të monitorimit të qarkullimit

55.1 Tatimpaguesit që kryejnë qarkullimin e mallrave ose shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, ose institucioneve financiare të parasë elektronike, të licencuara nga Banka e Shqipërisë, janë të detyruar të përdorin sistemin fiskal nëpërmjet përdorimit të

pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin në mënyrë të detyrueshme të kuponit tatimor.

Këta tatimpagues janë të detyruar të pajisen, të përdorin dhe të mirëmbajnë pajisjet fiskale në përputhje me dispozitat e vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 781, datë 14.11.2007, "Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

55.2 Tatimpagues në sektorë të veçantë të ekonomisë, siç përcaktohet në VKM-në janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sisteme të monitorimit të qarkullimit.

55.3 Tatimpaguesi është i ndaluar të mbajë apo përdorë pajisje fiskale dhe sisteme monitorimi të qarkullimit, të ndryshme nga ato të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore apo akteve nënligjore në zbatim të ligjit.

56. Mbledhja e të dhënave të paisjeve fiskale

Ministri i Financave mund të vendosë me udhëzim të posaçëm për krijimin dhe funksionimin e një sistemi automatik të mbledhjes së të dhënave të regjistruara nga paisjet fiskale.

57. Mbajtja e regjistrimeve kontabile për qëllime tatimore

57.1 Personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin, janë të detyruar të mbajnë llogari, regjistrime dhe regjistra për të gjitha ngjarjet dhe veprimet që përfshijnë furrnizimet e kryera nga ana e tyre, furnizimet e marra prej tyre nga persona të tjerë, për të gjitha importet nga jashtë vendit dhe eksportet për jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe me aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tij.

57.2 Për regjistrimin e veprimeve ekonomike e tregtare, që lidhen me detyrimet tatimore, përdoren edhe librat, regjistrat apo dokumentacioni, i përcaktuar në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, në ligjin për tatimin mbi të ardhurat, në ligjin për akcizat, në ligje të tjera të veçanta tatimore dhe në aktet nënligjore në zbatim të tyre. Regjistrimi i operacioneve ekonomike e tregtare të personit të tatueshëm në libra dhe regjistra bëhet në mënyrë kronollogjike dhe sistematike. Këto regjistrime do të sherbëjnë si bazë për vetëvlerësimin dhe vetëdeklarimin e detyrimeve tatimore të personave të tatueshëm apo, kur është rasti, për përcaktimin e detyrimit tatimor të tyre.

57.3 Regjistrat dhe librat, nga ana e personave të tatueshëm, mund të mbahen edhe në formë elektronike. Regjistrat dhe librat e mbajtur në format elektronik duhet të garantojnë, në çdo kohë, një pasqyrim të plotë të veprimeve ekonomike dhe të të dhënave për tatimet. Në këtë rast, personi i tatueshëm është i detyruar të lejojë hyrjen e administratës tatimore në çdo kompjuter ku janë mbajtur librat dhe regjistrat.

57.4 Si regjistër për evidentimin e shitjeve me pakicë të kryera nga personat e tatueshëm shërbejnë edhe regjistrimet e bëra në memorjen e pajisve fiskale apo pajisjeve elektronike. Qarkullimi ditor i memorizuar në këto pajisje, hidhet për çdo ditë, me një shifër të vetme në librin e shitjeve. Në të njëjten mënyrë veprohet edhe për shitjet me pakicë të dokumentuara me dëftesa tatimore. Totali i qarkullimit të realizuar sipas gjithë dëftesave tatimore të lëshuara gjatë një dite, hidhet me një shifër të vetme në librin e shitjeve.

57.5 Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, për përllogaritjen e detyrimit tatimor, janë të detyruar të mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe të lëshojnë fatura tatimore, dëftesa tatimore dhe kuponë tatimorë, në përputhje me ligjin "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, dhe udhëzimin "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", në zbatim të tij. Këto regjistrime do të shërbejnë si bazë për vetëvlerësimin dhe vetëdeklarimin e detyrimeve tatimore të personave të tatueshëm apo, kur është rasti, për përcaktimin e detyrimit tatimor.

Për tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, që

janë të regjistruar në TVSH, libri i shitjeve dhe libri i blerjeve, të mbajtura për efekte të TVSH-së, shërbejnë si të tillë edhe për efekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

58. Dokumentimi i mallrave

58.1 Të gjithë personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin dhe personat e tatueshëm, tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, mallrat gjendje në çdo vend biznesi, mallrat në transport apo mallrat në përdorim për çfarëdo arsye qoftë, janë të detyruar t'i justifikojnë me dokumentin e nevojshëm tatimor. Dokumenti i nevojshëm tatimor që provon pronësinë apo kontrollin mbi mallrat gjendje dhe në përdorim janë faturat tatimore të TVSH-së, faturat e thjeshta tatimore dhe dokumentacioni i prodhimit. Kurse si dokument i nevojshëm tatimor që provon pronesine apo kontrollin mbi mallrat gjatë transportit është fatura tatimore e TVSH-së, fatura e thjeshtë tatimore ose fatura e shoqërimit të mallit, në rastet kur mallrat që transportohen nuk janë destinuar për shitje, por për lëvizje të brendshme, siç përcaktohet në pikën 46.1.9 dhe 46.1.10 më sipër të këtij udhëzimi. Fleta e shoqërimit të mallit përdoret për të shoqëruar mallin gjatë transportit, vetëm në rastin kur transaksioni është kryer në kushtet e parashikuara në pikën 46.1.9.1 të këtij udhëzimi.

58.2 Kur gjatë kontrolleve që ushtrohen nga strukturat e administratës tatimore, konstatohet së mungon dokumentacioni i kërkuar ligjor për dokumentimin e mallit, zbatohen dispozitat e parashikuara në nenin 121 të ligjit dhe pikës 121 të këtij udhëzimi. Kjo procedurë shoqërohet me procesverbalet përkatës. Mallrat e padokumentuara inventarizohen dhe me qëllim dokumentimin e tyre tatimpaguesi detyrohet të lëshojë një faturë si faturë nga blerësi sipas nenit 53 të ligjit. Tatimpaguesi i cili në këtë rast konsiderohet së ka kryer shkelje për sa nuk ka dokumentuar mallin me faturë në rolin e shitësit ose nuk ka marrë faturë në rolin e blerësit dhe për pasojë nuk ka paguar TVSH-në përkatëse në blerje, ose nuk ka llogaritur TVSH-në në shitje, dënohet sipas nenit 121 të ligjit.

58.3 Shfuqizuar.

58.4 Shfuqizuar

59. Pagesat me para në dorë

59.1.1 Në zbatim të pikës 1 të nenit 59 të ligjit, personat e tatueshëm nuk mund të kryejnë midis tyre transaksione shitjeje dhe blerjeje me lekë në dorë, kur vlera e çdo transaksioni është më e madhe se *150 mijë lekë*. Kryerja me lekë në dorë dhe jo nëpërmjet kalimit nga llogaria likuiduese e blerësit në llogarinë likuiduese të shitësit e transaksioneve të shitblerjes që e kalojnë vlerën *150 mijë lekë,* përbën shkelje si për shitësin, ashtu dhe për blerësin dhe dënohet, sipas nenit 120 të ligjit me një gjobë sa 10 për qind e vlerës së çdo transaksioni të kryer me lekë në dorë. Konsiderohet shkelje e pikës 1 të nenit 59 të Ligjit dhe zbatohen sanksionet e parashikuara në nenin 120 të tij edhe rasti kur, me qëllimin për të shmangur likujdimin e detyrimeve nëpërmjet kanaleve bankare, personat e tatueshëm, shitës dhe blerës, fraksionojnë ose ndajnë në disa fatura një furnizim apo transaksion të kryer, i cili në kushte normale të personave jo të lidhur do të realizohej si një transaksion i vetëm.

Kufizimi i parashikuar në nenin 59 të ligjit dhe në këtë pikë të udhëzimit jepet për transaksionet mbi vlerën 150 mijë lekë që kryhen me para në dorë ndërmjet dy personave të tatueshëm, fizikë ose juridik tregtarë. Mosrespektimi i tij konsiderohet shkelje dhe aplikohet dënimi i përcaktuar në përputhje me përcaktimet e nenit 120 të ligjit. Ky kufizim nuk aplikohet kur pagesa kryhet për një transaksion midis një personi tregtar dhe një individi, pavarësisht së vlera e transaksionit është mbi 150 mijë lekë.

Shembull: Një individ, ditën e shtunë shtrohet me urgjencë në një spital privat i regjistruar si tatimpagues dhe i nënshtrohet një ndërhyrje kirurgjikale në zemër. Spitali kërkon kryerjen e një pagese prej 200.000 lekë paradhënie për hospitalizimin. Individi ose të afërm të tij kryejnë pagesën në arkën e spitalit dhe pajisen me kuponin tatimor si pagesë e kryer me para në dorë, si dhe me faturën përkatëse tatimore, pasi vlera e transaksionit është mbi 40.000 lekë. Kjo pagesë e kryer me para në dorë nuk është objekt i kufizimit të përcaktuar në nenin 59 dhe në këtë pikë të udhëzimit dhe si e tillë nuk është e detyrueshme të kryhet nga llogaria bankare e blerësit në llogarinë bankare të shitësit.

59.1.2 Për të verifikuar nëse ndarja në shume fatura e një transaksioni është bërë me

qëllim shmangien e pagesave nëpërmjet llogarive bankare dhe për të përcaktuar rastet e fraksionimit apo ndarjes së një fature e cila normalisht duhet të konsierohet si një e vetme, administrata tatimore analizon me kujdes formën e transaksionit të kryer dhe mundësinë që ai të jetë fraksionuar me qëllim shmangien e pagesave nëpërmjet llogarive likuiduese bankare, duke marrë në konsideratë faktore të tillë si:

a) Natyrën dhe funksionet e pjesëve përbërëse të furnizimit, të cilat janë fraksionuar në disa fatura;

b) Kapacitetin e mjetit me të cilin janë transportuar furnizimet e fraksionuara (p.sh. me një mjet 25 tonësh shitësi ka bërë disa furnizime, secila me peshë 2-3 tonë, duke lëshuar jo një por disa fatura me vlerë nën 1 milion lekë).

59.1.3 Për qëllime të zbatimit të kësaj dispozite, nuk konsiderohet si transaksion i kryer me para në dorë, pagesa për transaksionet, e cila kryhet nëpërmjet institucioneve financiare të parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë, ose pagesat e kryera me kartë krediti. Një tatimpagues i cili likuidon një faturë nëpërmjet institucioneve financiare të parasë elektronike edhe kur vlera e transaksionit është më shumë së 150.000 lekë, atëherë për qëllime të zbatimit të kufizimit për transaksionet mbi 150.000 lekë, ky transaksion nuk konsiderohet i kryer me para në dorë. Gjithashtu edhe pagesat e kryera me kartë krediti, për transaksione të ndryshme midis dy personave të tatueshëm nuk konsiderohen të kryera me para në dorë. Kështu kur një agjenci turistike e cila likuidon restorantin ose kryen pagesën e një muzeu për vizitën në muze të turistëve për qëllime të paketave turistike nëpërmjet kartës së kreditit të agjencisë, nuk konsiderohet së e ka kryer transaksionin me para në dorë.

59.2 Afishimi i çmimeve

59.2.1 Në zbatim të pikës 2 të nenit 59 të ligjit, personat e tatueshëm, që kryejnë furnizime mallrash apo shërbimesh, janë të detyruar të afishojnë çmimet e shitjes së mallit apo të shërbimit që furnizojnë, pavarësisht nga natyra e furnizimit dhe nga statusi i blerësit. Kjo dispozitë është e detyrueshme për të gjithë personat e tatueshëm, si për ata që bëjnë furnizime mallrash apo shërbimesh me pakicë, ashtu dhe për ata që bëjnë furnizime mallrash apo shërbimesh me shumicë, pavarësisht nga fakti nëse janë persona të tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar e të tatimit mbi fitimin apo persona të tatueshëm, tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Personat e tatueshëm që shesin mallra apo shërbime me pakicë janë të detyruar të afishojnë në mënyrë të dukshme me etiketë, çmimin e çdo malli apo shërbimi që ata ofrojnë. Kurse personat e tatueshëm që furnizojnë mallra apo shërbime me shumicë, janë të detyruar të afishojnë dukshëm në vendin e furnizimit, listën e çmimeve të mallrave apo shërbimeve që ofrojnë për furnizim. Kjo listë i vihet në dispozicion administratës tatimore sa herë që kjo e fundit e kërkon një gjë të tillë me rastin e një verifikimi apo kontrolli tatimor në vend.

59.2.2 Të gjithë personat e tatueshëm, subjekte të çfarëdo lloj tatimi, që kryejnë njëkohësisht veprimtari tregtare të shitjes me shumicë për persona të tjerë të tatueshëm dhe të shitjes me pakicë për individë konsumatorë finalë, janë të detyruar që t'i organizojne Këto veprimtari në vende të veçanta, të ndara nga njëri-tjetri. Kjo do të thotë që një person i tatueshëm, në një njësi të përhershme të shitjes me pakicë (dyqan) nuk mund të kryejë nëpërmjet kësaj njësie edhe shitje me shumicë. Po ashtu, një person i tatueshëm që shet me shumicë (per persona të tjerë të tatueshëm) direkt nga magazina e tij apo nga çdo vend tjetër biznesi i tij, nuk mund të kryejë nga kjo magazinë apo vend tjetrer biznesi edhe shitje me pakicë për individë konsumatorë finalë. Konsiderohen shitje me pakicë të gjitha ato furnizime që bëhen:

a) për konsum përfundimtar;

b) në ato sasi që nuk tejkalojnë nevojat privatë normale të konsumatorit; dhe

c) që nuk janë të destinuara për t'u rishitur.

60. Detyrimi i tatimpaguesit për t'i dhene informacion administratës tatimore dhe për të lejuar hyrjen në mjediset e veprimtarisë ekonomike

60.1.1 Tatimpaguesi vë në dispozicion të administratës tatimore librat, regjistrimet,

informacionin dhe dokumentet e nevojshme për të kryer llogaritjen e saktë të detyrimeve të tij tatimore. Tatimpaguesi ka detyrimin të deklarojë në administratën tatimore ku është i regjistruar, emrin dhe numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS/NIPT) të personit fizik a juridik, nëse ai ka, dhe që mban llogaritë e tij, dhe/ose bën plotësimin e deklaratave tatimore dhe/ose bën deklarimet elektronike. Në rastet kur një gjë e tillë bëhet nga një individ (jo i punësuar), tatimpaguesi ka detyrimin të deklarojë të dhënat identifikuese të individit (emër, mbiemër dhe numrin e letërnjoftimit elektronik). Në rast se, tatimpaguesi i mban vetë apo nëpërmjet një të punësuari të tij llogaritë e tij, dhe bën po vetë deklarimet elektronike të detyrimeve tatimore, ai është i detyruar të deklarojë këtë fakt në administratën tatimore.

60.1.2 Personi i tatueshëm, subjekt i çfarëdo lloj detyrimi tatimor, që nuk permbush detyrimet e përcaktuara në këtë pikë të udhëzimit, penalizohet sipas nenit 126 të ligjit, për refuzim të dhënies së informacionit të kërkuar nga administrata tatimore.

60.2.1 Administrata tatimore ka të drejtë të hyjë në çdo mjedis apo vend ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij ekonomike e tregtare. Hyrja në çdo mjedis të personit të tatueshëm është e lejuar vetëm gjatë orarit zyrtar të punës. për të patur të drejtën e hyrjes në çdo mjedis apo vend ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij ekonomike e tregtare, personi i autorizuar i administratës tatimore, duhet të paraqesë autorizimin me shkrim për të hyre (urdhrin ditor të punës) ose lajmerimin për kontroll, të nënshkruar nga drejtori i drejtorisë rajonale.

60.2.2 Personi i autorizuar i administratës tatimore që hyn në mjediset apo vendet ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij ekonomike e tregtare mund të inspektojë dhe kontrollojë operimet e kompjuterëve, arkave regjistruese e pajisjeve të tjera elektronike në mjediset e personit, si dhe dhe mund të marrë kopjet e çdo llogarie, regjistrimi apo informacion tjetër në këto pajisje.

60.2.3 Personat e tatueshëm, subjekte të çfarëdo lloj tatimi apo takse, gjatë një kontrolli tatimor të administratës tatimore, janë të detyruar që të vënë në dispozicion të kësaj të fundit çdo dokument, çdo libër, çdo regjistër, çdo regjistrim dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar prej saj, të nevojshëm për të kryer llogaritjen e sakte të detyrimeve tatimore të personit.

60.3.1 Gjatë ushtrimit të një kontrolli tatimor, administrata tatimore ka të drejtë të kërkojë nga personi i tatueshëm edhe shpjegime e informacione shtesë. Shpjegimet apo informacionet shtesë mund të kërkohen nga administrata tatimore në forma të ndryshme, si nëpërmjet dergimit të pyetsoreve me shkrim tek tatimpaguesi, nëpërmjet kërkesave me shkrim për të dhënë dokumente, libra e regjistra, për të plotesuar të dhëna të ndryshme për aktivitetin ekonomik, transaksionet tregtare, operacionet financiare të kryera nga personi i tatueshëm me persona të tjerë të tretë, etj. Në këto raste, personi i tatueshëm është i detyruar të japë shpjegimet ose informacionet e kërkuara shtesë, me gojë ose me shkrim, brenda 20 ditëve nga data e postimit të kërkeses me shkrim të administratës tatimore ose nga data e nisjes së kësaj kërkese në postën elektronike të personit.

60.3.2 Gjatë ushtrimit të një kontrolli tatimor, administrata tatimore ka të drejtë gjithashtu të kërkojë të takohet, brenda orarit zyrtar të punës, me përfaqësues të personit të tatueshëm, nga të cilët kërkon shpjegime e informacione shtesë. Përfaqësuesit e personit të tatueshëm janë të detyruar t'i përgjigjen pyetjeve të punonjësit të administratës tatimore, si dhe të japin çdo të dhënë shtesë që ata kërkojnë.

61. Detyrimi i personave të tretë për të dhënë informacion

61.1.1 Gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, si dhe gjatë një kontrolli të ushtruar tek një person i tatueshëm, administrata tatimore mund të këtë nevojë që të disponojë informacione të tjera shtesë nga burime të treta për personin. Në këtë rast, administrata tatimore ka të drejtën t'i drejtohet me shkrim çdo personi të tretë që ka marrëdhënie biznesi dhe ka hyrë në transaksione tregtare ose financiare me personin e tatueshëm, për të kërkuar informacione, dokumente, libra e regjistrime që kanë lidhje me personin. Informacionet shtesë mund të kërkohen nga administrata tatimore në forma të ndryshme, si nëpërmjet dërgimit të pyetësoreve me shkrim tek personi i

tretë, nëpërmjet kërkesave me shkrim për të dhënë dokumente, libra e regjistrime apo për të plotësuar të dhëna të ndryshme që kanë të bëjnë me marrëdheniet e personit të tretë me personin e tatueshëm. Në Këto raste, personi i tretë, është i detyruar të jape dokumentet, librat, regjistrimet, shpjegimet ose informacionet e kërkuara shtesë, me gojë ose me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e postimit të kërkesës me shkrim të administratës tatimore ose nga data e nisjes së kësaj kërkese në postën elektronike të personit të tretë.

61.1.2 Në kuadrin e një kontrolli tatimor tek një personi i tatueshëm apo në kuadrin e kryerjes së çdo funksioni tjetër të saj, administrata tatimore ka të drejtë gjithashtu të kërkojë me shkrim për t'u takuar, brenda orarit zyrtar të punës, në mjediset e veprimtarisë ekonomike të personit të tretë ose në mjediset e administratës tatimore, me përfaqësuesit e një personi të tretë, për të kërkuar shpjegime e informacione shtesë. Përfaqësuesit e personit të tatueshëm janë të detyruar t'i përgjigjen pyetjeve të punonjësit të administratës tatimore si dhe të japin çdo të dhënë shtesë që ata kërkojnë.

61.2 Çdo person i tretë që ka lidhje me personin e tatueshëm apo disponon informacione dhe të dhëna për të dhe nuk permbush detyrimet e përcaktuara në këtë pikë të udhëzimit, penalizohet sipas nenit 126 të ligjit, për refuzim të dhënies së informacionit të kërkuar nga administrata tatimore.

62. Personat, të cilëve u adresohet kërkesa për të dhënë informacion

62.1. Personat e tretë, që janë të detyruar të japin infomacione, dokumente, libra, regjistrime apo shpjegime për personat e tatueshëm, me gojë ose me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e postimit të kërkeses me shkrim të administratës tatimore ose nga data e nisjes së kësaj kërkese në postën elektronike të personit të tretë, janë personat e listuar në pikat 62.2 – 62.12 në vijim.

62.2 të gjithë personat e tatueshëm, për dividentet që u paguhen aksionereve ose për pjeset e fitimit që u shperndahen ortakeve, për transaksionet tregtare dhe financiare të kryera me persona të tjerë të tatueshëm, për pagesat e bëra për nenkontraktoret e tyre, për pagesat e marra si nenkontrokatore të një personi tjetër, për debitoret dhe për kreditoret.

62.3 Bankat dhe institucionet financiare janë të detyruara ti paraqesin administratës tatimore, në përgjigje të kërkesës me shkrim, të gjitha të dhënat që disponojnë lidhur me personat e tatueshëm.

62.4 Shoqërite komisionere ose shoqërite e fondeve të investimeve kolektive, për transaksionet e titujve.

62.5 Agjentët e pasurive të paluajtshme, për veprimet ndaj klientëve.

62.6 Blerësit ose shitësit e pasurise së paluajtshme, për përshkrimin, vendndodhjen, karakteristikat dhe çmimin e pasurisë së paluajtshme.

62.7 Noteret, për veprime noteriale, për shitblerje të pasurive, të luajtshme apo të paluajtshme, apo kontrata sipërmarrjeje.

62.8 Personat juridikë, rezidentë dhe jorezidentë, për pagesat e bëra personave jorezidentë.

62.9 Institucionet shtetërore dhe nëpunësit e administratës shtetërore. Këtu perfshihen institucione të tilla si Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët rajonale të saj, Drejtoria e Thesarit dhe degët rajonale të saj, Agjencina Shtetërore e Kadastrës dhe Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, njësitë pushtetit vendor (bashkite dhe komunat), etj. Këto institucione shteterore veprojne si me poshte:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, është e detyruar që ti dergoje çdo muaj zyrtarisht (pa kërkese) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas percaktimeve të bëra në një Mareveshje të perbashket, të lidhur midis dy Drejtorive të Përgjithshme, të dhëna analitike për të gjithë personat e tatueshëm që kanë kryer importe dhe eksporte gjatë muajit. Ky informacion duhet të përmbaje domosdoshmerisht të dhënat identifikuese të personit të tatueshëm, si emrin tregtar të tij, numurin e identifikimit të te tij, vlerën doganore dhe detyrimet doganore e tatimore të paguara në Dogane. të dhënat e derguara janë të ndara për sejcilin tatimpagues dhe për çdo

rreth. Administrata doganore është e detyruar të shënojë në fletën e zhdoganimit të importeve dhe në fleten e doganimit të eksporteve numrin e identifikimit të personit të tatueshëm sipas Certifikatës së Regjistrimit, vitin dhe vendin ku është regjistruar tatimpaguesi. Ato janë të detyruara të mos lejojne veprime doganore për personat e tatueshëm që nuk paraqesin certifikatën e regjistrimit si persona të tatueshëm dhe vertetimin zyrtar të lëshuar nga drejtoria rajonale e tatimeve të juridiksionit. Degët rajonale të doganave, janë të detyruara gjithashtu të japin çdo informacion që lidhet me importet dhe eksportet e një personi të tatueshëm, sipas kërkeses me shkrim të Drejtorisë rajonale të tatimeve.

b) Drejtoria e Thesarit dhe degët rajonale të saj, janë të detyruara që t'i dergojne çdo muaj zyrtarisht (pa kërkese) drejtorive respektive rajonale të tatimeve, sipas percaktimeve të bëra në një Mareveshje të perbashket, të lidhur midis dy Drejtorive, informacione analitike për të gjithë personat e tatueshëm që kanë marre financime nga buxheti i shtetit, për të kryer punime apo shërbime të ndryshme apo për të furnizuar mallra për institucione shteterore. Këto informacione duhet të përmbajnë të dhëna identifikuese për personin e tatueshëm perfitues, si emrin tregtar të tij, numurin e identifikimit, adresën, shumën e financuar, etj.

c) Zyrat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë të detyruara të dergojne në drejtorive rajonale të tatimeve, sipas kërkeses me shkrim të ketyre të fundit, aktet e regjistrimit të pasurise për personin e tatueshëm, të cilat përmbajnë llojin e pasurise që tjetërsohet, emrin e shitësit, tatimin e paguar dhe vleften përkatëse të pasurise së shitur apo të tjetërsuar. Këto akte përfshijnë si rastet e kalimit të pronesise nëpërmjet shitjes, ashtu edhe rastet e dhurimit e të trashegimise së pasurise.

ç) Njësitë e pushtetit vendor janë të detyruara të dergojne në drejtoritë respektive rajonale të tatimeve, sipas kërkeses me shkrim të ketyre të fundit, informacione analitike për të gjithë personat e tatueshëm që kanë marre financime nga buxheti i tyre, për të kryer punime apo shërbime të ndryshme apo për të furnizuar mallra për institucione vendore. Këto informacione duhet të përmbajnë të dhëna identifikuese për personin e tatueshëm perfitues, si emrin tregtar të tij, numurin e identifikimit, adresën, shumën e financuar, etj. Njësitë pushtetit vendor janë të detyruara gjithashtu të japin informacione, sipas kërkeses me shkrim të Drejtorisë përkatëse rajonale të tatimeve, për të gjithë personat e tatueshëm të regjistuar në juridiksionin e tyre.

62.10 Kontraktoret e tjere të tatimpaguesit për transaksione ekonomike dhe financiare që ata kanë me tatimpaguesin.

62.11 Donatoret, organizatat ndërkombëtare, organizatat jofitimprurëse, fondacionet, institucionet buxhetore, etj., për pagesat e bëra tatimpaguesve për furnizimin e mallrave dhe të shërbimeve të kryera.

62.12 të gjithë personat e tretë të mesiperm, janë të detyruar që, kur sistemi i tyre i mbajtjes së regjistrimeve është i informatizuar, të japin informacionet e kërkuara nga administrata tatimore në mënyrë elektronike.

63. Përjashtimi nga detyrimi për të dhënë informacion

63.1 Në rast të hetimit tatimor nga organet e administratës tatimore, kanë të drejtë të refuzojnë dhënien e informacionit, personat e mëposhtëm:

a) anëtarët e familjes së tatimpaguesit;

b) avokatët, noterët, këshilltarët tatimorë, doktorët dhe personeli mjekësor për informacionin që kanë njohur gjatë veprimtarisë normale profesionale.

63.2 Personat e përmendur në pikën 1 më lart, me përjashtim të tatimpaguesit, nuk janë të detyruar të japin informacion tek organet e administratës tatimore kur ky informacion mund t'i ekspozojë ata, si dhe anëtarët e shkallës së parë të familjes së tyre për ndjekje penale. Në këtë rast, administrata tatimore duhet ta njohë tatimpaguesin me të drejtën e këtyre personave për të refuzuar dhënien e informacionit, informacion, i cili duhet të regjistrohet dhe nënshkruhet nga personi i interesuar.

KREU VII
DEKLARATA TATIMORE

64. Mënyra e deklarimit, afatet dhe vendi i paraqitjes së deklaratave tatimore

64.1. për detyrimet tatimore që sipas ligjeve të veçanta tatimore, vetevleresohen dhe vetedeklarohen, dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore që gjithashtu sipas ligjit përkatës vetedeklarohen, personat e tatueshëm, deklarojnë dhe paguajnë detyrimet tatimore në përputhje me ato dispozita.

64.2.1 Periudhat tatimore, sipas llojit të detyrimeve tatimore e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe sipas kategorive të personave të tatueshëm, janë përcaktuar në secilin ligj të vecante tatimor. Kështu, për personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të tatimit mbi fitimin, periudhat tatimore janë mujore per: TVSH, tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi, për akcizen, për lojrat e fatit dhe për kontributetet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe vjetore për tatimin mbi fitimin. Kurse për personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi fitimin e biznesit të vogël, periudhat tatimore për llogaritjen, deklarimin dhe pagesat e tatimit janë sipas ligjit "Për sistemin e taksave vendore" dhe udhëzimin në zbatim të tij "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", si dhe janë periudha tremujore për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.

64.2.2 Personat e tatueshëm e nderpresin deklarimin vetëm pasi ato kanë marre konfirmimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit për çregjistrimin e tyre nga regjistri tregtar ose konfirmimin nga administrata tatimore së kanë kaluar në regjistrin pasiv të personave të tatueshëm. Nderprerja e detyrimit për deklarim, hyn në fuqi, sipas rastit, muajin, tremujorin apo vitin e pare pas datës së çregjistrimit ose pas kalimit në regjistrin pasiv. Kështu, një person i tatueshëm, subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar dhe i tatimit mbi fitimin, që merr konfirmimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit se, cregjistrimi i tij ka hyrë në fuqi me datë 20 tetor 2008, do të nderprese paraqitjen e deklaratave të tij mujore për TVSH-ne, tatimin mbi të ardhurat personale, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhat tatimore nendor 2008 e në vijim, kurse për tatimin mbi fitimin duke filluar nga periudha tatimore 2009 e në vijim (pas paraqitjes së deklarates së tatimit mbi fitimin për vitin 2008).

64.3 Formularët e deklarimit të çdo lloj tatimi dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe formularët e tjere shoqërues të deklarates që duhet të paraqesin personat e tatueshëm për çdo periudhë tatimore, i vihen në dispozicion ketyre të fundit, pa pagese nga administrata tatimore. Administrata tatimore e realizon një gje të tillë si me poshte:

a) duke i ofruar mundesine personave të tatueshëm të deklarojnë dhe/ose paguajnë në mënyrë elektronike detyrimet tatimore, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al,

b) duke i ofruar mundësinë personave të tatueshëm të shkarkojne dhe printojne deklaratat e tyre tatimore nga faqja zyrtare e internetit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al,

c) duke i vënë deklaratat tatimore në dispozicion të personave të tatueshëm nëpërmjet sporteleve të zyrave të shërbimit për personat e tatueshëm,

ç) duke i derguar në adresën e personit nëpërmjet shërbimit postar rekomande. Në këtë rast, personi i tatueshëm duhet të bëjë kërkese me shkrim në Drejtorinë rajonale të tatimeve, paraqitja e të ciles do të thotë së personi ka marre përsipër përgjegjësine e mbrritjes në kohe dhe në adresën e duhur të deklaratave tatimore të nisura me shërbim postar rekomande.

64.4 Forma dhe përmbajtja e çdo deklaratë tatimore, për çdo lloj tatimi dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, dhe ndryshimi i tyre miratohet nga Ministri i Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor dhe legjislacionit për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. së bashku me deklaraten tatimore, personat e tatueshëm janë të detyruar të paraqesin në administratën tatimore edhe çdo dokument tjetër të kërkuar në

udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të ligjeve të veçanta tatimore. Përveç kësaj, kur shihet e nevojshme për permiresimin dhe lehtesimin e administrimit tatimor, pika 4 e nenit 64 të ligjit i jep Ministrit të Financave autoritetin, për të përcaktuar apo ndryshuar formën dhe përmbajtjen e deklaratave tatimore dhe dokumente të tjera tatimore.

65. Dorëzimi i deklarates tatimore

65.1.1 Formulari i deklarimit plotësohet në dy kopje, njera nga të cilat është për administratën tatimore dhe tjetra për vete personin e tatueshëm. Personat e tatueshëm mund ta paraqesin deklaraten tatimore në administratën tatimore :

a) Nëpërmjet shërbimit postar, me të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nenshkruar mareveshje dypalëshe bashkepunimi. Në këtë rast deklarata merret ose konsiderohet së është marre nga administra tatimore diten e shtatë pas datës së dergimit. Kështu, në qoftë se së deklarata është pranuar në shërbimin postar me datë 1 të muajit, ajo konsiderohet së është marre nga administrata tatimore me datë 8 të muajit;

b) Nëpërmjet dorëzimit në çdo banke apo institucion tjetër financiar me të cilët Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nenshkruar mareveshje dypalëshe bashkepunimi. në këtë rast deklarata konsiderohet e paraqitur datën kur ajo ka mbrritur në banke dhe kjo e fundit ka vendosur vulen datore në të dy kopjet e deklarates. Banka pasi i kthen njeren nga kopjet e vulosura të deklarates personit të tatueshëm, në fund të çdo ditë pune mbledh kopjet e dyta të deklaratave dhe ia dorezon ato administratës tatimore për përpunim, siç parashikohet në marëveshjet e perbashketa të lidhura midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe bankave përkatëse;

c) Nëpërmjet deklarimit elektronik në sistemin e deklarimit elektronik të tatimeve nëpërmjet internetit permes faqes së internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al.

ç) në rastin e deklarimit elektronik, daklaratat tatimore konsiderohen të paraqitura, në datën e dërgimit të deklaratës së plotësuar nga ana e tatimpaguesit. Bara e proves të dërgimit të deklaratës bie tatimpaguesin.

65.1.2 Personi i tatueshëm paraqet deklaratat tatimore të çdo tatimi dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore edhe nëqoftëse ai, për periudhen tatimore nuk ka për të paguar detyrim tatimor apo kontribute, pasi detyrimi i tij mund të jetë zero ose pasi ai mund të mos këtë kryer aktivitet gjatë asaj periudhe tatimore. Plotësimi i saktë i deklaratës, paraqitja dhe pagesa brenda afateve kohore të përcaktuara është detyrim ligjor për të gjithë personat e tatueshëm. Moszbatimi i këtij detyrimi ngarkon me përgjegjësi ligjore personin e tatueshëm dhe dënohet në bazë të ligjit dhe të këtij udhëzimi.

65.2 Deklarat tatimore plotësohen dhe dërgohen në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi dhe të udhëzimeve të tjera në zbatim të legjislacionit tatimor.

65.3 Në rastet kur afati i fundit për dorëzimin e deklaratës bie në ditë pushimi, atëherë si ditë e fundit e afatit llogaritet dita e parë e punës, pas ditës së pushimit. Kështu për shembull, në qoftë se data 14 e një muaji bie diten e shtune të këtij muaji, si dite e fundit e afatit të paraqitjes së deklarimit për TVSH-ne për personin e tatueshëm, do të konsiderohet data 16 e muajit (pra dita e hene si dite e pare pas dites së shtune dhe të djele si dite pushimi).

65.4 Tatimpaguesi ose përfaqësuesi i tij nënshkruajnë deklaratën tatimore, shënojnë numrat e tyre të identifikimit tatimor dhe konfirmojnë, në përgjegjësinë e tyre, së deklarata është e plotë dhe e saktë. Deklaratat e dërguara dhe paguara në mënyrë elektronike pranohen pa nënshkrimin formal të tatimpaguesit.

65.5 Deklarata tatimore vlerësohet e dorëzuar, nëse plotësohen kërkesat e këtij ligji, të legjislacionit tatimor dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tyre.

65.6 Këshilli i Ministrave përcakton afatet kohore për dorëzimin e deklaratave tatimore e të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.

65.7.1 Në zbatim të pikës 7 të nenit 65 të ligjit, në rastin e personave fizikë, detyrimi për të dorëzuar deklaratat tatimore ndërpritet në çastin e aplikimit të tyre për çregjistrim në Qendrën

Kombëtare të Biznesit. Bazuar në protokollin e komunikimit elektronik të të dhënave, lidhur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, informacioni për aplikimin për çregjistrim të tatimpaguesit person fizik merret "on line" nga sistemi informatik i administratës tatimore. Mbi bazën e këtij informacioni, sistemi informatik i tatimeve, duke filluar nga muaji që pason muajin e aplikimit të personit fizik për çregjistrim, nuk gjenëron më deklaratat tatimore të tij për të gjithë llojet e tatimeve.

65.7.2 Në rastin e tatimpaguesve persona juridikë, detyrimi për të deklaruar ndërpritet në momentin e dorëzimit të raportit përfundimtar të likuidimit /bashkimit/ndarjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose gjykatë. Bazuar në protokollin e komunikimit elektronik të të dhënave, lidhur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, informacioni për çregjistrimin e tatimpaguesit person juridik që ushtron veprimtari ekonomike merret "on line" nga sistemi informatik i administratës tatimore. Mbi bazën e këtij informacioni, sistemi informatik i tatimeve, duke filluar nga muaji që pason muajin e dorëzimit të raportit përfundimtar të likuidimit/bashkimit/ndarjes në QKB të personit juridik që ushtron veprimtari ekonomike, nuk gjenëron më deklaratat tatimore të tij për të gjithë llojet e tatimeve. Kurse për tatimpaguesit persona juridikë që çregjistrohen me vendim gjykate, çregjistrimi për qëllime tatimore bëhet efektiv nga data e paraqitjes së raportit përfundimtar të likuidimit /bashkimit /ndarjes në administratën tatimore dhe duke filluar nga muaji që pason muajin e çregjistrimit të personit juridik, sistemi nuk gjenëron më deklaratat tatimore të tij për të gjitha llojet e tatimeve për të cilat personi juridik ka përgjegjësi tatimore.

65.8 Tatimpaguesit, të cilët nuk kanë paraqitur deklaratën apo deklaratat e tyre tatimore për një periudhë të caktuar tatimore, pas datës 1 dhjetor 2014 këto deklarata të munguara do t'i dorëzojnë sipas formatit të deklaratës së re në fuqi pas kësaj datë. Përjashtim nga ky rast bëhet vetëm për deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe deklaratës së tatimit mbi të ardhurat personale nga pagat. Deklaratat e munguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat personale nga pagat do të dorëzohen sipas formatit të deklaratës në fuqi në atë kohë.

66. Zgjatja e afatit të deklarimit

Shfuqizuar

67. Ndryshimi i deklarates tatimore

67.1 Pas paraqitjes së një deklaratë tatimore, personi i tatueshëm mund të konstatoje vete së e ka plotesuar në mënyrë të pasakte atë ose së ka bërë një ose disa gabime gjatë plotesimit të një deklaratë tatimore. Gabimet mund të jenë të llojeve të ndryshme. për shembull, mund të jenë harruar disa fatura shitje ose blerje të pa hedhura në librin e shitjeve e të blerjeve e për rrjedhoje edhe në deklaraten mujore të TVSH-së. Mund të jenë harruar pa hedhur në librin e blerjeve një apo disa deklarata doganore. Gjatë plotesimit të një deklaratë mund të jenë bërë gabime në llogaritje, si për shembull baza e tatueshme të mos perputhet me TVSH e llogaritur, etj. Në të gjithë Këto raste, bazuar në nenin 67 të Ligjit, personi i tatueshëm mund të plotesoje një deklaratë të re tatimore, e cila do të ndryshoje dhe zevendesoje daklraten e pare.

67.2 Tatimpaguesi ka të drejtë për të korrigjuar deklaratat e tij tatimore vetëm brenda 36 muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare mujore, tre-mujore apo vjetore, sa herë konstaton gabime dhe pasaktësi në deklarim. Tatimpaguesi e humbet të drejtën për të korrigjuar deklaratat e tij në ulje detyrimi, sipas parashikimit të kësaj pike, nëse deklarata, që ai kërkon të korrigjojë, është kontrolluar nga administrata tatimore.

Ai mund të ndryshojë një deklaratë të kontrolluar më parë, vetëm nëse ai ka për të deklaruar një detyrim tatimor më të madh se detyrimi që ka rezultuar nga kontrolli.

Shembull. Një tatimpagues konstaton se në librin e blerjeve të periudhës tatimore dhjetor 2015 nuk ka përfshirë një faturë blerje të kësaj periudhe. Për pasojë vlerën e kësaj fature ky tatimpagues nuk e ka deklaruar as në deklaratën e TVSH-së së muajit dhjetor 2015. Në përputhje me nenin 67 të ligjit, tatimpaguesi ka të drejtë të ndryshojë këtë deklaratë brenda 36 muajve nga data 14 janar 2016 (afati i përcaktuar i dorëzimit të deklaratës së muajit dhjetor 2015), por me kusht që kjo deklaratë të mos jetë kontrolluar më parë nga administrata tatimore. Ndërkohë që për

qëllime të zbritjes së TVSH-së, tatimpaguesi ka të drejtë të deklarojë faturën e blerjes dhe të zbresë TVSH-në në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për TVSH-në, jo më vonë se 12 periudha tatimore përfshirë dhe periudhën dhjetor 2015".
Nëse për periudhën tatimore, mars 2014, periudhë kjo e kontrolluar më parë tatimpaguesi konstaton se ka tatim shtesë për të deklaruar dhe paguar (p.sh., një shitje e padeklaruar), atëherë ai ka të drejtë të ndryshojë deklaratën e muajit mars 2014 brenda datës 14 prill 2017.

67.3.1 Nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë të re tatimore të ndryshuar, personit të tatueshëm, sipas rastit, i llogariten detyrimet tatimore shtesë dhe kamatvonesat që lidhen me këtë detyrim tatimor shtesë, për të gjithë periudhen nga afati i fundit i paraqitjes së deklarates fillestare dhe kryerjes së pagesës deri në datën e paraqitjes së deklarates së re të ndryshuar dhe pagesës shtesë. Pagesa e detyrimit tatimor shtesë dhe e kamatevonesave që lidhen me këtë detyrim shtesë bëhet siç përcaktohet në nenin 74 të ligjit dhe në piken 10 të këtij udhëzimi.

67.3.2 Nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë të re tatimore të ndryshuar, personi i tatueshëm, sipas rastit, mund të kërkojë gjithashtu kreditimin e detyrimit tatimor të paguar me teper si dhe të interesave që ai duhet të perfitoje lidhur me këtë pagese të tepert, për të gjithë periudhen nga afati i fundit i paraqitjes së deklarates fillestare dhe pagesës deri në datën e paraqitjes së deklarates së re të ndryshuar. Shuma e paguar me teper së bashku me interesat që lidhen me te, mund të kërkohet të kaloje për llogari të detyrimeve të tjera tatimore të papaguara në momentin e paraqitjes së deklarates së re të ndryshuar ose për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të personit të tatueshëm. Pavarësisht nga sa me lart, personi i tatueshëm, nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë të re tatimore të ndryshuar, ka të drejtën dhe mundesine të kërkojë rimbursimin e shumës së tatimit të paguar me teper dhe të interesave që lidhen me këtë shume.

67.4 Për llogaritjen e interesit të përmendur në pikën 3 të nenit 67 të ligjit, zbatohen dispozitat e këtij Udhëzimi për kamatëvonesat.

KREU VIII
VLERËSIMI TATIMOR

68. Vlerësimi tatimor

68.1. Detyrimet tatimore të personave të tatueshëm vleresohen siç përcaktohet në ligjet e veçanta tatimore dhe në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi dhe udhëzimeve specifike tatimore.

68.2 Vetëvlerësimet e bëra nga tatimpaguesi.

68.2.1 Nëse tatimpaguesit i kërkohet nga legjislacioni tatimor të dorëzojë deklaratë tatimore dhe të paguajë detyrimin tatimor, deklarata konsiderohet vetëvlerësim tatimor i bërë nga tatimpaguesi. Llogaritja, deklarimi dhe pagesa e tatimit bëhet në mënyrën dhe afatin e parashikuar në ligjin tatimor përkatës. Të tilla janë deklarimet e tatimit mbi vlerën e shtuar, të tatimit mbi fitimin, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat nga punësimi, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël etj.

68.2.2 Vetëvlerësim dhe vetëdeklarim bëhet edhe për të ardhurat individuale për të cilat nuk është mbajtur tatimi në burim, përfshirë të ardhurat e realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga një person i tatueshëm rezident shqiptar. Në këto raste llogaritja dhe deklarimi i detyrimeve tatimore bëhet nga tatimpaguesi në përputhje me dispozitat e ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

68.2.3 Parapagimi i detyrimit tatimor, i cili përdoret në rastin e parapagimit të tatimit mbi fitimin gjatë vitit ushtrimor dhe të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është, gjithashtu, vetëvlerësim tatimor.

Llogaritja e kësteve të parapagimit të tatimit mbi fitimin dhe pagesa e tyre bazohet në mënyrën dhe afatet e parashikuara në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat". Vetëvlerësimi përfundimtar i detyrimit tatimor bëhet në momentin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të

ardhurave të tatueshme (të fitimit/humbjes).

Llogaritja e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të biznesit të vogël apo pagesa e detyrimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël bazohet në mënyrën e parashikuar në ligjin "Për sistemin e taksave vendore" dhe udhëzimit në zbatim të tij "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël". Vlerësimi përfundimtar i detyrimit tatimor të biznesit të vogël, për subjektet, të cilat kanë detyrim për të deklaruar, bëhet në momentin e paraqitjes së deklaratës vjetore (formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin), siç përcaktohet në ligjin "Për sistemin e taksave vendore" dhe udhëzimin në zbatim të tij.

68.3 Vlerësimet e bëra nga Administrata Tatimore

68.3.1 Administrata tatimore ka autoritetin dhe detyrimin për të mbikëqyrur të gjithë procesin e vlerësimit të detyrimeve tatimore të personave të tatueshëm. Ajo mund të bëjë një vlerësim të detyrimit tatimor të personit të tatueshëm, në rastet e meposhteme :

a) Kur gjatë një kontrolli tatimor të kryer në vend tek personi i tatueshëm, provon së detyrimi tatimor i deklaruar nga ky i fundit është i pasaktë. Në këtë rast, administrata tatimore është e detyruar të procedoje nëpërmjet kontrollit tatimor, sipas rregullave të përcaktuara në kapitullin "Kontrolli Tatimor" të ligjit dhe në këtë udhëzim.

b) Kur administrata tatimore konstaton së detyrimi tatimor, i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë. Në këtë rast vlerësimi tatimor bazohet në informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit ose në rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të ligjit ose në mënyrat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenin 72 të ligjit.

c) Kur personi i tatueshëm nuk ka respektuar detyrimin ligjor për të paraqitur deklaratën tatimore. Në këtë rast, vlerësimi i detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore mund të bëhet direkt nga zyra, nëpërmjet përdorimit të metodave alternative të vlerësimit tatimor të përcaktuara në nenin 72 të ligjit dhe në këtë udhëzim.

d) Kur personi i tatueshëm nuk lejon hyrjen për ushtrimin e kontrollit tatimor të autorizuar. Edhe në këtë rast, vlerësimi tatimor i detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore mund të bëhet direkt nga zyra, nëpërmjet përdorimit të metodave alternative të vlerësimit tatimor të përcaktuara në nenin 72 të ligjit dhe në këtë udhëzim.

68.3.2 Vlerësimi i bërë nga administrata tatimore hyn në fuqi 10 ditë kalendarike pas datës kur ky vlerësim është marrë ose konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesve.

68.3.3 Barra e provës për të provuar pasaktësinë e vlerësimeve tatimore të administratës tatimore bie mbi tatimpaguesin.

68.3.4 Vlerësimi tatimor i administratës tatimore, i bërë nga zyra në përputhje me paragrafët c) dhe d) të pikës 68.3.1 më lart, bie poshte dhe anullohet sapo personi i tatueshëm rregullon situaten e tij, duke paraqitur deklaraten apo deklaratat e munguara apo duke lejuar dhe krijuar kushtet e nevojshme për ushtrimin e kontrollit tatimor, mbi bazën e të cilit bëhet vlerësimi i ri tatimor.

68.4 Vlerësimi tatimor i bërë nga agjenti i mbajtjes së tatimit në burim

Nëse detyrimi tatimor mbahet në burim nga një agjent i mbajtjes së tatimit në burim dhe tatimpaguesi nuk është subjekt i kërkesës së dorëzimit të deklaratës tatimore për tatimin e mbajtur në burim, mbajtja e tatimit në burim është vlerësim tatimor. Kjo mënyrë përdoret kryesisht për tatimin mbi të ardhurat personale nga pagat dhe shpërblimet e tjera, për kontributet e sigurimeve shoqërore, për interesat bankare apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, dividentët, huatë dhe qeratë, kalimin e pronësisë, e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale etj., sipas përcaktimit në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

68.5 Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, me vlerë deri në 1000 (një mijë) lekë, e cila ka ardhur si rezultat i një vlerësimi të kryer nga administrata tatimore, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlere zero.

69. Njoftimi i vlerësimit tatimor

69.1 Njoftimi i vlerësimit tatimor, i bërë nga administrata tatimore për personin e tatueshëm, duhet t'i dërgohet atij në adresën e deklaruar nga vetë ai. Njoftimi i vlerësimit i dërgohet tatimpaguesit në rrugë elektronike, në rastin kur tatimpaguesi është regjistruar si përdorues i sistemit elektronik tatimor të shërbimit, dhe nëpërmjet shërbimit postar rekomande. Njoftimi i vlerësimit i dërgohet tatimpaguesit brenda 10 ditëve kalendarike nga data e lëshimit të tij. Data e lëshimit të njoftimit të vlerësimit tatimor, konsiderohet data e plotësimit të tij, e cila shënohet në rubrikën përkatëse të formularit të njoftimit të vlerësimit.

69.1/1 Data e marrjes dijeni nga tatimpaguesi, për njoftimin e vlerësimit të nisur nga administrata tatimore, konsiderohet dita e dhjetë, në ditë kalendarike, pas datës së dërgimit të këtij akti nga ana e administratës tatimore. Data e dërgimit është data e pranimit të njoftim-vlerësimit në shërbimin postar. Kështu, në qoftë së njoftimi i vlerësimit është pranuar në shërbimin postar më datë 1 të muajit, ai konsiderohet së është marrë dhe i është bërë i ditur tatimpaguesit më datë 11 të muajit. Komunikimi i njoftimit të vlerësimit, nga ana e administratës tatimore, bëhet në rrugë elektronike, me pëlqimin e tatimpaguesit, nëpërmjet dërgimit të tij në llogarinë e tatimpaguesit, llogari kjo që është hapur në sistemin elektronik tatimor të shërbimit, ose nëpërmjet dërgimit në adresën e postës elektronike (e-mail) të tatimpaguesit, kur një adresë e tillë i është njoftuar nga vetë tatimpaguesi administratës tatimore. Do të konsiderohet së tatimpaguesi ka marrë dijeni për njoftim-vlerësimin, në rastin e dërgimit të tij në rrugë elektronike, momenti i dërgimit, përfshirë këtu edhe konfirmimin automatik të marrjes nga sistemi kompjuterik, por në çdo rast si afat i vlefshëm, që konsideron si të marrë njoftim-vlerësimin, do të jetë dita e 10 (dhjetë) nga data e nisjes së dokumentit në rrugë elektronike. Në rast së njoftimi i vlerësimit i është dërguar nga ana e administratës tatimore në orën 12:00 të datës 1 të muajit, do të konsiderohet së është marrë nga tatimpaguesi në orën 12:00 të datës 11 të po atij muaji. Si kohë e vlefshme, do të merret data dhe ora e sistemit elektronik, sipas standardit të matjes së orës zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

69.2 Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e tatimit duhet të përmbajë informacionin, si më poshtë:

a) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit person fizik, ose emrin e personit juridik;

b) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;

c) datën e njoftimit;

ç) çështjen, për të cilën bëhet njoftimi dhe periudhën ose periudhat tatimore, që u referohet njoftimi;

d) shumën e tatimit të vlerësuar apo, sipas rastit, edhe uljen e humbjes tatimore, uljen e kredisë tatimore, kamatëvonesën, gjobat;

dh) kërkesën për pagesën e tatimit dhe afatin e pagesës;

e) vendin dhe mënyrën e pagesës së tatimit;

ë) shpjegimin e arsyes së vlerësimit;

f) shpjegimin e së drejtës së tatimpaguesit për të ankimuar vlerësimin.

69.3 Njoftimi i vlerësimit tatimor regjistrohet dhe një kopio depozitohet në dosjen e personit të tatueshëm brenda pese ditesh kalendarike nga data e leshimit të tij.

69.4 Personi i tatueshëm, që nuk është dakord me njoftimin e vlerësimit tatimor, ka të drejtë ta ankimojë atë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit në përputhje me procedurat e parashikuara në kreun XIII të ligjit. Në rastet kur nuk mund të provohet e saktë data e marrjes së vlerësimit të detyrimit tatimor, konsiderohet të jetë marrë 10 (dhjetë) ditë nga data e nisjes me postë.

70. E drejta për të nxjerre njoftimin e vlerësimit tatimor

70.1 Njoftimi i vlerësimit tatimor, lëshohet nga drejtoria rajonale e tatimeve nen juridiksionin e të ciles është personi i tatueshëm dhe nenshkruhet nga drejtori i kësaj drejtorie.

70.2 Drejtoritë rajonale të tatimeve mund të bëjnë vlerësime tatimore për çdo lloj detyrimi tatimor dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, subjekte të te cilave janë personat e tatueshëm, nen juridiksionin e tyre.

70.3 Zyra tatimore e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor për llojet e taksave që administron, për të gjithë personat e tatueshëm, subjekte të taksave vendore, përfshirë edhe tatimpaguesit që klasifikohen si biznes i vogël.

Për detyrimet tatimore, të lidhura me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, njoftimi i vlerësimit tatimor nxirret nga Drejtoria Rajonale Tatimore përkatëse.

71. E drejta për të përdorur mënyrat alternative të vlerësimit tatimor nga administrata tatimore

71.1 Administrata tatimore ka të drejtë të kontrollojë saktesine e percaktimit të detyrimeve tatimore, pavarësisht nga mënyra e vlerësimit tatimor të përdorur. Nëpërmjet kontrolleve tatimore, mund të kryhet verifikimi i saktesise së deklarimeve tatimore për tatimin mbi fitimin, për TVSH-ne dhe për të gjitha llojet e tjera të detyrimeve tatimore, përfshirë tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në kushte e rrethana të caktuara nga ligji dhe në këtë udhëzim, administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyrat alternative të vlerësimit të detyrimeve tatimore të personave të tatueshëm. E drejta për përdorimin e mënyrave alternative në vlerësimin e detyrimeve tatimore përdoret në rastet e meposhteme :

a) Kur personi i tatueshëm, për një periudhe të caktuar tatimore nuk ka deklaruar detyrimet tatimore të tij, siç përcaktohet në ligjet specifike tatimore. Kështu, për shembull, nëse një person i tatueshëm nuk paraqet deklaraten mujore të TVSH-së, drejtoria rajonale e tatimeve të juridiksionit, pasi ka zbatuar të gjitha procedurat paraprake të përcaktuara në ligjin "Për TVSH" dhe në udhëzimin në zbatim të tij, ka të drejtë të bëjë llogaritjen e detyrimit tatimor nëpërmjet vlerësimit tatimor nga zyra, sipas procedurave të përcaktuara në manualin përkatës të punës. Në të njëjten mënyre veprohet edhe në rastet kur personi i tatueshëm nuk paraqet deklaratat e tjera tatimore, si deklaraten e të ardhurave të tatueshme (bilancin e veprimtarisë ekonomiko financiare) të një viti të caktuar, deklaraten e akcizes, deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale për ato kategori të ardhurash për të cilat deklarimi sipas ligjit përkatës është i detyrueshem. Në këtë rast, vlerësimi tatimor, duke përdorur rregullat e përcaktuara në nenin 72 të Ligjit, mund të bëhet direkt nga zyra, pa qenë e nevojshme kryerja e një kontrolli në vend prane personit të tatueshëm. Njoftimi i vlerësimit tatimor nga zyra i dergohet personit të tatueshëm me nenshkrimin e drejtorit të degës rajonale të tatimeve. Njoftimi i vlerësimit tatimor i bërë nga zyra shërben edhe si thirrje për personin e tatueshëm për të paraqitur deklarat e tij tatimore të paparaqitura. Vlerësimi tatimor i administratës tatimore, i bërë nga zyra bie poshte dhe anullohet sapo personi i tatueshëm të rregulloje situaten e tij, duke paraqitur deklaraten apo deklaratat e munguara. Anullimi shoqërohet kurdohere me zbatimin e penaliteteve përkatëse për deklarim dhe pagese të vonuar dhe detyrimin për pagimin e tyre.

b) Kur gjatë një kontrolli tatimor të kryer nga drejtoria rajonale e tatimeve, rezulton së personi i tatueshëm ka paraqitur një apo disa deklarata tatimore me të dhëna të pasakta ose të fallsifikuara. Vlerësimi tatimor, duke përdorur metodat alternative bëhet gjithmone në kuadrin e një kontrolli tatimor në vend tek personi i tatueshëm.

c) Kur gjatë një kontrolli tatimor të kryer nga dega rajonale e tatimeve, nuk gjenden regjistrimet dhe dokumentacioni i duhur për percaktimin e detyrimit tatimor, ose kur Këto regjistrime dhe dokumente kanë mangesi të tilla që nuk lejojne paraqitjen e situates reale të personit të tatueshëm dhe llogaritjen e detyrimeve të tyre tatimore. Me një situatë të tillë kemi të bejme, për shembull, në rastet kur gjatë kontrollit personi i taueshem nuk paraqet dokumentet e transaksioneve të kryera, nuk ka mbajtur regjistrime të rregullta të cilat bëjnë të mundur percaktimin e detyrimit tatimor, sic përcaktohet në ligjet e vecanta tatimore dhe në udhëzimet në zbatim të tyre. Kemi të bejme gjithashtu me një situatë të tillë edhe në rastet kur gjatë një kontrolli tatimor provohet së personi i tatueshëm nuk ka paraqitur një pjese të dokumentacionit ose të regjistrimeve si dhe kur dokumentacioni dhe regjistrimet e paraqitura janë dukshem me të meta, të paverteta dhe të pabesueshme. Pra, vlerësimi tatimor, duke përdorur metodat alternative bëhet gjithmone në kuadrin e një kontrolli tatimor në vend tek personi i tatueshëm.

ç) Kur personi i tatueshëm nuk lejon hyrjen për kontroll, vlerësimi tatimor bëhet direkt nga zyra, duke përdorur rregullat e përcaktuara në nenin 72 të ligjit, pa qenë e nevojshme prezenca e metejshme në vend tek personi i tatueshëm. Njoftimi i vlerësimit tatimor i përgatitur nga zyra, i dergohet personit të tatueshëm me nenshkrimin e drejtorit të Drejtorisë rajonale të tatimeve. Vlerësimi tatimor i administratës tatimore, i bërë nga zyra, bie poshte dhe anullohet sapo personi i tatueshëm të rregulloje situaten e tij, duke lejuar dhe krijuar kushtet e nevojshme për ushtrimin e kontrollit tatimor. Anullimi shoqërohet kurdohere me zbatimin e penaliteteve përkatëse (përfshirë dënimin për moslejim kontrolli) dhe detyrimin për pagimin e tyre.

d) Kur nuk bashkepunon me kontrollin tatimor të administratës tatimore dhe nuk ve në dispozicion të kontrollit, informacionin e kërkuar dhe dokumentet e tjera të nevojshme për llogaritjen e detyrimit të tij tatimor. Edhe në këtë rast vlerësimi tatimor bëhet me metoda alternative duke përdorur rregullat e përcaktuara në nenin 72 të ligjit.

dh) Kur gjatë një kontrolli tatimor të kryer nga drejtoria rajonale e tatimeve, konstatohet së personi i tatueshëm, hyn në transaksione me persona të lidhur jo në bazë të parimit të vleres së tregut, ose hyn në transaksione pa efekte ekonomike thelbesore. Në të gjithë Këto raste, administrata tatimore ka të drejtën e rivlerësimit të transaksionit, duke marre parasysh vlerën reale të tregut për transaksionin, njelloj siç do të ndodhte në qoftë se ky transaksion do të ishte kryer midis dy personave që nuk janë të lidhur. Kemi të bejme me persona të lidhur në rastet e përcaktuara në piken "h" të nenit 5 të Ligjit. Vlerësimi tatimor, duke përdorur metodat alternative të përcaktuara në piken "dh", të nenit 71 të ligjit, bëhet gjithmone në kuadrin e një kontrolli tatimor në vend tek personi i tatueshëm, duke patur parasysh edhe dispozitat e pikës 51.3 të këtij Udhëzimi. e) Kur gjatë një kontrolli tatimor të kryer nga drejtoria rajonale e tatimeve, konstatohet së personi i tatueshëm, hyn në transaksione shitblerje me para në dorë dhe kur vlera e transaksionit e kalon vlerën prej 150 mijë lekë. Edhe në Këto raste, administrata tatimore ka të drejtë të rivleresoje vetëm transaksionet në fjale dhe jo të gjithë veprimtarinë e personit të tatueshëm. Vlerësimi tatimor, duke përdorur metodat alternative, bëhet gjithmone në kuadrin e një kontrolli tatimor në vend tek personi i tatueshëm, duke patur parasysh edhe dispozitat e pikës 51.3 të këtij Udhëzimi.

ë) Kur gjatë një kontrolli tatimor të kryer nga drejtoria rajonale e tatimeve, konstatohet së personi i tatueshëm, nuk ka përdorur rregullisht pajisjet fiskale. Në Këto raste, administrata tatimore mund të rivleresoje të gjithë volumin e shitjeve me pakicë të personit të tatueshëm të cilat duhet të ishin evidentuar me leshimin e kuponave tatimore me pajisje fiskale. Vlerësimi tatimor, duke përdorur metodat alternative të përcaktuara në piken "ë", të nenit 71 të ligjit, bëhet gjithmone në kuadrin e një kontrolli tatimor në vend tek personi i tatueshëm. Në asnje rast, ky vlerësim nuk mund të bëhet direkt nga zyra.

f) kur tatimpaguesi me status "person fizik" konstatohet nga administrata tatimore së regjistron ose mban më shumë së një numër identifikimi unik të subjektit dhe dorëzon deklarata të veçanta për çdo NIPT/NUIS, për qëllime të shmangies tatimore dhe minimizimit të detyrimit tatimor.

Në këtë rast, administrata tatimore nëpërmjet vlerësimit alternativ në vend ose nga zyra, bën vlerësimet e duhura për deklarimin e të ardhurave, ndryshimin e përgjegjësive tatimore, të NUIS/NIPT që do të përcaktojë tatimpaguesi. NUIS/NIPT-et e tjera tatimpaguesi, mund ti regjistrojë si adresa sekondare (dytësore) të NUIS/NIPT kryesor.

71.2 Aplikimi i metodave alternative të vlerësimit tatimor sipas gërmave b), c) dhe dh) të nenit 71 të Ligjit bëhet pasi është marrë një vendim me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale.

71.3 Në çdo rast kur një tatimpagues nuk ka dorëzuar deklaratat e tij tatimore për një periudhë tatimore, ai njoftohet nga ana e administratës tatimore me anë të "Letër kujtese", për mos përmbushjen e këtij detyrimi. Administrata tatimore i dërgon tatimpaguesit "Letër kujtesën" brenda 5 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit ligjor të deklarimit, duke i kujtuar tatimpaguesit të dorëzojë brenda 10 ditëve të ardhshme kalendarike, deklaratën e padorëzuar, që i përket një periudhe tatimore. Mënyra e komunikimit të "Letër kujtesës" për tatimpaguesin, bëhet

sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 23 të ligjit. Forma dhe përmbajtja e "Letër kujtesës" janë sipas modelit të paraqitur në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

71.3.1 Në rast së mbas kalimit të afatit 10-ditor, nga data e nisjes së "Letër kujtesës", tatimpaguesi nuk ka plotësuar detyrimin e tij, për të dërguar apo dorëzuar në administratën tatimore deklaratën e padërguar për një periudhë të caktuar tatimore, administrata tatimore ka detyrimin të bëjë një vlerësim të detyrimeve tatimore të tatimpaguesit, sipas njërës prej metodave të parashikuara nga neni 72 i ligjit. Vlerësimi i kryer i njoftohet tatimpaguesit, sipas modelit të njoftim-vlerësimit automatik i dhënë në shtojcën 2 të këtij udhëzimi. Tatimpaguesi nuk ka të drejtë që ta kundërshtojë këtë njoftim-vlerësimi në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, në rrugën e ankimit të akteve administrative tatimore. Tatimpaguesi ka të drejtë, që me marrjen e njoftim-vlerësimit të bërë nga ana e administratës tatimore, sipas parashikimit të kësaj pike, të paraqesë deklaratën e tij tatimore. Vetëm në rastin e paraqitjes së deklaratës tatimore të padorëzuar më parë, anulohet vlerësimi i detyrimit tatimor të bërë nga zyra prej administratës tatimore. Administrata tatimore fillon procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, sipas njoftim-vlerësimit të bërë nga zyra në mënyrë automatike nga sistemi informatik, nëse nga ana e tatimpaguesit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftim-vlerësimit tatimor, nuk është dorëzuar deklarata tatimore ose nuk është paguar shuma e mësipërme e detyrimit.

71.4 Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor

71.4.1 Në rastet kur tatimpaguesi/tatimpaguesit kryejnë veprime apo transaksione apo seri veprimesh apo transaksionesh, në mënyrë direkte apo indirekte me persona të tretë, të cilat deformojnë parimet e ligjit tatimor, nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut, janë pa efekte ekonomike thelbësore, forma nuk reflekton thelbin e tij ekonomik, apo evidentohen elemente të veprimeve/ transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, administrata tatimore ka të drejtën e rikarakterizimit të këtyre transaksioneve me qëllim përcaktimin e detyrimit të saktë tatimor.

71.4.2 Për këtë qëllim, administrata tatimore nuk merr parasysh një veprim/transaksion apo një seri veprimesh/ transaksionesh, të cilat, duke qenë së konkludohet që janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave. Në këto kushte, veprimi/transaksioni rikarakterizohet dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të parashikuar në ligjin e procedurave tatimore apo ligjet e tjera tatimore.

71.4.3 Barrën e provës për të vërtetuar së veprimet/transaksionet janë ndërmarrë nga tatimpaguesi apo tatimpaguesit, me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e ligjit, e ka administrata tatimore.

71.4.4 Nëse administrata tatimore konkludon së rasti është brenda konceptit të nenin 71/2 të ligjit dhe e argumenton këtë sipas pikës 71.4.3 më sipër, ajo i lejon tatimpaguesit që të paraqesë prova, dokumente dhe argumente që tregojnë së 'qëllimin biznesor' apo 'thelbin ekonomik i transaksionit /transaksioneve' të ndërmarra nuk ka qenë përfitimi i avantazheve tatimore.

71.4.5 Në rastin e një veprimi/transaksioni apo një seri veprimesh/transaksionesh të një tatimpaguesi, për të vlerësuar nëse jemi në situatat sipas paragrafëve 71.4.1 dhe 71.4.2 më sipër, administrata tatimore analizon dhe vlerëson efektin e detyrimeve tatimore të gjenëruara në zinxhirin e plotë të veprimeve/transaksioneve ndërmjet tatimpaguesve që analizohen. Nëse veprimet/transaksionet nuk kanë çuar në uljen e detyrimeve tatimore, apo nuk janë zgjedhur dhe përdorur elemente të tillë si statusi juridik i tatimpaguesit, niveli tarifor i taksimit për kategori të ndryshme tatimpaguesish, nuk aplikohen dispozitat e nenit 71/2 të ligjit.

71.4.6 Tatimpaguesit kanë të drejtë të zgjedhin formën juridike dhe atë të regjistrimit që parashikon legjislacioni përkatës i fushës. E drejta e tatimpaguesit për të zgjedhur formën e organizimit, e cila është në përputhje me ligjet në fuqi, nuk mund të interpretohet si shmangie e

detyrimeve tatimore, dhe nuk përbën shkak për zbatimin e nenit 71/2 të ligjit. Procedurat e nenit 71/2 zbatohen në ato raste kur administrata tatimore konkludon së veprime që kanë të bëjnë me statusin e tatimpaguesit, apo formën e regjistrimit të tij, janë ndërmarrë duke shfrytëzuar në mënyrë jo të ndershme ndryshime ligjore që favorizojnë tatimpagues me statuse të ndryshme.

Shembull 1: Punonjësi A.M. ka qenë i punësuar me kontratë pune si inxhinier IT-je pranë subjektit "Sky". Në momentin kur ndryshon regjimi i taksimit të biznesit të vogël, p.sh., kur tatimi për intervalin e qarkullimit 0–5 milionë bëhet zero, individi A.M. ndërpret marrëdhëniet e punësimit dhe regjistrohet në QKB si person fizik tregtar, duke ofruar vetëm në kompaninë "Sky" të njëjtat shërbime që ofronte edhe më parë si i punësuar me kontratë, por duke shmangur detyrimet tatimore që paguante si çdo i punësuar. Në raste të tilla administrata tatimore analizon me kujdes veprimet dhe transaksionet në mënyrë që të dallojë veprime/transaksione që bëhen më qëllim shmangien apo uljen e detyrimeve tatimore, nga ngjarje apo situata kur një individ kalon normalisht nga statusi "i punësuar" në statusin e "profesionistit të lirë" dhe ofron shërbime jo vetëm të tatimpaguesi ku ishte i punësuar.

Shembull 2: Tatimpaguesi "TradeAlb9" person juridik, ushtron veprimtarinë e tregtimit të produkteve ushqimore dhe paguan 15 % tatim mbi fitimin. Ky subjekt zhvillon veprimtarinë në 10 adresa sekondare të tregtimit me shumicë dhe pakicë të mallrave që tregton. Për të përfituar avantazhe tatimore, subjekti "TradeAlb9" mbyll disa apo të gjitha adresat sekondare. Në këto adresa regjistrohen biznëse të tjera, të cilat furnizohen nga subjekti "TradeAlb9", por që paguajnë tatim mbi fitimin me tarifë 0 % (për qarkullim 0–5 milionë) ose 5 % (për qarkullim 5–15 milionë). Në këtë rast, administrata tatimore analizon hollësisht faktet dhe rrethanat, dhe pasi krijon bindjen së veprimet/ transaksionet janë ndërmjet personave të lidhur, direkt apo indirekt, dhe janë ndërmarrë me qëllim përfitimin e avantazheve tatimore, të cilat vijnë në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e ligjit, rikarakterizon transaksionet duke llogaritur shumën e duhur të detyrimit tatimor që do të paguhej në kushte normale të zhvillimit të biznesit.

71.4.7 Administrata tatimore duhet të analizojë situatën dhe të dallojë rastet kur tatimpaguesi / tatimpaguesit kryejnë veprime apo transaksione apo seri veprimesh apo transaksionesh, në mënyrë direkte apo indirekte me persona të tretë, veprime të cilat deformojnë parimet e ligjit tatimor, nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut, apo janë pa efekte ekonomike thelbësore, nga rastet kur tatimpaguesit ka të drejtë ligjore për të zgjedhur formën e organizimit dhe regjistrimit të cilat lidhen me një trajtimin të caktuar fiskal. E drejta e tatimpaguesit për të zgjedhur formën e regjistrimit që është në përputhje me ligjin, nuk duhet të interpretohet në çdo rast si shkelje e parimeve të nenit 71/2 të ligjit, duke mos përbëre shkak për rivlerësim nga administratat tatimore.

Shembull 1. Individi "D.N" i cili më parë ka qenë i punësuar në kompaninë "L2", pajiset me licencën "Kontabël i Miratuar" dhe synon të hyjë në tregun e shërbimeve dhe konsulencës në këtë fushë. Ai regjistrohet në QKB si person fizik tregtar dhe deklaron qarkullimin 4.5 milionë lekë në vit që pret të realizojë, duke përcaktuar në këtë mënyrë edhe pozicionin e tij tatimor. Pasi regjistrimit, ai lidh kontrata shërbimi e konsulence me subjekte të ndryshme, dhe deklaron të ardhurat që realizon. Në këtë rast, administrata tatimore nuk mundet që pa prova dhe fakte të qenësishme, të kërkojë zbatimin e nenit 71/2 dhe të llogarisë për individin "D.N." detyrime që i përkasin regjimeve të tjera tatimore.

71.4.8 Për zbatimin e nenit 71/2 të ligjit, administrata tatimore ka të drejtën e rikarakterizimit të transaksioneve me qëllim përcaktimin e detyrimit të saktë tatimor vetëm nëse:

i) Drejtoria Rajonale e Tatimeve ka paraqitur kërkesë të argumentuar dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar përdorimin e nenit 71/2 të ligjit, me qëllim rikarakterizimin e transaksioneve për tatimpaguesin / tatimpaguesit.

ii) Rikarakterizimi i transaksioneve bëhet në kuadrin e një kontrolli tatimor në vend, duke ekzaminuar dhe analizuar dokumentacionin.

71.4.9 Rikarakterizimi i transaksionit dhe përdorimi i metodave alternative të vlerësimit për përcaktimin e detyrimit tatimor, në rastet kur aplikohet neni 71/2 i ligjit, në thelb është

vlerësim alternativ nga administrata tatimore. Qëllimi i këtij vlerësimi alternativ është që të përcaktojë së sa duhej të ishte detyrimi tatimor ligjor i pagueshëm nga tatimpaguesi, nëse nuk do të ishim në kushtet e moskryerjes së veprimeve apo transaksione të cilat deformojnë parimet e ligjit tatimor, nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut, apo evidentohen elemente që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore. Nëse nuk ka prova dhe fakte që jemi para një rasti të evazionit tatimor, por vërehen elementë të shmangies tatimore "ligjore", administrata tatimore nuk mund të aplikojë penalitetet e nenit 116 të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

72. Baza e mënyrave alternative të vlerësimit tatimor

72.1 Në përdorimin e metodave alternative të vlerësimit tatimor administrata tatimore bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke patur parasysh edhe faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Të dhënat kryesore ku bazohet gjykimi i administratës tatimore, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:

a) të dhëna direkte nga deklaratat tatimore të tatimpaguesit apo transaksione të tjera të ngjashme të tatimpaguesit;

b) të dhëna direkte, dokumentacione e informacione të marrë nga palët e treta;

c) të dhëna, dokumentacione e informacione të marrë nga transaksione të ngjashme të kryera nga tatimpagues të tjerë;

ç) të dhëna të tjera indirekte, si konsumi energjisë, karburantit, lëndëve të para, normativave të ndryshme, etj.,

d) Çmimet sipas të dhënave të disponueshme në doganë ose çmimet e referencës së shitjes me pakicë që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

e) Të dhëna për çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, çmimet e referencës së qirave, siç përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për këtë qëllim.

Në përdorimin e metodave alternative mbahen parasysh edhe dispozitat e pikës 51.3 të këtij Udhëzimi.

72.2 Për zbatimin e metodave arternative të vlerësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, , mund të lidhë marrëveshje me shoqatat e specializuara të biznesit, kur një gjë e tillë është e nevojshme dhe e mundur për të përcaktuar vlerën orientuese të tatueshme mbi bazën e të cilës bëhet vlerësimi i detyrimeve tatimore me mënyra alternative. Këto marrëveshje botohen në Buletinin Tatimor të administratës tatimore.

72.3 Kur vlerësohet detyrimi tatimor, që lind nga transaksione ndërmjet personave të lidhur, mënyra alternative e bazuar në vlerat e tregut për ato transaksione do të merret për bazë për llogaritjen e të ardhurave të tatueshme. Në zbatimin e kësaj dispozite mbahen parasysh edhe dispozitat e pikës 51.3 të këtij udhëzimi.

73. E drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore

73.1 E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose e ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës.

73.2 Afati i parashkrimit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të ndërpritet kur:

a) si rezultat i apelimit të vlerësimit të mëparshëm bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast afati i parashkrimit është data më e vonëshme ndërmjet:

i) afatit të parashkrimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;

ii) 30 ditë kalendarike nga data e vendimit përfundimtar të gjykatës së apelit;

b) si rezultat i një kontrolli ose hetimi tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore, bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast, afati i parashkrimit është data më e vonëshme ndërmjet:

i) afatit të parashkrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;

ii) 30 ditë kalendarike nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar, me shkrim, të kontrollit ose hetimit tatimor;

c) ndaj tatimpaguesit ka filluar një çështje penale për detyrimet e tij tatimore. Në këtë rast, afati i parashkrimit është data më e vonëshme ndërmjet:

i) afatit të parashkrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;

ii) 30 ditë kalendarike nga data e marrjes nga gjykata e vendimit të formës së prerë, për çështjen penale.

73.3 Në rastet kur ndaj tatimpaguesit hapet një çështje penale për detyrimet tatimore të tij, pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 73, e drejta për vlerësim tatimor vlerësohet së nuk është parashkruar.

73.4 E drejta e tatimpaguesit për të kërkuar rimbursimin e tepricës kreditore të çdolloj tatimi përfshirë tatimin e paguar tepër, parashkruhet kur kanë kaluar 5 vjet nga data e dorëzimit të deklaratës tatimore përkatëse, fillestare ose e ndryshuar.

KREU IX
PAGESA DHE RIMBURSIMI I TATIMIT

74. Afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor

74.1 Personat e tatueshëm janë të detyruar të paguajnë detyrimet e tyre tatimore brenda afateve të parashikuara në ligjet e veçanta tatimore në fuqi.

74.2 në rastin e një njoftim vlerësimi tatimor të lëshuar nga administrata tatimore, detyrimi tatimor i vlerësuar është i detyrueshem të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të njoftim vlerësimit tatimor.

74.3 Detyrimet tatimore paguhen në bankat dhe në institucionet e tjera që kanë lidhur marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të pranuar këto pagesa. Në këto marrëveshje përcaktohet lloji i detyrimit që do të arkëtohet për llogari të administratës tatimore, vendi i arkëtimit të këtyre detyrimeve, kushtet që duhet të plotësohen dhe mënyra e dhënies së informacioneve për pagesat e arkëtuara nga bankat. Pagimi i detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve në bankë bëhet vetëm nëpërmjet urdhërpagesës përkatëse të gjenëruar nga sistemi informatik i tatimeve. Bankat nuk mund të pranojnë asnjë pagesë të detyrimeve tatimore, nëse tatimpaguesi nuk dorëzon urdhërpagesën përkatëse të plotësuar në mënyrë të rregullt. Urdhërpagesa ka formën dhe përmbajtjen sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Kur është e mundur për personin e tatueshëm, pagimi i detyrimeve tatimore nga ana e tij mund të bëhet edhe në mënyrë elektronike, nëpërmjet bankave ose institucioneve të tjera, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet që këto të fundit kanë lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për pranimin e pagesave elektronike.

74.4 Kur afati i fundit për pagesën e detyrimit tatimor bie në ditë pushimi, data e pagesës së tatimit është dita e parë e punës, pas ditës së pushimit. Kështu për shembull, në qoftë se data 14 e një muaji bie diten e shtune të këtij muaji, si dite e fundit e afatit të pagesës së TVSH-ne për personin e tatueshëm, do të konsiderohet data 16 e muajit (pra dita e hene si dite e pare e punës pas dites së shtune dhe të djele, si dite pushimi).

74.5 Të gjitha pagesat tatimore kryhen në lekë.

75. Detyrimet tatimore, të paguara më tepër

75.1.1 Kur shuma e detyrimit tatimor të paguar është më e madhe së shuma e tatimit të vlerësuar në njoftimin e vlerësimit tatimor apo në deklaraten tatimore, administrata tatimore e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga personi i tatueshëm. një gje e tille, bëhet në mënyrë automatike nga vete administrata tatimore, brenda periudhes së pare vijuese tatimore që vjen pas periudhes në të cilën personi i tatueshëm rezulton me kredi tatimore. për tatimin mbi fitimin një gje e tille, bëhet brenda muajit të pare që pason muajin në të cilin personi i tatueshëm rezulton me kredi tatimore. Ky rregull zbatohet në mënyrë automatike nga administrata tatimore edhe në rastin kur personi i tatueshëm rezulton me teprice kreditore të TVSH-së e cila ka plotesuar kushtet ligjore për tu rimbursuar. Teprica kreditore e TVSH-së e një personi të tatueshëm, e cila ka plotesuar kushtet ligjore për tu

rimbursuar, kalon në mënyrë automatike, brenda periudhes së pare vijuese tatimore që vjen pas periudhes në të cilën personi i tatueshëm ka plotesuar kushtet ligjore, për llogari të detyrimeve të tjera tatimore të papaguara të personit të tatueshëm. për këtë kalim, njoftohet menjeherë edhe personi i tatueshëm sipas rregullave të njoftimit të përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim.

Në zbatim të nenit 75, pika 1, germa "a", drejtoritë rajonale tatimore procedojnë me kthimin e detyrimeve tatimore të paguara tepër, përfshirë edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, duke paraqitur në degën përkatëse të thesarit urdhërpagesën për rimbursim, sipas modelit nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, të detajuar sipas klasifikimit ekonomik të të ardhurave tatimore, për të cilat bëhet kthimi i detyrimeve tatimore të paguara tepër.

75.1.2 Kur shuma e teprices së kredise tatimore është më e madhe se shuma e detyrimeve të tjera tatimore të papaguara të personit të tatueshëm, diferenca e mbetur, sipas kërkesës me shkrim të personit të tatueshëm, mund të :

a) Rimbursohet automatikisht për personin e tatueshëm, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e derdhjes së shumës së paguar më tepër apo nga data e plotesimit të kushteve ligjore për rimbursim;

b) Kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.

75.2 Veprimet për shumat e paguara më tepër për detyrimet tatimore regjistrohen në dosjen e tatimpaguesit.

75/1. Mënyra dhe procedura për rimbursimin e TVSH-së së miratuar dhe për kompensimin e detyrimeve tatimore me TVSH-në, e rimbursueshme.

75/1.1 Personi i tatueshëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 77 të ligjit për TVSH-në, ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së nëpërmjet kërkesës për rimbursim. Gjithashtu, me kërkesën për rimbursim, përcaktohet shuma që do të kalojë për kompensim të detyrimeve tatimore të papaguara, nëse ka të tilla, përveç detyrimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shumën që do t'i rimbursohet nëpërmjet thesarit.

75/1.2 Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, nëpërmjet strukturave përkatëse të administratës tatimore, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim dhe 30 ditëve për tatimpaguesit eksportues, kryejnë procedurën e rimbursimit sipas këtij udhëzimi dhe miraton tepricën e TVSH-së së zbritshme si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, sipas analizës së riskut, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, e cila shqyrton kërkesën për rimbursim, si dhe kryen të gjithë procedurën e rimbursimit, i kërkon Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse të ushtrojë kontroll tatimor përpara miratimit të shumës së rimbursueshme.

1. Rregullat e rimbursimit

Rimbursimi i TVSH-së kryhet nëpërmjet sistemit të thesarit:

a) brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së eksportuesve të kategorizuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar";

b) brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për tatimpaguesit që nuk kategorizohen më sipër.

Afatet e përcaktuara për rimbursimin e TVSH-së, sipas kategorive të personave të tatueshëm fillojnë nga data e kërkesës për rimbursim të TVSH-së, kërkesë e bërë nëpërmjet formularit, "Kërkesë për rimbursim të TVSH-së", sipas modelit të miratuar, datë e cila është e njëjtë me datën e pasqyrimit të formularit, "Kërkesë për rimbursim të TVSH-së", në sistemin informatik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Rimbursimi i TVSH-së kryhet sipas një procedure të bazuar në analizën e riskut për rimbursim. Kriteret e riskut janë objektive dhe zbatohen me drejtësi për të gjithë tatimpaguesit. Trajtimi i kërkesave mund të ndryshojë në varësi të shkallës së riskut dhe vlerës së TVSH-së të kërkuar për rimbursim.

Administrimi i procesit të rimbursimit të TVSH-së kryhet në përputhje me rregullat me bazë riskun, të vendosura në rregulloren e hartuar nga Komiteti i Menaxhimit të Riskut pranë DPT-së dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Me marrjen e kërkesës për rimbursim, fillimisht verifikohet nëse kërkesa është bërë nga një tatimpagues eksportues ose jo.

Eksportues për qëllime të këtij udhëzimi konsiderohen eksportuesit e kategorizuar sipas VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" për qëllime të rimbursimit të TVSH-së.

Nëse sipas kritereve të VKM-së tatimpaguesi është eksportues me risk zero, për periudhën për të cilën kërkon rimbursim, atëherë kërkesa nuk i nënshtrohet analizës së riskut për rimbursim dhe rimbursohet automatikisht.

Nëse tatimpaguesi nuk është eksportues me risk zero (eksportues vlera e eksporteve të kryera prej të cilit është më shumë së 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve përfshirë eksportet), por i nënshtrohet regjimit të përpunimit aktiv ose është eksportues, vlera e eksporteve të të cilit përbën më shumë së 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve përfshirë eksportet, duhet të rimbursohet brenda 30 ditëve, por duke iu nënshtruar më parë analizës së riskut.

Nëse tatimpaguesi nuk është eksportues, atëherë kërkesa për rimbursim, i nënshtrohet procedurës normale të rimbursimit duke iu nënshtruar analizës së riskut për rimbursim.

Kërkesat për rimbursim, të cilat pas shqyrtimit nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve konsiderohen pa risk, do të procedohen me rimbursim automatik të shumës së kërkuar, duke mos kryer kontroll të personit të tatueshëm përpara së të miratojë rimbursimin e TVSH-së, ndërsa për kërkesat e tjera, të cilat vlerësohen me risk, rimbursimi i shumës së kërkuar do të kryhet nëpërmjet thesarit pas kontrollit nga zyra ose kontrollit në vend.

2. Procedura e rimbursimit

2.1 Çdo person i tatueshëm, i cili plotëson kushtet e parashikuara në nenin 77 të ligjit "Për TVSH-në", ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së.

2.2 Për këtë ai plotëson formularin "Kërkesë për rimbursim të TVSH-së", sipas modelit të miratuar në këtë udhëzim. Aplikimi bëhet elektronikisht dhe i kalon për trajtim Drejtorisë së rimbursimit të TVSH-së, në DPT. Kjo kërkesë regjistrohet automatikisht në regjistrin e posaçëm të rimbursimit të TVSH-së sipas një rendi kronologjik.

2.3 Kjo drejtori kryen dhe përfundon procesin e verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim në lidhje me:

a) Përputhshmërinë e shumës së kërkuar për rimbursim sipas formularit "Kërkesë për rimbursim", me shumën e TVSH-së së zbritshme që rezulton në llogarinë e tatimpaguesit.

b) Plotësimin e kërkesave ligjore mbi kërkesën për rimbursim, të cilat konsistojnë në:

i) Për tatimpaguesit e përcaktuar eksportues, sipas VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për këtë qëllim, verifikimin e plotësimit të kriterit ligjor, nëse teprica e TVSH-së së zbritshme të kërkuar për rimbursim është më e madhe së 400.000 lekë;

ii) Për tatimpaguesit e tjerë joeksportues, verifikimin e plotësimit të kriterit ligjor, nëse rezulton me TVSH-në të zbritshme për secilën nga tri periudhat e njëpasnjëshme, shumë e cila pas këtyre tri periudhave duhet të jetë më e madhe së 400.000 (katërqind mijë) lekë.

Në përfundim të këtij procesi, personi përgjegjës mban një akt për evidentimin e plotësimit ose jo të kritereve të mësipërme.

2.4 Në rastin kur nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim rezulton së kriteret nuk janë plotësuar, kërkesa konsiderohet e parregullt dhe nuk pranohet. Në këtë rast, Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i procesit të verifikimit, nis nëpërmjet postës elektronike për personin e tatueshëm një njoftim me shkrim sipas formatit nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi, "Njoftimi për mospranim të kërkesës për rimbursim të TVSH-së", ku i bëhet e ditur së kërkesa e tij nuk është pranuar, duke dhënë njëkohësisht edhe shkaqet e mospranimit. Ky person i tatueshëm, mund të paraqesë një kërkesë të re për rimbursim sipas rregullave të mësipërme,

vetëm pasi të ketë rregulluar situatën dhe të ketë eliminuar shkaqet për të cilat nuk iu pranua kërkesa e mëparshme.

Në këtë rast, Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së, në DPT bën pasqyrimin e refuzimit në sistemin informatik tatimor duke kaluar shumën e kërkuar për rimbursim nga "Kërkesë për rimbursim të TVSH-së" në "Tepricë kreditore e TVSH-së".

2.5 Në rastin kur nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim rezulton së kriteret janë plotësuar, kërkesa konsiderohet e pranuar. Në këtë rast, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës tatimpaguesit i dërgohet njoftim, sipas formatit nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, "Njoftim për pranimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së" dhe tatimpaguesi vihet në dijeni së kërkesa e tij do të procedohet më tej nëpërmjet analizës së riskut për rimbursim.

Ky njoftim përmban:

i) emrin dhe NIPT-in e personit të tatueshëm;

ii) cilësimin nëse subjekti është eksportues ose jo;

iii) shumën e kërkuar për rimbursim; dhe

iv) datën kur është regjistruar, kërkesa në DPT. Ky njoftim nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Gjithashtu, në të njëjtën kohë një kopje e këtij njoftimi i dërgohet edhe degës së thesarit elektronikisht ose nëpërmjet shërbimit postar.

Në këtë rast, sipas procedurës, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT vijon me vlerësimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së, sipas kritereve të riskut.

Për qëllime të analizës së riskut, kjo Drejtori, kur e gjykon të nevojshme, mund t'i kërkojë personit të tatueshëm kopjet e faturave të blerjeve apo të deklaratave të importit, për të cilat ka lindur e drejta e zbritjes së TVSH-së.

Në përfundim të procesit që lidhet me vlerësimin e faktorëve të riskut, kryhet procedura e mëposhtme.

2.5.1 Nëse kërkesa për rimbursim konsiderohet pa risk atëherë procedohet me miratimin e rimbursimit dhe kryerjen e procedurave të pagesës nëpërmjet sistemit të thesarit. Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së, në DPT, përgatit për tatimpaguesin njoftimin zyrtar sipas formatit nr. 3, "Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së", bashkëngjitur këtij udhëzimi, një kopje të së cilës ia dërgon degës së thesarit elektronikisht ose nëpërmjet shërbimit postar dhe vijon me procedurën për rimbursim nëpërmjet thesarit.

2.5.2 Nëse kërkesa për rimbursim rezulton me risk për rimbursim, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, e dërgon në drejtorinë rajonale ku është regjistruar tatimpaguesi për kontroll nga zyra ose në vend para së të rimbursohet. Procedura e kontrollit kryhet siç është parashikuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Me qëllim respektimin e afateve të rimbursimit të TVSH-së, në rastet kur tatimpaguesi i nënshtrohet kontrollit tatimor, afati për përfundimin e Raportit të Kontrollit nga inspektori/inspektorët është, jo më shumë së 5 ditë kalendarike pas përfundimit të tij. Gjithashtu, edhe afati për kundërshtimin e rezultateve të kontrollit tatimor nga tatimpaguesi është jo më shumë së 5 ditë kalendarike pas datës kur vlerësohet së është marrë. I njëjti afat prej 5 ditësh kalendarike zbatohet dhe për plotësimin dhe nënshkrimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit.

2.5.3 Pas përfundimit të kontrollit nga zyra ose në vend, nxjerrjes së rezultateve përfundimtare të tij, ku saktësohet shuma e TVSH-së për t'u rimbursuar, dhe pas kryerjes së kompensimeve të nevojshme në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, raporti paraprak dhe më pas raporti përfundimtar i kontrollit ku detajohet shuma e miratuar për rimbursim dhe shuma e kompensimeve të kryera, në rastet kur kryhen kompensime, i përcillet Drejtorisë të Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, e cila njofton tatimpaguesin dhe degën e thesarit sipas formatit nr. 3, "Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSh-së", duke vijuar me procedurën për rimbursim nëpërmjet thesarit.

2.6 Pas miratimit të shumës së TVSH-së për t'u rimbursuar plotësohet urdhër-pagesa për rimbursim (UPR) me shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimbursohet për personin e tatueshëm dhe të dhëna të tjera sipas formatit nr. 4 të urdhërpagesës bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe së bashku me njoftimin në përputhje me formatin nr. 3, pasi nënshkruhen nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, i dërgohen me postë rekomande degës përkatëse të thesarit në dy kopje. Njëra nga kopjet e UPR-së, pasi kundërfirmoset dhe vuloset nga dega e thesarit, i kthehet Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në DPT. Dega përkatëse e Thesarit, regjistron UPR-në në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe paguan brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, duke debituar llogarinë ekonomike të së ardhurës nga TVSH-ja për shumën e rimbursueshme. Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së rakordon me degën e thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare lidhur me TVSH-në. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të thesarit) njofton zyrtarisht/elektronikisht Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, e cila reflekton ndryshimet në dosjen e tatimpaguesit dhe në kontabilitet.

2.7 Nëse pas rezultateve të kontrollit kërkesa për rimbursim refuzohet tërësisht ose pjesërisht, mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim edhe nëse është i pjesshëm, personi i tatueshëm njoftohet nga drejtoria rajonale tatimore me një akt njoftim vlerësimi tatimor sipas përcaktimit të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Drejtoria rajonale tatimore, në përfundim të kontrollit nëse kërkesa për rimbursim refuzohet tërësisht ose pjesërisht, mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim edhe nëse është i pjesshëm njofton gjithashtu, Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, e cila nga ana e saj njofton degën e thesarit sipas formatit nr. 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi për refuzimin e rimbursimit.

Në raste të refuzimit ose të mosmiratimit të një kërkese për rimbursim, plotësisht ose pjesërisht, për arsye që kanë të bëjnë me rezultatet e kontrollit ose me shkelje të tjera ligjore, personi i tatueshëm ndaj çdo refuzimi ose mosmiratimi për rimbursim, ka të drejtë të apelojë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Të gjitha procedurat e mësipërme, për kryerjen e të cilave ngarkohet Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT dhe drejtoritë rajonale tatimore, duhet të procedohen brenda afateve të përcaktuara, përkatësisht 30 ditë për eksportuesit e kategorizuar sipas VKM-së, dhe 60 ditë për tatimpaguesit e tjerë, duke filluar nga data e paraqitjes të kërkesës për rimbursim në Drejtorinë Rimbursimit të TVSH-së. Pagesa e shumës së miratuar për rimbursim kryhet brenda 5 ditëve nëpërmjet sistemit të thesarit.

2.8 Siç përcaktohet në nenin 77 të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, administrata tatimore, para së të procedojë me rimbursimin e TVSH-së për një person të tatueshëm, ka të drejtë ta detyrojë atë person të provojë që qëllimi i veprimtarisë ekonomike është realizimi i transaksioneve të tatueshme, që i japin të drejtën e zbritjes së TVSH-së.

75/1.3 Në rastin kur tatimpaguesi e kërkon, radha e kompensimit të detyrimeve (sipas llojit të tyre) duhet të përcaktohet nga personi i tatueshëm, si dhe përparësia e kompensimit do të bëhet sipas plotësimit (radhitjes) së rubrikave për llojin e tatimit në formularin "Kërkesë për rimbursim", i cili plotësohet në momentin kur tatimpaguesi kërkon rimbursimin e shumës së TVSH-së.

75/1.4 Në rastin kur personi i tatueshëm nuk ka detyrime të tjera tatimore dhe drejtoria rajonale nuk ka rimbursuar në llogarinë e tij shumën e miratuar për t'u rimbursuar, pasi janë plotësuar kushtet, tatimpaguesit i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve tatimore të periudhave të ardhshme, deri në masën e shumës së TVSH-së që kërkohet për t'u rimbursuar. Në këtë rast, drejtoria rajonale tatimore shumën e parimbursuar e kalon për likuidim të këtyre detyrimeve. Data e deklarimit të deklaratës tatimore fillestare në të cilin ka lindur detyrimi për t'u paguar (dhe i papaguar) do të konsiderohet si datë për kalimin e shumës së rimbursueshme për llogari të këtij detyrimi.

75/1.5 Në rastin kur administrata tatimore ka verifikuar, vlerësuar dhe njoftuar me shkrim tatimpaguesin, së nuk plotësohen kushtet ligjore për rimbursimin e TVSH-së, duke dhënë edhe sqarimet përkatëse, tatimpaguesi nuk mund të pretendojë t'i rimbursohet TVSH-ja e kërkuar për rimbursim e as të kalojë TVSH-në e pretenduar për t'u rimbursuar për llogari të detyrimeve të tjera. Në këtë rast tatimpaguesi mund të ndjekë të gjitha procedurat ligjore të apelimit.

Kompensimi i detyrimit për t'u paguar (detyrim sipas vetëdeklarimit me deklaraten tatimore fillestare) me shumën e TVSH-së së rimbursueshme do të bëhet me datën e deklarimit të deklaratës tatimore fillestare vetëm në rastin kur detyrimi i papaguar me këtë deklaratë i përket një periudhe tatimore pas periudhës në të cilën është miratuar rimbursimi dhe vetëm për detyrim të papaguar sipas deklaratës tatimore fillestare.

75/1.6 Deklarimi sipas afateve ligjore të përcaktuara sipas këtij ligji apo ligjeve specifike është i detyrueshëm për t'u zbatuar në çdo rast, përndryshe mosdeklarimi në kohë do të bëhet shkak për llogaritjen e kamatvonesave dhe gjobave sipas këtij ligji edhe për pagesën e detyrueshme nëse tatimpaguesi do të ketë sipas deklarimit.

75.3 Kompensimi nga teprica kreditore i detyrimeve tatimore brenda çdo tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kryhet automatikisht nga sistemi informatik.

75.3 Në zbatim të nenit 75, pika 4 të ligjit, në raste të veçanta, shumat e tatimeve dhe të taksave për t'u paguar apo të paguara më tepër në administratën tatimore ose administratën doganore mund të kompensohen përkundrejt njëra-tjetrës.

Në rast se tatimpaguesi në administratën tatimore/doganore rezulton me tatime/taksa të paguara më tepër dhe njëkohësisht në administratën tatimore/doganore ka tatime/taksa të papaguara dhe përmbush kriteret e përcaktuara më poshtë në këtë pikë, ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për kompensim. Në kërkesën, e cila paraqitet njëkohësisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, tatimpaguesi kërkon kompensimin/kalimin e shumës së paguar me tepër në organin tatimor për likuidimin e tatimeve/taksave të papaguara pranë organit doganor, ose anasjelltas kërkon pranë organit doganor kompensimin/kalimin e shumës së paguar më tepër për likuidim të tatimit/taksës së papaguar që ka në administratën tatimore.

Kriteret që duhet të përmbushen për të ushtruar të drejtën për të kërkuar kompensim të ndërsjellë midis organit tatimor dhe organit doganor, janë të gjitha si vijon:

- teprica kreditore, që do të përdoret për kompensim, është me e madhe se 1.000.000.000 lekë;
- teprica kreditore në shumën e mësipërme është e rimbursueshme sipas një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- tatimet/taksat që kompensohen përfshijnë TVSH-në, tatim fitimin, akcizën, taksën kombëtare.

Me paraqitjen e kërkesës nga tatimpaguesi, përkatësisht, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve/Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shkëmbejnë zyrtarisht informacionin midis strukturave të tyre lidhur me situatën e tatimpaguesit për sa vijon:

1. Paraqitje dhe shpjegim i situatës së tatimpaguesit, të lëshuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve duke përcaktuar shumën kreditore dhe/ose debitore sipas llojit, si dhe duke argumentuar që ky informacion shkëmbehet për qëllime të kompensimit midis dy administratave, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës që dokumenton/provon situatën kreditore ose debitore përkatësisht.

Paraqitje dhe shpjegim i situatës së tatimpaguesit të lëshuar nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave, duke përcaktuar shumën kreditore dhe/ose debitore sipas llojit, si dhe duke argumentuar që ky informacion shkëmbehet për qëllime të kompensimit midis dy administratave, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës që dokumenton/provon situatën kreditore ose

debitore përkatësisht.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me marrjen e kërkesës prej tatimpaguesit, shkëmbejnë midis tyre informacionin sipas pikës 1 më sipër, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e protokollimit të kërkesës dhe dakordësojnë përkatësisht shumën që do të kompensohet.

3. Pas shkëmbimit të informacionit, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe drejtori i Përgjithshëm i Doganave nënshkruajnë marrëveshjen për kompensimin e tatimeve/ taksave, sipas modelit të marrëveshjes të miratuar me këtë udhëzim.

4. Menjëherë pas nënshkrimit dhe protokollimit të marrëveshjes, respektivisht në të dy institucionet, administratat përkatëse kryejnë procedurat teknike-administrative, me qëllim realizimin e kompensimit. Në bazë të aktmarrëveshjes, shuma e paguar më tepër pakësohet në organin përkatës dhe shuma debitore pakësohet në organin tjetër. Strukturat përkatëse të dy administratave tatimore dhe doganore vijojnë procedurat e mëtejshme për sistemimin dhe kontabilizimin e pozicioneve debitore dhe kreditore në sistemet informatike përkatëse/regjistrat e kontabilitetit, sipas urdhrit të titullarit të institucionit tatimor/doganor.

5. Pas realizimit të kompensimit dhe evidentimit të tij në sistemet informatike përkatëse /regjistrat e kontabilitetit përkatës tatimor dhe doganor, administratat njoftojnë zyrtarisht njëra-tjetrën dhe tatimpaguesin për përdorimin e shumave përkatëse kreditore dhe për situatën debitore apo kreditore pas kompensimit në të dyja administratat tatimore dhe doganore.

6. Kjo procedurë kompensimi duhet të kryhet dhe të përfundojë jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit përkatësisht në protokollin e të dy institucioneve tatimore dhe doganore.".

7. Pas përfundimit të procedurës në pikën 5 më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dërgojnë zyrtarisht në Degën e Thesarit të Tiranës dhe për dijeni në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit njoftimin mbi veprimet kontabile (kreditore dhe debitore për çdo llogari ekonomike dhe institucionin respektiv me shumat përkatëse të tyre) me qellim evidentimin në kontabilitetit e qeverisë.

76. Kamatëvonesa

76.1.1 në rastet kur një person i tatueshëm nuk paguan shumën e plote të detyrimit tatimor brenda afateve të përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore, ai detyrohet të paguajë kamatevonesa mbi shumën e detyrimit tatimor të papaguar duke filluar nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme për tu paguar, deri në datën në të cilën pagesa kryhet.

76.1.2 Për detyrimet tatimore të konstatuara si të papaguara pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, por që i perkasin periudhave tatimore para hyrjes në fuqi të tij, zbatohen interesat e përcaktuara në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", për të gjithë periudhen para dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Kështu për shembull, në qoftë se nga një kontroll i ushtruar në janar të vitit 2009, rezulton së personi i tatueshëm ka një detyrim tatimor të papaguar prej 500 mijë lekë që i perket periudhes tatimore janar 2007, kjo shume do të ngarkohet me interesat e ligjit të ri, si për periudhen nga janari 2007 deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të ri ashtu dhe për të gjithë periudhen pas hyrjes në fuqi të tij deri në momentin e pagesës së shumës së detyrimit prej 500 mijë lekë. Interesat e përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", zbatohen edhe për detyrimet tatimore të konstatuara si të papaguara para hyrjes në fuqi të tij por që janë të papaguara teresisht apo pjeserisht, pas hyrjes në fuqi të ligjit. Pra, për detyrimet tatimore që rezultojne të papaguara ende diten e hyrjes në fuqi të ligjit, për periudhen pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri deri në datën e pagesës zbatohen interesat e reja, kurse për periudhen nga data e konstatimit të detyrimit deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, zbatohen interesat e vjetra. për shembull, të supozojme së nga një kontroll tatimor i kryer në janar 2007, ka rezultuar së personi i tatueshëm ka një detyrim tatimor të papaguar prej 1 milion lekë, dhe ky detyrim është i papaguar teresisht edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Në Këto kushte, shuma e detyrimit

tatimor prej 1 milion lekë të papaguar ende, për periudhen nga janari 2007 deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të ri do të ngarkohet me interesat e ligjit të vjeter, kurse për periudhen nga data e hyrjes në fuqi të tij deri në datën e kryerjes së pagesës së detyrimit, do të ngarkohet me interesat e ligjit të ri.

76.2 Nëse një rimbursim apo kthimi i një tatimi të paguar tepër, i cili duhej kryer nga administrata tatimore, sipas nenit 75 dhe 75/1 të Ligjit apo ligjeve të tjera tatimore, nuk kryhet brenda 30 ditëve kalendarike, administrata tatimore paguan kamatëvonesë për shumën e paguar më tepër nga personi i tatueshëm.

76.3 Kamatevonesa për mospagimin e detyrimeve tatimore brenda afateve të përcaktuara, është 120 për qind e shkalles së interesit nderbankar të Bankes së Shqipërisë e cila shpallet nga kjo e fundit për çdo tremujor, në bazë të shkalles mesatare të një tremujori me pare. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, para perfundimit të çdo tremujori duhet të marre informacion nga Banka e Shqipërisë lidhur me nivelin mesatar tremujor të interesit me të fundit të dhënë nga ana e saj. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve merr masa për dergimin e këtij informacioni në të gjitha drejtoritë rajonale si dhe për reflektimin e tij në sistemin e integruar tatimor kompiuterik.

Për qëllime të transparencës dhe të informimit të tatimpaguesve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon dhe përditëson në faqen zyrtare të internetit, normën e interesit që aplikon për llogaritjen e kamatëvonesës, në përputhje me këtë udhëzim sa herë që kjo normë ndryshon.

76.4 në çdo rast kamatëvonesat konsiderohen pjese e pandare e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Kamatëvonesat mblidhen duke respektuar të gjitha procedurat e mbledhjes së tatimeve të papaguara dhe derdhen në llogarine përkatëse të te ardhurave tatimore.

77. Marrëveshja e pagesës me këste

77.1 Në zbatim të nenit 77 të Ligjit, për shkaqe që kanë të bëjnë me gjendjen e keqe të perkohshme financiare të personit të tatueshëm, ky i fundit mund të kërkojë të paguajë me keste një detyrim tatimor të papaguar. Tatimpaguesi mund të lejohet në çdo kohë dhe sa herë që është e nevojshme të lidhë marrëveshje të pagesës me këste, por, në të njëjtën kohë ai duhet të vërtetojë pamundësinë aktuale financiare, si dhe të tregojë që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes. Për të gjykuar në lidhje me pamundësinë financiare mund të shërbejnë pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditëtet etj.

77.2 Kërkesa nga ana e personit të tatueshëm bëhet me shkrim dhe i drejtohet drejtorit të Drejtorisë rajonale të tatimeve. Në kërkese paraqiten të gjithë rrethanat në të cilat ndodhet personi i tatueshëm dhe arsyet pse ai kërkon të lidhe një mareveshje për të paguar me keste detyrimet e tij tatimore. Në kërkesë duhet të paraqiten argumentet për pamundësinë aktuale financiare, si dhe argumentet mbi aftësinë paguese të tatimpaguesit në të ardhmen.

77.3.1 Marrëveshja e pagesës me këste bëhet me shkrim, brenda një afati prej 10 ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës. Kjo marrëveshje nënshkruhet nga tatimpaguesi dhe nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve ose drejtuesi i njësisë së ngjashme me të vetëm nëse tatimpaguesi paguan menjëherë 20% të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja e pagesës me këste.

77.3.2 Pranimi i pagesës me keste të një detyrimi tatimor të papaguar, nga administrata tatimore, do të thotë së gjatë periudhes për të cilën është rene dakord për pagimin me keste, ndaj tatimpaguesit nuk mund të merren masat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të përcaktuara në Ligj. Këto masa duhet të merren vetëm pasi ka perfunduar afati për të cilin është pranuar pagesa me keste ose pas datës së zgjidhjes së marrëveshjes së pagesës me keste.

77.4 Pagesa me keste nuk mund të pranohet për një periudhe me të gjatë së fundi i vitit të ardhshem kalendarik pas momentit të hartimit të mareveshjes.

77.5 Drejtori i Drejtorisë rajonale të tatimeve, kur kërkesa e personit të tatueshëm është e paargumentuar dhe e pajustifikuar nga rrethanat, mund të refuzojë kërkesën për marrëveshje pagese me këste ose të kërkojë garanci bankare para së të hyjë në një marrëveshje të tillë.

Garancia duhet të jepet nga njera prej bankave, klient i të ciles është personi i tatueshëm që kërkon pagesën me keste. Në këtë rast, banka që lëshon garancine, bëhet garante për detyrimin e personit të tatueshëm. Pasi personi i tatueshëm paraqet dokumentin e kësaj garancie, drejtori i Drejtorisë rajonale të tatimeve mund të pranoje të nenshkruajë mareveshjen e pagesës me keste të detyrimeve tatimore të papaguara.

77.6 Në rastet e marrëveshjeve për pagesë me këste, duke filluar nga muaji që pason muajin në të cilin është nënshkruar marrëveshja deri në përfundimin e afatit të marrëveshjes sipas pikës 4 të nenit 77 të ligjit, me kushtin që marrëveshja të jetë përmbushur tërësisht, tatimpaguesi paguan kamatëvonesat, por nuk llogaritet gjobe për pagesë të vonuar.

77.7 a) Marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet për detyrime tatimore të vendosura nga administrata tatimore si rezultat i një vlerësimi tatimor të kryer, sipas nenit 68, të ligjit në fuqi "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", si dhe për detyrime tatimore të vetëdeklaruara (vetëvlerësimit) nga tatimpaguesi.

b) Pavarësisht sa përcaktohet në shkronjën "a", të mësipërcituar, administrata tatimore nuk hyn në një marrëveshje të pagesës me këste, vetëm për detyrim tatimor mbi të ardhurat të mbajtur në burim dhe të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, si dhe për detyrim nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tatimpaguesit.

c) Përjashtimisht, në rastet kur në cilësinë e tatimpaguesit janë institucione apo ente shtetërore apo publike, qendrore apo vendore apo ente të tjera ku shteti është palë, për raste të një interesi të lartë publik ose të nevojës për moslejimin e cenimit të rendit dhe të sigurisë kombëtare, mund të lidhet një marrëveshje me këste edhe për detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

d) Në çdo rast, për lidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste, duhet të përmbushen kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 77, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe marrëveshja nuk lehtëson pozitën ligjore të personit përgjegjës në rastet e prezumimit apo konsumimit të veprës penale së parashikuar ligjërisht lidhur me detyrimin tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

77.8 Marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet edhe në rastet kur ka filluar mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore për tatimpaguesin. Në këto raste edhe pse hiqet urdhërbllokimi i llogarive bankare të tatimpaguesit, nuk mund të hiqet masa e sigurimit të detyrimit tatimor. Nuk mund të lidhet marrëveshje nëse për tatimpaguesin kanë filluar procedurat sipas nenit 96 të ligjit për sekuestrimin e pasurisë.

78. Zgjidhja e Marrëveshjes së pagesës me këste

Marrëveshja e pagesës me këste mund të zgjidhet nga administrata tatimore, në momentin me të pare që personi i tatueshëm nuk e respekton atë lidhur me rregullshmerine e pagesave si dhe kur ai nuk paguan detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja. Në këtë rast, personi i tatueshëm është i detyruar të paguajë të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, që mbulohen nga kjo marrëveshje, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes së marrëveshjes. Nëse këto detyrime nuk paguhen, administrata tatimore mbledh detyrimet në përputhje me dispozitat e kreut XI të ligjit.

79. Radha e pagesës së detyrimeve tatimore dhe të kontributeve

Pagesat e kryera për çdo tatim, përveç pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, fillimisht do të shkojnë për të mbyllur detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj detyrimi, në qoftë së këto detyrime nuk janë në proces apelimi, gjykimi apo në marrëveshje të pagesës me këste të detyrimeve tatimore të papaguara. Në rastet kur një tatimpagues, për arsye të ndryshme, nuk arrin të paguajë të gjithë shumën e detyrimeve të deklaruara prej vetë atij apo të vlerësuara nga administrata tatimore, shumat e paguara mbulojnë detyrimet e papaguara sipas radhës së mëposhtme:

a) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore;

b) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit;
c) kontributet e detyrueshme suplementare të sigurimeve shoqërore;
ç) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit;
d) tatimet;
dh) kamatëvonesat;
e) gjobat;
ë) kostot administrative.

Në rastet kur një tatimpagues, për çfarëdo arsye, rezulton me një mbipagesë të një detyrimi tatimor apo të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, shuma e mbipagesës kalon për pagesën e detyrimeve të papaguara sipas radhës së mësipërme të pagesave.

Radha e mësipërme e pagesave zbatohet edhe në çdo rast pagese të paidentifikuar të kryer nga tatimpaguesi.

KREU X
KONTROLLI TATIMOR

80. Kontrolli tatimor

80.1.1 Objektivi i kontrollit tatimor është sigurimi i plotësimit të detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, nëpërmjet zbulimit dhe parandalimit të shmangieve tatimore dhe evazionit fiskal.

80.1.2 Perpara së të procedohet konkretisht nëpërmjet një kontroll tatimor tek personi i tatueshëm, drejtoria rajonale e tatimeve është e detyruar ti dergoje paraprakisht atij njoftimin për kontroll. Përmbajtja e njoftimit për kontroll është siç përcaktohet në nenin 81 të ligjit.

80.2 Kontrolli tatimor i veprimtarisë ekonomike e tregtare të personit të tatueshëm bazohet në deklaratat tatimore të tij, në dokumentet, në librat dhe regjistrimet e mbajtuara nga ai, si dhe në të dhënat e siguruara nga palet e treta që kanë hyre në maredhenje me personin e kontrolluar apo nga çdo burim tjetër të mundshem informacioni. Kontrolli konsiston në verifikimin në vend të kontabilitetit dhe të dokumentacionit të mbajtur nga tatimpaguesi (i çfarëdo forme juridike qoftë ai), për tu siguruar mbi saktesine e deklaratave të paraqitura. Nëse kontabiliteti i tatimpaguesit është i kompjuterizuar, kontrollori mund të therrase persona të specializuar në kontrollin informatik. Në këtë rast, personi i tatueshëm informohet me shkrim për emrat dhe cilësite e ketyre të fundit. Kur gjatë ushtrimit të kontrollit tatimor tek personi i tatueshëm, konstatohen rrethanat e përcaktuara në nenin 71 të ligjit, drejtoria rajonale e tatimeve mund të procedoje me mënyrat alternative të vlerësimit tatimor.

80.3 Kontrollet tatimore jane:

a) Kontroll tatimor i plote në vend. Këto kontrolle janë gjithë përfshirëse dhe ndermerren për të kontrolluar të gjitha aspektet e biznesit të personit të tatueshëm për të gjitha periudhat kohore që nga kontrolli i plote i fundit dhe të gjithë llojet e tatimeve. Këto kontrolle kryhen bazuar në analizën e riskut.

b) Vizitat fiskale. Këto janë kontrolle të shkurtra të kryera gjatë një periudhe të shkurter kohore për të verifikuar saktesine e deklaratave dhe pagesave, si rregull vetëm për një periudhe të caktuar tatimore dhe vetëm për një lloj tatimi. Në rastet kur nga Këto vizita fiskale konstatohen probleme serioze dhe dyshime të bazuara për fshehje tatimi, kontrollori propozon kryerjen e një kontrolli të plote në vend.

c) Verifikimet në vend. Këto verifikime të shkurtra synojne zbulimin në kohe të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshëm (identifikimin e personave të paregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale në mallrat e akcizes, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe leshimin faturave tatimore, etj. Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verfikimit, të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e dites, të lëshuar nga drejtuesi i Drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend.

d) Kontrolli që kryhet me objekt "Transferimin e çmimit" është kontroll specifik që kryhet në zbatim të neneve 36–36/7 të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe udhëzimit nr. 16, datë 18.6.2014 "Për transferimin e çmimit". Nëse një tatimpagues është kontrolluar më parë për tatim fitimin, por nuk është kontrolluar për qëllime të transferimit të çmimit në zbatim të dispozitave për këtë qëllim, atëherë kontrolli për transferimin e çmimit nuk konsiderohet rikontroll tatimor në kuptim të nenit 85 të ligjit dhe pikës 85 të këtij udhëzimi.

Procedurat teknike të detajuara për kryerjen e një kontrolli tatimor përcaktohen në manualin e kotrollit tatimor.

80.4.1 Plani i përgjithshëm i kontrollit për një vit kalendarik bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve brenda muajit dhjetor të vitit paraardhës. Kriter baze për përgatitjen e planit të kontrolleve, është vlerësimi i analizes së riskut të kryer në mënyrë automatike apo manuale nga çdo drejtori rajonale e tatimeve, për të identifikuar personat e tatueshëm që paraqesin riskun me të larte për evazion dhe shmangie tatimore. Plani i kontrollit hartohet duke synuar perfshirjen për kontroll të personave të tatueshëm me riskun me të larte. Plani i kontrollit të drejtorisë rajonale përgatitet nga përgjegjësi i Drejtorisë së kontrollit tatimor dhe miratohet e nenshkruhet nga drejtori i Drejtorisë rajonale të tatimeve.

80.4.2 Në rastet kur tatimpaguesi i ka deklaratat tatimore, ku përfshihen deklaratat e TVSH-së dhe të tatim-fitimit apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të certifikuara nga kompani audituese ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë, ku vërtetohet së ato janë në përputhje me legjislacionin fiskal, administrata tatimore e përfshin këtë element në analizën e riskut të tatimpaguesit.

80.4.2.1 Certifikimit do t'i nënshtrohen deklarata e tatimit mbi fitimin (vjetore), deklarata e tatimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël, si dhe deklarata e tatimit mbi vlerën e shtuar (mujore) të tatimpaguesve të cilët kanë për detyrim që të deklarojnë pranë administratës tatimore.

Certifikimi i deklaratave tatimore nuk është kërkesë e detyrueshme, por është në vullnetin e lirë të tatimpaguesit nëse i certifikojnë apo jo, deklaratat e tyre tatimore nga kompanitë audituese ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë.

Procesi i certifikimit do të bëhet me një raport i cili do të dorëzohet elektronikisht duke u ngarkuar në sistemin e deklarimit të detyrimeve tatimore, por jo më vonë së data e fundit e muajit gjatë të cilit raporti është lëshuar nga kompania audituese ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë. Raporti duhet të përmbajë detaje të arsyeshme dhe kalkulimet e nevojshme për zërat për të cilët tatimpaguesi dhe kompania audituese kanë rënë dakord. Gjithashtu duhet të përmbajë edhe detaje dhe kalkulime për të cilat tatimpaguesi dhe kompania audituese mund të mos kenë rënë dakord.

Kompanitë audituese nuk duhet të bëjnë certifikimin e deklaratave tatimore të njëjtit tatimpagues për të njëjtin lloj tatimi për më gjatë së katër (4) vite të njëpasnjëshme. Pas një pauze njëvjeçare mund të fillojë përsëri edhe për katër (4) vite të tjera.

80.4.2.2. Deklaratat tatimore të certifikuara do të jenë objekt i kontrollit nga administrata tatimore sipas procedurave të rregullta të kontrollit të parashikuara nga ligji nr. 9920, datë 20.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Deklaratat tatimore të certifikuara do të merren në konsideratë nga organet tatimore gjatë analizës së riskut në procesin e përzgjedhjes së tyre për kontroll tatimor.

80.4.2.3 Procedura e konkurrimit për krijimin e listës së kompanive audituese/kompanive të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë, që do të kenë të drejtën për certifikimin e deklaratave tatimore për pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e legjislacionit fiskal, kryhet sipas përcaktimeve të kësaj dispozite. Për t'u listuar për të fituar të drejtën për kryerjen e këtij shërbimi, kompanitë audituese/apo kompanitë e klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

i) Të jenë shoqëri të auditimit ligjor të publikuara në Regjistrin publik të EKR-ve të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar apo kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë të regjistruara sipas kushteve të përcaktuara në ligj;

ii) Të ketë përvojë në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe këshillimeve tatimore;

iii) Të kenë auditues ligjor me eksperiencë në rolin e ortakut.

Të drejtën për të aplikuar për listim e kanë edhe bashkimet e dy shoqërive audituese/kompani të të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë, që të vetme nuk i plotësojnë kriteret e mësipërme, të cilat kur aplikojnë dorëzojnë edhe marrëveshjen e bashkëpunimit midis tyre, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet reciproke në rast përfshirje si bashkim shoqërish për kryerjen e certifikimit të deklaratave tatimore.

Kompanive audituese /kompanive të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë, u bëhet ftesë dhe u kërkohet të paraqesin dokumentacionin sipas kritereve të përcaktuara në këtë dispozite, pranë protokollit të Ministrisë së Financave në adresën bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë". Dokumentet dorëzohen në një zarf të mbyllur me mbishkrimin: "Për komisionin e përzgjedhjes së shoqërive audituese, për listim".

Për të marrë pjesë në konkurrim, kompanitë audituese/ kompanitë e klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë, duket të plotësojnë disa kritere:

1. Kriteri ligjor përfshin vërtetimin me dokumente të faktit që subjekti aplikues plotëson këto dy kushte:

a) ka 10 vite përvojë në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe këshillimeve tatimore;

b) ka të paktën një auditues ligjor në rolin e ortakut të angazhimit me përvojë pune jo më pak së 5 vjet;

Për të vërtetuar kushtet si më sipër, dhe kërkesat e tjera të konkurrimit, kompanitë audituese/ kompanitë e klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë dorëzojnë:

- ekstraktin e QKB-së;
- vërtetim nga IEKA-ja që është e regjistruar në Regjistrin Publik të EKR-së/vërtetim për regjistrim sipas ligjit të veçantë;
- një listë të klientëve të cilëve ju ka ofruar shërbimet e auditimit, kontabilitetit dhe këshillimet tatimore, me të cilët ka lidhur kontratat e shërbimit.
- listëpagesat e punonjësve;
- CV të audituesit ligjor në rolin e ortakut të angazhimit;
- vërtetim që shoqëria nuk është në proces falimentimi;
- vërtetim që administratorët dhe ortakët nuk janë dënuar për shkelje penale;
- vërtetim që nuk ka detyrimet tatimore të papaguara;
- vërtetim që nuk ka detyrime për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të papaguara.

Kompania Audituese duhet të jetë e regjistruar në Regjistrin Publik të EKR-së të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Kompanitë e klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë duhet të jenë të regjistruara sipas kushteve të përcaktuara në ligj.

Në rastet e bashkimit të kompanive audituese/kompanive të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë, çdo anëtar i bashkimit duhet të dorëzojë dokumentet e lartëpërmendura. Bashkimi i kompanive audituese/kompanive të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen e bashkëpunimit midis tyre, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet reciproke.

2. Kriteri teknik: Për të vërtetuar kapacitetin teknik aplikuesi duhet të paraqesë:

Historik i shkurtër dhe përshkrim i kompanisë audituese/ kompanisë të klasifikuar si të tillë me ligj të veçantë përfshirë një prezantim të stafit dhe kualifikimeve të tyre (CV);

3. Kritere të tjera: Deklaratë e Administratorit të shoqërisë së Shoqëria nuk do të kryejnë shërbimin e verifikimit dhe certifikimit të deklaratave tatimore të një tatimpaguesi, në rastet kur ato, të punësuarit e tyre apo palët e lidhura me to, siç përcaktohet në Kodin e Etikës të IEKA-s/ligjin e veçantë, i kanë dhënë tatimpaguesit shërbime të kontabilitetit, të konsulencës fiskale apo shërbime të tjera të ngjashme, në lidhje me përgatitjen e deklaratave tatimore.

Këto kritere duhet të vërtetohen përmes dokumenteve të lëshuara jo më parë së tre muaj nga dita e dorëzimit të dokumentacionit.

Afati i shqyrtimit të kërkesave për komisionin është 30 ditë pune nga afati i përfundimit të dorëzimit të aplikimeve.

Kriteret e vlerësimit të shoqërive bazohen në vlerësimin fiton/nuk fiton. Për t'u shpallur fitues shoqëria duhet të plotësoje kriteret e përgjithshme, si dhe të dorëzojë të plotë dokumentacionin e përcaktuar në kriterin ligjor, teknik dhe kriteret e tjera, si dhe çdo element tjetër të vlerësuar si të nevojshëm nga Komisioni.

Dokumentet ligjorë dhe administrativë duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuar dhe të legalizuar apo që mbajnë vulën apostile.

Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të kërkesave nga Kompanitë Audituese/ose Kompanitë e klasifikuara sit ë tilla me ligj të veçantë, Komisioni fillon vlerësimin e tyre. Në varësi të analizave paraprake të propozimeve, Komisioni mund të kërkojë shpjegime dhe informacione shtesë lidhur me dokumentet e paraqitura duke caktuar afatin e paraqitjes së tyre.

Vlerësimi i propozimeve kryhet nga Komisioni në bazë të kritereve të shpallura në këtë procedurë.

Ankesat e subjekteve ndaj procedurës së zhvilluar i paraqiten Komisionit brenda 5 ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës së fituesve. Vendimi përfundimtar jepet brenda 5 ditëve kalendarike nga paraqitja e ankesës.

Ministri i Financave cakton me urdhër anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes së kompanive audituese/kompanive të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë, për listim. Brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit për dorëzimin e dokumenteve, Komisioni, dorëzon pranë ministrit të Financave një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur dhe së bashku me listën e shoqërive që janë kualifikuar sipas kësaj procedure. Lista publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në website e Ministrisë së Financave dhe website e Administratës Tatimore. Listimi do të bëhet për një periudhë 4 (katër)-vjeçare.

80.4.2.4 Ministria e Financave mund të heqë nga lista Shoqëritë audituese të listuara ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë, në të gjitha rastet kur vërtetohet se:

- puna e kryer ka mangësi të konsiderueshme në zbatimin e procedurave të parashikuara për kryerjen e këtij angazhimi;
- raporti i shoqërisë audituese ka pasaktësi të qëllimshme për t'iu shmangur detyrimeve tatimore;
- raporti i shoqërisë audituese përmban gabime me ndikim të konsiderueshëm në vlerën e tatimit shtesë të përllogaritur;

Mosrespektimi i detyrimeve në kuadër të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

80.4.2.5 Detyrat e shoqërive:

i) Kompanitë audituese ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë të listuara si më sipër, nuk mund të kryejnë shërbimin e verifikimit dhe certifikimit të deklaratave tatimore të një tatimpaguesi, në rastet kur ato, të punësuarit e tyre apo palët e lidhura me to, siç përcaktohet në Kodin e Etikës të IEKA-s, i kanë dhënë tatimpaguesit shërbime të kontabilitetit, të konsulencës fiskale apo shërbime të tjera të ngjashme, në lidhje me përgatitjen e deklaratave tatimore.

ii) Kompanitë audituese ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë do të certifikojë përputhshmërinë e deklaratave tatimore të përgatitura nga tatimpaguesit, me dispozitat ligjore, parimet dhe standardet e kontabilitetit, si dhe t'i certifikojë ato në përputhje me legjislacionin tatimor.

iii) Kompanitë audituese ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë janë përgjegjëse duke filluar nga procesi i verifikimit e deri tek certifikimi.

iv) Në rast së ndodh ndonjë gabim gjatë verifikimit dhe certifikimit, kompanive audituese ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë e cila ka certifikuar dokumentet përkatëse do të mbahet përgjegjës bashkërisht dhe proporcionalisht me tatimpaguesin përkatës në lidhje me detyrimet tatimore, por gjithmonë në kufijtë e përgjegjësisë për verifikim dhe certifikim.

80.4.2.6. Kontrolli i cilësisë të certifikimit të deklaratave tatimore nga shoqëritë audituese ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë duhet të bëhet në bazë të rregullores së IEKA-s për kontrollin e cilësisë në kryerjen e angazhimeve të auditimit, dhënies së sigurisë dhe misioneve të tjera nga EKR-të, sipas një marrëveshjeje të përbashkët midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe Organizatës profesionale të audituesve –IEKA-s.

80.5 Kontrollet, që kryhen nga administrata tatimore qendrore, urdhërohen nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve, duke u bazuar në planet e kontrollit dhe rezultatet e analizës së riskut.

81. Njoftimi i kontrollit tatimor

81.1 Administrata tatimore i dërgon tatimpaguesit njoftimin për kontroll, duke përcaktuar edhe periudhën apo periudhat tatimore 0object kontrolli, llojet e tatimit që do të kontrollohen dhe kohën e parashikuar të zgjatjes së kontrollit.

Gjatë ushtrimit të kontrollit administrata tatimore dhe tatimpaguesi duhet të bashkëpunojnë për realizimin efikas të kontrollit.

81.1/1 Njoftimi për fillimin e kontrollit tatimor i dërgohet tatimpaguesit të paktën 30 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të kontrollit të plotë tatimor të shkruar në njoftim, ndërsa në rastin e vizitave fiskale ky njoftim i dërgohet tatimpaguesit të paktën 10 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të vizitës fiskale. Në rastet e kryerjes së kontrollit tatimor si rezultat i kërkesës së tatimpaguesit për rimbursim tatimor, nuk zbatohen afatet e mësipërme.

81.1.1 Administrata tatimore kryen verifikime në terren për zbulimin në kohë të shkeljeve lidhur me regjistrimin e personave të tatueshëm; përdorimin e pajisjeve fiskale ose sistemeve fiskale; dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport; dokumentimin e çdo transaksioni shitjeje të mallrave apo të shërbimeve dhe lëshimin e faturave tatimore; regjistrimin e punonjësve, si dhe çdo verifikim tjetër për zbatimin e legjislacionit tatimor.

81.1.2 Verifikimet, sipas pikës 1, kryhen pa njoftimin paraprak të personit të tatueshëm. Përpara verifikimit, punonjësi i administratës tatimore tregon dokumentin personal të identifikimit, si dhe urdhrin ditor të punës, të lëshuar nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse për verifikimin në terren. Për kundërvajtjet administrative tatimore, të evidentuara gjatë verifikimit në terren, merren masat administrative sipas ligjit.

81.2 Njoftimi i kontrollit tatimor përmban:

a) identifikimin e organit, që kryen kontrollin tatimor;

b) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik, ose emrin e personit juridik, subjekt kontrolli;

c) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;

ç) datën e lëshimit;

d) bazën ligjore për kontrollin:

dh) llojet e tatimit, objekt kontrolli;

e) periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor;

ë) një përshkrim të shkurter me referencat ligjore të drejtave dhe të detyrave të tatimpaguesit gjatë kontrollit tatimor, përfshirë të drejtën e ankimit të vlerësimit, që bëhet në bazë të kontrollit tatimor;

f) datën dhe orën kur fillon dhe përfundon kontrolli tatimor, sipas përcaktimit nga të dhënat e analizës së riskut;

g) vendin e kontrollit tatimor;

gj) nënshkrimin nga personi që autorizon kontrollin;

h) një kërkesë për vënien në dispozicion të administratës tatimore të informacionit specifik për kontrollin tatimor.

Afati për kryerjen e kontrollit, i përcaktuar në përputhje me shkronjën "f", mund të zgjatet pas miratimit nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, por jo më shumë së 15 ditë pune.

81.3 Nëse tatimpaguesi ka kryer transaksione të cilat nuk i ka deklaruar dhe për pasojë

nuk ka paguar tatimin përkatës që detyrohet, atij i jepet mundësia të deklarojë çdo të dhënë për transaksionin e padeklaruar, nëpërmjet një "formulari-pyetësor" sipas formatit bashkëngjitur këtij udhëzimi, që i vihet në dispozicion së bashku me njoftimin për kontroll. Pas plotësimit të formularit-pyetësor dhe dorëzimit të tij në Drejtorinë Rajonale Tatimore, tatimpaguesi vetëdeklaron mbi bazën e rivlerësimit të deklaratave tatimore të periudhave përkatëse, transaksionet e padeklaruara dhe të pasqyruara në formularin-pyetësor duke paguar menjëherë tatimin ose kontributin përkatës së bashku me kamatëvonesën, të llogaritur në përputhje me nenin 76, të ligjit.

Deklarimi sipas kësaj pike është i vlefshëm vetëm nëse bëhet brenda 30 ditëve kalendarike, përpara fillimit të kontrollit të plotë tatimor.

81.4 Për detyrimin tatimor të deklaruar përpara fillimit të kontrollit tatimor sipas pikës 81.3, nuk aplikohet gjobë për pagesë të vonuar sipas nenit 114 të ligjit, por aplikohet dënimi administrativ me gjobë në masën 50 % të tatimit ose kontributit përkatës. Ky dënim llogaritet dhe vlerësohet nga inspektori i kontrollit dhe i njoftohet tatimpaguesit nëpërmjet njoftim vlerësimit tatimor të lëshuar në përputhje me përcaktimet e nenit 69 të ligjit, në përfundim të kontrollit tatimor.

Nëse dënimi i aplikuar sipas kësaj dispozite është më i madh së dënimi që aplikohet për shkeljen sipas dispozitës përkatëse të kreut XIV "Sanksionet" të ligjit, atëherë aplikohet dënimi më i ulët.

81.5 Nëse tatimpaguesi nuk deklaron sipas pikës 81.3 përpara fillimit të kontrollit, merret i mirëqenë fakti që nuk ka detyrim tatimor për të deklaruar. Në këtë rast për çdo detyrim tatimor apo shkelje të konstatuar gjatë kontrollit vijon procedura normale e kontrollit, në përfundim të së cilës nxirren rezultatet e kontrollit duke aplikuar gjithashtu çdo dënim administrativ të parashikuar sipas ligjit "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar.

82. Përjashtimi i inspektorit nga kontrolli tatimor

82.1 Nëpunësit e administratës tatimore, të lidhur me tatimpaguesin, subjekt kontrolli, nuk mund të marrin pjesë në kontrollin e këtij tatimpaguesi.

82.2 Me nëpunës të administratës tatimore, të lidhur me tatimpaguesin, subjekt kontrolli, kuptojmë personin:

a) me lidhje gjaku deri në shkallën e tretë;

b) përfaqësues të tatimpaguesit;

c) të lidhur me marrëveshje biznesi me tatimpaguesin.

83. Raporti i kontrollit tatimor

83.1 Pas çdo kontrolli tatimor, jo më shumë së shtatë dite nga perfundimi i tij, inspektori i kontrollit tatimor, është i detyruar të përgatisë raportin e kontrollit.

83.2 Raporti i kontrollit tatimor, pershkruan veprimtarinë ekonomike e tregtare të personit të tatueshëm, deklaratat, dokumentet, librat, regjistrat dhe regjistrimet e kontrolluara, të dhënat e shfrytezuara gjatë kontrollit dhe burimet e tyre, mënyrat e ushtrimit të kontrollit, etj. Raporti i kontrollit jep gjetjet e tij, problemet e dala, rezultatet e kontrollit, shkeljet e kryera nga personi i tatueshëm me argumentimin përkatës, shumën e vlerësimit tatimor të propozuar dhe referencat ligjore ku e mbështët ate. Raporti i kontrollit përbën bazen për vlerësimin tatimor pas kontrollit, për kontrolle të mevonshme si dhe për vlersimin e punës së vete kontrollorit nga ana e drejtuesve të Drejtorisë rajonale të tatimeve.

83.3 Pas përgatitjes së raportit të kontrollit nga ana e inspektorëve të kontrollit dhe para dërgimit të tij të tatimpaguesi, raporti i kontrollit miratohet nga strukturat përkatëse të kontrollit përfshirë përgjegjësin e sektorit, drejtorin e kontrollit tatimor, si dhe drejtori i drejtorisë rajonale. Një kopje e raportit të kontrollit i dërgohet tatimpaguesit me shërbimin postar rekomande.

83.4 Personi i tatueshëm i kontrolluar ka të drejtë të kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet së raporti është marrë nga tatimpaguesi.

83.5 Kundershtimi paraqitet me shkrim dhe ai i dergohet drejtorisë rajonale të tatimeve

me shërbimin postar rekomande ose dorëzohet dorazi në drejtorinë rajonale përkundrejt marrjes së një konfirmimi me shkrim.

83.6 Inspektori/inspektoret e kontrollit tatimor, në bashkëpunim me eprorin direkt, brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kundershtimit të personit të tatueshëm, shqyrtojne kundershtimin e paraqitur dhe japin gjykimin e tyre për te, gjykim të cilin e përfshijnë në projektin e raportit perfundimtar të kontrollit tatimor. për shembull, në qoftë se raporti i kontrollit tatimor është marre nga ana e personit të tatueshëm nëpërmjet shërbimit postar rekomande në datën 5 të një muaji, personi i tatueshëm deri me datë 10 të muajit duhet të dergoje kundershtimin e tij, nëpërmjet shërbimit postar rekomande, në adresën e Drejtorisë rajonale të tatimeve. Duke supozuar që drejtoria rajonale e tatimeve e ka marre kundershtimin në datën 15 të muajit, inspektori/inspektoret e kontrollit do të kene 5 dite pune kohe për të shqyrtuar kundershtimin e personit të tatueshëm, për të dhënë gjykimin e tyre për kundershtimin dhe së fundi për ta përfshirë këtë gjykim në projektin e raportit perfundimtar të kontrollit.

84. Raporti perfundimtar i kontrollit tatimor

84.1 Raporti perfundimtar i kontrollit tatimor duhet të përgatitet dhe të nenshkruhet nga inspektori/inspektoret e kontrollit tatimor dhe nga urdheruesi i kontrollit tatimor, brenda 14 ditëve kalendarike nga data kur është marre apo vleresohet së është marre kundershtimi i personit të tatueshëm nga ana e Drejtorisë rajonale të tatimeve.

84.2 Raporti perfundimtar i kontrollit duhet të pershkruajë detajet e veprimeve të kryera gjatë kontrollit, deklaratat, dokumentet, librat, regjistrat dhe regjistrimet e kontrolluara, të dhënat e shfrytezuara gjatë kontrollit dhe burimet e tyre, mënyrat e ushtrimit të kontrollit, gjetjet me kryesore të tij, problemet e dala, rezultatet e kontrollit, shkeljet e kryera nga personi i tatueshëm me argumentimin përkatës, shumën e vlerësimit tatimor të propozuar dhe referencat përkatëse ligjore.

84.3 Brenda 14 ditëve kalendarike nga data kur është marre apo vleresohet së është marre kundershtimi i personit të tatueshëm, drejtoria rajonale e tatimeve dergon me shërbimin postar rekomande në adresën e personit, raportin perfundimtar të kontrollit dhe njoftimin e vlerësimit përkatës, nëse ka një të tillë. një kopje e raportit perfundimtar mbahet nga drejtoria rajonale tatimore.

84.4 Nëse raporti përfundimtar i kontrollit tatimor propozon një vlerësim të ri, tatimpaguesi ka afat të paguajë ose apelojë njoftim-vlerësimin që lidhet me këtë raport kontrolli jo më vonë së 30 ditë kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të njoftim-vlerësimit.

85. Rikontrolli tatimor

85.1.1 Rezultatet e kontrollit tatimor janë detyruese për administratën tatimore, gje që do të thotë se, njoftimi i vlerësimit tatimor, mbetet në fuqi në çdo rast, përfshirë këtu dhe rastin kur ai ka gabime që janë në disfavor të administratës tatimore. Në këtë rast për personin e tatueshëm nuk mund të këtë asnje pasoje tjetër, pervec detyrimit për të paguar detyrimet tatimore, gjobat dhe kamate-vonesat e përcaktuara në këtë njoftim vlerësimi tatimor.

85.1.2 Administrata tatimore nuk ka të drejtë që, pas perfundimit të një kontrolli tatimor, të rikontrollojë perseri personin e tatueshëm për të njëjtin detyrim tatimor të te njëjtes periudhe tatimore. Përjashtim nga ky rregull, bëhet vetëm në rastet kur :

a) Personi i tatueshëm nuk ka bashkepunuar me kontrollin tatimor ose nuk ka vënë në dispozicion të tij informacionin dhe dokumentacionin e duhur për percaktimin e detyrimeve tatimore. Në këtë rast, administrata tatimore mund të bëjë vlerësim tatimor nga zyra, nëpërmjet mënyrave alternative të vlerësimit, bazuar në informacionet që disponon ose mund të sigurojë nga palët e treta, duke patur parasysh edhe dispozitat e pikës 51.3 dhe 72 të këtij udhëzimi. Por, në qoftë se personi i tatueshëm, angazhohet me veprime konkrete për bashkepunim me administratën tatimore dhe për venjen në dispozicion të saj të te gjithë dokumentacionit të duhur, mund të procedohet me tej nëpërmjet ushtrimit të një rikontrolli tatimor.

b) Administrata tatimore ka prova konkrete dhe të besueshme, që personi i tatueshëm është përfshirë në evazion tatimor. Këto prova mund të sigurohen nga burime të ndryshme

informacioni, nga kontrolle në persona të tjerë të tatueshëm, etj.

c) inspektori, gjatë kontrollit tatimor, nuk ka vepruar në përputhje me procedurat ligjore dhe, për këtë shkak, ndaj tij kanë filluar procedura disiplinore apo janë marrë masa disiplinore. Si kusht për të proceduar nëpërmjet një rikontrolli tatimor në këtë rast është sigurimi i provave së inspektori tatimor ka kryer gabime serioze në vlerësim dhe për këtë arsye veprimet e tij janë të denueshme me masa disiplinore. Në këtë rast, në përbërjen e grupit të rikontrollit tatimor nuk mund të bëjnë pjesë inspektorë, që kanë marrë pjesë në kontrollin tatimor të mëparshëm.

85.2 për të kryer një rikontroll tatimor, drejtoria rajonale e tatimeve duhet të marre miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. të drejtën për të kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miratimin e një rikontrolli e ka drejtori i Drejtorisë rajonale të tatimeve si dhe drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor apo i Auditit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kërkesa për rikontroll bëhet me shkrim dhe ajo duhet të përmbaje fakte dhe argumente konkrete.

85.3 Në rastet e kryerjes së rikontrollit tatimor, tatimpaguesit së bashku me njoftimin e kontrollit i vihet në dispozicion vendimi i miratimit të rikontrollit nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Në këtë vendim shprehen qartë dhe në mënyrë të argumentuar, arsyet e rikontrollit, si dhe referencat ligjore mbi të cilat është bazuar ky vendim.

86. Bashkepunimi me specialiste të jashtëm

86.1 Kur gjatë një kontrolli tatimor, inspektorit/inspektoreve të kontrollit i mungon ekspertiza e duhur për të kontrolluar dhe vlerësuar me korrektësi detyrimin tatimor të një personi të tatueshëm, drejtoria rajonale e tatimeve mund të kërkojë asistencë teknike nga specialistë të jashtëm të fushave të veçanta. për shembull, kur inspektori i kontrollit konstaton së kontabiliteti i personit të tatueshëm është i kompjuterizuar, ai mund të kërkojë nga drejtori i Drejtorisë rajonale të tatimeve që të angazhoje persona të specializuar në kontrollin informatik. E njëjta gje mund të bëhet edhe në rastet kur kontrollohen veprimtari specifike të tilla si ndertimi, telekomunikacionet, bankat, etj. Në këtë rast, personi i tatueshëm informohet me shkrim për emrat dhe cilësite e personave të jashtëm specialiste të fushes.

86.2 Specialistit të jashtëm, të kontraktuar nga administrata tatimore, mund t'i jepet vetëm informacioni teknik përkatës. Specialisti i jashtëm është subjekt i të njëjtave rregulla të ruajtjes së konfidencialitetit, si të gjithë nëpunësit e administratës tatimore. Specialisti i jashtëm paguhet nga administrata tatimore konform rregullave në fuqi për blerjen e shërbimeve nga palë të treta.

87. Asistenca e huaj

87.1 Administrata tatimore mund të kërkojë asistencën e një autoriteti tatimor të huaj, për zgjidhjen e çështjeve të veçanta tatimore, në përputhje edhe me dispozitat përkatëse të marrëveshjeve ndërkombëtare tatimore.

87.2 Asistenca e huaj kërkohet në bazë të marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare. Në çdo rast:

a) informacioni i dhënë të jetë objekt i ruajtjes së konfidencialitetit në përputhje me dispozitat përkatëse të marrëveshjes tatimore ose i të njëjtave rregulla të ruajtjes së konfidencialitetit, sipas këtij Udhëzimi;

b) informacioni i marrë të përdoret vetëm në përputhje me dispozitat e marrëveshjes tatimore dhe dispozitave të legjislacionit tatimor.

KREU XI
MBLEDHJA ME FORCË E DETYRIMIT TATIMOR

88. Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor

88.1.1 Sipas nenit 88 të ligjit, paragrafi 1, administrata tatimore ka autoritetin për të mbledhur me forcë detyrimet tatimore të papaguara, kur konstaton së tatimpaguesi nuk ka paguar në afat detyrimet e tij tatimore. Para së të filloje procedurat e mbledhjes me forcë të

detyrimeve tatimore, administrata tatimore ka për detyre të verifikojë nëse personi ndaj të cilit ajo do të veproje sipas parashikimeve të Kreut XI të ligjit për procedurat tatimore, ka apeluar detyrimin tatimor në hallkën përkatëse të apelimit tatimor, konform kërkesave të këtij ligji. Në rastet kur detyrimi tatimor nuk është apeluar ose është humbur e drejta e apelimit ose ekziston një vendim apelimi i formës së prerë, administrata tatimore është e detyruar të dërgoje në adresë të tatim paguesit njoftimin për pagimin e detyrimeve tatimore, dhe të njoftoje atë për fillimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore.

88.1.2 Si datë e mos paraqitjes së ankimit nga ana e tatim paguesit do të konsiderohet dita e pare e punës së administratës tatimore që bie mbas datës së fundit të afatit të ankimit. Kështu psh, nëse një tatimpaguesi afati i ankimit i mbaron me datë 30.06.2008, si datë e cila do të konsiderohet që ankimi nuk është paraqitur do të jetë data 01.07.2008. Nëse kjo dite bie dite pushimi zyrtar apo dite pushimi javor, si datë e mos paraqitjes së ankimit do të konsiderohet dita e pare e punës që vjen pas datës 01.07.2008.

88.1.3 në rastin kur tatimpaguesi për të kundërshtuar detyrimet tatimore, ka paraqitur në Drejtorinë e Apelimit Tatimor ose në Komisionin për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor, një ankim, procedurat e mbledhjes me forcë fillojne, me mbarimin e procedurave të ankimit. Procedurat e ankimit konsiderohen së kanë përfunduar ditën e pare të mbarimit të afatit ligjor që ka tatimpaguesi për t'iu drejtuar gjykatës. Në rast së tatim paguesi nuk i është drejtuar gjykatës kompetente për të vazhduar procedurën e ankimit, dita e nesërme e punës pas mbarimit të këtij afati do të konsiderohet si data që administrata tatimore ka të drejtë të filloje procedurën e mbledhjes me forcë të detyrimeve. Kështu, nëse mbas afatit 30 ditor të së drejtës së ankimit, tatimpaguesi nuk ka depozituar, apo ka paraqitur kërkese padinë në gjykate, organi tatimor fillon procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor ditën e nesërme mbas datës që e drejta e personit për t'u drejtuar gjykatës është parashkruar.

88.1.4 në rast së tatimpaguesi i është drejtuar gjykatës kompetente, si datë e fillimit të procedurave të mbledhjes me forcë të tatimit konsiderohet dita e pare e punës që vjen mbas datës kur vendimi i gjykatës ka marre formën e prerë.

88.1.5 Pavarësisht nga sa me sipër, tatimpaguesi në çdo rast kur ka filluar një procedure ankimi kundrejt aktit administrativ të administratës tatimore, duhet të njoftoje drejtorinë rajonale të juridiksionit, së ka paraqitur një ankim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor ose në Komisionin për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor, ose në gjykate.

88.2 Në çdo rast administrata tatimore në ushtrimin e kompetencave të saj, për mbledhjen me forcë të tatimeve, si dhe në zbatimin e këtyre procedurave së pari duhet të marre në konsideratë analizimin dhe vlerësimin e riskut, çka do të thotë të marre në analize nëse tatimpaguesi do të paguajë detyrimin e tij, apo ai ka tendence t'i shmanget këtij detyrimi. Pra analiza e riskut nënkupton marrjen e masës shtërnguese më efektive, me koston më të ulët si për administratën edhe për tatimpaguesin, dhe që siguron mbledhjen e detyrimeve.

88.3 Administrata tatimore në vlerësimin e riskut, për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimit, duhet të marre në konsideratë edhe situatën financiare e pasurore të tatimpaguesit. Në rradhe të pare, administrata tatimore vlerëson dhe analizon mundësinë reale të arkëtimit të tatimit prej tatimpaguesit. Në të njëjtën kohë ajo vlerëson mundësinë apo tendencën e tatim paguesit për t'ju shmangur detyrimit tatimor. Administrata tatimore, për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimit tatimor të papaguar, duhet të veproje me shpejt dhe me pare tek tatimpaguesit, pasuria e të cilëve siguron përmbushjen e detyrimit tatimor të papaguar, të cilët kanë risk të lartë për kryerjen e transaksioneve të paligjshme për tjetërsimin e pasurisë së tyre, duke minimizuar mundësinë e aplikimit të masave shtërnguese.

88.4 Administrata tatimore, pasi ka ezauruar procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të papaguar, sipas këtij kreu, mund të mbledhë detyrimin tatimor të mbetur të papaguar edhe nëpërmjet një personi juridik publik. Për këtë qëllim Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për çdo rast nënshkruan një marrëveshje me personin juridik publik, i cili duhet të jetë një person i specializuar në kryerjen e procedurave për këtë qëllim, ose të ketë mundësi

efektivisht të kryejë këto procedura kundrejt një komisioni në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

88.5 Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

89. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar

89.1 Duke pasur parasysh përmbushjen e dispozitave të pikës 88 më lart, kur administrata tatimore, arrin në përfundimin së një detyrim tatimor nuk është paguar plotësisht, ajo menjëherë njofton tatimpaguesin për detyrimin e papaguar, nëpërmjet postës rekomande ose në rrugë elektronike.

Njoftimi nga ana e administratës tatimore mund të bëhet edhe me forma të tjera të dërgimit të njoftimit, përveç postës dhe rrugës elektronike, duke përfshire edhe dorëzimin dorazi të njoftimit kundrejt konfirmimit të marrjes së tij prej tatimpaguesit.

Njoftimi përmban shumën e detyrimit të papaguar, llojin e tatimit apo të sanksionit që pason në rast të mos pagimit, fillimin e aplikimit të masave shtrënguese.

Njoftimi i kërkesës për pagimin e detyrimit tatimor, nxirret nga personi përgjegjës, apo çdo person tjetër i cili e ka të drejtën e nxjerrjes së njoftimit, si e drejtë e deleguar, apo si një e drejte e rrjedhur për shkak të funksioneve që ai kryen.

Në rastin kur detyrimet tatimore që do të paguhen janë të pushtetit vendor, njoftimi nxirret nga Kryetari i Zyrës Tatimore të qeverisjes vendore. Njoftimi i tatimpaguesit për të paguar detyrimet tatimore, nxirret brenda 10 ditëve nga ana e administratës tatimore, dhe ky afat fillon të llogaritet nga data kur tatimpaguesi ka pasur detyrimin për ta paguar atë.

Administrata tatimore duhet ta nxjerrë njoftimin e kërkesës për pagim brenda tri ditëve pune nga dita e parë e punës pas përfundimit të afatit ligjor për pagimin e detyrimeve. Njoftimi vendoset në dosjen e tatimpaguesit brenda 5 ditëve nga data e dërgimit të tij me poste rekomande, në rrugë elektronike apo nga data kur njoftimi i është dorëzuar dorazi tatimpaguesit kundrejt konfirmimit të këtij të fundit për marrjen e tij. Me kalimin e 10 ditëve nga data e nisjes me postë të këtij njoftimi ose brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit dorazi tatimpaguesit të njoftimit apo në rrugë elektronike, fillon zbatimi i procedurës për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore.

89.2 Administrata tatimore përdor mënyrën me efikase dhe me të sigurtë për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara nga ana e tatimpaguesit. Në asnjë rast administrata tatimore nuk mbivlerëson një mënyre kundrejt një tjetre, si dhe nuk përjashton ekzekutimin mbi disa grupe pasurish të tatimpaguesit kundrejt të tjerave. Ajo, në kuptim të nenit 91 të Ligjit për procedurat tatimore, nxjerr njoftimin sipas të cilit për pasuritë e tatimpaguesit do të fillojnë procedurat për vënien në ekzekutim të tyre, me qëllim përmbushjen e detyrimit tatimor të papaguar nga tatimpaguesi.

Gjithashtu, në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo ditë të një shume jo më pak së 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë së detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit.

Për këtë arsye, tatimpaguesi njoftohet më përpara së të fillojë verifikimi dhe monitorimi në terren i aktivitetit tregtar të tatimpaguesit.

Në fund të ditës, mbahet procesverbal midis inspektorit tatimor dhe tatimpaguesit mbi qarkullimin ditor dhe kalimin e 50% të shumës të qarkullimit ditor në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme të punës. Në këtë rast, tatimpaguesi do të gjenërojë nga sistemi urdhër-pagesat përkatëse dhe do të kryejë pagesat për detyrimin tatimor në bankë. Inspektori ndjek dhe verifikon nëse derdhja e shumës 50% të qarkullimit nga tatimpaguesi, është bërë në baza ditore.

Urdhri i konfiskimit për të konfiskuar në fund të çdo ditë një shumë jo më pak së 50% e qarkullimit ditor të realizuar, por jo më shumë së detyrimi tatimor, lëshohet nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara.

Ky urdhër është akti i vetëm me anë të të cilit administrata tatimore ushtron të drejtën e konfiskimit të qarkullimit ditor.

Urdhri i konfiskimit të qarkullimit përmban detyrimisht të dhënat e mëposhtme:

a) Emri i tatimpaguesit;

b) NIPT-i;

c) Adresa e tatimpaguesit;

ç) Numri dhe data e njoftimit të vlerësimit tatimor, ose të dhënat e aktit të mbledhjes me forcë të detyrimit sipas fazës në të cilën është procedura e mbledhjes;

d) bazën ligjore sipas të cilës është duke u kryer masa e konfiskimit, konkretisht neni 89 i ligjit;

e) shuma e qarkullimit ditor të matur;

f) shuma e qarkullimit ditor për të cilën vendoset masa e konfiskimit;

g) shprehje e qartë e detyrimit që tatimpaguesi brenda ditës së nesërme të punës duhet të kalojë për llogari të administratës tatimore pagesën e shumës së konfiskuar për detyrimet për të cilat ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimit.

Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë/të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes/transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar. Për këtë arsye, administrata tatimore i dërgon Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe bankave ku tatimpaguesi ka llogari bankare, njoftimin e kërkesës për pagimin e detyrimit tatimor. Tatimpaguesi mund të kryejë veprime në Qendrën Kombëtare të Biznesit të shitjes, transferimit të kapitaleve të veta, vetëm kundrejt paraqitjes së një vërtetimi të Qendra Kombëtare e Biznesit, nga administrata tatimore së transaksioni kryhet për efekt të pagimit të detyrimit tatimor.

89.3 Kur administrata tatimore, nga provat e mbledhura prej saj, ose që gjenden pranë saj, krijon bindjen së pagimi i detyrimeve tatimore është në rrezik për tu paguar, ajo nuk pret dërgimin e njoftimit sipas paragrafit 1 të nenit 89 të ligjit për procedurat tatimore, por fillon menjëherë procedurën e mbledhjes me forcë të detyrimeve duke përdorur një ose të gjitha mënyrat e parashikuara nga Kreu XI i ligjit.

89.4 Kur të dhënat dhe provat e mbledhura nga administrata tatimore tregojnë së ndodhemi përpara rasteve të parashikuara në paragrafin 3 të nenit 89 të ligjit për procedurat tatimore, organi tatimor mund të bëjë kallëzim për ndjekje penale sipas nenit 131, paragrafi "2" të këtij ligji, dhe i kërkon organit të prokurorisë të kërkoje në gjykatë marrjen e masës së sigurimit personal sipas nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu administrata tatimore, vetë ose nëpërmjet organit të prokurorisë, ka të drejtë t'i kërkoje edhe bankave me seli në Republikën e Shqipërisë, të mos lejojnë tatimpaguesin të kërkoje transferimin e shumave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky ndalim transferimi nuk kërkohet vetëm për tatimpaguesin, por edhe për të gjithë pronaret dhe/ose administratoret e tij.

90. Urdhëri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit

90.1 Në kuptim të paragrafit 1, të nenit 90, si datë e mospagimit në mënyrë vullnetare të detyrimeve tatimore do të merret dita e parë e punës mbas datës së vendosur në njoftimin e bërë nga ana e administratës tatimore, sipas paragrafit 1, të nenit 89, të ligjit dhe procedurave dhe afateve të parashikuara në paragrafin 3, të nenit 23.

Në rast se në këtë datë nga ana e tatimpaguesit nuk është paguar detyrimi tatimor, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, apo titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore, nxjerr urdhërbllokimin e llogarive bankare dhe të llogarive depozitë të tatimpaguesit, si masë për garantimin e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor. Ky urdhër bllokimi u dërgohet bankave te të cilat administrata tatimore ka dijeni se tatimpaguesi ka llogarinë e tij.

Urdhri i bllokimit mund të dërgohet me postë ose në rrugë elektronike (në adresat e postës elektronike që administrata tatimore dhe banka i kanë komunikuar njëra-tjetrës zyrtarisht).

Në rast se administrata tatimore lëshon urdhra bllokimi për më shumë se 20 tatimpagues, në të njëjtën ditë, ata duhet të dërgohen në format elektronik. Në të dyja rastet, çdo urdhër bllokimi duhet të përmbajë të gjitha elementet e përshkruara si më poshtë.

Në urdhër përshkruhet identiteti i plotë i tatimpaguesit (personit juridik, personit fizik tregtar apo individit), llogaritë e të cilit preken nga dalja e këtij urdhri, që duhet të përmbajë detyrimisht emrin e plotë dhe NIPT-in përkatës të subjekteve tregtare. Urdhri i bllokimit duhet të përmbajë shkakun e nxjerrjes së tij, llojin e detyrimit që po ekzekutohet, datën kur tatimpaguesi duhej ta kishte paguar vetë detyrimin tatimor, si dhe shumën që bankat duhet të bllokojnë (në çdo rast, shuma që kërkohet të bllokohet nga bankat, është shuma më e vogël ndërmjet shumës që administrata tatimore kërkon të marrë me shumën që rezulton në llogarinë bankare të tatimpaguesit në momentin e nxjerrjes së urdhërbllokimit.

Nëse urdhri i bllokimit nuk përmban elementet e përcaktuara si më sipër dhe banka e ka të pamundur të identifikojë saktë subjektin, ajo nuk vendos masën e bllokimit të llogarive / depozitave, por njofton administratën tatimore në lidhje me mangësitë e konstatuara.

Kur urdhri i bllokimit përmban elementet e përcaktuara si më sipër, Banka, brenda ditës së nesërme të punës nga dita e marrjes së urdhrit, bën bllokimin e llogarive/depozitave të tatimpaguesit, deri në shumën e detyrimit tatimor të papaguar dhe brenda 5 ditëve pune nga marrja e urdhrit njofton administratën tatimore për gjendjet e llogarive/depozitave të tatimpaguesit. Në qoftë se tatimpaguesi ka më shumë se një llogari në të njëjtën bankë, banka, mbi bazën e urdhrit të organit tatimor, bllokon vetëm llogarinë/llogaritë që kanë shumën e mjaftueshme të detyrimit të papaguar.

Informacioni në lidhje me gjendjet e llogarive/depozitave të bllokuara mund të dërgohet nga banka me shkresë zyrtare ose në rrugë elektronike. Gjithashtu, brenda këtij afati banka bën njoftimin e debitorit me shkrim ose në mënyrë elektronike për marrjen e urdhrit të bllokimit.

Brenda 2 ditëve pune nga marrja dijeni për bllokimin e shumave të caktuara në llogaritë/depozitat bankare, administrata tatimore i dërgon bankës apo bankave të cilat kanë konfirmuar gjendjet në llogari, një urdhër ekzekutimi, i cili duhet të përmbajë shumën që kërkohet të transferohet, si dhe numrat e llogarive. Urdhri i ekzekutimit duhet të jetë i shoqëruar edhe me urdhër pagese ose faturë për arkëtim, ku përcaktohen kodet e llogarive apo barcode-t.

Transferimi i shumës mbi bazën e urdhrit të ekzekutimit bëhet nga banka jo më vonë se 3 ditë pune nga dita e marrjes së urdhrit. Për kryerjen e këtij veprimi dhe brenda të njëjtit afat, banka njofton administratën tatimore dhe subjektin me shkrim ose në rrugë elektronike.

Në rast se detyrimi i tatimpaguesit ekzekutohet plotësisht, administrata tatimore dërgon menjëherë një urdhër zhbllokimi në adresë të bankave ku tatimpaguesi është klient.

Në rast se detyrimi i tatimpaguesit ekzekutohet pjesërisht, administrata tatimore dërgon një urdhër të ri bllokimi drejtuar bankave, ku tatimpaguesi ka llogari bankare për shumën e detyrimit tatimor të papaguar që rezulton mbas kryerjes së ekzekutimit të pjesshëm.

Në rast se tatimpaguesi nuk ka gjendje në llogaritë bankare në asnjë nga bankat, llogaritë do të vazhdojnë të mbahen të bllokuara në bazë të urdhërbllokimit, që është lëshuar nga administrata tatimore.

Në zbatim të nenit 99, të ligjit nr. 9920/2008, nëse pas zbatimit ndaj subjektit të të gjitha masave shtrënguese për mbledhjen me forcë të detyrimit (duke përfshirë edhe shitjen e pasurisë së sekuestruar), detyrimet tatimore të personit juridik nuk shlyhen plotësisht, administrata tatimore e transferon detyrimin tatimor të mbetur të subjektit tek ortaku, aksionari dhe administratori. Për këtë qëllim, pasi merr vendimin e gjykatës së formës së prerë dhe në zbatim të nenit 99, të ligjit nr. 9920/2008, si dhe procedurave dhe afateve të parashikuara në paragrafin 99 të këtij udhëzimi, fillimisht administrata tatimore garanton mbledhjen e detyrimit nëpërmjet vendosjes së urdhërbllokimit mbi llogaritë dhe depozitat e ortakëve, aksionarëve dhe administratorëve të subjektit dhe më pas zbaton ndaj tyre masat shtrënguese të mbledhjes me forcë të parashikuara në ligjin nr. 9920/2008. Edhe në këtë rast, urdhërbllokimi si masë preventivuese vendoset sipas procedurave të paragrafit të dytë të kësaj pike.

90.2 Me përjashtim të rasteve kur në ligj është parashikuar ndryshe, nëse në bankë, ku tatimpaguesi ka llogarinë bankare, ka edhe urdhra pagese të tjera, urdhri i lëshuar nga

administrata tatimore ekzekutohet sipas radhës së përcaktuar në nenin 605 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

91. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor

91.1 Sipas nenit 91 të Ligjit, kur administrata tatimore konstaton së detyrimet tatimore nuk janë paguar prej tatimpaguesit në afatin e caktuar, ajo kërkon sigurimin e pagimit të këtij detyrimi nëpërmjet vendosjes së masave të sigurisë për të gjithë pasurinë e tatimpaguesit. Në këtë rast, me plotësimin e kërkesave të pikës 89 më lart, nëse detyrimi nuk është paguar, administrata tatimore është nxjerr njoftimin me ane të te cilit tatimpaguesi dhe çdo person tjetër marrin dijeni, së ndaj pasurive të tatimpaguesit administrata tatimore ka nxjerre Urdhrin për Bllokimin e tyre, dhe së kanë filluar procedurat për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara. Njoftimi sipas parashikimit me sipër bëhet për faktin, që personat e tretë të marrin dijeni për fillimin e këtyre procedurave, dhe që organet apo institucionet të cilët kanë regjistrime të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesit debitor të regjistrojnë detyrimin tatimor të papaguar si barre mbi këto pasuri, dhe të mos lejojnë kryerjen e transaksioneve për transferimin e pasurive të tatimpaguesit debitor, deri në momentin që detyrimi tatimor i papaguar është arkëtuar. Ky urdhër për fillimin e procedurave për ekzekutimin me forcë të mbledhjes së detyrimit tatimor të tatimpaguesit nëpërmjet ekzekutimit mbi pasuritë e tij, publikohet në faqen zyrtare të internetit të administratës tatimore. Si pasuri e tatim paguesit konsiderohen të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, që janë në pronësi të tij, apo që ndodhen në përdorim, apo me të drejta të tjera tek persona të tretë. Në kuptim të pasurive mbi të cilat mund të vendosen masat e sigurisë përfshihen edhe pasuritë e personave të përcaktuar në nenin 99 të ligjit "Për procedurat tatimore", të cilat shërbejnë për pagimin e detyrimeve tatimore për pjesën që atyre iu takon të paguajnë në përpjesëtim me detyrimin tatimor.

91.2.1 Me qëllim sigurimin e pagimit të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, administrata tatimore në përputhje me nenin 91 të ligjit "Për procedurat tatimore", vendos për marrjen e masave të sigurimit për ekzekutimin e detyrimit. Qëllimi i vendosjes së masave të sigurimit të detyrimit tatimor është mos humbja e pasurisë, apo mos tjetërsimi i saj tek të tretët, pa u paguar me pare detyrimet tatimore. Masat e sigurimit të pasurisë vendosen nëpërmjet barreve siguruese për pasuritë e luajtshme dhe hipotekës për pasuritë e paluajtshme të tatimpaguesit, apo të personave të cilëve ju drejtohet akti i cili bën vendosjen e tyre. Masat e sigurimit të pasurise, merren gjithmonë me ane të një vendimi me shkrim të Drejtorit te Drejtorisë Rajonale ku tatim paguesi është i regjistruar për pagimin tatimeve të tij. të drejtën për nxjerrjen e Vendimit për marrjen e masave për sigurimin e pasurisë me qëllim pagimin e tatimeve e ka edhe titullari i Zyrës tatimore të qeverisjes vendore, për rastin e mospagimit të detyrimeve tatimore vendore. Pavarësisht së vendimi për daljen e masave të sigurimit të pasurisë së tatimpaguesit bëhet nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale, apo titullari i Zyrës Tatimore Vendore, ato kanë efekt për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe çdo person juridik, publik a privat, si dhe persona fizike që kanë të regjistruar pasuri të tatimpaguesit, janë të detyruar të ekzekutojnë vendimin e nxjerre për marrjen e masave të sigurisë mbi pasurinë e tatimpaguesit debitor.

91.2.2 Si masa që mund të merren nga ana e administratës tatimore nëpërmjet vendosjes së masave të sigurimit të pasurisë, janë urdhri dhe njoftimi për vendosjen e barrës siguruese apo barrës hipotekore ndaj pasurive të tatimpaguesit.

91.2.3 Hipoteka si mjet i sigurimit të pagimit të detyrimeve tatimore, vendoset gjithnjë në bazë të vendimit të nxjerre nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara, apo nga titullari i Zyrës Tatimore të qeverisjes vendore. Akti me ane të të cilit kërkohet të vendoset hipoteka, i dërgohet Zyrës Vendore të Agjencisë së Kadastrës, ku ndodhet pasuria e paluajtshme e tatimpaguesit, apo ku ndodhet selia e tij, si dhe Kryeregjistruesit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në vendimin e vendosjes së hipotekës, nëse Dega Rajonale Tatimore apo Zyra Vendore e tatimeve nuk disponon të dhëna mbi pasurinë e paluajtshme të debitorit, së bashku me vendimin e saj, i kërkohet Agjencisë Shtetërore e Kadastrës dhe zyrës së

saj vendore, që brenda një afati kohor prej 5 ditëve pune të bëjnë identifikimin e këtyre pasurive, dhe të bëjnë vendosjen në hipoteke të tyre në favor të administratës tatimore, deri në momentin që detyrimi tatimor i papaguar prej tatimpaguesit të jetë shlyer. Hipoteka vendoset jo vetëm mbi sendet e paluajtshme në pronësi të tatimpaguesit, apo të personave të tjerë të parashikuar në nenin 99 të Ligjit "Për Procedurat Tatimore", por edhe mbi uzufruktet e këtyre sendeve, si dhe të drejtave të tjera mbi to, të drejta këto që janë të lidhura me të ardhurat e pronarit të sendit të paluajtshëm. Administrata tatimore me vendimin e saj për vendosje hipoteke, kërkon vendosje hipoteke edhe për sendet e ardhshme të paluajtshme të tatimpaguesit apo personave të tjerë të parashikuar në nenin 99 të ligjit "Për procedurat tatimore". Kjo kërkese bëhet pavarësisht nëse administrata tatimore disponon apo jo të dhëna në lidhje me faktin së tatimpaguesi gjatë periudhës së mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, mund të marre në pronësi të vet një pasuri të paluajtshme apo jo. Gjithnjë gjatë gjithë periudhës së mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për çdo pasuri të re e cila vjen në favor të tatimpaguesit debitor, ajo pasuri do të rëndohet me hipoteke në favor të administratës tatimore, që ka filluar procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor. Në rastet kur këto sende të paluajtshme janë në bashkëpronësi edhe me persona të tjerë ndaj të cilëve nuk mund të shtrihet procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, administrata e cila ka nxjerre vendimin për vendosjen e hipotekës, duhet të bëjë veçimin e këtyre pjesëve, dhe të vendose hipotekën vetëm për pjesën që i takon si pronësi tatimpaguesit apo personave të tjerë të parashikuar në nenin 99 të ligjit "Për procedurat tatimore".

91.2.4 Me hipotekimin e sendeve të paluajtshme, të uzufrukteve, dhe të drejtave mbi këto sende, në rast së tatimpaguesi ka një sigurim mbi to, atëherë edhe të gjitha të ardhurat që mund të rrjedhin nga sigurimi i sendit, gjatë periudhës së mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, kalojnë në favor të organit tatimor. Në rastin kur sendet e siguruara janë në bashkëpronësi me persona të tjerë ndaj të cilëve nuk shtrihet procedura e mbledhjes me forcë të tatimit, shoqëria e sigurimit në ato raste kur ndodh ngjarja për të cilën sendi është i siguruar, do të kaloje në favor të organit tatimor të ardhurat në perpjestim me përqindjen e bashkepronesise së tatimpaguesit apo personave të tjerë të parashikuar në nenin 99 të ligjit "Për procedurat tatimore", ndaj të cilit ka dale vendimi.

91.2.5 Barra siguruese merret si mase sigurimi për të gjitha pasuritë e luajtshme të debitorit. Për vendosjen e barreve siguruese administrata tatimore do të veproje në përputhje me ligjin Nr.8537 datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", Rregulloren e Barrëve Siguruese të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Energjetikes dhe Tregtisë Nr. 493, datë 06.07.2006, si dhe në përputhje me Udhëzimet e nxjerra nga Kryeregjistruesi i Barreve Siguruese. Për të bërë identifikimin e pasurive të luajtshme ndaj të cilave mund të vendoset një barre siguruese, administrata tatimore, e cila është kompetente për nxjerrjen e vendimit për vendosjen e barrës siguruese, duhet t'i dërgoje njoftim të gjithë zyrave në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të ngarkuara nga ligji për të bërë regjistrimin e pasurive të luajtshme. Zyrat apo institucionet të cilat regjistrojnë pasuri të luajtshme në Republikën e Shqipërisë, në çdo rast bëjnë regjistrimin e barrës në emër të administratës tatimore nga dita e parë e punës pas distës së publikimit të aktit për fillimin e këtyre procedurave, sipas nenit 91 të Ligjit për procedurat tatimore në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Barra siguruese mund të vendoset mbi pasuritë e mëposhtme:

a) Automjetet, ku si të tilla do të konsiderohen ato mjete sipas përkufizimit të nenit 54 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë Nr.8378, datë 22.7.1998

b) Ciklomotoret ku si të tilla do të konsiderohen ato mjete sipas përkufizimit të nenit 52 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

c) Makinat bujqësore, ku si të tilla do të konsiderohen ato mjete, sipas përkufizimit të nenit 57 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

ç) Makinat teknologjike, ku si të tilla do të konsiderohen ato mjete, sipas përkufizimit të nenit 58 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

d) Mallrat me numër serie, ku si të tilla do të konsiderohen ato mallrat që renditen si vijon: automjete, ciklomotorë, makina bujqësore, makina teknologjike, mjete fluturimi, mjete lundrimi, motomjete, motorë mjeti fluturimi, rimorkio, trolejbusë.

dh) Mjete fluturimi, ku si të tilla do të konsiderohen ato mjete të ndërtuara për transportimin e personave dhe/ose mallrave nëpërmjet ajrit.

e) Mjet lundrimi, ku si të tilla do të konsiderohen ato mjete të ndërtuara për të transportuar persona ose sende, nëpërmjet ujit dhe që vihen në lëvizje kryesisht nga çdo lloj tjetër force, përveç forcës së muskujve dhe që i kalon gjashtë metra gjatësi. Motomjet, ku si të tilla do të konsiderohen ato mjete, sipas përkufizimit të nenit 53 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

f) Metalet dhe gurët e çmuar.

g) Tituj pronësie mbi letrat me vlere publike, si bonot e thesarit, dhe privatë si aksione, kambiale, çeqe etj të parashikuara sipas ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 "Për titujt".

Për vendosjen e barrës siguruese, në rastet kur administrata tatimore ka dijeni për sende të luajtshme në pronësi të tatimpaguesit apo të personave të tjerë ndaj të cilëve ajo ka nxjerre urdhrin, vendosja e barrës siguruese bëhet sipas Formularit "Njoftimi C – Regjistrimi i Pretendimeve Shtetërore" të Zyrës së Regjistrimit të Barreve Siguruese", sipas modelit të përcaktuar në Rregulloren e Barrëve Siguruese të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Energjetikes dhe Tregtisë Nr. 493, datë 06.07.2006,

91.2.7 në qoftë se, sendet mbi të cilat është vendosur barra siguruese, janë të siguruara, shpërblimi që tatimpaguesi, apo personat ndaj të cilëve është vendosur barra siguruese, do të merrnin në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, kalon në favor të administratës tatimore, nëse ngjarja për të cilën ata janë siguruar ndodh gjatë periudhës së zhvillimit të procedurave të mbledhjes me forcë të tatimeve.

91.2.8 Administrata tatimore i kërkon informacion zyrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të mjeteve motorike, mjeteve lundruese, të regjistrimit të aksioneve, të regjistrimit të titujve shtetërore, metaleve dhe gurëve të çmuar, nëse në emër të tatimpaguesit apo personave të tjerë ndaj të cilëve ajo ka nxjerre vendimin për marrjen e masave të sigurisë, figurojnë të regjistruara në pronësi të tyre sende, të cilat ato janë të detyruara t'i regjistrojnë. Institucionet e mësipërme janë të detyruara brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit, të informojnë administratën tatimore nëse tatimpaguesi apo personat ndaj të cilëve ka dale vendimi kanë pasuri në emër të tyre apo jo.

91.2.9 Kur mbas lajmërimit që i ka bërë tatimpaguesit apo personave të tjerë ndaj të cilëve rendon detyrimi për të paguar tatimin, administrata tatimore ka arritur në përfundimin së duhet të mbledhë me forcë tatimet, ajo përgatit njoftimin përkatës për marrjen e masave të sigurisë mbi pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesit, duke vendosur ndaj tyre barre siguruese apo hipoteke.

Ky njoftim përpilohet sipas pikës 91.4 të këtij Udhëzimi dhe i dërgohet zyrave të cilat kanë të regjistruara pasuri të luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesit, duke i njoftuar ato për fillimin e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore.

91.3. Para vendosjes së një barre siguruese dhe/ose barre hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit, ky i fundit duhet të njoftohet me shkrim. Njoftimi duhet të përmbajë të gjithë informacionin lidhur me to.

91.4 Njoftimi për marrjen e masave të sigurisë sipas pikës 91.2.9 më lart, do të përmbajë:

a) Të dhënat identifikuese të tatimpaguesit;

b) Selinë e regjistruar në regjistrin tregtar;

c) Vende të tjera të ushtrimit të veprimtarisë prej tatimpaguesit nëse ai ka;

ç) NIPT-in;

d) Shumën e detyrimit tatimor të papaguar;

dh) Faktin që të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të tatimpaguesit konsiderohen të rënduara me barrë siguruese apo hipotekore, pavarësisht nëse barrat e

mësipërme janë të regjistruara ose jo;

e) Kërkesën për të identifikuar nëse në emër të tatimpaguesit, apo personave të parashikuar në nenin 99 të Ligjit "Për procedurat tatimore", ka apo jo të regjistruara pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;

ë) Kërkesën për të vendosur barre siguruese për pasuritë e luajtshme dhe hipoteke për pasuritë e paluajtshme;

91.5 Forma e njoftimit që administrata tatimore iu drejton zyrave të cilat regjistrojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, hartohet në përputhje me formën e dhëne në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

91.6 në rastet kur vendimi për vendosjen e masave të sigurise i drejtohet një personi fizik i cili vdes gjatë periudhës së nxjerrjes së vendimit, vendimi ngelet në fuqi për pasurinë edhe nëse kjo pasuri kalon tek trashëgimtaret e tij.

92. Ankimimi i masës së sigurimit të detyrimit tatimor

92.1.1 Tatimpaguesi ndaj pasurise të te cilit ka dale një vendim për vendosjen e masave të sigurisë, qoftë në formën e barres siguruese apo të hipotekes, ka të drejtë të paraqesë ankese tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale, vetëm në ato raste kur zbatimi i masave të sigurisë nuk është ekzekutuar në mënyre të rregullt. Me përjashtim të rastit kur detyrimi tatimor i pambledhur konsiderohet në rrezik në kuptim të nenit 92, paragrafi i pare i Ligjit. Konsiderohet së ekzekutimi i Vendimit për marrjen e masave të sigurisë nuk është kryer në rregull në rastet e meposhtme:

a) kur tatimpaguesi nuk ka patur njoftim me shkrim për sigurimin e detyrimit tatimor, brenda afateve kohore të parashikuara nga Ligji;

b) kur gjatë periudhës së daljes së vendimit dhe ekzekutimit të tij detyrimi tatimor është paguar;

c) nëse pasuria e vendosur si barre siguruese apo hipoteke, është në grupin e sendeve mbi të cilat nuk mund të shtrihet ekzekutimi sipas nenit 529 të Kodit të Procedurës Civile;

d) kur akti me ane të te cilit kërkohet të veprohet për ekzekutimin për mbledhjen me forcë të tatimeve ka dale jo në emër të tatimpaguesit por kundrejt një personi tjetër.

92.1.2 Tatimpaguesi, në rast së ka konstatuar parregullshmeri në ekzekutimin e vendimit, e ushtron të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të tyre. Në çdo rast në ankesën e tij tatimpaguesi është i detyruar t'i provoje administratës tatimore momentin së kur ai ka marre dijeni për një parregullsi, gjë e cila duhet të provohet vetëm me ane të provave shkresore. Në çdo rast, pavarësisht nga paraqitja e provave prej tatimpaguesit, kur rrethanat e çështjes tregojnë së ai kishte mundësi për të marre dijeni për njoftimin për ekzekutimin e vendimit me pare, ankesa e tatimpaguesit nuk merret në konsideratë nga ana e administratës tatimore. Kërkesa, nëse nuk është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh, konsiderohet e pavlefshme dhe nuk shqyrtohet.

92.2 Kur një parregullsi e pretenduar nga tatimpaguesi rezulton së është e vërtete, atëherë titullari i administratës tatimore që ka nxjerre vendimin për marrjen e masave të sigurisë, i përcaktuar sipas paragrafit 2 të nenit 92 të Ligjit, ka të drejtë që në bazë të një vendimi me shkrim, të motivoje revokimin e vendimit dhe të çliroje nga barra sendet mbi të cilat është vendosur barra siguruese apo hipoteka. Në çdo rast vendimi i revokimit dhe i pranimit të kërkeses ankimore të tatimpaguesit duhet të jetë i arsyetuar dhe të jepet brenda afateve kohore të parashikuara në rastin e kthimit të përgjigjes për një ankim tatimor. Në çdo rast vendimi që ka marre në shqyrtim kërkesën për kundërshtim të vendimit të marrjes së masave të sigurisë për shkak të parregullshmerive në ekzekutim ruhet në dosjen e tatimpaguesit.

92.3 Në qoftë së drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara apo titullari i njësisë së ngjashme me të nuk miraton kërkesën e tatimpaguesit, tatimpaguesi mund ta ankimojë këtë vendim brenda afateve dhe në formën, mënyrën e kërkuar nga kreu XIII i ligjit dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim për ankimet tatimore.

93. Sekuestrimi i pasurisë

93.1 Sipas nenit 89 të ligjit, në lajmërimin për pagimin e detyrimeve tatimore,

administrata tatimore është e detyruar të njoftoje tatimpaguesin për afatin kohor që ai ka në dispozicion për të paguar vullnetarisht detyrimin e tij tatimor. Kur administrata tatimore konstaton së nga ana e tatimpaguesit nuk është paguar detyrimi brenda këtij afati kohor, ajo, në përputhje me nenin 90 dhe 91 të ligjit, bllokon llogarite bankare të tatimpaguesit, nxjerr njoftimin për fillimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor, si dhe merr masat për sigurimin e pasurisë së tij duke vendosur mbi sendet në pronësi të tatim paguesit, barre siguruese apo hipoteke. Me nxjerrjen e Urdhër Bllokimit sipas nenit 90 dhe Vendimit për marrjen e masave të sigurisë në përputhje me nenin 91 të ligjit, administrata tatimore siguron në favor e saj pagimin e detyrimit nëpërmjet tërheqjes së parave nga llogaria bankare e tatimpaguesit, ose nëpërmjet vendosjes së sekuestros për pasuritë mbi të cilat është vendosur barra siguruese dhe hipoteka. Sipas nenit 90 të Ligjit për procedurat tatimore bankat të cilave ju është dërguar Urdhër Bllokimi i llogarive dhe depozitave të kursimit të tatimpaguesit kalojnë, sipas parashikimeve të pikës 90.1 të këtij Udhëzimi, shumat në favor të administratës tatimore, dhe nëse këto shuma nuk plotësojnë detyrimin tatimor të papaguar të tatim paguesit, administrata tatimore sekuestron dhe më pas konfiskon në favor të saj të gjitha sendet e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të tatimpaguesit, ndaj të cilave ajo ka vendosur me pare barrën siguruese apo hipotekën.

93.2 Administrata tatimore është organi përgjegjës për kryerjen e të gjitha veprime procedurale për të ekzekutuar sekuestron mbi sendet, mbi të cilat janë vendosur si barre siguruese dhe hipoteke. Për ketë qëllim administrata tatimore e cila ka kompetencën e kryerjes së sekuestros, njofton zyrën ku ajo ka regjistruar barrën siguruese, dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe zyrave vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në rastin kur sendet janë në hipoteke. Ekzekutimi i masës së sigurimit nëpërmjet sekuestrimit, konfiskimit dhe shitjes së pasurisë sipas kreut XI të ligjit për procedurat tatimore, është objekt i dispozitave të ligjit "Për kundërvajtjet administrative" dhe realizohet nga administrata tatimore.

93.3. Urdhëri për Sekuestrim nxirret nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale ose titullari i Zyrës Tatimore të qeverisjes vendore. Sekuestrimi mbi të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejtave mbi këto pasuri të tatimpaguesit debitor ekzekutohet duke filluar mbas 37 ditëve nga data e nxjerrjes së njoftimit të detyrimit tatimor të papaguar, me ane të te cilit tatimpaguesi është njoftuar për fillimin e procedurave për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore. Procedurat për vendosjen në sekuestro mbi pasuritë e tatimpaguesit debitor nuk pezullohen dhe nuk pushojnë, deri sa nga ana e tatimpaguesit të jetë shlyer plotësisht detyrimi tatimor. Në rastin e mallrave të cilat për nga natyra e tyre mund të prishen deri në momentin e shitjes, organi tatimor bën shitjen e tyre të menjëhershme, me çmimin e tregut dhe arkëton menjëherë vlerën e tyre për efekt të shlyerjes së detyrimeve tatimore të papaguara.

93.4.1 Administrata tatimore, e ushtron të drejtën e saj për nxjerrjen e Urdhrit për Sekuestrim, vetëm nëse ajo me pare kundrejt tatimpaguesit ka nxjerre Vendimin për masat e sigurimit të pasurisë së tatimpaguesit, sipas parashikimeve të nenit 91 të Ligjit. Në çdo rast do të konsiderohet si akt për marrjen e masave të sigurisë kundrejt pasurisë së tatimpaguesit debitor, akti që organi tatimor ka nxjerre në kuptim të nenit 91 të Ligjit, me ane të së cilit njofton së ndaj tatim paguesit debitor kanë filluar procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, dhe së të gjitha pasuritë të luajtshme apo të paluajtshme të debitorit janë të renduara ose rendohen me barre siguruese apo hipoteke. Çdo veprim i kryer për tjetërsim të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të të tretëve nga data e nxjerrjes së njoftim vlerësimit tatimor prej tatim paguesit do të konsiderohet prej administratës tatimore si i pavlefshëm, dhe detyrimi për arkëtimin e këtij detyrimi tatimor do të shtrihet edhe tek personat në emër dhe për llogari të të cilëve ka kaluar kjo pasuri.

93.4.2 Sekuestrimi i pasurive të tatimpaguesit mbi të cilat me ane të Vendimit të marrjes së masave të sigurisë është vendosur barre siguruese apo hipoteke, bëhet nga administrata tatimore ditën e pare pasardhëse të punës që llogaritet mbas 37 ditëve nga data kur administrata tatimore i ka dërguar tatimpaguesit, njoftimin për pagimin e detyrimeve tatimore të papaguara prej tij, dhe që e ka njoftuar së ndaj tij do të fillojnë procedurat për mbledhjen me forcë të

detyrimit tatimor. Njoftimi për pagimin e detyrimeve tatimore dhe për fillimin e procedurave për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore, do të konsiderohet i marre nga tatim paguesi ditën e 37 të nisjes së tyre me poste apo me dorëzimin dorazi kundrejt konfirmimit për marrjen e tij nga ana e tatimpaguesit. Me kalimin e këtij afati, ditën e pare të punës mbas ditës së 37, administrata tatimore i konsideron të gjitha pasuritë e tatimpaguesit të siguruara me barre siguruese apo hipoteke, për efekt të arkëtimit të detyrimit tatimor të papaguar.

93.5 Administrata tatimore kur ka njoftime apo prova me ane të cilave provon së pagimi i detyrimit tatimor, megjithë marrjen e masave të sigurisë,është në rrezik, nuk respekton afatet për sekuestrimin e pasurisë nëpërmjet nxjerrjes së Urdhrit për Sekuestrim, sipas nenit 93 të Ligjit, por bën sekuestrimin e menjëhershëm të pasurive të tatimpaguesit në favor të administratës tatimore. Administrata tatimore vepron sipas paragrafit 5 të nenit 93 të Ligjit, në ato raste kur ajo ka të dhëna së tatimpaguesi, përpiqet të tjetërsojë pasuritë e tija, apo të ulë vlerën e tyre, si dhe kur ai kërkon të largohet nga vendi. Në çdo rast kur administrata tatimore gjykon së sipas analizës së riskut të kryer prej saj, megjithë marrjen e masave të sigurisë, detyrimi tatimor është në rrezik për tu arkëtuar, ajo (administrata) vepron sipas paragrafit 5 të nenit 94 të Ligjit.

94. Urdhëri i sekuestrimit

94.1.1 Urdhëri i Sekuestrimit, është akti i vetëm me ane të të cilit administrata tatimore ka të drejtë filloje procedurat e shitjes për pasuritë kundrejt të cilave më pare ishte vendosur masat e sigurisë. Urdhëri i Sekuestrimit bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara apo Titullari i Zyrës Tatimore të Njësisë Vendore.

94.1.2 Urdhëri i Sekuestrimit përmban detyrimisht të dhënat e parashikuara në nenin 94 të Ligjit.

Ne Urdhërin e Sekuestrimit pervecse sa parashikohet në nenin 94 të Ligjit, duhet të përfshihet edhe informacioni i meposhtem:

a) Emri i tatimpaguesit;

b) NIPT-i;

c) Selia e regjistruar, dhe në rastin personave të parashikuar në nenin 99 të ligjit, nëse ata janë persona fizike edhe adresa e vendbanimit të tyre;

ç) Numri dhe data e njoftimit të vlerësimit tatimor.

95. Pasuria, objekt i sekuestrimit

95.1 Administrata tatimore për efekt të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara, sipas Kreut XI të ligjit, ka të drejtë të sekuestrojë pasurinë e tatimpaguesit debitor dhe ta shesë atë sipas parashikimeve të këtij Kreu. Por ajo (administrata tatimore) sipas nenit 95 të Ligjit nuk mund të sekuestroje dhe të kaloje në favor të saj për të shitur me vone me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore të papaguara pasuritë siç janë përcaktuar në nenin 529 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas këtij neni administrata tatimore nuk mund të sekuestroje pasuritë e mëposhtme:

a) sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiljet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;

b) ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;

c) dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;

ç) librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;

d) deri 3 dynymë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljet e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;

dh) ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditëtit ose familjare ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë së 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;

e) frutat natyrore një muaj para së ato të piqen.

96. Shitja e pasurisë së konfiskuar

96.1 Me kalimin e afatit 15-ditor nga dita e marrjes së njoftimit të sekuestrimit nga ana e tatimpaguesit, i cili ende nuk ka shlyer detyrimin tatimor, sendet e paluajtshme ose të luajtshme të sekuestruara nga administrata tatimore, prej tatimpaguesit, konfiskohen dhe i nënshtrohen procesit të shitjes së tyre, me qëllim arkëtimin e detyrimit tatimor. Në këtë rast, administrata tatimore vepron në përputhje me të gjitha rregullat e parashikuara në ligjin "Për ankandin publik". Në zbatim të procedurave të shitjes, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si autoritet tatimor qendror është autoriteti shitës, i cili është përgjegjës për realizimin e ankandit publik në përputhje me ligjin 'Për ankandin publik' dhe procedurave për shitjen e pasurisë së konfiskuar, që janë përcaktuar me udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 4, të nenit 96, të ligjit.

96.2.1 Me përfundimin e procesit të shitjes së mallrave të konfiskuara, të ardhurat nga shitja përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet e shitjes për zhvillimin e ankandit publik dhe më pas zbatohet radha e pagesës, në përputhje me nenin 79 të ligjit.

Kostot administrative përbëhen nga të gjitha kostot e papaguara më parë për marrjen e masave të sigurisë, sekuestrimit të tyre, vlerësimit, transportit, të publikimit etj.

96.2.2 në ato raste kur nga shitja realizohen më shumë të ardhura së sa ka qenë detyrimi tatimor i papaguar prej tatimpaguesit, këto shuma administrata tatimore është e detyruar t'ia ktheje tatimpaguesit brenda 5 ditëve pune nga data e përfundimit të arkëtimit të parave të realizuara nga shitja në favor të administratës tatimore. Në ketë rast administrata tatimore njofton me shkrim tatimpaguesin, si dhe i kërkon atij të japë numrin e llogarisë bankare në mënyre që të bëhet kalimi i këtyre shumave në favor të tatimpaguesit. Në rast së tatimpaguesi nuk ka llogari bankare, atëherë këto shuma depozitohen në një banke me seli në Republikën e Shqipërisë, në vendin ku tatimpaguesi ka selinë apo vendbanimin e tij, në emër dhe për llogari të këtij të fundit.

96.3 Shuma e mbetur i kthehet tatimpaguesit brenda pesë ditëve pune nga data e përfundimit të ankandit.

97. Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë

97.1.1 Administrata tatimore, gjithnjë niset nga qëllimi kryesor, ai i mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara. Për arritjen e këtij qëllimi ajo kryen të gjitha veprimet e parashikuara nga nenet 89-96 të këtij ligji, dhe në rast se, edhe me përfundimin e këtyre veprimeve që përfundojnë me shitjen e sendeve të sekuestruara prej saj, nuk arrihet të arkëtohet detyrimi tatimor i papaguar, apo nuk është e mundur që të ndërmerren masat e parashikuara në këto nene, ajo ka të drejtë të kërkoje përmbushjen e këtij detyrimi edhe nga personat e tretë, nëpërmjet transferimit të detyrimit të tatimpaguesit tek këta persona. Sipas nenit 97, paragrafi 1 i Ligjit, persona të tretë të cilëve administrata tatimore u transferon detyrimin, konsiderohen ata persona, të cilët gjatë periudhës së mbledhjes me forcë të detyrimeve kundrejt një tatimpaguesi, kanë përfituar prej tij pasuri të ndryshme. Në kuptim të zbatimit të ligjit për procedurat tatimore, pasuritë e përfituara mund të jenë si sende të luajtshme ashtu edhe të paluajtshme. Paragrafi pare i nenit 97 të Ligjit "Për Procedurat Tatimore", kërkon domsdoshmerisht përmbushjen e dy kritereve për transferimin e detyrimit. së pari detyrimi tatimor i tatimpaguesit të mos jete arkëtuar plotësisht edhe pas shitjes së pasurive të tatimpaguesit, pasuri ndaj të cilave me pare ishin marre masat e sigurimit të detyrimit, dhe së dyti që personi i tretë t'i ketë fituar këto pasuri prej tatimpaguesit debitor, gjatë periudhës së fillimit dhe zbatimit të procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të papaguar. Vetëm në këto raste administrata tatimore transferon detyrimin e papaguar tek personi i tretë.

97.1.2 Nëse administrata tatimore ndodhet përpara rastit të dhëne në paragrafin 97.1.1 më lart, ajo është e detyruar t'i njoftoje personit të tretë, detyrimin tatimor të transferuar. Në ketë njoftim administrata tatimore njofton personin e tretë, së tek ai është transferuar detyrimi tatimor i një tatimpaguesi, nga i cili ky person ka përfituar pasuri gjatë periudhës së sekuestrimit të pasurive të tatimpaguesit debitor. Njoftimi i këtij detyrimi bëhet gjithmonë me shkrim, dhe përmban:

a) Emrin tregtar apo emrin në rastin e personit fizik, apo individ, dhe në rastin e fundit

gjenëralitetet e këtij të fundit, të personit të tretë që i transferohet detyrimi;

b) NIPT-in, nëse ka;

c) Selinë e regjistruar apo adresën e vendbanimit të tij;

ç) Shumën e detyrimit që atij i transferohet si detyrim tatimor;

d) Vlerësimin e shumës që i takon të paguajë, dhe së ku është mbështetur për llogaritjen e saj;

dh) Pasurinë e përfituar prej tij nga tatimpaguesi debitor gjatë periudhës së procedurave të sekuestrimit të pasurisë së tatimpaguesit debitor;

e) Afatin e pagimit të kësaj shume në favor të administratës tatimore;

f) Bankën dhe numrin e llogarisë së ku do të kryejë pagesën;

g) Emrin tregtar, apo emrin e regjistruar të tatimpaguesit, detyrimi i të cilit nuk është arkëtuar edhe pas shitjes së pasurive të tij;

gj) NIPT-in e tatimpaguesit debitor;

h) Selinë e regjistruar apo adresën e tatimpaguesit debitor.

97.1.3 Administrata tatimore konsideron si afat maksimal të pagimit të shumës së detyrimit tatimor që i transferohet personit të tretë ditën e 14, dite e cila llogaritet duke filluar nga data e marrjes dijeni të njoftimit të parashikuar në paragrafin e mësipërm. Si vlerësim së njoftimi ka mbërritur, në ato raste kur administrata nuk ka konfirmim për marrjen e tij, do të merret afati maksimal postar që llogaritet nga data e nisjes së njoftimit me poste deri në mbërritjen në adresën e personit të tretë. Njoftimi për personin e tretë mund të bëhet edhe me forma të tjera të dërgimit të tij si dhe me dhënien dorazi të tij kundrejt konfirmimit për marrjen e tij për personin që i adresohet njoftimi. Personi i tretë të cilit i drejtohet njoftimi duhet të paguajë detyrimin brenda afatit 14 ditor nga data e marrjes dijeni për njoftimin. Në rast së dita e 14 bie dite pushimi, ky afat shtyhet deri në ditën e pare të punës që vjen mbas këtij afati.

97.2 Detyrimi tatimor që do të perllogaritet për personin e tretë ndaj të cilit është transferuar detyrimi, do të bëhet mbi bazen e vleres së tregut të pasurise e cila i është transferuar personit të tretë. Në asnjë rast organi tatimor, nuk mund të llogarise detyrimin për personin e tretë më shumë sesa është vlera reale e tregut për pasurinë e përfituar prej tij. Për të llogaritur vlerën e tregut administrata tatimore mbështetet në të dhëna që mund të marre prej INSTAT-it, në të dhëna që ajo disponon prej tatimpaguesve të tjerë për të njëjtin transaksion të kryer në kushte dhe vend të njëjte me atë që ka kryer tatimpaguesi dhe personi i tretë, në çmime që mund të kenë zyra të ndryshme që merren me regjistrimin e pasurive dhe në çmimet në rastet e kryerjes së transaksioneve për kalimin e pronesise së tyre, në çmimet që mund të ketë nxjerre vete administrata tatimore nga hulumtimi i tregut.

97.3 në çdo rast kur detyrimi tatimor i transferohet një të treti, administrata tatimore kryen të gjitha veprimet e parashikuara nga neni 88 e vijues i ligjit dhe në ketë udhëzim, pasi personi i tretë që i është transferuar detyrimi tatimor, konsiderohet si tatim pagues debitor dhe njoftohet për transferimin e këtij detyrimi. Në çdo rast njoftimi përveç sa është parashikuar në nenin 89 të Ligjit, dhe në ketë Udhëzim, duhet të përmbaje të arsyetuar edhe shkakun e transferimit të këtij detyrimi tatimor tek personi i tretë. Personit të cilit i transferohet detyrimi, i jepen të gjitha të drejtat që ai ka për ta kundërshtuar ketë transferim, dhe për t'i provuar administratës tatimore, së detyrimi tatimor nuk mund t'i transferohet këtij personi. Nëse personi që i transferohet detyrimi, edhe pas njoftimit të bërë nga administrata tatimore, nuk e kundërshton atë brenda afateve kohore të parashikuara në ligj për tatimpaguesin, administrata tatimore është e detyruar të filloje të gjitha masat shtrënguese që i jep ligji për mbledhjen me forcë të tatimit prej tij.

98. E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë

98.1 Administrata tatimore, njëkohësisht me procedurat e tjera të vjeljes me forcë të detyrimit tatimor të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore në ato raste kur ka dijeni që pale të treta kanë për të paguar shuma të caktuara në favor të tatimpaguesit debitor, mund të kërkoje nga këta persona që detyrimet e tyre monetare kundrejt tatimpaguesit, ti derdhin në favor të

administratës tatimore. Palët e treta për të kryer këto pagesa në favor të administratës tatimore, duhet të jenë njoftuar prej kësaj të fundit me shkrim, dhe detyrimi i tyre fillon brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, por jo më vonë së sa 37 dite prej datës së nisjes së njoftimit nga organit tatimor.

98.2 në çdo rast administrata tatimore është e detyruar të njoftoje palën e tretë sipas afateve të përcaktuara në nenin 69 të ligjit për procedurat tatimore, çka do të thotë që ajo brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni për pagesat që kanë për të kryer palët e treta kundrejt tatimpaguesit duhet të përgatisë njoftimin për palën e tretë. Si rregull administrata tatimore duhet të nxjerre njoftimin që ditën e pare të marrjes dijeni të detyrimeve që palët e treta i kanë tatimpaguesit, detyrimi tatimor i të cilit nuk është paguar.

98.3.1 Nëse me kalimin e 37 ditëve nga data kur është nxjerre njoftimi për pagimin e detyrimeve nga pala e tretë, prej kësaj të fundit nuk janë kryer pagesat, administrata tatimore mund të filloje të gjitha procedurat e parashikuara nga nenet 88 e vijues të ligjit

98.3.2 Kur tatimpaguesi nuk e ka paguar detyrimin e tij brenda afatit 30 ditor të njoftuar sipas paragrafit të pare të nenit 98, dhe kur njoftimi i është dërguar brenda të gjitha afateve të parashikuara në nenin 98, paragrafi 2 të Ligjit, administrata tatimore fillon mbledhjen me forcë të këtij detyrimi ndaj personit të tretë. Procedura e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor ndaj një personi të tretë është e njëjte me procedurën për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara nga tatimpaguesit debitorë.

99. Përgjegjësia e ortakut, aksionerit dhe administratorit

99.1 në rastin e personave juridike, kur pas shitjes së pasurive të personit tatimpagues debitor, administrata tatimore nuk ka arritur ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar kundrejt saj, ajo e transferon detyrimin tatimor të personit juridik tek ortaket, aksioneret dhe tek administratoret e personit juridik. Si të tillë do të konsiderohen vetëm ata persona që figurojnë me cilësitë e mësipërme në regjistrin tregtar apo në regjistrat e tjerë ku personi juridik është i regjistruar, mbas datës së daljes së njoftimit të detyrimit tatimor për tatim paguesin. Transferimi i detyrimeve personave të parashikuar me sipër lejohet vetëm në rastet e parashikuara në nenin 16 të Ligjit "Për për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Për ketë qëllim, së pari administrata tatimore duhet të ketë analizuar nëse personi juridik, përgjegjësia e të cilit për mospagimin e detyrimit tatimor u transferohet personave, ndodhet vërtete në kushtet e nenit 16 të ligjit "Për për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

99.2 në çdo rast, kur detyrimi tatimor i papaguar u kalon personave sipas parashikimeve të nenit 99, paragrafi 1 i Ligjit "Për procedurat tatimore", administrata do t'i konsideroje ata si debitorë solidare. Kjo do të thotë që të gjithë janë përgjegjës për përmbushjen e detyrimit tatimor të papaguar, por në çdo rast kjo përgjegjësi individuale do të jetë e njëjte me pjesën që ortaku apo aksioneri zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë. Në ato raste kur debitor është edhe administratori i shoqërisë, administrata tatimore duhet të kontrollojë nëse administratori i shoqërisë, është ortak apo aksioner në kapitalin themeltar të shoqërisë. Në ato raste kur administratori është ortak apo aksioner në kapitalin themeltar të shoqërisë, përgjegjësia e tij është njëjte me atë të ortakeve apo aksionereve të tjerë të shoqërisë. Në rastin kur administratori nuk ka cilësinë e ortakut administrata tatimore duhet ta trajtoje atë si debitor solidar, bashke me ortaket apo administratoret e tjerë të shoqërisë. Në çdo rast administrata tatimore nuk bën ndarjen e detyrimit tek personat me cilësinë e ortakut, aksionerit apo administratorit, por vetëm njofton këta për transferimin detyrimit, dhe janë këta të fundit të detyruar bashkërisht për përmbushjen e tij. Administrata tatimore nuk i ndan këta persona nga njeri tjetri por kërkon prej tyre përmbushjen e detyrimit. Në çdo rast administrata tatimore duhet të mbajë në konsideratë Kodin Civil, nenet 423 e vijues të tij, për përmbushjen e detyrimit nga personat e mësipërm të cilët konsiderohen si solidare në përmbushjen e tij.

99.3 në rast së personi juridik tatimpagues i cili ka detyrime tatimore të papaguara, nuk arrin t'i paguaje Këto detyrime edhe pas perfundimit të procesit të likuidimit apo falimentimit, detyrimi tatimor i papaguar, iu transferohet si solidare personave që kanë patur cilësinë e ortakut,

aksionerit apo të administratorit/administratoreve në momentin e kryerjes së procesit të likuidimit apo falimentimit të personit tatimor debitor për detyrimet tatimore. Në ketë rast administrata tatimore e transferon detyrimin e saj të tretëve, duke respektuar të njëjtën mënyre dhe rregulla si kur transferon detyrimin tek këta, sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 99.

99.4.1 në çdo rast kur administrata tatimore transferon detyrimin tatimor të papaguar prej personit juridik, ajo e njofton aktin e transferimit të këtij detyrimi, personave të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 99 të Ligjit "Për procedurat tatimore", duke i njoftuar ata. Rregullat e parashikuara në kapitullin XIII "Mbledhja me forcë e tatimeve" duhet të respektohen nga administrata tatimore për kryerjen njoftimeve të saj. Në çdo rast, edhe kundrejt personave që kanë cilësinë ortakut, aksionerit apo të administratoreve të personit juridik detyrimi tatimor i të cilit nuk është paguar, janë të vlefshme për të arkëtuar detyrimin, të gjitha veprimet e parashikuara nga nenet 88 e vijues të Ligjit "Për procedurat tatimore", çka nënkupton që administrata tatimore në momentin e transferimit të këtij detyrimi, i konsideron ata si tatimpagues, detyrimi i të cilëve nuk është arkëtuar dhe ndaj tyre do të filloje me forcë mbledhjen e detyrimeve tatimore. Në çdo rast kundrejt këtyre personave detyrimi do të jetë i përbashkët dhe në çdo rast ata janë solidare, çka nënkupton së për arkëtimin e detyrimeve do të trajtohen njësoj si debitorët solidare sipas nocioneve të dhëna në Kodin Civil nenet 423-435 të tij.

99.4.2 në çdo rast kur administrata tatimore fillon mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara nga personat që kanë cilësinë ortakut, aksionerit apo administratorit të personit juridik tatimpagues, detyrimi i të cilit është i pambledhur dhe iu është transferuar këtyre të fundit, ajo i merr masat shtrënguese vetëm nëse është përpara kushteve të parashikuara nga neni 88 i Ligjit "Për procedurat tatimore". Një gjë e tille do të thotë që detyrimi tatimor i transferuar këtyre personave ka marre forme të prere dhe është në fuqi.

100. Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese

100.1 Procedurat për mbledhjen me forcë të tatimeve, që janë procedurat për zbatimin e masave shtrënguese të parashikuara nga ligji, janë në të drejtën e organit tatimor për tu filluar brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor duhej të paguhej. Detyrimi për të paguar tatimin është dita kur vlerësimi tatimor është hedhur zyrtarisht në regjistrat apo sistemet elektronike të administratës tatimore. Një gjë e tille do të thotë, që e drejta e administratës tatimore për të filluar zbatimin e masave shtrënguese parashkruhet me kalimin e 5 viteve nga data e mesiperme.

100.2 Afati parashkrues për të drejtën e administratës tatimore për zbatimin e masave shtrënguese, ndërpritet vetëm nëse gjatë periudhës 5 vjeçare kanë ndodhur njëra nga ngjarjet e mëposhtme:

a) Periudha kohore kur detyrimi tatimor është kundërshtuar nga ana e tatimpaguesit. Si periudhe gjatë së cilës ndërpritet afati parashkrues për nxjerrjen dhe zbatimin e masave shtrënguese do të konsiderohet koha nga data kur tatimpaguesi ka paraqitur një ankim në organin administrativ dhe deri në përfundimin e shqyrtimit të ankimit të tij në rrugë gjyqësore. Periudha e ankimit mbaron ditën që akti i organit tatimor me ane të te cilit është vendosur tatimi ka marre forme të prere. Në ketë rast afati i llogaritjes së parashkrimit të së drejtës së administratës tatimore për zbatimin e masave shtrënguese fillon ditën e nesërme nga data e marrjes së aktit tatimor forme të prere.

b) Kur detyrimi tatimor është objekt i një kontrolli ose hetimi zyrtar nga ana administratës tatimore. Në ketë rast si datë në të cilën ndërpritet afati do të merret data në të cilën administrata tatimore, ka marre një vendim që për detyrimin tatimor të zhvilloje kontrollin apo të ketë nisur një hetim tatimor. Data në të cilën do të rifilloje llogaritja e afatit parashkrues do të merret dita e nesërme e datës në të cilën kontrolli tatimor apo hetimi zyrtar i administratës tatimore ka përfunduar, dhe data e vendosur në aktin zyrtar, me ane të cilin mbyllet kontrolli apo hetimi zyrtar i administratës tatimore.

c) Kur detyrimi tatimor është objekt i një çështjeje penale. Si datë për fillimin e ndërprerjes së afatit parashkrues të parashikuar në nenin 100 paragrafi 1 do të merret data kur

organi i ndjekjes së veprës penale ka regjistruar fillimin e procedimit penal, dhe ky afat do të filloje të llogaritet nga dita e nesërme e datës kur ceshtja penale është mbyllur me një vendim të vlefshëm dhe të formës së prere të organit të ndjekjes penale apo të gjykatës që ka shqyrtuar ceshtjen penale.

101. Detyrimi për t'u paraqitur

101.1 Me qëllim për të zbatuar në mënyre të rregullt dhe të plote legjislacionin tatimor, si dhe për të marre të dhëna të nevojshme për çështje të cilat i kërkohen administratës tatimore për zbatimin e ligjit, ajo ka të drejtë të thërrasë dhe të dëgjoje çdo person i cili ka dijeni për ceshtjen e cila është në objektin e punës së organit tatimor brenda kufijve të dhëne nga ligji.

101.2 Thirrja e personave pranë administratës tatimore bëhet në ato raste kur personi i cili thirret ka në zotërim dokumente apo regjistrime të ndryshme të të dhënave, të cilat kanë interes për organin tatimor, për përcaktimin sa me të drejtë të detyrimit tatimor, ose kur bëhet në funksion të masave shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve tatimore, me qëllim marrjen e informacioneve për pasuri apo transaksione të kryera nga tatimpaguesi.

101.3 Flete thirrja mundëson administratën tatimore të ushtrojë funksionet e saj në ato raste kur ajo nuk arrin të sigurojë bashkepunimin vullnetar të tatimpaguesve. Kjo metode përdoret për të detyruar paraqitjen e personave, me apo pa dokumente, si dhe deklarimin e tyre mbi ceshtje që lidhen me hetime të kryera nga administrata tatimore. Informacioni i kërkuar në një flete thirrje mund të jetë i natyrës dokumentere ose dëshmuese.

Informacioni që kërkohet të merret duhet t'i përshtatet qëllimit të hetimit të ceshtjes dhe është e arsyeshme të supozohet së ky informacion është në zotërim të personit të cilit i drejtohet flete thirrja.

Fletë thirrja nxirret që të sigurohet informacioni që nuk është dhënë në mënyre të vullnetshme nga tatimpaguesi ose nga një pale të tretë. Gjithashtu fletë thirrja mund të nxirret kur pala e tretë kërkon nxjerret e saj për të justifikuar dhënien e informacionit.

Ne rast së fletethirrja synon të sigurojë marrjen e të dhënave ose dokumenteve të posaçme, atëherë fletethirrja duhet të përmbaje një përshkrim të qarte të të dhënave apo dokumenteve që kërkohen. Për shembull, në rast së qëllimi i flete thirrjes është marrja e informacionit që i nevojitet administratës tatimore për vlerësimin e detyrimit të TVSH-së për periudhën tatimore mars 2008, atëherë në flete thirrje duhet të shkruhet "te gjithë regjistrat dhe të dhënat në zotërimin tuaj ose brenda kontrollit dhe aksesit tuaj në lidhje me detyrimin e TVSH-së të tatimpaguesit për periudhën tatimore Mars 2008".

Në rast së fletë-thirrja synon të sigurojë marrjen nga administrata tatimore të të dhënave ose dokumenteve të ndryshme nga persona të tretë, atëherë fletethirrja duhet të përmbaje një përshkrim të qarte të transaksioneve që personi i tretë mund të ketë kryer me tatimpaguesin debitor, përfshirë të dhëna apo dokumente të tjera që kërkohen.

Personi që thirret duhet të paraqitet personalisht. Ai/ajo nuk mund të dërgoje një përfaqësues por mund të shoqërohet nga një i tille.

Administrata tatimore dhe personi i thirrur për t'u paraqitur mund të bien dakord për ndryshimin e datës dhe orës së paraqitjes. Asnjë ndryshim nuk mund të bëhet në mënyrë të njeaneshme nga i thirruri në lidhje me datën dhe oren e takimit. Kjo do të përbënte shkas për penalizimin e personit të thirrur në përputhje me ligjin.

Ne paraqitjen e tij, dëshmitari mund të pyetet në lidhje me regjistrat dhe të dhënat e tjera të tatimpaguesit të cilat ekzistojnë në forme shkresore. Nëse thirrja përmban kërkesën për dokumente specifike, personi i thirrur duhet t'i paraqesë ato dokumente sigurisht kur ato janë nën zotërimin apo aksesin e tij/saj.

Në rastet kur nuk është e qartë për administratën tatimore së cilat dokumente specifike mund të zotërojë tatimpaguesi apo një palë e tretë, flete thirrja mund të nxirret vetëm për tu paraqitur dhe për të dëshmuar. Një flete thirrje e dyte mund të nxirret duke përshkruar me hollësi të mjaftueshme të dhënat apo dokumentet që nevojiten.

101.4 Fletë thirrja dërgohet me postë rekomande, të paktën 15 ditë kalendarike para datës së caktuar për paraqitje ose dërgim informacioni. Nëse një tatimpagues ose palë e tretë merr një fletë thirrje nga administrata tatimore dorazi, një kopio e fletë thirrjes duhet t'i dërgohet edhe me postë rekomande.

101.5 Kur administrata tatimore kërkon të thërrasë një person për tu paraqitur, ajo e bën këtë duke pasur parasysh kohen që personi ka me të përshtatshme për tu paraqitur, normalisht gjatë orëve zyrtare të punës, me përjashtim të rasteve kur për nevoja urgjente thirrja bëhet jashtë orarit zyrtar dhe për këtë bihet dakord me personin e thirrur. Një fletë thirrje për paraqitje urgjente mund të bëhet kur administrata tatimore ka bindjen së tatimpaguesi ose pala e tretë mund të humbasin, manipulojnë apo zhdukin dokumentet që disponojnë.

101.6 Kur personi i thirrur nuk paraqitet në vendin dhe orën e kërkuar nga ana e administratës tatimore, dhe nuk ka paraqitur shkaqe të arsyeshme për pamundësinë objektive të paraqitjes së tij, administrata tatimore ka detyrimin e aplikimit të sanksioneve ndëshkuese në përputhje me nenet 126 dhe 127 të Ligjit.

101.7 në ato raste kur tatimpaguesi ose pala e tretë janë në pamundësi objektive për tu paraqitur, ato njoftojnë administratën tatimore e cila shtyn takimin për një datë tjetër, dhe për ketë qëllim duhet të njoftoje përsëri personin sipas formës dhe procedurës të parashikuar në nenin 105 të ligjit. Si shkaqe objektive të cilat e detyrojnë personin të mos paraqitet, mund të merren në konsiderate, sëmundja e personit apo e familjareve të tij në ato raste kur këta të fundit kanë nevoje për kujdesin e personit që është thirrur, kur nuk ndodhet përkohësisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ose në ato raste kur ditën dhe orën e takimit ai është thirrur nga ndonjë gjykatë e çdo shkalle për pjesëmarrje me cilësi të ndryshme procedurale në gjykim, dhe raste të tjera të ngjashme me to. Në çdo rast administrata tatimore duhet të këtë të provuara prej personit arsyen e mosparaqitjes para organit tatimor. Në rastin e mos paraqitjes së shkaqeve për pamundësi objektive për tu paraqitur, administrata tatimore ndërmer sanksionet përkatëse sipas neneve 126 dhe 127 të ligjit. .

102. Ndërprerja e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor

102.1 Administrata tatimore i ndërpret masat shtrënguese për sigurimin e pagimit të detyrimit tatimor në rast se:

a) Tatimpaguesi e ka paguar të gjithë detyrimin e tij tatimor.

b) Në përputhje me nenin 100 të ligjit është parashkruar e drejta e administratës tatimore për fillimin e procedurave të zbatimit të masave shtërnguese, duke patur parasysh edhe rastet e ndërprerjes së afatit të parashkrimit sipas pikës 2 të nenit 100 të ligjit. Procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor që kanë filluar përpara skadimit të afatit të parashkrimit e spostojnë këtë afat deri në përfundim të procedurës. P.sh. Nëse në zbatim të procedurave të mbledhjes me forcë është konfiskuar një sasi malli apo një automjet, një ditë para afatit të parashkrimit, ky afat do të shtyhet deri në datën e përfundimit të procedurës, pra të shitjes së mallit apo automjetit.

c) Kur nga ana e autoriteteve të parashikuara në nenin 103 të Ligjit "Për procedurat tatimore" është vendosur dhe shpallur detyrimi tatimor i pambledhshem. Në këtë rast ndërprerja e procedurave fillon nga dita e nxjerrjes së aktit për deklarimin e tatimeve si të pambledheshme, dhe kjo evidentohet dhe regjistrohet në dosjen e tatim paguesit.

ç) në të gjitha ato raste kur tatimet janë falur me ligj nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast procedurat ndërpriten ditën e hyrjes në fuqi të ligjit me ane të cilit është vendosur falja e detyrimeve tatimore, dhe kjo gjë regjistrohet në dosjen e tatim paguesit. Në ato raste kur detyrimi tatimor përbëhet nga detyrime që falen dhe detyrime që nuk falen administrata tatimore bën zbritjen e detyrimeve të falura dhe i regjistron ato në dosjen e tatimpaguesit, dhe për pjesën e mbetur të detyrimit ajo mban në fuqi masat shtrënguese për sigurimin e pagimit të detyrimit.

103. Procedurat për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm

103.1 Deklarimi si i pambledhshem i detyrimeve tatimore, është procesi i cili kryhet vetëm në raste ekstreme, dhe vetëm në ato raste kur administrata tatimore ka zbatuar të gjitha

masat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të parashikuara nga nenet 88- 101 të Ligjit, dhe nuk është arritur të mblidhet dhe të arkëtohet detyrimi tatimor. Detyrimi tatimor mund të deklarohet i pambledhshem vetëm në rastet e mëposhtme:

a) Kur megjithëse është bërë shitja e investimeve likuide dhe aktiveve të tjera, nuk është bërë i mundur arkëtimi i detyrimit. Sipas këtij parashikimi administrata tatimore në çdo rast duhet të ketë të evidentuara dhe të provuara që ajo ka kryer të gjitha veprimet e kërkuara nga ligji për vendosjen e masave të sigurisë mbi të gjitha pasuritë e subjektit. Tatimpaguesi duhet gjithashtu të provojë së nuk disponon pasuri të tjera të çdo forme dhe kudo që të ndodhen të cilat mund të përdoren për shlyerjen e detyrimeve,

b) Tatimpaguesi dhe administrata tatimore provojnë me evidencë të saktë së tatimpaguesi nuk disponon asnjë lloj pasurie apo të ardhure që do mund të përdorej për shlyerjen qoftë edhe me këste të detyrimit tatimor të papaguar, dhe së edhe veprimtaria e ardhshme e tatimpaguesit, nuk mund të gjenëroje, apo të sjelle të ardhura, të cilat të jenë të vlefshme për përmbushjen e detyrimit tatimor.

c) Kur administrata tatimore nga analiza e situatës financiare dhe pasurore të subjektit tatimpagues arrin në përfundimin së edhe nëse ndaj tatimpaguesit do të fillonte një procedure likuidimi apo falimentimi, shuma e detyrimit tatimor nuk mund të mblidhej edhe sikur ky proces të përfundonte dhe së pasuria në pronësi të tatimpaguesit, debitorit që gjendet pranë tij apo në përdorim tek personat e tretë, nuk është në gjendje të përmbushe edhe pagimin e kostove administrative të këtij procesi.

Që detyrimi tatimor të konsiderohet i pambledhshëm duhet që të plotësohen të gjitha kushtet e dhëna në paragrafët a), b) dhe c) më lart.

103.2 në çdo rast tatimi do të deklarohet si i pambledhshem me ane të një vendimi të nxjerre nga titullari që e ka ketë të drejtë sipas nenit 103, paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit. Vendimi për deklarimin e tatimit të pambledhshem duhet të jetë i arsyetuar, dhe mbështetur në prova. Vendimi duhet të arsyetoje së megjithë masat e marra për sigurimin e aseteve të tatimpaguesit dhe ekzekutimin e tyre, nuk ka asnjë mundësi reale për të bërë të mundur pagimin e detyrimit. Administrata tatimore duhet të argumentoje së edhe sikur nga ana e saj të merren veprime të tjera, në asnjë rast nuk është e mundur të arkëtohet detyrimi tatimor. Në pjesën arsyetuese administrata tatimore duhet të jape një vlerësim të gjendjes reale pasurore të tatimpaguesit, marrëdhënieve të tij me tretët, për aq sa i përket detyrimeve që të tretët mund ti kenë tatimpaguesit, apo pasurive të cilat janë në përdorim apo në zotërim nga persona të tretë, si dhe mundësive të ardhshme për mbledhjen e detyrimit tatimor. Në arsyetimin e vendimmarrjes për deklarimin e tatimit si të pambledhshem, duhet të parashtrohet edhe argumentimi i mos eficenses për vazhdimin e procedurave të tjera për mbledhjen e detyrimit tatimor. Si arsyetim për një mos eficense në mbledhjen e tatimit duhet të bëhet një përshkrim i përllogaritjes së shpenzimeve që administrata tatimore është e detyruar të kryejë, në krahasim me shumën që ajo do të përfitoje si pjese e detyrimit tatimor të papaguar, nga kryerja e veprimeve të saj, në ato raste kur shuma e kostove administrative dhe shpenzimeve të tjera që administrata tatimore është e detyruar të kryejë për mbledhjen e detyrimit, është me e vogël së sa shuma që do të përfitohet nga arkëtimi i detyrimit tatimor të papaguar. Por në çdo rast administrata tatimore është e detyruar të arsyetoje së ajo ndodhet në rastin e parashikuar në piken 103.1 të këtij udhëzimi, dhe pasi me pare, ajo ka kryer dhe evidentuar veprimet e saj për mbledhjen e detyrimit tatimor. Gjithashtu vendimi për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshem, duhet të jetë i shoqëruar edhe me provat konkrete në të cilat administrata tatimore mbështet arsyetimin e saj.

103.3 Për klasifikimin si të pambledhshëm të një pjese ose të të gjithë detyrimit (borxhit) tatimor, njësia përkatëse e borxhit i paraqet një relacion me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm të tatimeve, sipas të cilit evidenton çdo dokumentacion dhe veprim të kryer për mbledhjen e detyrimit tatimor sipas ligjit dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Ky relacion përmban informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar si vijon:

a) Emrin tregtar të personit fizik apo juridik që e paraqet atë, ose në rastin e personit fizik

kur nuk ka emër tregtar, gjenëralitetet e kërkuesit;

b) NIPT-in;

c) Adresën e sakte të tatim paguesit, si dhe të selisë së regjistruar të tij;

ç) Aktin me ane të cilit i është njoftuar detyrimi tatimor i papaguar, dhe që ai i detyrohet për ta paguar.

d) Një përshkrim të masave të marra nga ana e administratës tatimore në kuptim të kreut XIII të Ligjit "Për procedurat tatimore", dhe nëse ato janë ekzekutuar apo jo, duke i dhënë edhe shpjegime mbi aktet administrative të nxjerra për ketë qëllim nga administrata tatimore.

Kërkesa e mësipërme duhet të ketë të bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e plote të aktiveve dhe pasiveve të tatipaguesit, dokumentacion ky që duhet të jetë në mënyre të përmbledhur dhe analitik, duke qenë minimalisht të përfshira të dhënat e meposhtme:

a) Një përshkrim të hollësishëm të te gjithë të ardhurave dhe shpenzimeve të tij, duke përshkruar me hollësi çdo të ardhur të pasqyruar dhe çdo shpenzim të pasqyruar;

b) Parashikimin e fluksit të parave që do të thotë mënyrën e lëvizjes së mjeteve financiare të cilat kanë dale, janë të detyruara të dalin në të ardhmen për kryerjen e pagesave të ndryshme, dhe ato që kanë hyre dhe pritet të hyjnë në llogarite e tatimpaguesit;

c) të gjitha deklaratat e fitim humbjeve dhe pasqyrat përkatëse të tyre, si dhe bilancin e tij për një periudhe kohore duke filluar nga data e nxjerrjes së aktit administrativ që i ka vendosur detyrimin tatimor apo të aktit administrativ që e ka konsideruar tatimpaguesin si person që ka detyrime tatimore të papaguara;

ç) Listën e plote të debitorëve të tij duke treguar shumat që ata i detyrohen, shkakun e lindjes së detyrimit si dhe adresat e sakta të tyre, dhe periudhën e maturimit të detyrimit, apo humbjes së të drejtës për të kërkuar përmbushjen e tyre, duke treguar hapat e hedhura prej tij për mbledhjen e detyrimeve dhe duke dhëne mundësitë që janë reale për mbledhjen e detyrimeve;

d) Listën e plote të kreditoreve të tij, shumat që ai iu detyrohet, shkakun e lindjes së detyrimit, dhe cilat prej tyre janë të kundërshtueshme dhe nuk qëndrojnë, afatin e maturimit të detyrimit dhe afatin e parashkrimit të detyrimit;

dh) Listën e aktiveve që disponon tatimpaguesi.

103.4 Kur administrata tatimore ka të dhëna dhe zotëron prova së tatimpaguesi i cili ka paraqitur kërkesë për deklarimin si të pambledhshem të detyrimit të tij tatimor, përpiqet tu shmanget pagimit të detyrimeve të tij tatimore të papaguara duke bërë evazion fiskal, ose ka elemente të plote që e bëjnë administratën tatimore të dyshoje së ndodhet përpara rastit të mashtrimit të situatës financiare me qëllim mospagimin e detyrimeve tatimore, ajo refuzon kërkesën dhe kërkon prej tatimpaguesit pagimin e detyrimeve si dhe merr të gjitha masat për sigurimin e pagimit të detyrimeve tatimore, duke ia kaluar rastin drejtorisë së investigimit.

103.5 Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka kompetence për të deklaruar tatimin si të pambledhshem, për shumat nen 5.000.000 (pesemilion) lekë. Në çdo rast tatimi deklarohet i pambledhshem me Vendim të shkruar të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, , në përputhje dhe me dispozitat e pikave 103.1 – 103.4 të këtij Udhëzimi.

103.6. Deklarimi i pambledhshëm i detyrimit tatimor apo i një pjese të tij në zbatim të përcaktimeve të pikës 6, të nenit 103, të ligjit, bëhet si më poshtë:

a) për shuma deri në 1 000 000 (një milion) lekë, bëhet me urdhër të drejtorit rajonal të tatimeve, bazuar në vendimin e marrë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim në DRT, i cili funksionon sipas përcaktimeve të bëra në këtë udhëzim;

b) për shuma mbi 1 000 000 (një milion) lekë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë, sipas propozimit të DRT-së, bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, bazuar në vendimin e marrë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim në DPT. Komisioni funksionon sipas përcaktimeve të bëra në këtë udhëzim;

c) për shuma mbi 5 000 000 (pesë milionë) lekë, sipas propozimit të DPT-së, bazuar në vendimin e marrë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim në DPT, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat. Komisioni funksionon sipas përcaktimeve të bëra në këtë udhëzim.

Komisioni sipas përcaktimeve në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, ngrihet dhe funksionon përkatësisht në drejtoritë rajonale tatimore, ku funksionojnë strukturat e mbledhjes së detyrimeve të papaguara dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Në çdo rast, komisioni miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe duhet të përmbajë 7 anëtarë, konkretisht:

Komisioni që ngrihet në Drejtorinë Rajonale Tatimore ka në përbërje 7 përfaqësues, si më poshtë:

- kryetar – drejtori i Strukturës së mbledhjes së detyrimeve të papaguara në DRT;
- anëtar – përfaqësues i strukturës ligjore në DRT-në që administron tatimpaguesin;
- anëtar – përfaqësues i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në DPT;
- anëtar – përfaqësues i Drejtorisë Antikorrupsion në DPT;
- anëtar – përfaqësues i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT-në që administron tatimpaguesin;
- anëtar – dy përfaqësues të strukturës së mbledhjes së detyrimeve të papaguara në DRT.

Komisioni që ngrihet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ka në përbërje 7 përfaqësues, si më poshtë:

- kryetar – Drejtori i Strukturës së Mbledhjes së detyrimeve të papaguara në DPT;
- anëtar – përfaqësues i Drejtorisë Ligjore në DPT;
- anëtar – përfaqësues i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në DPT;
- anëtar – përfaqësues i Drejtorisë Antikorrupsion në DPT;
- anëtar – përfaqësues i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT;
- anëtar – përfaqësues i Drejtorisë së Analizës së Riskut;
- anëtar – përfaqësues i strukturës së mbledhjes së detyrimeve të papaguara në DPT.

Komisioni verifikon përmbushjen e të gjithë kërkesave ligjore, procedurale dhe dokumentare për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, dhe veprimet e kryera nga strukturat e mbledhjes së detyrimeve të papaguara në përputhje me nenet 88–104, të ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Komisioni përkatësisht në DRT/DPT është përgjegjës për kryerjen dhe përmbushjen e të gjithë procedurës dhe verifikimit të çdo dokumentacioni në përputhje me përcaktimet e ligjit të procedurave tatimore dhe udhëzimit në zbatim të tij, përpara se të marrë vendimin për shpalljen e detyrimeve të papaguara, si të pambledhshëm.

Në përfundim të shqyrtimit të rastit, komisioni merr vendim për shpalljen ose jo si të pambledhshëm, të detyrimit tatimor të papaguar.

Për shpalljen i pambledhshëm, të detyrimit tatimor të papaguar, vendimi duhet të jetë unanim nga të gjithë anëtarët e komisionit. Mbledhjet e komisionit dokumentohen me proces verbal dhe nëse njëri apo më shumë anëtarë nuk shprehen dakord për shpalljen e detyrimeve të papaguara, si të pambledhshme, ata nënshkruajnë kundër dhe argumentojnë me shkrim qendrimin e tyre.

Edhe nëse të paktën njëri nga anëtarët nuk është dakord, detyrimi tatimor i papaguar nuk shpallet i pambledhshëm.

Nëse Komisioni, pas shqyrtimit, nuk merr vendim unanim për shpalljen e detyrimit tatimor të papaguar si të pambledhshëm, procedura për këtë qëllim mbyllet sipas rastit nga drejtori rajonal ose drejtori i përgjithshëm i Tatimeve dhe strukturat e mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar, vijojnë kryerjen e procedurave për mbledhjen e detyrimit tatimor.

Bazuar në vendimin e Komisionit, përkatësisht në DRT ose DPT, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" të kësaj pike, drejtori rajonal i tatimeve/drejtori i përgjithshëm i tatimeve/ministri përgjegjës për financat përkatësisht sipas shumave, nxjerr urdhrin për shpalljen e detyrimit tatimor të papaguar si të pambledhshëm.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, bazuar në vendimin e Komisionit të ngritur në DPT, propozon dhe i rekomandon ministrit përgjegjës për financat shpalljen e detyrimit tatimor të papaguar si të pambledhshëm. Propozimi shoqërohet me një kopje të vendimit të komisionit dhe

një kopje të urdhrit për ngritjen e komisionit.

Bazuar në propozimin dhe rekomandimin e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ministri përgjegjës për financat nxjerr urdhrin për shpalljen e detyrimit tatimor të papaguar si të pambledhshëm.

103.7. Detyrimi tatimor ose një pjesë e tij i deklaruar i pambledhshëm, në zbatim të nenit 103 të ligjit, pasqyrohet si i tillë në regjistrin kontabël të detyrimeve.

103.8 Fillimi i procedurës për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm mund të bëhet me kërkesë nga ana e tatimpaguesit ose kryesisht nga ana e administratës tatimore në juridiksionin e të cilës është regjistruar tatimpaguesi.

103.9 Në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe mënyra të tjera të gjykuara si të domosdoshme nga ana e administratës tatimore, në fillim të çdo viti do të bëhet publikimi i vlerës totale të tatimeve të deklaruara sipas nenit 103 të ligjit si të pambledheshme. Publikimi duhet të përfshije edhe numrin në total të kërkesave të paraqitura nga tatimpaguesit për të kërkuar deklarimin si të pambledhëshme të detyrimeve të tyre tatimore, dhe sa kërkesa janë pranuar nga ato që i janë paraqitur administratës tatimore.

104. Fillimi i procedurave të falimentimit

104.1 Fillimi i procedurës së falimentimit në gjykatë nga administrata tatimore bëhet në përputhje me ligjin për falimentimin.

Administrata tatimore në juridiksionin e të cilës është regjistruar tatimpaguesi, ose administrata tatimore në juridiksionin e të cilës ushtrohet veprimtaria ekonomike e tatim paguesit dhe në favor të së cilës paguhen detyrimet tatimore prej tatimpaguesit, ka detyrimin të kërkojë në gjykatën kompetente, fillimin e procedurave të falimentimit.

104.2 Për të gjithë ata tatimpagues ndaj të cilëve administrata tatimore ka kërkuar fillimin e një procedure falimentimi, duhet të jenë të publikuara prej saj në faqen zyrtare të Drejtorisë së Pergjitshme të Tatimeve informacionet përkatëse. Për ketë qëllim zyra tatimore, Drejtoria Rajonale, e cila ka kërkuar në gjykatë fillimin e një procedure falimentimi, është e detyruar që të dërgoje në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, një informacion për subjektin tatim pagues ndaj të cilit ajo ka kërkuar fillimin e një procedure falimentimi. Informacioni duhet të përmbaje, emrin e shoqërisë tregtare, si dhe emërtimin e saj të shkurtuar, NIPT-in, adresën e selisë së regjistruar, emrin e administratorit apo të administratoreve të shoqërisë, si dhe datën dhe numrin e regjistrimit të kërkeses në gjykate, dhe gjykatën ku është depozituar kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit. Në rastet e hedhjes së të dhënave gabim, administrata tatimore është detyruar të korrigjoje menjëherë listën e publikimeve sipas kësaj pike, si dhe të vërë shënimin në faqen e saj për arsyen e heqjes së publikimit.

104.3 Në çdo rast punonjësi i administratës tatimore, i cili ka detyrimin për të kërkuar në gjykatë fillimin e një procedure falimentimi kundrejt një tatimpaguesi, është i detyruar që pas verifikimeve të bëra, nëse ndodhet në një nga rastet e kërkuara nga neni 104, paragrafi 1 i Ligjit të Procedurave Tatimore, të paraqesë në gjykatë kërkesën për fillimin e procedurave të falimentimit. Mos paraqitja e kërkeses për një periudhe 6 mujore nga data kur ajo duhej bërë përbën shkelje disiplinore dhe ligjore për punonjësin që e kishte këtë detyrim.

KREU X II
HETIMI TATIMOR

105. Struktura dhe funksionet e njësive të hetimit tatimor

105.1 Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara, hetimi dhe zbatimi në përbërje të administratës tatimore qendrore, që kanë funksion parësor mbledhjen e informacionit tatimor, hetimin e rasteve tatimore, zbatimin e masave shtrënguese, marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.

Misioni dhe objektivat e njësive të hetimit tatimor përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe kryerjes së detyrave të tyre janë:

a) Parandalimi, zbulimi dhe hetimi i shkeljeve penale tatimore nëpërmjet kryerjes së veprime hetimore për rastet e dyshuara të shkeljes së Kodit Penal në fushën e tatimeve dhe taksave, duke kryer veprimet procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale në përputhje me kompetencat që kanë sipas legjislacionit të fushës "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", si dhe bashkërendimin e punës me Prokurorinë për ndjekjen e hetimit;

b) Mbledhja, përpunimi dhe shkëmbimi i informacionit mbi zbatimin e legjislacionit tatimor, si dhe në përputhje me ligjin "Për procedurat tatimore në RSH" me qëllim zbulimin e shkeljeve penale në fushën e tatimeve dhe taksave, të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë;

c) Mbledhja, përpunimi dhe shkëmbimi i informacionit për sa u përket çështjeve në fushën e pastrimit të parave të lidhura me çështjet tatimore, duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

d) Zbatimi i masave shtrënguese të parashikuara në legjislacionin tatimor në bashkëpunim me strukturat përkatëse të mbledhjes së borxhit tatimor, me qëllim mbledhjen e tatimeve dhe taksave të papaguara;

e) Marrjen dhe aplikimin e masave (dënimeve) administrative për kundërvajtjet administrative tatimore të konstatuara për rastet e shkeljeve të parashikuara në ligjin e procedurave tatimore dhe në këtë udhëzim, që kanë të bëjnë me verifikimin dhe konstatimin e kryerjes së veprimtarisë ekonomiko-tregtare pa u regjistruar, mbajtjen, transportimin përdorimin dhe tregtimin e mallrave pa dokumentacionin e duhur tatimor, punonjës të padeklaruar në organin tatimor etj., pa u kufizuar vetëm në to.

105.2 Punonjësit e strukturës së hetimit tatimor, gëzojnë atributet e policisë gjyqësore në përputhje me përcaktimet në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" dhe në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

105.3. Punonjësit e strukturës së hetimit tatimor pajisen me armë, në përputhje me ligjin e fushës "Për armët". Miratimi i lejes për mbajtjen e armës jepet nga Ministria e Brendshme, pas autorizimit të ministrit të Financave.

105.4 Strukturat e hetimit tatimor në përputhje me strukturën organizative të administratës tatimore qendrore dhe në zbatim të nenit 16 të ligjit dhe pikës 16 të këtij udhëzimi janë të organizuara në Drejtori të Hetimit Tatimor në nivel qendror pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe në nivel rajonal pranë Drejtorive Rajonale Tatimore.

Në nivel qendror, Drejtoria e Hetimit Tatimor është pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në nivel rajonal, Drejtoritë e Hetimit Tatimor janë përkatësisht tre të tilla:

- Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror që kryen funksionet e saj pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë;
- Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor që kryen funksionet e saj pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier;
- Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Verior që kryen funksionet e saj pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër;

Drejtoritë e hetimit tatimor në rajone mbulojnë pjesë të caktuara të territorit të vendit siç është përcaktuar në strukturën organizative dhe organigramën e administratës tatimore qendrore.

Ato ushtrojnë funksionet e tyre dhe kryejnë detyrat e përcaktuara sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, në përputhje me rregulloren e brendshme të administratës tatimore qendrore, si dhe me manualin e hetimit tatimor.

105.5 Drejtori i Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve drejton gjithë veprimtarinë e kësaj strukture në nivel qendror dhe në rajone. Ai emërohet nga Ministri i Financave dhe për kryerjen e funksioneve dhe detyrave të strukturave të hetimit tatimor, raporton periodikisht dhe sa herë që i kërkohet të ministri i Financave.

105.5.1 Drejtori i Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve drejton dhe

organizon punën për menaxhimin e strukturave të hetimit në nivel qendror dhe rajonal.

Ai harton dhe miraton të drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve kriteret specifike që duhet të plotësojnë punonjësit e strukturave të hetimit tatimor me qëllim kryerjen e procedurave të rekrutimit, emërimit, largimit dhe marrjen e masave disiplinore në përputhje me Kodin e Punës. Në zbatim të neneve 19 dhe 20 të ligjit për rekrutimin e punonjësve të hetimit tatimor në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin e Punës, i propozon drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve kandidatura të mundshme për tu përzgjedhur për t'u punësuar në struktura të caktuara të drejtorisë së hetimit tatimor në qendër dhe rajone, në përputhje dhe në zbatim të përshkrimit të punës për këto pozicione.

105.5.2 Për detyrat që lidhen me mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, hetimin e veprave penale dhe pastrimin e parave, menaxhimi i strukturave rajonale të hetimit tatimor, sikurse edhe sistemi i raportimit, organizohen në linjë vertikale përkatësisht nga drejtoritë e hetimit tatimor në rajone në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT dhe anasjellas.

105.5.3 Për kryerjen e funksioneve që lidhen me zbatimin e masave shtrënguese dhe kryerjen e verifikimeve dhe aplikimin e dënimeve për kundërvajtjet administrative, strukturat e hetimit në rajone bashkërendojnë punën me strukturat dhe funksionet e tjera operacionale rajonale. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton rregulloren e bashkërendimit të punës ndërmjet strukturave të zbatimit në rajone dhe strukturave të drejtorive rajonale tatimore.

105.5.4 Qarkullimi i informacionit të klasifikuar, i raporteve, të dhënave dhe dokumentacionit që ka lidhje me hetimin e veprave penale në fushën tatimore, bëhet duke zbatuar dispozitat e legjislacionit të fushës në fuqi. Drejtoria e hetimit tatimor në DPT dhe drejtoritë e hetimit tatimor në Rajone, krijojnë arkivin e të dhënave të klasifikuara, si dhe zbatojnë protokollin e veçantë me qëllim ruajtjen e sekretit hetimor. Drejtori i Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, merr masat për ngritjen e kartotekës dhe pajisjen me vulën përkatëse sipas përgjegjësisë ligjore.

105/1 Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsioni) është strukturë e specializuar zbulimi, hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore.

Objektivi strategjik i kësaj strukture është që të mbajë të pastër figurën e punonjësit të administratës tatimore qendrore si duke parandaluar fenomenet e korrupsionit në administratën tatimore, por edhe duke hetuar edhe zbuluar rastet e tilla të konstatuara.

105/1.1 Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) për realizimin e detyrave dhe funsioneve të saj ka si mision dhe objektiva sa më poshtë:

a) parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprimeve të punonjësve të administratës tatimore, të cilat përbëjnë vepër penale;

b) mbledhjen e informacionit nga burime të ndryshme në lidhje me veprimet, mosveprimet apo veprimtaritë e punonjësve të administratës tatimore qendrore, të cilat mund të përbëjnë vepër penale;

c) bashkërendimin e punës me prokurorinë për vazhdimin e hetimeve penale për punonjësit e administratës tatimore qendrore;

d) bashkëpunimin me institucionet e tjera shtetërore të ngarkuara me ligj për luftën ndaj korrupsionit dhe trajtimin e rasteve në bashkëpunim.

105/1.2 Punonjësit e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsioni) gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

105/1.3 Punonjësit e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsioni) pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin përkatës të fushës. Miratimi i lejes për mbajtjen e armës jepet nga Ministria e Brendshme, pas autorizimit të ministrit të Financave.

105/1.4 Struktura e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) është e organizuar vetëm në nivel qendror pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtori i Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsioni) drejton veprimtarinë e kësaj strukture dhe raporton direkt të drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

KREU X III
ANKIMIMI ADMINISTRATIV TATIMOR

106. Objekti i ankimit administrativ tatimor

106.1. Objekti ankimimit

106.1.1 Sipas nenit 106 të Ligjit të Procedurave Tatimore, tatimpaguesi mund të ankimojë kundër:

a) çdo akti administrativ të administratës tatimore,

b) i cili ka të bëjë me tatimpaguesin, dhe

c) ndikon në detyrimin e tij tatimor.

Këto tre kërkesa duhet të plotësohen detyrimisht të gjitha.

106.1.2 Për qëllime të këtij neni, akt administrativ konsiderohen të gjitha aktet të nxjerra nga organet e administratës tatimore që shkaktojnë efekte ligjore për çdo tatimpagues individualisht.

Shembuj të vendimeve administrative që mund të ankimohen lidhur me tatimpaguesin dhe detyrimin e tij tatimor përfshijnë:

a) çdo njoftim vlerësimi (për shembull një vlerësim tatimor i nxjerrë pas një kontrolli tatimor (neni 84(5) e Ligjit);

b) çdo akt tjetër administrativ që ndikon detyrimin tatimor të tatimpaguesit përfshirë kërkesën për kompensim (kur, për një tatim ose disa lloje tatimesh, tatimpaguesi ka një detyrim por gjithashtu gëzon edhe të drejtën e kreditimit ose rimbursimit,

c) çdo akt që ndikon kërkesën e tij për rimbursim,

ç) çdo akt që ndikon kërkesën e tij për lehtësim tatimor,

d) gabimet në llogaritjen e përqindjes së kamatëvonesës (neni 76 (4) e Ligjit),

dh) vendosjen ose gabimet në llogaritjen e shumave dhe llojeve të gjobave,

e) njoftimet për regjistrimin e tatimpaguesit në një përgjegjësi tatimore.

106.1.3 Aktet administrative që nuk kanë të bëjnë me tatimpaguesin ose që nuk ndikojnë detyrimin e tij tatimor, nuk mund të bëhen objekt ankimi. të tilla raste, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:

a) Aktet administrative për fillimin e kontrollit të një deklaratë tatimore,

b) Aktet administrative të refuzimit të kërkesës për kontroll të bërë nga tatimpaguesi.

c) Aktet administrative që lidhen me mbledhjen e detyrimeve.

ç) Aktet administrative të bllokimit të veprimtarisë së tatimpaguesit, sipas neneve 41 dhe 122 të ligjit.

d) Një detyrim tatimor apo një veprim/mosveprim i administratës tatimore, për të cilin Drejtoria e Apelimit Tatimor apo Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore ka vendosur më parë, nuk mund të bëhet sërish objekt ankimi administrativ, pavarësisht nëse pasqyrohet në një akt të ri administrativ.

106.1.4 Aktet e Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore që rezultojnë nga procedura e ankimit nuk mund të jenë objekt ankimi administrativ. Këto vendime mund të ankimohen vetëm në gjykatë.

106.1.5 Ankimi mund të bëhet vetëm nga tatimpaguesi (tatimpagues është personi ose individi që me ligj detyrohet të paguajë tatime, taksa ose kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore), nga përfaqsuesi i tatimpaguesit, si edhe agjenti tatimor.

106.1.6 Ankimi mund të bëhet edhe kundër një mosveprimi, d.m.th. një mosveprimi nga ana e administratës tatimore që ndikon në detyrimin tatimor të tatimpaguesit (p.sh. një akt që nuk është miratuar brenda periudhës së përcaktuar në ligj pavarësisht nëse tatimpaguesi ka bërë kërkesë në lidhje me të.

106.1.7 Nëqoftëse administrata tatimore ka nxjerrë disa vendime administrative lidhur me të njëjtin tatimpagues, për secilin prej tyre mund të bëhet ankim më vete. Tatimpaguesi mund të apelojë dy vendime apo akte në të njëjtin apelim kur ato plotësojnë kërkesat për apelim në

bazë të këtij Udhëzimi. Gjatë procedurës së ankimit, Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore ka të drejtë të grupojë së bashku disa ankime me kusht që kjo gjë të çojë në uljen e kostos dhe rritjen e efektivitetit të procedurës së ankimit.

106.1.8 Me përjashtim të ankimimit të ushtruar nga tatimpaguesi, në përputhje me parashikimin e nenit 92, kreu XI të ligjit, masat administrative të parashikuara sipas këtij kreu dhe në kapituj të tjerë të këtij ligji, që kanë të bëjnë me masat e mbledhjes me forcë, nuk janë objekt apelimi administrativ pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore. Të tilla raste, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:

a) Urdher-bllokimi i llogarive bankare dhe kërkesa për shlyerjen e detyrimeve tatimore të papaguara (neni 90)

b) njoftimi për një palë të tretë sipas nenit 97 të Ligjit(Transferimi i Detyrimit Tatimor Palës së Tretë), ose

c) njoftimi për një palë të tretë sipas nenit 98 të Ligjit (E Drejta për të Kërkuar Detyrimet nga Pala e Tretë), etj.

Në raste të tilla akti apo vendimi nuk mund të bëhet objekt ankimi administrativ sepse këto vendime kanë të bëjnë me mënyren me të mire të mbledhjes së detyrimeve tatimore siç parashikohet në Kreun XI (nenet nga 88 deri në 104).

106.1.9 Akti administrativ i konfiskimit i mbajtur sipas nenit 122 pika 4 të ligjit, që lejon konfiskimin e mallrave për prishjen e shenjave të bllokimit nuk është objekt i apelimit pranë strukturave të apelimit tatimor në Ministrisë e Financave. Në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative ankimohet në shkallë administrative në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

106.1.10 Akti administrativ për vendosjen e mases së sigurise sic parashikohet në nenin 92 ankimohet në Drejtorinë e Apelimit Tatimor ose Komisionin për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore. Ankimi bëhet vetëm në ato raste kur vendimi i ekzekutimit të masave të sigurisë nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt. Neni 92 parashikon fillimisht ankimin tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale dhe me pas, nëse tatimpaguesi nuk pranon vedimin e tij, lejon ankim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore sipas Kreut XIII të Ligjit. Kërkesa drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore mund të mos merret parasysh dhe të bëhet ankim drejtpërsëdrejti në Drejtorinë e Apelimit Tatimor ose Komisionin për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore vetëm nëqoftëse Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore nuk nxjerr aktin brenda 15 ditëve kalendarike nga dita e marrjes së kërkesës.

106.1.11 Tatimpaguesi ka të drejtë të bëjë vërejtje për mënyrën e punës së administratës tatimore dhe të punonjësve të saj. Këto vërejtje dëgjohen nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe nga zyrtarët e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në këto raste nuk mund të bëhet ankim administrativ.

106.2 Dorëzimi i ankimit administrativ tatimor

106.2.1 Ankimi bëhet në Drejtorinë e Apelimit Tatimor ose Komisionin për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore dhe mund të dorëzohet dorazi ose dërgohet me postë rekomande. Datë e marrjes së ankimimit nga Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore konsiderohet data e protokollimit në Ministrinë e Financave për ankimet e dorëzuara dorazi. për rastet e ankimimeve të derguara me poste rekomande, datë e dorëzimit të ankimit nga ana e tatimpaguesit konsiderohet data e dorëzimit në postë. Për ankimet e paraqitura nga data 1 janar 2017 deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, data e marrjes së ankimit nga Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni është data në të cilën Drejtoria e Apelimit Tatimor ka filluar ushtrimin e funksioneve pranë Ministrisë së Financave sipas legjislacionit në fuqi dhe ankimet janë marrë në dorëzim nga drejtori i Apelimit Tatimor.

106.2.2 Në qoftë së ankimi dorëzohet pranë një organi jokompetent (për shembull në zyrën tatimore rajonale ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve), afati i ankimit vlerësohet i respektuar nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent.

106.2.3 Ankimi bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ankimuesi. Gabime jo materiale,

ortografike, apo mungesa që nuk prekin vlefshmerine apo thelbin, të cilat nuk cënojnë mundësinë e trajtimit efikas të apelimit, nuk përbëjnë arsye për mos-marrjen në shqyrtim të apelimit. Kushti i paraqitjes së ankimimit me shkrim plotësohet nëse ankimi dërgohet me faks, por nuk plotësohet nëse ankimimi dërgohet me postë elektronike.

106.2.4 Ankimi me shkrim dhe dokumentacioni që i bashkangjitet duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e tatimpaguesit,

b) numrin e regjistrimit të tatimpaguesit (NIPT),

c) aktin administrativ, të nxjerrë ose të panxjerrë nga organi tatimor, që është objekt ankimi duke përfshirë periudhën tatimore përkatëse dhe shumën e detyrimit tatimor,

ç) vertetimin e pagesës së detyrimit tatimor që ankimohet ose garancinë bankare,

d) arsyet për ankimin e tij,

dh) informacion në mbështetje të ankimit (Aktin e kontrollit, procesverbalet, etj.)

e) çdo dokument tjetër që ankimuesi e gjykon të rëndësishëm,

ë) nënshkrimin e tij;

f) dokumentacionin që vërteton datën e marrjes së njoftim vlerësimit të ankimuar (kopje të zarfit postar nëpërmjet të cilit është dërguar akti administrativ i ankimuar apo konfirmim nga shërbimi postar, ose konfirmim nga drejtoria rajonale tatimore, kur ky akt është marrë dorazi pranë saj).

106.2.5 Nëqoftëse nuk plotësohet ndonjë prej kërkesave të përmendura në paragrafin me lart, Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore i kërkon tatimpaguesit ta ridërgojë ankimin e tij të plotësuar si duhet me informacionin e kërkuar brenda 15 ditëve kalendarike. Kjo Dispozite i jep ankimuesit mundësinë për t'i korrigjuar dhe kompletuar të gjitha mungesat formale (me përjashtim të pagesës). Periudha prej 60 ditësh për shqyrtimin nga autoritetet fillon vetëm nëqoftëse plotësohen si duhet të gjitha kërkesat (d.m.th. periudha do të zgjatet deri në më pak së një muaj kur ankimi nuk është plotësuar si duhet).

106.2.6 Nëse tatimpaguesi nuk përmbush kërkesat dhe procedurat sipas pikës 106.2.5 më lart, Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore ka të drejtë të refuzojë ankimin.

106.3 Afati i ankimit tatimor

106.3.1 Ankimi duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur akti administrativ është marrë ose konsiderohet të jetë marrë; afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës nëqoftëse dita e fundit e afatit bie në ditë pushimi apo feste zyrtare. Administrata tatimore gjykon që tatimpaguesi e merr njoftimin që i dërgohet tatimpaguesit brenda dhjetë ditëve kalendarike pas ditës së dërgimit. Data e dërgimit konsiderohet data e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar (neni 23 paragrafi (3) i Ligjit).

Nëse edhe pas procedurave të përcaktuara në pikën 106.2.5 të udhëzimit, tatimpaguesi nuk provon datën e marrjes së aktit të ankimuar, afati i ankimit fillon nga e nesërmja e nxjerrjes së aktit ose pranimit të tij nga shërbimi postar.

Nëse tatimpaguesi nuk e ka marrë njoftim vlerësimin për shkak të një gabimi në njoftim nga administrata tatimore, afati 30 ditor i ankimit fillon në ditën kur marrësi provon nëpërmjet dokumentacionit përkatës së ka marrë dijeni për njoftimin.

106.3.2 Nëqoftëse, në kundërshtim me ligjin, në aktin administrativ mungon njoftimi që informon tatimpaguesin për të drejtën e tij për të ankimuar aktin administrativ, përfshir afatin dhe hallkën e apelimit, tatimpaguesi mund të ankimojë brenda tre muajve nga data kur akti administrativ është marrë, ose konsiderohet të jetë marrë.

106.3.3 Në rast mosveprimi të administratës tatimore (refuzimi për të nxjerrë një akt), procedura e ankimit fillon tre muaj pas ditës së dorëzimit të kërkesës fillestare për nxjerrjen e aktit administrativ. Ankimi duhet të paraqitet jo më parë së 7 ditë dhe jo më vonë së 45 ditë nga data e përfundimit të afatit tremujor, i cili konsiderohet si afat për përfundimin e procedurës administrative.

106.3.4 Nëqoftëse ankimi pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore nuk bëhet brenda afatit të caktuar, ai konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet, përveç kur afati zgjatet në përputhje me nenin 109 (paragrafi 4) të Ligjit për Procedurat Tatimore. Rivendosja në afat së cilës i referohet neni 109 i Ligjit përcaktohet në nenet 54 dhe 55 të Kodit të Procedurave Administrative.

Kërkesa për rivendosje në afat të ankimit duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga marrja e njoftim vlerësimit, duke paraqitur njëkohësisht ankimin dhe duke paguar apo vendosur garancinë bankare për detyrimin e përcaktuar në njoftim vlerësimin e ankimuar. Kërkesa për rivendosje në afat duhet të përmbajë shkaqet e arsyeshme dhe dokumentacionin vërtetues për mosparaqitjen e ankimit brenda afatit të ankimit. Shkaqe të arsyeshme konsiderohen rrethanat e parashikuara në pikën 111.4.2 të udhëzimit. Nëse adresa në të cilën administrata tatimore ka dërguar aktin e ankimuar përputhet me adresën e deklaruar nga tatimpaguesi dhe nuk vërtetohet një nga shkaqet e arsyeshme të mësipërme, mosmarrja e njoftimit brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 23 të ligjit, është në përgjegjësinë e vetë tatimpaguesit.

106.4 Dorëzimi i dokumentacionit të ankimimit

106.4.1 Tatimpaguesi dorëzon ankimin pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose komisionit, e cila duhet ta regjistrojë kërkesën ankimore me të dhënat përkatëse në sistemin tatimor.

106.4.2. Shfuqizuar.

107. Pagesa e tatimit objekt ankimi administrativ tatimor

107.1 Kur një detyrim tatimor është objekt ankimi, ankimi pranohet vetëm në qoftë së ankimuesi, në përputhje me nenin 107 (1) të ligjit:

a) paguan shumën e plotë të detyrimit tatimor, objekt ankimi, të përcaktuar në aktin administrativ që ankimohet ose vendos garanci bankare për këtë shumë me afat minimalisht 6 muaj, me qëllim shqyrtimin administrativ, por jo me pak së afati në të cilin vendimi merr formë të prerë, gjatë shqyrtimit gjyqësor;

b) vërteton pagesën ose garancinë, duke paraqitur një kopje të dokumentit të pagesës së detyrimit tatimor objekt ankimi ose të garancisë bankare. Si vërtetimi i pagesës, dhe ai i garancisë, janë kërkesa të detyrueshme. Një kopje e garancisë bankare dorëzohet nga tatimpaguesi pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore që ka nxjerrë aktin administrativ të ankimuar.

107.2.1 Shuma e pagueshme ose shuma e vënë si garanci bankare, në përputhje me pikën 1 të nenit 107 të ligjit, përjashton gjobat dhe kamatëvonesat e llogaritura, të përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

107.2.2 Tatimpaguesi pajiset nga Drejtoria Rajonale tatimore me urdhër pagese ku pasqyrohen saktësisht tatimi i pagueshëm, pas kompensimeve automatike të kryera nga sistemi informatik. Kur tatimpaguesi është në procedure apelimi nuk lejohet përfundimi i një marrëveshje për pagesën me këste të detyrimit që apelohet.

Nëse detyrimi në njoftimin e vlerësimit nuk përputhet me vlerësimin e regjistruar në sistemin informatik, tatimpaguesi duhet të paguajë apo vendosë garanci bankare për detyrimin tatimor sipas njoftim vlerësimit.

107.3.1 Në qoftë së tatimpaguesi nuk paguan shumën e caktuar para skadimit të afatit të ankimit, ose nuk vendos garancinë bankare, ankimi konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet. Pra, nëse tatimpaguesi ka paraqitur ankimin, dhe pas këtij momenti, por para skadimit të afatit të apelimit, ka paguar tatimin ose ka vendosur garancinë bankare, Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT) ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore duhet ta shqyrtojë ankimin. Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore nuk është e detyruar që para refuzimit të apelimit, ta informojë tatimpaguesin që ankimi i tij është i papranueshëm.

107.3.2. Në qoftë së tatimpaguesi bën ankim kundër një detyrimi tatimor dhe në të njëjtën kohë ka paraqitur një kërkesë për kompensim detyrimi (nëpërmjet së cilës ka argumentuar kompensimin e detyrimit tatimor që ankimohet me tatime të paguara tepër apo tepricë kreditore

nga periudha të mëparshme), në zbatim të neneve 75 dhe 107 të ligjit, Drejtoria Rajonale Tatimore është e detyruar që brenda një periudhe jo më shumë së 15 ditë kalendarike, t'i konfirmojë me shkrim tatimpaguesit për kompensimin e detyrimit objekt apelimi ose për moskryerjen e kompensimit.

107.4 Tatimpaguesi nuk mund të apelojë në gjykatë një akt administrativ që eshtë bjekt objekt ankimimi në Drejtorinë e Apelimit Tatimor ose Komisionin për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore, pa patur një vendim të kësaj drejtorie ose komisioni lidhur me këtë akt administrativ.

108. Veprimet e ndërmarra nga drejtoria e apelimit tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore lidhur me ankimin

108.1 Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore shqyrton dhe merr vendime të pavarura për ankimet e paraqitura nga tatimpaguesit. Ajo i bazon vendimet e saj në provat dhe argumentet e paraqitura nga tatimpaguesi dhe administrata tatimore.

108.2.1 Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore mund të kërkojë informacion shtesë, p.sh. dokumente të tjera nga tatimpaguesi, nga administrata tatimore dhe nga palë të treta, si dhe mund të kërkojë ose të bëjë verifikime që ndihmojne në shqyrtimin dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes. Në të tilla raste, afati i shqyrtimit të ankimit zgjatet 30 ditë.

108.2.2 Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore mund të marrë masa të tjera për qartësimin e fakteve, p.sh. ata mund të takohen me ankimuesin për qartësimin e fakteve.

108.3.1 Gjatë shqyrtimit të ankimit Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore nuk ka të njëjtat të drejta me ato të organit që ka bërë vlerësimin fillestar të detyrimit tatimor. Drejtoria ose komisioni e kufizon shqyrtimin vetëm në çeshtjet e ngritura gjatë ankimit. Nëqoftëse gjatë procedurës zbulohen fakte të reja që provojnë së detyrimi tatimor i përcaktuar nuk është i mjaftueshëm, Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore nuk mund ta rrisë vetë detyrimin tatimor. Kjo drejtori ose komision i dërgon shkresë organit administrativ që ka nxjerrë vendimin objekt ankimi me të cilën vë organin në dijeni për rrethanat e reja.

108.3.2 Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore ka të drejtë të gjykoje gjoba që nuk lidhen me detyrime tatimore në të njëjtat rrethana që gjykon për detyrimin tatimor të lidhur me të ose shkeljen tatimore të lidhur me te. Ky gjykim bazohet në analizimin e plotë të arësyeve që kanë shkaktuar dhe rrethanave në të cilat është kryer shkelja, duke evidentuar faktet dhe argumentat mbi bazën e të cilave bëhet gjykimi dhe merret vendimi.

Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore ka të drejtë të anullojë gjoba, plotësisht apo pjesërisht, pavarësisht nga vlefshmëria e detyrimit tatimor, në rastet e parashikuara në përputhje me nenin 111 të Ligjit.

Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore heq detyrimet apo gjobat që lidhen me gabime në llogaritje apo gabime të administratës tatimore apo të sistemit kompiuterik tatimor, dhe një gjë e tillë provohet nga Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore, nga tatimpaguesi ose nga Drejtoria Rajonale e Juridiksionit.

108.3.3 Vendimi i Drejtorisë së Apelimit Tatimor duhet të nënshkruhet dhe vuloset nga drejtori i Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose nëpunësi zëvendësues në përputhje me ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e funksionimit të Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore". Nënshkrimi nga të gjithë anëtarët bëhet në ekzemplarin e vendimit që mbahet në sekretari-arkiv, ndërsa vendimet që i dërgohen palëve pjesëmarrëse në procedurë nënshkruhen vetëm nga kryetari i KSHAT-it.

Në rastet e çështjeve analoge mund të përdoren arsyetimet e bëra në çështjet e mëparshme.

108.3.3 Pas shqyrtimit të çeshtjes, Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore vendos ta:

a) refuzojë ankimin për shkak së e konsideron ankimin të papranueshëm;

b) rrëzojë ankimin;

c) anullojë aktin administrativ objekt ankimi duke pranuar ankimin ose

ç) pranojë ankimin (pjesërisht ose plotësisht) dhe ta ndryshojë aktin administrativ objekt ankimi.

108.3.4 Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore e rrëzon një ankim nëqoftëse gjykon që ankimi është i pabazuar pasi procedura është ndjekur sipas rregullit dhe akti administrativ ka qenë i drejtë dhe ligjërisht korrekt, ndërsa ankimi është i pabazuar.

Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore e rrëzon një ankim edhe nëqoftëse zbulon që ka pasur mosveprime (ose gabime të administratës tatimore), por që ato kanë qënë aq të parëndësishme sa që nuk mund ta kenë ndikuar vendimin e administratës tatimore.

Nëqoftëse Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore zbulon që akti administrativ është bazuar në ligj por për arsye të tjera nga ato të shprehura në akt, ajo duhet të shpjegojë këto arsye në vendim dhe të rrëzojë ankimin.

108.3.5 Ankimuesi mund të heqë dorë nga ankimi para nxjerrjes së vendimit të ankimit.Nëqoftëse tatimpaguesi heq dorë nga ankimi, procedura e ankimit ndërpritet me një vendim për mbylljen e procedurës së ankimit.Heqja dorë nga një ankim nuk i heq të drejtën tatimpaguesit për të ankimuar përsëri me kusht që ankimi të bëhet brenda afatit të caktuar.

108.3.6 Nëqoftëse Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore konstaton që faktet në procedurë janë përcaktuar me mungesa dhe gabime, që procedura nuk ka mbajtur parasysh rregullat procedurale që mund të kenë ndikuar aktin administrativ, ose që përmbajtja e aktit administrativ të kundërshtuar është e paqartë ose bie ndesh me shpjegimet e tij, Drejtoria ose komisioni plotëson procedurën dhe eliminon mungesat vetë ose mund t'ia kërkojë këtë gjë administratës tatimore. Administrata tatimore duhet ta pranojë dhe zbatojë këtë vendim.

108.3.7 Nëqoftëse Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore konstaton që, duke marrë parasysh faktet e vërtetuara gjatë procedurës, vendimi i administratës tatimore duhet ndryshuar, Drejtoria ose komisioni e anullon aktin administrativ dhe vendos vetë për çeshtjen ose i kërkon administratës tatimore ta zgjidhë atë. Administrata tatimore duhet ta pranojë dhe zbatojë këtë vendim.

108.3.8 Nëqoftëse, gjatë procedurës, Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore konstaton që organi i administratës tatimore i ka vlerësuar provat gabimisht, ka nxjerrë konkluzion të gabuar nga faktet e parashtruar, që ligji në bazë të të cilit është marrë vendimi është zbatuar gabimisht, ose nëqoftëse ajo është e mendimit që duhej marrë një vendim i ndryshëm nga ai i marrë, Drejtoria ose komisioni e anullon aktin e administratës tatimore dhe vendos vetë për çeshtjen ose i kërkon administratës tatimore ta zgjidhë atë. Administrata tatimore duhet ta pranojë dhe zbatojë këtë vendim.

108.3.9 Nëqoftëse gjatë procedurës zbulohen fakte të reja që provojnë së detyrimi tatimor i përcaktuar nuk është i mjaftueshëm, Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore nuk mund ta rrisë vetë detyrimin tatimor. Përkundrazi, ajo i dërgon shkresë organit administrativ që ka nxjerrë vendimin objekt ankimi me të cilën e vë organin në dijeni për rrethanat e reja.

108.4. Ankimuesi ka të drejtë nëse e kërkon, të paraqitet vetë ose me përfaqësues në Drejtorinë e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore për të dhënë argumente dhe sqarime që ndihmojnë në trajtimin dhe zgjidhjen e drejtë të akimimit.

108.5. Në procedurën e ankimit, barra e provës për të provuar, vërtetuar së një vlerësim tatimor ose vendim është i pasaktë ushtrohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

108.6 Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore duhet të arësyetojë, argumentojë dhe të krijojë evidencë të plotë, në përputhje edhe me nenin 100 të Kodit të Procedurave Administrative, për arritjen e një vendimi të drejtë dhe të mbështetur në dispozitat ligjore dhe nënligjore përkatëse.

109. Vendimi për ankimin administrativ dhe e drejta e ankimit

109.1. Vendimi përmban një dispozitë që vë në dijeni tatimpaguesin dhe administratën tatimore për të drejtën e tij për ankimin e vendimit në gjykatë dhe i dërgohet tatimpaguesit dhe organit të administratës tatimore që ka bërë vlerësimin ose ka nxjerrë vendimin objekt ankimi. Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore merr masat për publikimin e qëndrimeve të mbajtura në vendimet e marra prej saj.

109.2 Tatimpaguesi mund të bëjë ankim gjyqësor por jo ankim administrativ kundër një akti administrativ të ndryshuar të Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore sipas paragrafit 108.3.3 d) dhe vendimeve të tjera. Vendimet e Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore mund të ankimohen vetëm në gjykatë.

109.3 Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore vendos për ankimin brenda 60 ditëve nga dita e marrjes së ankimit të plotësuar si duhet. Nëqoftëse dita e fundit e këtij afati bie në ditë pushimi apo feste zyrtare, afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës. Nëqoftëse ankimi nuk përmbush formalitetet e përcaktuara në nenin 6, afati 60-ditor fillon një ditë pas plotësimit të kërkesave formale nga ankimuesi por jo më vonë së 30 ditë kalendarike pas marrjes së ankimit. Pra, në asnjë rast koha e shqyrtimit të ankimit nga Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore nuk mund të kalojë 90 ditë duke filluar nga data e marrjes së ankimit.

109.4 Nëqoftëse Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore nuk nxjerr vendim brenda 60 ditësh nga marrja e ankimit të plotësuar si duhet, tatimpaguesi mund të fillojë një ankim gjyqësor edhe në mungesë të vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore.

109.5 Nëqoftëse vendimi i ankimit varet plotësisht ose pjesërisht nga një çeshtje e mëparshme që është subjekt i procedurave gjyqësore ose është nën juridiksionin e një organi tjetër publik, Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore mund të nxjerrë një vendim të përkohshëm për pezullimin e procedurës deri në zgjidhjen e çeshtjes së mëparshme, por jo shumë së 6 muaj nga momenti i nisjes së pezullimit. Nëse me mbarimin e këtij afati çështja e mëparshme nuk është zgjidhur, pezullimi ndërpritet dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor vijon me shqyrtimin e ankimit. Në rastet e pezullimit të procedurës, nëse pas nëntë muajsh nga momenti i dorëzimit të kërkesës fillestare, Drejtoria e Apelimit Tatimor apo Komisioni nuk kanë nxjerrë vendimin, ankimuesi mund të ankimojë drejtpërsëdrejti në gjykatë.

109.6 Gjithashtu, në rastin e pezullimit të një procedure sipas paragrafit109.2.4, vendimi përfundimtar i Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore duhet të nxirret brenda gjashtë muajsh nga data e marrjes së ankimit të plotësuar si duhet. Përndryshe ankimuesi mund të ankimojë drejtpërsëdrejti në gjykatë.

109.7 Tatimpaguesi ka të drejtë të bëjë ankimim në rrugë gjyqësore kundër vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi. Megjithatë, nëqoftëse tatimpaguesi nuk është njoftuar korrektësisht ose nuk është njoftuar fare për të drejtën e tij për të ankimuar vendimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore, ankimi në gjykatë duhet të bëhet brenda tre muajsh nga data kur vendimi është marrë, ose konsiderohet të jetë marrë.

109.8 Mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore në mungesë të një vendimi të Drejtorisë

së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore vetëm në qoftë se:

a) Vendimi administrativ nuk mund të jetë objekt ankimi sipas nenit 106 të Ligjit, ose

b) Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore nuk nxjerr vendim brenda 60 ditësh pas marrjes së ankimit të plotësuar si duhet, ose në rast pezullimi, nuk nxjerr vendim brenda gjashtë muajsh pas marrjes së ankimit të plotësuar si duhet. Nëqoftëse ankimi administrativ nuk plotëson kërkesat formale sipas pikës 106.2.4 me lart, afati 60-ditor fillon një ditë pasi ankimuesi të ketë plotësuar si duhet këto kërkesa formale, por jo më vonë së 30 ditë kalendarike pas marrjes së ankimit.

109.9 Ankimi në rrugë gjyqësore nga ankimuesi pranohet vetëm nëqoftëse ankimuesi ka qenë pjesërisht ose plotësisht i pasuksesshëm në ankimin e tij administrativ sipas vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore. Për një akt administrativ objekt ankimi nuk mund të kapërcehet faza e ankimit administrativ dhe të bëhet ankim drejtpërsëdrejti në gjykatë (neni 107 (4) i Ligjit).

109.10 Shfuqizohet.

110. Rimbursimi i detyrimit tatimor, pagesa e kamatvonesës dhe gjobës

110.1. Nëse vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore është në favor të tatimpaguesit, detyrimi tatimor, i paguar më tepër nga tatimpaguesi dhe kamatëvonesa për tatimet e paguara më tepër, të llogaritura nga data e pagesës së detyrimit tatimor deri në datën e rimbursimit, i rimbursohen tatimpaguesit brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi i strukturës përkatëse të apelimit tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore.

Nëse tatimpaguesi ka paraqitur garanci për pagesën e detyrimit, kjo çlirohet tërësisht apo pjesërisht sipas vendimit të Drejtorisë së Apelimit ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë apo vlerësohet të jetë marrë vendimi.

110.2. Nëse drejtoria e apelimit tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore lë në fuqi vendimin e administratës tatimore dhe tatimpaguesi e pranon vendimin, çdo detyrim tatimor, që përfshin tatimin në rastin kur nuk është paguar, por është vendosur garanci, kamatëvonesën, dhe çdo gjobë e llogaritur paguhen nga tatimpaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vendimi për ankimin administrativ është marrë ose vlerësohet të jetë marrë.

110.3. Njësitë e administratës tatimore, të përfshira në shqyrtimin administrativ të aktit, nuk mund të ankohen në gjykatë kundër vendimit të drejtorisë së apelimit tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore, sipas afateve të parashikuara në nenin 107, të këtij ligji.

KREU XIV
SANKSIONET

111. Denimet administrative

111.1 Çdo veprim ose mosveprim i tatimpaguesit, agjentit tatimor apo përfaqësuesit të tatimpaguesit, që bie në kundërshtim me ligjin, dhe që nuk është veper penale, përbën shkelje tatimore administrative dhe denohet administrativisht.

Për shkeljet që konstatohen, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", do të zbatohen nivelet e dënimeve administrative që parashikon ky ligj, pamvarësisht nga koha kur ka ndodhur shkelja.

111.1.1 në rastet kur shkeljet e konstatuara janë pasoje e njera tjetres, të rrjedhura nga një shkelje baze, për një lloj tatimi, vendoset një denim i vetëm që është dënimi me gjobën më të lartë i njërës nga shkerljet e mësipërme. P.sh., nëse një tatimpagues nuk ka lëshuar faturë tatimore ai do të dënohet sipas nenit 116 të Ligjit. Në të njëjtën kohë ky tatimpagues ka shkelje që lidhen ose janë pasojë e moslëshimit të kësaj fature, si mosregjistrimi i faturës në librin e

shitjeve, mosdeklarimi dhe mos-pagesa e tvsh-së që i takon kësaj fature, etj. Në këtë rast do të aplikohet denimi sipas nenit 116 të Ligjit, i cili përmban dënimin më të lartë krahasuar me rastet kur shkeljet e tjera do kishin ndodhur të veçuara. Ose, psh, nëse një tatimpagues nuk instalon pajisjen fiskale atehere ai nuk lëshon as kupon tatimor. Mosleshimi i kuponit është pasoje e mosinstalimit të pajisjes fiskale, kështu që në këtë rast mund të vendoset një gjobe e vetme.

111.1.2 në rastet kur gjoba nuk është fikse por me diapazon (me kufi minimal dhe maksimal), madhesia e gjobes brenda diapazonit të përcaktuar nga ligji vendoset duke përdorur gjykimin më të mirë bazuar në:

a) Rëndësinë e shkeljes

b) Arësyet e shkeljes

c) Historia e rregullshmerisë në plotësimin e detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit

d) Rrethanat konkrete të tatimpaguesit në kohen e shkeljes;

e) Madhesia e biznesit dhe vendndodhja

f) A është e përsitur shkelja dhe a ka qenë i informuar tatimpaguesi

g) Pasojat lidhur me tatimin e papaguar

111.2 Shkeljet e ligjit, që parashikohen për lëvizjen e mallrave, nëpërmjet kufirit doganor të Republikës së Shqipërisë, dënohen në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi. Në këtë rast organet doganore janë përgjegjëse për konstatimin e shkeljes dhe aplikimin e denimeve administrative.

111.3 Shkeljet e ligjit, që parashikohen për mallrat e akcizës, zbatohen në përputhje me ligjin në fuqi për akcizat. Çdo shkelje tatimore, e karakterizuar si e tille nga ligji për akcizat, denohet sipas percaktimeve të bëra në këtë ligj. Nga ana tjetër, çdo shkelje tjetër, që nuk permendet në ligjin për akcizat por karakterizohet si shkelje në bazë të ligjit për procedurat tatimore, denohet sipas percaktimeve të bëra në këtë të fundit.

111.4.1 Gjobat e vendosura për shkeljet tatimore administrative të parashikuara në Kreun XIV të ligjit për procedurat tatimore, mund të hiqen tërësisht ose pjesërisht në rrethanat e paragrafit 4 të nenit 111 të Ligjit dhe në piken 108.3.2 të këtij Udhëzimi, me përjashtim të gjobave të parashikuara në nenet 116 dhe 121 të Ligjit.

111.4.2 për rastet e vdekjes ose semundjes, mund të hiqet penaliteti për subjektet e meposhtme në rastet e meposhtme:

a) Individët - nëse ka ndodhur një vdekje ose semundje serioze e tatimpaguesit ose rrethane tjetër e pashmangeshme mungese e tatimpaguesit për shkak të vdekjes ose semundjes serioze të pjestareve të afert të familjes të tatimpaguesit si bashkeshorti, motra, vellai, prindi, gjysh/e, femijë që ka penguar deklarimin e tatimit ose pagesën e tij.

b) për tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari ekonomike - nëse ka ndodhur një vdekje ose semundje serioze ose rrethane tjetër e pashmangeshme mungese e tatimpaguesit ose e pjestareve të afert të familjes si bashkeshorti, motra, vellai, prindi, gjysh/e, femijë, që ka penguar deklarimin e tatimit ose pagesën e tij kur ky tatimpagues ka autoritet të vetëm perkundrejt plotesimit, deklarimit dhe pagesave të deklaratave tatimore. Me fjale të tjera justifikohet heqja e sanksionit në rastet kur incidenti i ka ndodhur personit përgjegjës për deklarimin dhe pagesën.

Nëse dikush tjetër pervec tatimpaguesit është përgjegjës për të permbushur detyrimet tatimore duhet të konsiderohen arsyet pse tatimpaguesi nuk i permbushi detyrimet kur të shqyrtohet rasti.

Informacioni që duhet të shikohet në këtë rast do të jetë:

- Lidhjet e tatimpaguesit ose personave të tjerë pergjegjës të përfshirë
- Data e vdekjes
- Data, kohezgjatja dhe serioziteti i semundjes
- Data dhe arsyet e mungeses

111.4.2 Gjobat mund të hiqen edhe në rastin kur tatimpaguesi ka marre një udhëzim me shkrim nga organet tatimore lidhur me ceshtjet e tatimeve dhe ka vepruar në përputhje me te.

Ne shqyrtimin e ketyre rasteve administrata tatimore merr në konsiderate, faktoret e

meposhtem:

- Faktin nëse Këshilla që kishte marre tatimpaguesi ishte në përgjigje të kërkeses specifike që ai kishte bërë dhe ishe e lidhur me faktet që paraqiste kërkesa;

- Faktin nëse tatimpaguesi kishte vepruar apo jo në bazë të Këshilles në fjale;

Çdo faktor tjetër që ndihmon administratën tatimore në marrjen e një vendimi të bazuar.

111.5 Gjobat e vendosura për shkelje administrative, që lidhen me një detyrim tatimor, nuk mund të kalojnë 100 për qind të detyrimit tatimor.

112. Mungesa e ekzekutimit të detyrimit për regjistrim

112.1.1 Në rastin kur administrata tatimore identifikon persona të paregjistruar që ushtrojnë veprimtari tregtare, aplikon dënimin e parashikuar në nenin 112 të ligjit përkatësisht prej 10 000 lekë dhe 15 000 lekë sipas kategorive vetëm në rastin kur nga strukturat e administratës tatimore provohet dhe dokumentohet së për arsye të rrethanave ose për shkak të natyrës së veprimtarisë është në kushtet e pamundësisë për të ekzekutuar masat e parashikuara në nenin 41 të ligjit.

112.1.2 Kur organet tatimore konstatojne së Organizatat Jofitimprurëse nuk regjistrohen në organet tatimore sipas nenit 42(1), i denon ato me gjobe 10 000 lekë.

112.1.3 Kur organet tatimore konstatojne së tatimpaguesit nuk respektojne kërkesat e nenit 43(2) lidhur me përditësimin e të dhënave i denon ata me gjobe 10 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe 15 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin.

112.1.4 Kur organet tatimore konstatojne së organizatat jofitimprurëse nuk respektojne kërkesat e nenit 43(3) lidhur me përditësimin e të dhënave i denon ato me 10 000 lekë gjobe.

113. Mosdeklarimi në afat

113.1 Tatimpaguesi, i cili nuk dorëzon në afatet e përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore, deklaratën tatimore, dënohet me 10 (dhjetë) mijë lekë gjobë nëse është tatimpagues i tatimit mbi fitimin dhe me 5 (pesë) mijë lekë gjobë për çdo tatimpagues tjetër, për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar në afat. Kjo gjobë vendoset vetëm një herë për çdo deklaratë tatimore, pavarësisht nga zgjatja e vonesës, dhe ajo nuk ndikon në gjobën për pagesë të vonuar e cila llogaritet në bazë të nenit 114 të ligjit.

Dënimi sipas kësaj pike aplikohet edhe për dorëzimin me vonesë, jo në përputhje me afatet e përcaktuara në ligjin "Për mbledhjen e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" dhe në ligjin "Për procedurat tatimore të deklaratës "Për deklarimin e të punësuarave rishtas dhe të të larguarave nga puna".

113.2 Shfuqizuar.

114. Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore

114.1.1 Tatimpaguesi, i cili nuk paguan brenda afatit të parashikuar në ligj shumën e detyrimit tatimor, ose të kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 0.06 % të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë së 365 ditë kalendarike.

Shembull: Shfuqizuar.

114.1.2 Nëse tatimpaguesi ben një mareveshje për pagimin me keste të detyrimit sipas nenit 77(3) të ligjit për procedurat tatimore gjoba për mospagimin në afat të detyrimit tatimor nuk vendoset deri në afatin që përcakton neni 77(4). Shumë e papaguar e detyrimit tatimor është gjithashtu diferenca ndërmjet shumës së saktë të rimbursueshme dhe shumës së rimbursimit të marrë në datën e caktuar.

Shembull: Shfuqizuar.

114.2 Në zbatim të nenit 114 të ligjit, për efekt të llogaritjes së penaliteteve përkatëse, konsiderohen detyrime tatimore apo kontribute të sigurimeve të papaguara në afat, diferenca ndërmjet detyrimit tatimor apo detyrimit për kontributet e sigurimeve që duhet paguar dhe

shumës së paguar të tyre. Në rastet, kur situata tatimore e tatimpaguesit është e tillë që, detyrimi që duhet paguar rezulton një shumë negative (kredi tatimore), shumë e papaguar e detyrimit tatimor, konsiderohet edhe ulja e tepricës kreditore të tatimpaguesit, në rastin e një rivlerësimi tatimor. Si e tillë, edhe kjo shumë e papaguar e detyrimit penalizohet në përputhje me përcaktimet e nenit 114 të ligjit.

114.3 Shfuqizohet.

114.4 Gjobat nuk aplikohen për rastet e institucioneve buxhetore, të cilat vonesat në pagimin e detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore i kanë bërë për shkak të vonesave në çeljen e fondeve buxhetore. Kjo kategori tatimpaguesish, në momentin e dërgimit të deklaratave tatimore përkatëse, të cilat duhet të paraqiten brenda afateve ligjore të parashikuara, në të njëjtën kohë duhet të paraqesë pranë drejtorisë rajonale tatimore një kërkesë me shkrim, në të cilën të argumentohet arsyeja së mospagimi në afat është i lidhur me çeljen e fondeve buxhetore. Bashkëlidhur kësaj kërkese, duhet të paraqitet një vërtetim nga dega e thesarit që konfirmon mosçeljen e fondeve në afat.

114/1. Mospagimi i kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin

"Tatimpaguesi i cili nuk paguan në afat kështet paraprake të tatimit mbi fitimin ose kështet paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, detyrim ky i përcaktuar sipas nenit 30, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, dhe nenit 15, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, dënohet me gjobë, në masën 10 për qind të shumës së kështit për t'u paguar." Për aplikimin e dënimit duhet të mbahet parasysh së kështet e tatimit mbi fitimin janë mujore ose tremujore, kështu që dënimi llogaritet kur përfundon afati tremujor i pagesës së kështit për detyrimin e kështit ose pjesën e detyrimit të kështit të papaguar. Për shembull, për kështin e tremujorit të fundit të vitit 2016 për sa ndryshimi ligjor ka hyrë në fuqi me datën 1 dhjetor, pra moment në të cilin nuk ka përfunduar afati i pagesës së kështit atëherë dënimi do të aplikohet 10 % për vlerën e kështit 3-mujor, pasi tatimpaguesit i lind e drejta të paguajë kështin tremujor në fund të muajit dhjetor.

115. Plotesimi i pasaktë i deklarates tatimore dhe kërkesa e pasakte për rimbursim

115.1 Nëse tatimpaguesi dorëzon një deklaratë tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë së 365 ditë kalendarike.

115.2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar.

115.1.2. Një deklaratë tatimore, përfshirë deklarimin e tepricës kreditore, quhet e pasaktë kur nuk është e plotësuar me të dhënat reale financiare të subjektit. Deklarata tatimore do të quhet e saktë kur detyrimi tatimor ose teprica kreditore është llogaritur në mënyrë korrekte dhe për të cilën nuk është bërë asnjë gabim aritmetik ose logjik. Nëse pasaktësia është bërë me dashje, gjë që mund të arsyetohet dhe provohet bazuar në dokumentacionin, faktet dhe rrethanat konkrete, konsiderohet evazion.

115.1.3 Deklarim i pasaktë konsiderohet edhe rasti kur, si rezultat i një kontrolli tatimor, bëhet rivlerësim në ulje i tepricës kreditore të tatimpaguesit. Në këtë rast tatimpaguesi penalizohet me gjobë 20% të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar me tepricën kreditore që duhej deklaruar.

115.1.3 në rastet kur, sipas nenit 67 të ligjit për procedurat tatimore, tatimpaguesi dorezon një deklaratë të re me ndryshime në vend të një deklaratë të pasakte, neni 115 i ligjit nuk zbatohet.

P.sh. Në muajin Dhjetor tatimpaguesi konstaton së ka harruar të regjistrojë në Librin e Shitjeve të TVSH dhe të deklarojë në FDP-ne e muajit Shtator, një faturë me vlerë të tatueshme 10.000 lekë dhe tvsh të llogaritur 2.000 lekë. Në këtë rast tatimpaguesi do të dorëzojë një deklaratë të re për periudhën tatimore Shtator, ku të ketë reflektuar gabimin e sipërpërmendur. Në të njetin moment tatimpaguesi paguan diferencën e papaguar, pra 2.000 lekë tvsh, si dhe

kamatëvonesë për këtë shumë.

115.1.4 Dënimet për mosnjoftimin e ndryshimeve në lidhje me ndryshimin e pronësisë. Nëse një person juridik nuk njofton administratën tatimore lidhur me ndryshimet e pronësisë, sipas kërkesave të nenit 27/1, "Ndryshimi i pronësisë", të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, ai është përgjegjës dhe dënohet, si më poshtë vijon:

a) Për shkeljen në rastin e pikës 3, të nenit të sipërpërmendur, 15 (pesëmbëdhjetë) për qind të vlerës së tregut të aktiveve të trajtuara si me ndryshim pronësie;

b) Për shkeljen në rastin e pikës 4, të nenit të sipërpërmendur, 5 (pesë) për qind të vlerës së tregut të aksioneve ose interesave të ngjashme që u ka ndryshuar pronësia.

Dënimi, sipas shkronjës "b" më sipër, nuk zbatohet kur vërtetohet që personi nuk ishte në dijeni të ndryshimit të pronësisë apo nuk ka të dhëna, prova apo fakte që të besohet së personi duhet të ishte në dijeni.

116. Evazioni tatimor

116.1 Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë në përllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt. Në kuptim të këtij neni, termi "evazion tatimor" përfshin fshehjen apo shmangien me dashje të detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave (p.sh., shitjeve ose të ardhurave të realizuara), falsifikimin e dokumentacionit kontabël dhe tatimor, marrjen e dokumenteve të falsifikuara për të rritur fiktivisht shpenzimet e biznesit ose të TVSH-së së zbritshme duke çuar në përllogaritjen e pasakte të shumës së tatimit ose taksës. Klasifikimi i një shkeljeje si evazion tatimor duhet të jetë i argumentuar dhe i mbështetur në prova konkrete.

116.2 Në kuptim të pikës 1 të nenit 116 të ligjit, konsiderohet gjithashtu së kryejnë evazion tatimor duke kryer fshehje të të ardhurave, me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi i detyrimeve tatimore, tatimpaguesit, për të cilët konstatohet së kryejnë këto shkelje dhe për të cilët janë aplikuar dënimet administrative, në përputhje me:

a) pikën 1 të nenit 119 të ligjit,

b) pikën 3 të nenit 121 të ligjit;

c) pikën 1, shkronjat "a" e "b", të nenit 122 të ligjit.

117. Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave

Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme:

a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast së e ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në buxhetin e shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë së 365 ditë kalendarike;

b) Gjobë në masën 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës në rast së nuk mban tatimin në burim apo tatimin apo nuk mbledh taksën ose tarifën;

c) Gjobë në masën 100 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës nëse mban dhe nuk deklaron e paguan tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën e mbledhur.

118. Mosmbajtja e saktë e librave, regjistrave dhe dokumentacionit

Tatimpaguesi, që nuk arrin të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin tatimor, të kërkuar sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë një gjobë me 10 000 lekë, për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si biznes i vogël, dhe me 50 000 lekë për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si lloj tjetër biznesi.

Kjo gjobe aplikohet për mosmbajtjen e librave, regjistrave apo dokumentacionit tatimor. Gabime jo materiale, që nuk cenojne në thelb përmbajtjen e dokumentacionit dhe nuk kanë efekt

në llogaritjen e sakte të detyrimeve tatimore, nuk denohen me gjoben e mesiperme. Por, penaliteti do të aplikohet kur gabime të tilla jo materiale janë të shumta, të persëritura dhe tatimpaguesi nuk merr masa për ndreqjen e tyre.

119. Mosdeklarimi i të punësuarve

119.1 Organet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë tatimpaguesit, punëdhënësin ose të vetëpunësuar për të verifikuar nëse deklarimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe ato të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor.

Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkatës të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht), që fillojnë punë për herë të parë ose të punësuar rishtazi pranë tij duke plotësuar të dhënat e kërkuara për secilin prej tyre sipas formularëve përkatës. Ky deklarim duhet të bëhet të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës së të punësuarve. Në mbështetje të nenit 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", punonjësit e administratës tatimore, të autorizuar me shkrim, kryejnë verifikime e kontrolle në vendndodhjen e biznesit lidhur me deklarimin e të punësuarve, të të vetëpunësuarëve, të punonjësve të papaguar të familjes, numrit të punonjësve.

Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton së tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar:

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh;

b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

Numërimi i konstatimeve dhe zbatimi i penaliteteve të ndryshuara në nenin 119, zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të këtij neni me ligjin nr. 112/2016, datë 15.11.2016.

119.2 Këto gjoba nuk aplikohen në rastin kur nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e aktivitetit të tatimpaguesit me status ligjor person fizik, evidentohen persona mbi 16 vjeç, të cilët deklarohen si "të vetëpunësuar me punonjës të papaguar të familjes". Pas konstatimit, organi tatimor vërteton në portalin "e-Albania", nëpërmjet certifikatës familjare të të vetëpunësuarit, nëse ai plotëson ose jo kushtet për t'u konsideruar si person i papaguar i familjes apo si bashkëjetues, sipas kuptimit të Kodit Civil.

119.3 Organet tatimore kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklarimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta lidhur me deklarimin e pagës reale. Gjatë këtij procesi, organet tatimore mund të kërkojnë bashkëpunimin me Inspektoratin Shtetëror të Punës. Për vlerësimin e pagës reale të punonjësve të një tatimpaguesi, organet tatimore zbatojnë metodat alternative të vlerësimit bazuar në nenin 72 të ligjit për procedurat tatimore.

Nëse nga verifikimi dhe kontrolli rezulton së tatimpaguesi ka fshehur dhe nuk ka deklaruar pagën e saktë të përfituar nga punëmarrësi, si rezultat i marrëdhënies së punësimit, tatimpaguesi punëdhënës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimit tatimor dhe kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të llogaritur për gjithë periudhën që provohet së është kryer shkelja, dënohet me gjobë në masën 100 për qind të detyrimit dhe kontributit të llogaritur.

120. Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi 150.000 lekë

Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe së 150 000 lekë, dënohen me gjobë në masën 10 për qind të vlerës së secilit transaksion.

Ky dënim do të zbatohet si për blerësin, edhe për shitësin, nëse të dy janë persona

juridikë dhe/ose fizikë tregtarë, dhe blerësi ka paguar direkt shitësin me para në dorë. Në rast së blerësi ka paguar me para në dorë në llogarinë bankare të shitësit, dënimi zbatohet vetëm ndaj blerësit. Ashtu sikurse, nëse shitësi i autorizuar nga blerësi, për likuidimin e transaksionit ka tërhequr me para në dorë nga llogaria bankare e blerësit, dënimi zbatohet ndaj shitësit.

121. Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore

121.1 Për tatimpaguesin që mban në ruajtje, përdor ose transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, në përputhje me dispozitat e ligjit, aplikohen masat dhe dënimet si më poshtë:

a) Tatimpaguesit të tatimit të thjeshtuar të fitimit, që nuk është i regjistruar për TVSH-në, menjëherë në momentin e konstatimit i ndryshohet përgjegjësia tatimore duke kaluar si tatimpagues i TVSH-së. Për qëllim të konstatimit të mosdokumentimit të mallit detyrohet të lëshojë faturë, sipas nenit 53, të këtij ligji, me qëllim dokumentimin e mallit dhe aplikohet dënim, sipas pikës 1, të nenit 124, të ligjit.

b) Tatimpaguesi i regjistruar për TVSH-në detyrohet të dokumentojë mallin duke lëshuar faturë tatimore, sipas nenit 53, të këtij ligji. Për qëllim të konstatimit të mosdokumentimit të mallit i kryhet rivlerësim i shitjeve në të njëjtën vlerë me vlerën e tregut të mallit të padokumentuar dhe aplikohet dënim, sipas pikës 1, të nenit 124, të ligjit.

Në asnjë rast, në faturën e lëshuar sipas nenit 53 të ligjit për qëllime të dokumentimit të mallit, nuk llogaritet TVSH-ja në faturë. Kjo faturë ka për qëllim dokumentimin e mallit të konstatuar të padokumentuar.

Nëse tatimpaguesi që konstatohet së kryen shkeljen, është tatimpagues i tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin dhe faturat që ka në përdorim janë fatura të thjeshta tatimore (jo me TVSH) ai lëshon një faturë të thjeshtë tatimore për të dokumentuar mallin. Kjo faturë i bashkëngjitet akt konstatimit dhe procesverbalit përkatës dhe një kopje ruhet nga tatimpaguesi.

Në këtë faturë shënohet numri dhe data e akt konstatimit dhe procesverbalit përkatës, në mënyrë që të identifikohet që kjo faturë është lëshuar sipas kësaj pike të udhëzimit.

Ky tatimpagues pajiset me fatura tatimore me TVSH sapo i aktivizohet përgjegjësia për TVSH-në.

Nëse tatimpaguesi që konstatohet së ka kryer shkeljen është i regjistruar për TVSH-në dhe përdor faturat tatimore me TVSH-në, fatura që lëshohet për të dokumentuar mallin sipas këtij neni është faturë me TVSH-në, por pa llogaritur TVSH-në.

Kjo faturë nuk është dokument për njohjen si shpenzim i zbritshëm, për sa është një dokument i lëshuar në kushtet e shkeljes së konstatuar. Në faturë përveç të dhënave identifikuese, datës, numrit të akt konstatimit dhe procesverbalit përkatës duhet të evidentohet qartë përshkrimi i mallit dhe sasia e tij.

Për zbatimin e dënimeve sipas kësaj dispozite punonjësit e administratës tatimore duhet të evidentojnë me saktësi faktin që mallrat janë pa dokumentacionin e kërkuar dhe së këto mungesa kanë shkaktuar ose kanë për qëllim shmangien e tatimeve, duke pasur parasysh edhe dispozitat e pikës 58 të këtij udhëzimi.

121.2 Shfuqizuar.

121.3 Shfuqizuar.

121.4 Personi i identifikuar i paregjistruar, në kuptim të nenit 41 të ligjit, për sasinë e mallit që mban në ruajtje, përdor ose transporton, dënohet sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 121 të ligjit. Përpara së të kryhet kjo procedurë, tatimpaguesi duhet të jetë regjistruar dhe të jetë pajisur me certifikatën e regjistrimit dhe numër identifikimi të personit të tatueshëm.

122. Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale dhe sistemet e monitorimit të qarkullimit, për lëshimin e kuponëve fiskalë dhe të biletave

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 781 datë 14.11.2007 "Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale dhe sistemet e monitorimit të qarkullimit, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit për proceduren e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për

pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale dhe sistemet e monitorimit të qarkullimit" rregullon administrimin e paisjeve fiskale dhe kuponave tatimorë.

Kundërvajtjet administrative lidhur me përdorimin e pajisjeve fiskale dhe sistemet e monitorimit të qarkullimit dënohen bazuar në dispozitat që vijon:

122.1 Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, i cili detyrohet të përdorë pajisjen fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit, në përputhje me përcaktimet e ligjit për procedurat tatimore, dënohet në rast se:

a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:

i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë ose që plotësojnë për herë të parë detyrimin ligjor për instalimin e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit aplikohet një afat prej 15 ditësh pune për vendosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit të monitorimit të qarkullimit;

ii) nëse pas verifikimit të parë, sipas nënndarjes "i", të germës "a" , konstatohet së tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë ose sistemin e monitorimit të qarkullimit, merret masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 15 ditë kalendarike. Nëse tatimpaguesi, brenda këtij afati, nuk instalon pajisjen fiskale në vendin ku është konstatuar shkelja, masa e bllokimit shtyhet deri në instalimin e pajisjes fiskale. Në rastin kur situata nuk është rregulluar brenda 15 ditëve, tatimpaguesit i publikohen emri, NIPT-i dhe emri i përfaqësuesit të biznesit, në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Këto të dhëna të tatimpaguesit mbahen të publikuara nga administrata tatimore deri në momentin e instalimit të pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit.

iii) çdo konstatim i mëpasshëm i mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit, si shkelje e përsëritur, konsiderohet evazion tatimor siç parashikohet në nenin 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të ligjit, duke bërë kallëzim penal për tatimpaguesin;

b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve për:

i) konstatimin (verifikimin) e kryer, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe përveç masës së gjobës për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në bëhet vlerësim tatimor për tre muajt e fundit, duke përdorur metodat alternative, të parashikuara në nenet 71 dhe 72 të këtij ligji;

ii) konstatimin (verifikimin) tjetër pas konstatimit të parë, sipas nënndarjes "i", të kësaj shkronje, nëse tatimpaguesi vazhdon të mos e lëshojë kuponin tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, përveç aplikimit të dënimit si në nënndarjen "i", dhe në këtë rast merret masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 30 ditë kalendarike;

iii) çdo konstatim të përsëritur të moslëshimit të kuponit tatimor, pas dy konstatimeve të sipërpërmendura, përveç aplikimit të dënimit, si në nënndarjen "i", konsiderohet evazion tatimor sipas pikës 2, të nenit 116, të këtij ligji. Gjithashtu, publikohen emri i tatimpaguesit, NIPT-i dhe emri i përfaqësuesit të biznesit në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

c) lëshon një kupon tatimor/dëftesë tatimore /biletë, me vlerë të parashtypur, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, për kuponin tatimor/dëftesën tatimore/biletën me vlerë të parashtypur, me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

ç) lëshon kupon tatimor/dëftesë tatimore, ku ka shënuar një vlerë të ndryshme nga vlera e furnizimit ose e çmimit të afishuar, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

d) nuk afishon në një vend të dukshëm një poster që tregon detyrimin e blerësit të

mallrave apo të përfituesit të shërbimit për të kërkuar kupon tatimor, si dhe të drejtën e blerësit për të mos paguar për mallrat dhe shërbimet e blera në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të këtij ligji, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për secilën nga kërkesat në këtë paragraf;

dh) nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit tatimor në mjedisin e ofrimit të mallrave apo të shërbimeve, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

e) Shfuqizuar;

ë) nuk mban libër llogarie për qarkullimin e kryer të mallrave, me dënim, sipas përcaktimeve të nenit 118 të këtij ligji;

f) shfuqizuar;

g) nuk mban dhe mirëmban në kushte pune pajisjet fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë;

gj) nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në pajisjen fiskale ose sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve, me gjobë në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

h) mban ose përdor pajisje fiskale apo sisteme të monitorimit të qarkullimit, të cilat nuk janë në përputhje me këtë ligj apo aktet nënligjore në zbatim të tij, dënohet me konfiskim të mallrave gjendje. Gjithashtu, në përputhje me nenin 116, të këtij ligji, administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin.

Numërimi i konstatimeve dhe zbatimi i penaliteteve të ndryshuara në nenin 122, zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të këtij neni me ligjin nr. 112/2016, datë 15.11.2016.

122.2. Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljeve të parashikuara në këtë nen bëhen nga organet tatimore të juridiksionit, ku tatimpaguesi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljet.

122.3. Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të prodhuara nga institucionet e autorizuara, të përdorura në sektorë të ndryshëm, dënohet me gjobë, në masën 10, 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo biletë.

122.4 Në rast së një tatimpaguesi i është bllokuar veprimtaria nga administrata tatimore dhe ai prish shenjat dalluese të vendosura për bllokim të veprimtarisë, atij i konfiskohet e gjithë sasia e mallit. Për këtë qëllim, grupi i kontrolli pasi bën inventarizimin e mallrave dhe evidentimin e tyre në procesverbalin përkatës, mban gjithashtu aktin për konfiskimin e mallrave.

Në rastin e konfiskimeve në përgjithësi dhe sidomos në rastin e konfiskimit të mallrave që prishen si, ushqime, fruta-perime, produkte bujqësore dhe blegtorale etj., apo që kanë afat të afërt skadence, mund të zbatohet riblerja në vlerë e tyre nga personi i tatueshëm. Për këtë qëllim, grupi i kontrollit i paraqet drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit ku është kryer shkelja procesverbalin përkatës brenda 12 orësh nga plotësimi i tij. Drejtori i drejtorisë rajonale, brenda 24 orësh, nxjerr vendimin e vlerësimit në lekë të mallit të konfiskuar me vlerën e tregut të mallit. Vlerësimi kryhet nga një komision i përhershëm i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, i përbërë nga jo më pak së 4 punonjës, i ngritur për këtë qëllim me urdhër të drejtorit të drejtorisë rajonale. Për vlerësimin e vleftës së mallrave zbatohen dispozitat e pikës 51.3 të këtij udhëzimi.

Vendimi për vlerësimin e mallit të konfiskuar i jepet tatimpaguesit përkatës i cili duhet të paguajë detyrimin brenda ditës së parë të punës pas marrjes së tij. Pagesa bëhet në llogarinë e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit. Malli i konfiskuar lirohet vetëm pasi të jetë dorëzuar dokumenti që vërteton pagesën e vlerës së tij. Në dokumentacionin e konfiskimit, do të depozitohet një kopje e dokumentit të pagesës së vlerës së mallit të konfiskuar.

Në qoftë së tatimpaguesi përkatës nuk ushtron mundësinë e riblerjes së mallit brenda 12 orësh nga plotësimi i procesverbalit nga grupi i kontrollit ose nuk bën pagesën sipas afatit të përcaktuar në këtë pikë të udhëzimit për qëllime të riblerjes së mallit, atëherë malli i konfiskuar, do t'i kalojë për administrim Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, e cila do të ndjekë procedurat e mëtejshme.

122.5 Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljeve të parashikuara në këtë nen bëhen nga organet tatimore të juridiksionit, ku tatimpaguesi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljet. Në rastet kur strukturat qëndrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve disponojnë informacione ose ndermarrin verikime në terren, verifikime dhe kontrolle të tilla duhet të ushtrohen në bashkëpunim me strukturat përkatëse të organeve tatimore të juridiksionit.

123. Dënimet për shoqëritë e autorizuara dhe të paautorizuara

123.1 Shoqëritë e autorizuara, që tregtojnë dhe/ose mirëmbajnë pajisje fiskale, dënohen me gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkeljet që listohen në pikën 1 të nenit 123 të ligjit dhe më konkretisht në germat "a", "b", "c", "ç", "d".

123.2 Shoqëritë e paautorizuara, të cilat tregtojnë apo mirëmbajnë pajisje fiskale të subjekteve të tjera tatimpaguese, të paautorizuara nga Ministri i Financave, dënohen me gjobë, në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe sekuestrim të pajisjeve fiskale, ndërsa shoqëritë, që blejnë dhe përdorin pajisje të tilla fiskale, dënohen me gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe sekuestrim të pajisjes fiskale.

123.2 Shoqëritë e autorizuara nga Ministri i Financave, dënohen me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për shkeljet që listohen në pikën 3 të nenit 123 të ligjit dhe më konkretisht në germat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f".

123.4 Shoqëritë e autorizuara, që tregtojnë pajisje fiskale, dënohen me gjobë, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, kur konstatohet së tregtojnë pajisje fiskale me funksione të ndryshme nga ato të miratuara nga komisioni i ngritur për këtë qëllim në Ministrinë e Financave.

123.5 Për përcaktimin e nivelit të këtyre dënimeve, Drejtoria Rajonale Tatimore bazohet në kriteret e dhëna në pikën 111.1.2 të këtij udhëzimi dhe në veçoritë, kushtet dhe rrethanat e tatimpaguesit.

124. Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve

124.1 Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e ligjit për procedurat tatimore apo të ligjeve specifike tatimore. Nëse tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin, atëherë gjoba sipas paragrafit më lartë të kësaj pike, zbritet me 30 (tridhjetë) për qind. Administrata tatimore do të kryejë zbritjen e gjobës pas paraqitjes së kërkesë me shkrim nga tatimpaguesi pranë DRT-së përkatëse, kërkesë të cilës i bashkëlidhet edhe mandati i pagesës.

124.2 Për tatimpaguesit që kryejnë shkelje të përsëritur të moslëshimit të faturës, përveçse aplikohet dënimi me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, sipas pikës 1, të nenit 124 të ligjit, gjithashtu ndërmerren masat e mëposhtme:

a) tatimpaguesi, që nuk është i regjistruar për TVSH-në, në momentin kur konstatohet shkelja e përsëritur, sipas këtij neni, regjistrohet për TVSH-në;

b) tatimpaguesi i regjistruar për TVSH-në dhe tatimin e thjeshtuar të fitimit, në momentin kur konstatohet shkelja e përsëritur, sipas këtij neni, regjistrohet për tatimin mbi fitimin;

c) tatimpaguesi i tatimit mbi fitimin përfshihet menjëherë në listën e subjekteve me risk për efekt të analizës së riskut. Në rastet kur moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH-në është shkelje e përsëritur më shumë së 2 herë, atëherë përveç sa përcaktohet në pikat 1 dhe 2, të nenit 124 të ligjit, zbatohen edhe dispozitat e neneve 116 dhe 131 të ligjit

124.3 Në rast konstatimi të mospërmbushjes së detyrimit, sipas pikës 5, të nenit `, të ligjit të procedurave tatimore, tatimpaguesit i llogaritet TVSH-ja në masën që ky mall do të tregtohej me pakicë për konsumatorin final, si dhe do të dënohet me gjobë në masën 100 për qind të vlerës së TVSH-së të llogaritur që i përket vlerës së shitjeve që tejkalojnë kufirin e lejuar për shitjet me kupon tatimor, siç përcaktohet në pikën 5, të nenit 54, të këtij ligji, deri në datën

31.3.2016.

124.4 Nga data 1.4.2016, në rast konstatimi të mospërmbushjes së detyrimit sipas pikës 5, të nenit 54, të këtij ligji,tatimpaguesi dënohet me gjobë në masën 100 për qind të vlerës së TVSH-së.

125. Mosmarrja e kuponit tatimor

125.1 Blerësi ose përfituesi i shërbimit, i cili gjatë kontrollit rezulton së nuk disponon kupon tatimor për mallrat ose shërbimet e blera, në një distancë jo më shumë së 30 metra nga vendi i daljes së njësisë së shitjes së mallit ose shërbimit, dënohet me një gjobë prej 1 000 lekë.

125.2 Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljes së parashikuar në këtë nen bëhet nga organet e administratës tatimore të juridiksionit, ku kryhen shkeljet.

126. Mosdhenia e informacionit

126.1.1 Kur personat e përcaktuar në nenet 60, 61, 62 dhe 101 të këtij ligji, refuzojne të japin informacionin e kërkuar nga organet tatimore, denohen në përputhje me nenin 126 të këtij ligji. Për percaktimin e nivelit të këtyre dënimeve, Drejtoria Rajonale Tatimore bazohet në kriteret e dhëna në pikën 111.1.2 të këtij Udhëzimi dhe në veçorite, kushtet dhe rrethanat konkrete të shkeljes.

127. Pengimi i kontrollit ose i hetimit tatimor

127.1 Tatimpaguesi, i cili, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pengon ushtrimin e të drejtave të administratës tatimore për kontrollin apo hetimin tatimor, dënohet me një gjobë prej 100 000 lekë, për biznesin e vogël dhe 1 000 000 lekë për biznëset e tjera.

127.2 Të drejtën për miratimin e masës së gjobës, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, e ka drejtori i drejtorisë rajonale apo titullari i njësisë së ngjashme me të.

127.3 Në rast së organet tatimore kanë të dhëna të besueshme së tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare, organet tatimore kanë të drejtë t'ia sekuestrojnë, në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë së tij, dokumentacionin tatimor, pajisjet kompjuterike dhe fiskale, dhe mjete të tjera të mbajtjes së dokumentacionit të tatimpaguesit, që përmbajnë apo mund të përmbajnë informacion tatimor, dhe që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta.

Në të tilla raste, me urdhër të drejtorit të drejtorisë rajonale, apo me urdhër të drejtorit të hetimit tatimor, pas miratimit të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, punonjësi tatimor i ngarkuar për zbatimin e urdhrit bën sekuestrimin e dokumentacionit dhe pajisjeve të cituara në paragrafin më sipër. Dokumentacioni dhe/ose pajisjet e sekuestruara me fletëhyrje, depozitohen në laboratorin e drejtorisë rajonale, ku i nënshtrohen verifikimit të përmbajtjes. Informacioni i dokumenteve dhe/ose pajisjeve të sekuestruara, sipas paragrafit të parë të kësaj pike, trajtohet sipas pikës 25 të udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Administrata tatimore, pas ekspertizës që i bën dokumentacionit dhe ose pajisjeve, mjeteve të sekuestruara sipas paragrafit të parë të kësaj pike, është e detyruar të procedojë sipas rregullave të përcaktuara në kapitullin "Kontrolli tatimor" të ligjit dhe udhëzimit nr.24, datë 2.9.2008 të ndryshuar.

128. Leshimi i faturës tatimore të pasakte

128.1 Tatimpaguesi që lëshon një faturë tatimore të pasakte me pasoje uljen e detyrimit tatimor apo rritje të shumës për tu kredituar denohet në përputhje me nenin 128 (1) të ligjit për procedurat tatimore.

Fatura quhet e pasakte kur nuk është e plotësuar me të dhënat reale financiare të subjektit dhe ndikon në detyrimin tatimor që lidhet me atë faturë.

Fature e sakte është ajo ku detyrimi tatimor i llogaritur është absolutisht korrekt dhe për të cilën nuk është bërë asnje gabim aritmetik ose llogjik.

128.2 në së një tatimpagues lëshon një faturë tatimore të pasakte në lidhje me informacionin që kërkohet të përmbaje në bazë të dispozitave të ligjit për procedurat tatimore ose të ligjeve të tjera tatimore në fuqi, por që është e sakte persa i perket detyrimit tatimor,

denohet sipas paragrafit 2 të nenit 128 të ligjit për procedurat tatimore.

128.3.1 Nëse një tatimpagues nuk është i regjistruar në TVSH lëshon fature me TVSH denohet sipas paragrafit 3 të nenit 128 të ligjit për procedurat tatimore.

128.3.2 Nëse një tatimpagues i regjistruar në TVSH lëshon fature me TVSH pa qenë i detyruar nga ligji të bëjë kështu denohet sipas paragrafit 3 të nenit 128 të ligjit për procedurat tatimore. Nëse ky tatimpagues lëshon gabimisht fature tatimore me TVSH pa qenë i detyruar por ka paguar në organet tatimore TVSH lidhur me Këto fatura , atehere nuk penalizohet.

128/1 Dënime të tjera

Për shkeljet e konstatuara në rastin kur përgjegjës për të aplikuar TVSH-në është personi i tatueshëm blerës nëpërmjet "autongarkësës së TVSH-së", aplikohen dënimet si më poshtë:

a) Me gjobë në përputhje me nenin 118 të ligjit, kur ky person nuk ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për TVSH-në, por moslëshimi i faturës nuk sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.

b) Me gjobë në përputhje me nenin 124 të ligjit, kur vepron sipas shkronjës "a", të nenit 128/1, por në këtë rast, moslëshimi i faturës sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.

c) Me gjobë, në përputhje me pikën 1, të nenit 128 të ligjit, kur ky person ka lëshuar faturë tatimore jo në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin për TVSH-në.

ç) Me gjobë në përputhje me nenin 115, të ligjit, kur ky person i tatueshëm ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkesave të ligjit për TVSH-në dhe nuk e ka deklaruar atë duke sjellë pasoja në TVSH-në e pagueshme.

128/2. Dënimet për mosngarkim ose ngarkim të pasaktë të numrave IMEI të Baza e të Dhënave

128/2.1 Çdo tatimpagues që nuk ngarkon të dhënat e numrave IMEI të telefonave celularë ose ngarkon informacion të pasaktë, dënohet me një gjobë prej 30 000 (tridhjetë mijë) lekësh për çdo mosngarkim/ngarkim jo të saktë.

Neni 128/3 "Dënimet për certifikimin e pasqyrave financiare nga audituesit.

128/3.1 Në rast së nga kontrolli i bërë nga administrata tatimore të tatimpaguesit, deklaratat tatimore të të cilëve janë certifikuar nga kompanitë certifikuese, sipas pikës 4, të nenit 80, të këtij ligji, së janë në përputhje me legjislacionin fiskal, rezulton detyrim tatimor, kompania certifikuese dënohet me një gjobë, në masën 50 për qind të detyrimit tatimor të ngarkuar tatimpaguesit.

129. Dënimet për tatimpaguesit, që janë banka apo institucione financiare

Shkeljet e bëra nga bankat apo institucionet financiare lidhur me zbatimin e detyrimeve që atyre i rrjedhin nga dispozitat e legjislacionit tatimor lidhur me dhënien e informacionit, bllokimin e llogarive të tatimpaguesit apo mbajtjen dhe transferimin e detyrimeve tatimore të tatimpaguesve, dënohen sipas nenit 129 të ligjit për proçedurat tatimore. Në çdo rast, shuma e gjobës që zbatohet nuk mund të jetë më e madhe së shuma e kërkuar për t'u bllokuar.

130. Mosafishimi i çmimeve të shitjes

Mosafishimi i çmimeve të shitjes së mallrave apo shërbimeve dënohet me gjobë me 100 000 (njëqind mijë) lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin dhe 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë.

Për aplikimin e këtij dënimi mbahen parasysh përcaktimet e nenit 59 të ligjit dhe pikës 59 të këtij udhëzimi.

Në rastet kur çmimet janë të shënuara në kutinë ambalazhuese të mallit si në rastin e barnave, atëherë subjektet tregtuese nuk i nënshtrohen detyrimit të afishimit të listës së çmimeve. Nuk i nënshtrohen detyrimit për afishimin e çmimeve gjithashtu ata tatimpagues të cilët nuk mund të përcaktojnë çmime të fiksuara paraprakisht për shërbimet që kryejnë, si pasojë e kostove që mund të rëndojnë çmimin e shërbimit në varësi të faktorëve të ndryshëm. Të tilla raste mund të jenë agjencitë e udhëtimit të cilat nuk ofrojnë shërbimin nëpërmjet biletave me çmim të parashtypur, si biletat e transportit ndërkombëtar, çmimi i të cilave vendoset ose përcaktohet në varësi të itinerarit të udhëtimit.

Në rastet e shërbimeve të një natyre të tillë, çmimi për të cilat ndryshon dhe nuk është i paracaktuar, mund të afishohen tarifat orare të shërbimit.

131. Veprat penale

131.1. Konsiderohen veper penale dhe denohen në përputhje me dispozitat e Kodit Penal veprat e përkufizuara në nenin 131 të ligjit për proçedurat tatimore.

131.2 Administrata tatimore bën kallëzim penal në prokurori për çdo shkelje të parashikuar në pikën 1 të nenit 131 të ligjit.

131.3 Përjashtimisht, për tatimpaguesit, të cilët, deri në datën 31.12.2015, me vullnetin e tyre deklarojnë dhe për pasojë korrigjojnë një deklaratë tatimore të plotësuar qëllimisht gabim, në kushtet e nenit 116 të ligjit, pavarësisht periudhës tatimore që i përket kjo deklaratë, paguajnë tatimin dhe kamatë-vonesat, sipas nenit 76, të këtij ligji, administrata tatimore, në përputhje me këtë nen, nuk do të bëjë kallëzim penal. Korrigjimi, i cili përfshin tatimin e papaguar dhe kamatëvonesat, do të vetëdeklarohet nga tatimpaguesi në deklaratën e muajit korrent, brenda datës 31.12.2015, ose do të kërkojë të bëhet nëpërmjet një rivlerësimi nga administrata tatimore.

Tatimpaguesit nuk përfitojnë nga kjo dispozitë, nëse shkelja, sipas paragrafit të mësipërm, është konstatuar paraprakisht nga administrata tatimore.

Çdo procedurë sipas kësaj pike duhet të përfundojë brenda datës 31.12.2015.

Shembull

Në datën 20 tetor të vitit 2012, një tatimpagues ka kryer shitje malli në vlerën 100,000 lekë, ndërsa fatura me TVSH që ka lëshuar është në vlerën 60,000 lekë dhe më pas ka deklaruar tek FDP e TVSH-së, më datën 14 dhjetor 2012, shumën e TVSH prej 10,000 lekë (60,000 / 6 = 10,000 lekë). Pra tatimpaguesi nuk ka deklaruar vlerën reale të shitjes, së mallit dhe ka nëndeklaruar të ardhurat me 50,000 lekë (100,000 – 50,000 = 50,000 lekë) më pak dhe ka paguar 10,000 lekë TVSH më pak (50,000 x 20% = 10,000).

Në përputhje me pikën 3 të nenit 131 të ligjit të procedurave, tatimpaguesi do të bëjë vetë-korrigjimin. Për këtë arsye, tatimpaguesi do të lëshojë një faturë në të cilën do të përcaktojë vlerën e tatueshme 50, 000 lekë dhe TVSH -në përkatëse 10, 000 lekë. Në deklaratën e muajit korrent, pra FDP e TVSH-së së muajit dhjetor 2015, tatimpaguesi do të shtojë vlerën e TVSH nga vetëkorrigjimi prej 10,000 lekë. Tatimpaguesi do të gjenërojë nga sistemi urdhër pagesën përkatëse dhe shuma e detyrimit që ai duhet të paguajë do të përfshijë përveç detyrimit të urdhër pagesës, edhe kamatë-vonesën për gjithë periudhën e mospagimit në kohë të detyrimit, e cila do të përllogaritet nga vetë tatimpaguesi. Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë tatimpaguesi do të veprojë për të korrigjuar të njëjtën vlerë të nëndeklaruar për llogaritjen dhe pagimin e tatimit mbi fitimin, apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël.

Në rast së tatimpaguesi ka vështirësi në llogaritjen e kamatëvonesave ose në kryerjen e procedurës së vetëdeklarimit, tatimpaguesi duhet t'i drejtohet me një shkresë zyrtare drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar që të bëjë vetë-korrigjimin. Brenda 4 ditëve pune nga proto-kollimi i kërkesës, drejtoria rajonale tatimore duhet të kthejë përgjigje.

Nga data e marrjes së kërkesës për rivlerësim nga tatimpaguesi, DRT nuk ndërmerr kontroll tek tatimpaguesi.

131.4 Shfuqizuar.

131.5 Dispozitat e këtij udhëzimi:

- nuk zbatohen për kapitalin/fondet që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar;
- kapitalin/fondet e përfituar si rezultat i veprave penale të korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm;
- nuk bien ndesh me detyrimin e organeve tatimore që burojnë nga legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

132. Ndjekja e dyfishtë

132.1 Vendosja e dënimit administrativ, sipas këtij ligji ose një ligji tjetër tatimor, nuk e

ndalon administratën tatimore për të paraqitur kallëzim penal në prokurori, për vepra penale tatimore.

132.2 Përfundimi i një çështjeje penale kundër tatimpaguesit nuk ndalon vendosjen, për të njëjtin tatimpagues, të një dënimi administrativ, sipas këtij ligji ose një ligji tjetër tatimor.

KREU XV
DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

133. Efekti në detyrimet tatimore dhe vlerësimet ekzistuese

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë":

1. Çdo vlerësim tatimor i kryer pas hyrjes në fuqi të ligjit duhet detyrimisht të jetë i bazuar në dispozitat e ligjit, pamvarësisht nga periudha tatimore me të cilën lidhet njoftim vlerësimi.

2. Për shkeljet që konstatohen, pas hyrjes në fuqi të Ligjit, do të zbatohen nivelet e dënimeve administrative që parashikon ky ligj, pamvarësisht nga koha kur ka ndodhur shkelja. P.sh. gjobat për mosdeklarim në afat për të gjitha llojet e detyrimeve tatimore që i njoftohen tatimpaguesit pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit të ri, duhet të llogariten bazuar në nenin 113 të Ligjit, pra me 10.000 lekë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar, pamvarësisht nga periudhat e mosdeklarimit. Po kështu, gjobat për pagesë të vonuar që i njoftohen tatimpaguesit pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit do të llogariten në bazë të nenit 114 të Ligjit. Pra gjoba për pagesë të vonuar do të jetë 5% e shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj apo pjesë të muajit gjatë kohës që pagesa nuk është kryer, por jo më pak së 10 mijë lek dhe jo më shumë së 25% e detyrimit tëpapaguar.

3. Çdo apelim i paraqitur në Drejtorinë e Apelimit Tatimor pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të shqyrtohet bazuar në procedurat e ligjit të ri.

4. Shfuqizuar.

5. Në zbatim të paragrafit 2 të nenit 133 të ligjit, për të evidentuar tatimpaguesit e çregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit deri në datën e përcaktuar në këtë ligj dhe ende të paçregjistruar në administratën tatimore, Qendra Kombëtare e Biznesit i dërgon administratës tatimore një listë të detajuar me emrin e tatimpaguesit, datën e çregjistrimit, NUIS dhe emrin e administratorit ose përfaqësuesit të tij, i cili është çregjistruar nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Të gjithë tatimpaguesit, të cilët figurojnë të çregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit deri në datën e përcaktuar në ligj, por ende nuk janë çregjistruar në administratën tatimore, çregjistrohen nga regjistri i tatimpaguesve dhe konsiderohen të çregjistruar që nga data e çregjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Çdo gjobë për mosdeklarim të deklaratave tatimore pas datës së çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit është e pavlefshme dhe si e tilë nuk duhet të vlerësohet ose në rast së është vlerësuar, duhet të hiqet. Veprimet për çregjistrimin e këtyre tatimpaguesve do të kryhen nga administrata tatimore pas marrjes së informacionit nga Qendra Kombëtare e Biznesit për tatimpaguesit e çregjistruar deri në datën e përcaktuar në ligj dhe që nuk figurojnë në regjistrin tregtar.

Në zbatim të paragrafit 3 të nenit 133 të ligjit, tatimpaguesit, të cilët kanë bërë kërkesë për çregjistrim pranë QKR-së dhe me paraqitjen e kësaj kërkese, kanë ndërprerë deklarimin e deklaratave pa veprimtari (me vlerë zero) në organin tatimor, nëse nga administrata tatimore nuk është provuar ose provohet së këta tatimpagues kanë kryer veprimtari ekonomike pas kërkesës së tyre për çregjistrim, u falen gjobat për mosdeklarim për çdo deklaratë dhe çdo gjobë e aplikuar për mosdeklarim të deklaratave tatimore pas datës së paraqitjes së kërkesës për çregjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit është e pavlefshme dhe duhet të hiqet. Çdo gjobë e aplikuar për mosdeklarim të deklaratave tatimore pas datës së paraqitjes së kërkesës për çregjistrim në

Qendrën Kombëtare të Biznesit, është e pavlefshme dhe hiqet, apo për çdo deklaratë të padorëzuar ose të pavlerësuar pa veprimtari pas datës së paraqitjes së kërkesës për çregjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, gjoba për mosdeklarim ose deklarim të vonuar të deklaratës, nuk vlerësohet.

Administrata tatimore merr masat për evidentimin e veprimeve të mësipërme në regjistrin e tatimpaguesve dhe vijon procedurat për çregjistrimin e këtyre tatimpaguesve.

5. 5. Tatimpaguesve, të cilët me fillimin e sistemit të ri të IT-së, edhe pse nuk kanë pasur përgjegjësinë tatimore për një tatim apo taksë të caktuar, janë ngarkuar me këtë përgjegjësi dhe, për pasojë, janë evidentuar si debitorë pranë administratës tatimore, deri në datën 31.8.2015, u shfuqizohen gjobat dhe interesat e përllogaritur.

134. Komisioni i Apelimeve Tatimore

Ankimet administrative tatimore të cilat janë paraqitur në protokollin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve përpara datës 1 janar 2017, për të cilat deri më datën 31.12.2016 nuk ka akoma një vendim përfundimtar nga kjo strukturë, regjistrohen në një listë të veçantë të specifikuar me të gjitha të dhënat përkatëse dhe dërgohen zyrtarisht nga Drejtoria e Apelimit në DPT në Ministrinë e Financave. Kjo listë së bashku me praktikat përkatëse protokollohen në Protokollin e Ministrisë së Financave dhe merren në dorëzim nga Drejtori i Apelimit në momentin e fillimit të funksionimit të kësaj strukture në Ministrinë e Financave. Afatet e shqyrtimit të tyre llogariten në përputhje me ligjin që nga data e protokollimit fillestar të kërkesës për apelim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor.

Për kërkesat të cilat në datën 31.12.2016 nuk u ka përfunduar afati i përcaktuar për shqyrtimin dhe vendimmarrjen, ky afat ndërpritet më datë 31.12.2016 dhe llogaritja e afatit vazhdon nga data e marrjes në dorëzim të këtyre ankimimeve nga Drejtoria e Apelimit Tatimor në Ministrinë e Financave.

135. Nxjerrja e akteve nënligjore

135.1 Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 pika 2 të ligjit dhe të miratojë manualet teknike, manualin e vlerësimit, të investigimit, të shërbimit të tatimpaguesit dhe të masave shtrënguese, si dhe manuale apo rregullore të tjera në zbatim të Ligjit dhe të këtij Udhëzimi.

135.2 Aktet nënligjore dhe manualet botohen edhe në buletinin tatimor dhe janë detyruese për administratën tatimore dhe tatimpaguesit.

135.3 Buletini tatimor është publikimi zyrtar i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

136. Shfuqizime

Shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore që rrjedhin prej ligjit 8560 datë 22.12.1999 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit 7758 datë 12.10.1993 "Për Dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet", të shfuqizuar në bazë të nenit 136 të ligjit për proçedurat tatimore.

137. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Nr.3959/2/prot Tiranë, më 14.4.2010

AKTMARRËVESHJE

(në zbatim të pikës 75/1.4, e vendosur me udhëzimin nr.13, datë 14.4.2010)

Në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr.13, datë 14.4.2010 "Për një shtesë në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, palët e përfshira në këtë aktmarrëveshje bien dakord sa më poshtë:

-Të njohim dhe të pranojnë kompensimin e detyrimit doganor të TVSH-së së shtyrë në import me tepricën kreditore të TVSH në organin tatimor, detyrim apo tepricë e cila është provuar dhe pranuar nga të gjitha palët e përfshira në këtë marrëveshje, deri në ditën e nënshkrimit të saj.

- Me nënshkrimin e aktmarrëveshjes, teprica kreditore pakësohet tek organet tatimore dhe kjo aktmarrëveshje merr vlefshmërinë e pagesës për të procedurar më tej për mbylljen e skemës së shtyrjes së TVSH-së në import.

- Shuma e njohur dhe pranuar nga palët në këtë marrëveshje është në masën …… lekë.

- Kjo aktmarrëveshje nënshkruhet nga subjekti tatimpagues……, me NIPT……, i regjistruar pranë drejtorisë tatimore rajonale……e përfaqësuar nga z/znj…… me nr.pasaporte……rezident në ……..

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave
Emër, mbiemër, firma

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve
Emër, mbiemër, firma

Tatimpaguesi
Emër, mbiemër, firma

MODELI I URDHËRPAGESËS PËR RIMBURSIM

(shtuar me udhëzimin nr. 4/1, datë 23.5.2014)

MODELI NR. 1: URDHËR - PAGESE RIMBURSIMI

Emërtimi i Institucionit	**Drejtoria Rajonale e Tatimeve**
NIPT - i	**xxxxxxxxxx**
Kodi i Institucionit	**1010xxxx**
Entiteti i Qeverisjes	**001**
Rrethi	**xxxx**

Nr. i Kuponit

URDHËR - PAGESË RIMBURSIMI

Nr. **Datë** __.__.20__

Nr.	Struktura e llogarive_kodi						SHUMA në Lekë	Objekti i pagesës
	Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomik	Nën Llogaria	Kod Projekti		
1								
2								
3								
TOTALI ME SHIFRA							xxx,xxx.xx	X
TOTALI ME FJALË							(……..)	

IBAN: AL

Të dhëna për subjektin përfitues:	
Emri i subjektit perfitues	
NIPT - i	
Nr.llog.bankare të subjektit	
Emri i Bankës	
Adresa e Bankës	
xxxxxx (p.sh.Tiranë)	

Dokumentat ngjitur Urdhër Pagesës Rimbursimit:		
Emërtimi	**Nr. Dokumenti**	**Data e Dokumentit**
Njoftimi	nr. xxx	datë __,__,20__
Të tjera (Emërtime, numër, datë)		

PËR DREJTORINË RAJONALE TATIMORE _____

DREJTORI I DREJTORISË RAJONALE
(_____)

DREJTORI I DR. VLERËSIMIT/KONTABILITETIT
(_____)
Vula

PËR DEGËN E THESARIT
Aprovuar date

DREJTORI I DEGËS SË THESARIT
(_____)
Vula

Shënim: Qelizat për "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar datë", plotësohen nga nëpunesi i Degës së Thesarit

Formati i këtij Urdhër Pagese Rimbursimi është miratuar nga Ministri i Financave me udhëzimin nr. ,,,,,, datë __.__.20__

SHTOJCA 1
MODEL LETËR KUJTESË
(shtuar me udhëzimin nr. 26, datë 16.12.2014)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE_____

Nr. _____Prot Datë_____

Drejtuar: Emri i tatimpaguesit
Adresa_____
NUIS/NIPT

LETËR KUJTESË

I nderuar tatimpagues

Me anë të kësaj letre kujtese, ju vëmë në dijeni së sipas të dhënave të sistemit tatimor, nga ana juaj nuk është plotësuar detyrimi ligjor për dorëzimin e deklaratës tatimore të periudhës tatimore_____ për sa i përket _____. Afati për dorëzimin e kësaj deklaratë ka qenë deri në datën__/__/____.

Më anë të kësaj letre, ju kujtojmë së ju duhet të plotësoni dhe dorëzoni deklaratën tuaj të padorëzuar, brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të kësaj letre. Nëse ju nuk dorëzoni brenda këtij afati deklaratën tatimore, administrata tatimore do të bëjë vlerësimin e detyrimit tuaj tatimor, i cili do të kryhet në mënyrë automatike nga sistemi informatik, në një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 72 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Ju lutem merrni në konsideratë këtë letër kujtese për dorëzimin e deklaratës tatimore sipas afatit të mësipërm.

DREJTORI

SHTOJCA 2
MODEL NJOFTIM VLERËSIMI AUTOMATIK NGA ZYRA
(shtuar me udhëzimin nr. 26, datë 16.12.2014)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE_____

Nr. _____Prot Datë_____

NJOFTIM VLERËSIMI AUTOMATIK NGA ZYRA

Drejtuar: Emri i tatimpaguesit
Adresa_____
NUIS/NIPT

I nderuar tatimpagues,

Megjithëse jeni njoftuar nga administrata tatimore nëpërmjet "Letër kujtesës" nr. _____, prot., datë_____ për mosdorëzimin e deklaratës tatimore të _____, për periudhën _____, ju përsëri nuk keni përmbushur detyrimin tuaj për të dorëzuar këtë deklaratë tatimore. Bazuar në nenin 71/1 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", ju dërgojmë njoftimin e vlerësimit tatimor, ku detyrimet tuaja janë të llogaritura në mënyrë automatike nga sistemi informatik në përputhje me metodat e parashikuara nga neni 72 i ligjit të sipërcituar.

Sa më sipër, ju njoftojmë së detyrimet tuaja tatimore për _____, për periudhën _____të mosdeklarimit janë:

Lloji i tatimit	**Detyrimi**
Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)	
Tatim fitimi	
Tatim mbi të ardhurat personale nga pagat (TAP)	
Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	
Tatim të thjeshtuar mbi fitimin	
Tatim në burim i të ardhurave	
Taksa kombëtare	
Tarifa kombëtare	
Taksë për rentën minerare	
Tatim mbi lojërat e fatit	
Të tjera	

Ju njoftojmë se, në bazë të paragrafit 4 të nenit 71/1 të ligjit të sipërcituar, ky njoftim-vlerësimi tatimor i bërë nga zyra është i paapelueshëm. Vetëm paraqitja e deklaratës tuaj tatimore të kësaj periudhe, me të dhënat reale, e anulon këtë njoftim vlerësimi.

Administrata tatimore, do të fillojë mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore, sipas njoftim- vlerësimit të bërë nga zyra në mënyrë automatike sipas sistemit informatik, nëse nga ana juaj, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të njoftim-vlerësimit tatimor nuk është dorëzuar deklarata tatimore ose nuk është paguar shuma e mësipërme e detyrimit.

DREJTORI

(shtuar me udhëzimin nr. 26, datë 16.12.2014)

SHTOJCA 3
Model i Urdhër Pagesës së Detyrimeve Tatimore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE_____

URDHER PAGESE

(A) Numri Serial:	
(B) Periudha tatimore	
(C) NIPT/NSSH	
(D) Emri i Tatimpaguesit	

Arsyet për Urdhër Pagesë

Pagesë kundrejt detyrimit tatimor.

Detaje te urdher pagesës

Duke perfshire interesin dhe gjoben per pagese te vonuar deri më:

Nxjerrë më _____ _____ (Gjithesej per tu paguar)

(Vlera e detyrimit është e vlefshme për datën e nxjerrjes së Urdhër Pagesës. Për pagesa më vonë kjo shumë mund të rritet me detyrime të tjera.)

Vetem per perdorim zyrtar

PAGESA

☐ Leke

☐ Xhirim

☐ Cek

SHUMA E PAGUAR

Data, Vula e Bankes dhe nenshkrimi i nepunesit te bankes

(shtuar me udhëzimin nr. 14/1 , datë 4.9.2015)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE

KERKESE PER RIMBURSIM

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

Numri identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): .....
Emri tregtar i Personit te Tatueshem: .....
Emri Mbiemri i Personit Fizik .....
Adresa: .....
Qyteti/Komuna/Rrethi: .....
Numri i telefonit: .....

Kerkoj rimbursimin e kredise per

Tatimin : Kodi i tatimit **periudhen :** Periudha Tatimore Nr vleresimit (Per perdorim zyrtar)

Kredia duhet te transferohet dhe/ose rimbursohet ne perputhje me kerkesen qe une kam paraqitur ne vijim. Ne te njejten kohe une e di dhe pranoj qe nje pjese e kredise apo e gjithe kredia mund te perdoret per te shlyer detyrimet qe une mund te kem ndaj zyres se tatimeve.

..... Nenshkrimi i tatimpaguesit ..... Data

Kontrolluar & Autorizuar nga:
(Per perdorim zyrtar)

..... Emri i inspektorit ..... Kodi ..... Data e autorizimit

	Tatimpaguesi	Zyra e Tatimeve
[19] KREDIA E RIMBURSUESHME :	[19]	
Shperndarja e rimbursimit:		
[30] Transferim ne nje detyrim tatimor tjeter : Taksa / Periudha tatimore / Numri i vleresimit	[30]	
[31] Transferim ne nje detyrim tatimor tjeter : Taksa / Periudha tatimore / Numri i vleresimit	[31]	
[32] Transferim ne nje detyrim tatimor tjeter: Taksa / Periudha tatimore / Numeric i vleresimit	[32]	
(Kodi i takses: 0-TVSH, 1-Tat.Fitimi, 4-TAP, 5-Sig. shoq, 6-Sig. shend)		
[33] Totali Transferimeve {[30] + [31] + [32]}:	[33]	
[34] Rimbursim :	[34]	
[35] MBETET PA U SHPERNDARE {[19] - [33] - [34]}:	[35]	

Formati 1
(shtuar me udhëzimin nr. 14/1, datë 4.9.2015 dhe ndryshuar me udhëzimin nr. 14/2, datë 8.10.2015)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RIMBURSIMIT TE TVSH-SE

Nr_____Prot Datë ...../...../.....

(Formati Nr. 1)

NJOFTIM PËR MOSPRANIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TË TVSH

Drejtuar: **Tatimpaguesit "_____"**

Z. _____

Nipt: _____

Adresa: _____

Në përgjigje të kërkesës suaj te kryer eletronikisht nepermjet formularit «Kerkese per rimbursim» nr. _____, datë _____, me anë të së cilës keni kërkuar rimbursimin e TVSH-se per shumën _____ lekë _____(shuma ne fjale), për periudhën _____, bazuar në:

- Ligjin Nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuar, neni 75/1 ;
- Udhezimin Nr. 24, date 02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuar , pika 75/1

Ju njoftojmë se për mosplotësim të _____*(arsyet e mospranimit)*_____,
_____
kërkesa juaj për rimbursim të TVSH-së nuk është pranuar nga administrata tatimore.
Pasi të keni rregulluar situatën dhe të keni plotësuar kërkesat e përcaktuara në dispozitat e sipërpërmendura, ju mund të paraqisni një kërkesë të re për rimbursim.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

D R E J T O R I I PERGJITHSHEM

_____

Ky njoftim i dërgohet personit të tatueshëm nepermjet shërbimit postar, brenda 5 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së.
Ky njoftim, formati nr.1,është miratuar me Udhëzimin Nr……, datë……., botuar ne FLZ ……, date ……..2015

Formati 2

(shtuar me udhëzimin nr. 14/1, datë 4.9.2015 dhe ndryshuar me udhëzimin nr. 14/2, datë 8.10.2015)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RIMBURSIMIT TE TVSH-SE

Nr_____Prot Datë ...../...../.....

(Formati Nr.2)

NJOFTIM PËR PRANIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TË TVSH

Drejtuar: *Tatimpaguesi: "_____"*
Z. _____
Adresa: _____

Në zbatim të nenit 75/1, te Ligjit Nr 9920, date 19.05.2008 "Per Proçedurat Tatimore ne RSH" dhe pikes 75/1 te Udhezimit Nr 24, date 02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuar, ju informojmë se është pranuar kërkesa për rimbursim te TVSH-se. Kjo kerkese sipas procedures do ti nenshtrohet analizes se riskut per rimbursim. Ne vijim do te njoftoheni per procedurat e metejshme.

Emri i Personit te Tatushëm:	
Numri i Identifikimit Personit Tatushem NIPT/NUIS:	
Emri Mbiemri (Administratori/Drejtori)	
Adresa:	
Qyteti/Komuna/Rrethi:	
Nr. Telefonit, E-mail:	
Kërkesa për rimbursim Nr. Prot	
Datë:	
Eksportues: [1)]	
Marrveshje Financiare:	
Shuma e kërkuar ne numer dhe fjale :	
Periudha:	
Dega e Bankes/Nr. Llogarise bankare:	

D R E J T O R I I PERGJITHSHEM

Shënime:

1.Kjo rubrikë plotësohet nëse subjekti është eksportues, duke përcaktuar kategorinë e eksportuesit sipas VKM Nr_____, datë_____ " Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për kategoritë e eksportuesve përfitues të rimbursimit të tvsh-së". Psh (eksportues me risk zero/ eksportues te tjere).

- Ky njoftim i dërgohet tatimpaguesit, brenda 5 diteve pune nga data e paraqitjes se kerkeses per rimbursim te TVSH-se.
- Ky njoftim është i vlefshëm vetëm për njoftimin e fillimit te proçedurës së rimbursimit dhe jo për ekzekutimin e rimbursimit. Në rast miratimi ky njoftim do të pasohet me formatin Nr. 3 ku përcaktohet shuma për tu rimbursuar.

Ky njoftim, formati nr.2, është miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr....., datë .....2015, botuar ne FLZ ....., date .....2015.

Formati 3

(shtuar me udhëzimin nr. 14/ , datë 4.9.2015 dhe ndryshuar me udhëzimin nr. 14/2, datë 8.10.2015)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RIMBURSIMIT TE TVSH-SE

Nr_____Prot Datë ...../...../.....

(Formati Nr. 3)

NJOFTIM PËR MIRATIMIN E RIMBURSIMIT TË TVSH

Drejtuar: **DEGËS SË THESARIT** _____

Tatimpaguesit: _____

Z. _____

Adresa: _____

Në zbatim të Ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuar, neni 75/1 dhe udhëzimin Nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar , pika 75/1.ju njoftojmë për rimbursimin e TVSH-së me te dhenat si më poshtë:

Emri i Personit te Tatushëm:	.....
Numri i Identifikimit Personit Tatushem NIPT/NUIS:	.....
Emri Mbiemri (Administratori/Drejtori)	.....
Adresa:	.....
Qyteti/Komuna/Rrethi:	.....
Nr. Telefonit, E-mail:	.....
Kërkesa për rimbursim Nr. Prot	.....
Datë:	.....
Eksportues: [1)]	.....
Marreveshje Financiare:	.....
Dega e Bankes/Nr. Llogarise bankare:	.....

Shuma e kërkuar per Rimbursim ……..……..….[1] *(Shuma sipas kërkesës së subjektit)*	
Shuma e miratuar për Rimbursim ..…… 2] *(Shuma e miratuar si e rimbursueshme sipas raportit përfundimtar të kontrollit)*	
Shuma e përdorur/ mbajtur për kompensim të detyrimeve tatimore..... …….[3]	
Shuma e TVSH për tu rimbursuar ([2]- [3]) ……..[4] *(Shuma që do të kaloje nga thesari në llogarinë bankare të subjektit)*	

DREJTORI I PERGJITHSHEM

_____

Shenime:
1) Kjo rubrike plotesohet vetem nese subjekti eshte eksportues, duke përcaktuar kategorinë e eksportuesit sipas VKM Nr_____, date_____" Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për kategoritë e eksportuesve përfitues të rimbursimit të tvsh-së". Psh (eksportues me risk zero/ eksportues te tjere)

- *Ky njoftim (Format Nr 3) pergatitet te pakten ne 5 kopje , 2 prej te cilave i dergohen Thesarit; 1 kopje i dergohet subjektit; 1 kopje ne dosjen e tatimpaguesit dhe 1 kopje ne zyren e protokollit.*
- *Ky njoftim eshte i vlefshem per ekzekutimin nga Dega e Thesarit te rimbursimit te TVSH-se se miratuar nga Administrata Tatimore*
- *Ketij njoftimi i bashkangjitet urdherpagesa (UPR) sipas formatit te miratuar sipas ketij udhezimi dhe i dergohet ne 2 kopje Deges se thesarit, e cila procedon me pagesen brenda 5 diteve. Njera kopje nga te cilat pasi kunderfirmohet dhe vuloset nga Dega e Thesarit i kthehet Drejtorise Pergjithshme te tatimeve*
- *Ky njoftim pa UPR i dergohet personit te tatueshem qe ka bere kerkesen per rimbursim te TVSH-se.*
- *Te gjitha shumat ne kete njoftim pervec se ne numer duhet te shkruhen dhe me fjale.*
- *Ky njoftim Formati Nr.3, eshte miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr ……, datë ……..2015, botuar ne FLZ ….., date ……..2015*

Formati 4

(shtuar me udhëzimin nr. 14/2, datë 8.10.2015)

(shtuar me udhëzimin nr. 14/2, datë 8.10.2015)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Nr_____Prot

Datë ...../...../.....

(Formati Nr. 4)

Emërtimi i Institucionit	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve ve
NIPT - i	xxxxxxxxxx
Kodi i Institucionit	1010xxxx
Entiteti i Qeverisjes	001
Rrethi	xxxx

Nr. i Kuponit

URDHËR - PAGESË RIMBURSIMI per TVSH-ne

Nr. Datë __.__.20__

Nr.	Struktura e llogarive_kodi			Llogaria Ekonomike	Nën Llogaria	Kod Projekti	SHUMA në Leki	Objekti i pagesës
	Institucioni	Kapitulli	Programi					
1								
2								
3								
TOTALI ME SHIFRA							xxx,xxx.xx	X
TOTALI ME FJALË							(.....)	

IBAN:	AL
Të dhëna për subjektin përfitues:	
Emri i subjektit perfitues	
NIPT - i	
Nr.llog.bankare të subjektit	
Emri i Bankës	
Adresa e Bankës	
xxxxxx (p.sh.Tiranë)	

Dokumentat ngjitur Urdhër Pagesës Rimbursimit:		
Emërtimi	Nr. Dokumenti	Data e Dokumentit
Njoftimi	nr. xxx	datë __.__.20__
Të tjera (Emërtime, numër, datë)		

PER DREJTORINE E RIMBURSIMIT _____

DREJTORI I DREJTORISE SE RIMBURSIMIT
(_____)

DREJTORI I PERGJITHSHEM I TATIMEVE
(_____)
Vula

PER DEGEN E THESARIT
Aprovuar date

DREJTORI I DEGES SE THESARIT
(_____)
Vula

Shënim: Qelizat për "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar datë", plotësohen nga nëpunesi i Degës së Thesarit

Ky njoftim Format nr. 4 është miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr ..., datë ....., botuar ne FLZ ....., date

Formati 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E RIMBURSIMIT TVSH-SE

Nr_____Prot Datë ...../...../.....

(Formati Nr.5)

NJOFTIM PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TE TVSH

Drejtuar: DEGËS SË THESARIT

Në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuar neni 75/1, dhe Udhëzimit ne zbatim te tij Nr. 24, date 02.09.2008, pika 75/1, ju njoftojmë se ***është refuzuar*** kërkesa për rimbursim e personit të tatueshëm me të dhënat:

Emri i Personit te Tatushëm:	
Numri i Identifikimit Personit Tatushem NIPT/NUIS:	
Emri Mbiemri (Administratori/Drejtori)	
Adresa:	
Qyteti/Komuna/Rrethi:	
Nr. Telefonit, E-mail:	
Kërkesa për rimbursim Nr. Prot	
Datë:	
Eksportues: [1)]	
Marrveshje Financiare:	
Shuma e kërkuar ne numer dhe fjale :	
Periudha:	
Dega e Bankes/Nr. Llogarise bankare:	

DREJTORI I PERGJITHSHEM I TATIMEVE DREJTORI I DEGËS SË THESARIT

Shënime: 1) Kjo rubrikë plotesohet nëse subjekti është eksportues, duke percaktuar kategorine e eksportuesit sipas VKM Nr_____, date_____" Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për kategoritë e eksportuesve përfitues të rimbursimit të tvsh-së". Psh (eksportues me risk zero/ eksportues te tjere)

- Ky njoftim sipas pikes 75/1.7 informon Degen e Thesarit per refuzimin e kerkesës për rimbursim.
- Ky njoftim, formati nr.5, është miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr , datë ., botuar ne FLZ , date

FLETË SHOQËRIMI MALLI

(Ky dokument lëshohet vetëm për rastet e lwvizjes sw mallit sic parashikohet nw pikën 46.1.9.1 të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në RSH"

Numri Serial: OOOOOOO
Numri i fletë-daljes /……/

Data: ……../……../……../

Të dhënat e shitësit të mallit:

Emri i Personit të Tatueshëm: /……/

NIPT: | | | | | | | | | | |

Adresa e Personit të Tatueshëm: /……
……/

Adresa nga niset malli: /……
……/

Telefon: /……/

Të dhënat e blerësit të mallit:
Personi i Tatueshëm Blerës i Mallit
/……/

NIPT: /……/
Adresa e blerësit të mallit: /……
……/
Telefon: /……/

Të dhënat e pritësit të mallit:
Adresa e mbërritjes së mallit:
/……/
Emri i Personit të Tatueshëm Pritës të Mallit:
/……/
NIPT: /……/
Adresa e Pritësit të Mallit: ……
……/
Telefon: /……/

Data e nisjes: /……/……/……../; Ora nisjes: /……../

Targa e mjetit transportues: /_____/.

Transporti bëhet me mjetin:

☐ E shitësit ☐ E blerësit ☐ E pritësit të mallit ☐ E të tretëve* [Plotëso në fund të faqes]

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia e matjes	Sasia

Lloji i ambalazhit /……/; Nr. Kolive (arkave, thasë, etj) /……/
**Kur transporti bëhet me të tretë:*
Emri i shoqërisë transportuese/ personit fizik: /…… / **NIPT**/……/
Adresa: /……/……/……/

Nisësi	**Transportuesi**	**Pritësi**
(emri, mbiemri, nënshkrimi)	(emri, mbiemri, nënshkrimi)	(emri, mbiemri, nënshkrimi)
_____	_____	_____

Shënim: Fleta e shoqërimit të mallit leshohet minimumi në tre kopje, origjinali dhe një kopje i merr transportuesi dhe ia dorwzon pritesit tw mallit. Pritesi i mallit origjinalin pasi e nenshkruan ia kthen transportuesit i cili ia dorezon bleresit te mallit , shoqerise që i ka lëshuar pritesit faturën tatimore për mallin e furnizuar
Ky dokumet nuk eshte fature shitje dhe eshte i vlefshem vetëm kur shoqërohet me kopje të faturës tatimore të shitjes

MODELI STANDART

FATURË SHOQËRIMI

(Ky dokument lëshohet për shoqërimin e mallrave siç parashikohet në pikat 46.1.9, 46.1.10, 50.4 dhe në cdo rast që parashikohet përdorimi i faturës së shoqërimit në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar

Numri Serial: 0000000
Numri i fletë-daljes /……/

Data: ……../……../……../

Emri i Personit të Tatueshëm /……/

NIPT: ☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐

Adresa e Personit të Tatueshëm/……
……/
Numri serial i Çertifikatës së NIPT:
/……/

Adresa nga niset :/……/

Telefon: /……/

Adresa e mbërritjes së mallit:
/……
……/

Numri serial i Çertifikatës së NIPT-it :
/……/

Data e nisjes : /……/……/……../; **Ora e nisjes : /……../** **Targa e mjetit : /_____/.**

Levizja e mallit nga: ☐ Magazinë, ☐ Ekspozitë, ☐ Dyqan ☐ Pikë shitje ☐ Të tjera

Për në : ☐ Magazinë ☐ Ekspozitë ☐ Dyqan ☐ Pikë shitje ☐ Të tjera

Transporti me mjetin: ☐ E vet ☐ E të tretëve* [Plotëso në fund të faqes]

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia e matjes	Sasia	Vlera

Lloji i ambalazhit /……/ ; Nr. Kolive(arkave,thasë,etj) /……/

**Kur transporti bëhet me të tretë :*

Emri i shoqërisë transportuese/ personit fizik : /…… / **NIPT**/……/

Adresa : /……/……/……/

Nisësi	**Transportuesi**	**Pritësi**
(emri, mbiemri, nënshkrimi)	(emri, mbiemri, nënshkrimi)	(emri, mbiemri, nënshkrimi)
_____	_____	_____

Shënim: Fatura e shoqërimit të mallit duhet të lëshohet minimumi në dy kopje, kopja e parë shoqeron mallin deri nw destinacion, kopja e dytë mbetet tek adresa ku niset malli ose e mban nisesi i mallit.

Shtuar me udhëzimin nr. 7, datë 10.1.2017

Shtojca 1: Nr prot...../ Datë.....

(Ketu shenohet nr prot i Drejtorise Rajonale ku dorezohet formulari)

FORMULAR PYETËSOR I VETËDEKLARIMIT PARA KONTROLLIT

Shënim: Ky formular pyetësor plotësohet nga tatimpaguesi në zbatim të nenit 81 të Ligjit 9920/2008 dhe i vihet në dispozicion tatimpaguesit 30 ditë përpara fillimit të kontrollit tatimor në vend, të përcaktuar në njoftimin për kontroll.
Tatimpaguesi ka të drejtë të plotësojë këtë formular përpara fillimit të kontrollit dhe të deklarojë në të detyrimin tatimor të padeklaruar për periudhat tatimore objekt kontrolli. Ky formular dorëzohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore nga tatimpaguesi përpara fillimit të kontrollit.

Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme duke paraqitur informacionin e kërkuar. Gjithashtu mund të paraqisni çdo informacion tjetër, nëse gjykohet e nevojshme nga ana juaj.

- Të dhënat e Njoftimit te Kontrollit (Nr. Prot/Datë).....
- Periudhat tatimore objekt kontrolli:.....

1. **Të dhënat identifikuese:**

(Emri i tatimpaguesit/Nipt-i, administratori/drejtori ekzekutiv, adresa kryesore/ të tjera, forma ligjore, numri i telefonit, adresa e e-mail-it,...etj).

Emri:.....Nipt:.....
.....Adresa kryesore dhe te tjera.....
.....
.....
Nr. Tel/E-mail.....

2. **Çfarë veprimtari/ aktivitete kryeni ?**

Përshkruani hollësisht llojin/et e aktivitetit/eve që kryeni aktualisht.

Përgjigje;.....
.....
.....

3. **Cilat janë përgjegjësitë tuaja tatimore? (specifikoni llojet e tatimeve/taksave/ kontributet për të cilat jeni përgjegjës)**

Përgjigje;.....
.....
.....
.....

4. **A i keni deklaruar të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit? Nesë jo, specifikoni cila është adresa/t e padeklaruara?**

Përgjigje.....
.....
.....
.....

5. A keni në ruajtje, përdorim apo transport mall/mallra të pashoqëruara me dokumentacion tatimor?

Përgjigje.....
.....
.....

6. A keni transaksione shitje/blerje, dhe veprime te tjera të padeklaruara në organin tatimor që janë object i këtij legjislacioni?

Përgjigje.....
.....
.....
.....

6/1. **Cilat janë të dhënat për këto transaksione? (specifikoni numer fature/date/ të dhënat për dokumentin përkates kontratë etj., nëse disponon)**

Përgjigje.....
.....
.....
.....

7. Te dhena te tjera mbi vetdeklarimin nese dispononi.

- A e kryeni per here te pare vetdeklarimin përpara kontrollit. Nese jo jepni sqarime me te hollesishme:

Pergjigje.....
.....
.....

- Jepni sqarime se cila ka qene aresyeja e mosdeklarimit ne kohe nga ana juaj e transaksioneve te mesiperme.

Përgjigje.....
.....
.....
.....

8 Cili është vetdeklarimi juaj sipas llojit të tatimeve? (shifrat e meposhtme te shprehen ne vlerë dhe me fjalë)

a) **Deklarimi për TVSH-në:**
Vlera e tatueshme e transaksionit.....
Tvsh:.....

b) **Deklarimi për tatimin mbi të ardhurat?**
Cili është lloji i tatimit/ Cila është vlera për t'u deklaruar/ tatimi përkatës ?

Tatimi mbi fitimin.....
Tatimi i thjeshtuar i Fitimit.....
Tatimi mbi te ardhurat personale.....
Tatimi I mbajtur ne burim.....

c) **Deklarimi i detyrimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.**

Cili është lloji i kontributit?.....
Cila është vlera për t'u deklaruar?.....

d) **Deklarimi i detyrimeve për taksat dhe tarifat kombëtare.**
Cila është lloji i taksës/tarifës?.....
Cila është vlera për t'u deklaruar.?.....

e) Tatimi i lojrave te fatit .....

9. Plotësoni tabelën e mëposhtme:

Llojet e tatimit/taksave	**Periudha/t tatimore**	**Vlera e deklaruar në organin tatimor?**	**Vlera e re, e deklaratës sipas muajit dhe vitit përkatës.**	**Komente/ deklarime të tjera**
Për Tvsh-në				
Për Tatim mbi të Ardhurat				
Për Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore				
Taksat/tarifat				
Lojrat e fatit Të tjera				

Përfaqësuesi i Tatimpaguesit/Administratori

_____
(emër/mbiemër/nënshkrimi/vula)

DRAFTMARRËVESHJE

Në zbatim të udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat, nr....., datë.....2020 "Për një shtesë në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe drejtori i Përgjithshëm i Doganave, bien dakord sa më poshtë:

- Të pranojnë kërkesën e tatimpaguesit ....., me NIPT....., për kompensimin e detyrimit në administratën tatimore/doganore për ..... (shëno llojin e tatimit/taksës TVSH-në, tatim fitimin, akcizën, taksën kombëtare) me tatime/taksa të paguara më tepër në administratën tatimore/doganore për ..... (shëno llojin e tatimit/taksës TVSH-në, tatim fitimin, akcizën, taksën kombëtare), detyrim apo tepricë e cila është provuar dhe pranuar nga palët në këtë marrëveshje, deri në ditën e nënshkrimit të saj.

- Shuma e njohur dhe pranuar nga palët në këtë marrëveshje është në masën ..... lekë.

- Në bazë të kësaj marrëveshjeje, shuma e paguar më tepër pakësohet në organin përkatës tatimor/doganor dhe shuma debitore pakësohet në organin tjetër tatimor/doganor.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave
Emër, Mbiemër, Firma.

Data e nënshkrimit
_____/_____/_____

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve
Emër, Mbiemër, Firma

Data e nënshkrimit
_____/_____/_____

FORMULAR APLIKIMI
KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Tel: E-mail: Web: tatime.gov.al	
Shënim**: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.* ***ME SHKRONJA TË MËDHA!	

SEKSIONI A: **INFORMACION MBI SUBJEKTIN**

1. Emri i tatimpaguesit *shih shënimin A1*

2. NUIS *Nr unik i identifikimit të subjektit (shih shënimin A2)*

3. Emri tregtar *shih shënimin A3*

4. Pronësia *shih shënimin A4*
☐ **Shqiptare private** ☐ **Shqiptare shtetërore** ☐ **E huaj** ☐ **E përbashkët**

5. Forma ligjore *shih shënimin A5*
☐ **OJF** ☐ **Ent publik** ☐ **Organizatë politike** ☐ **Ambulant** ☐ **Organizatë fetare**
☐ **Kryefamiljar** ☐ **P. Tatimor** ☐ **Trup diplomatik** ☐ **Nj. Zbat. Projekte** ☐ **P. Bujqësor**

6. Data e krijimit *shih shënimin A6*
Data Muaji Viti

Numri i dokumentit

7. Adresa kryesore, rruga, numri, nr. pallatit *(shih shënimin A7)*

Qyteti/fshati **Rrethi**

Nr. Tel **E-mail**

8. Aktiviteti *shih shënimin A8*

9. Kodi ekonomik *shih shënimin A9*
(Kjo fushë plotësohet nga inspektori i tatimeve)

Kode të tjerë

TË DHËNA MBI ADMINISTRATORIN/PËRFAQËSUESIN LIGJOR

10. Emri dhe mbiemri i pronarit/administratorit/drejtorit të tatimpaguesit *(shih shënimin A10)*

11. NID *Nr i identifikimit personal (shih shënimin A11)*

12. Nr. tel *shih shënimin A12*

13. Adresa, rruga, numri, nr. pallatit *(shih shënimin A13)*

Qyteti/fshati **Rrethi**

SEKSIONI B: **INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN**

1. Për çfarë jeni regjistruar? *(shih shënimin B1)*

☐ **Tatim fitimi** ☐ **Tatimi për të ardhura nga punësimi** ☐ **Renta minerare**
☐ **TVSH** ☐ **Tatimi në burim** ☐ **Tarifat**
☐ **Sigurimet shoqërore** ☐ **Tatim për lojërat e fatit** ☐ **Akciza**
☐ **Tatim i thjeshtuar mbi fitimin** ☐ **Taksat nacionale** ☐ **Të tjera**

Ky formular është standardizuar nga ADISA

ADISA VËMENDJA JONË.TI

2. Kategoria për efekt sigurimesh *(shih shënimin B2)* ☐ **Punëdhënës** ☐ **I vetëpunësuar**

3. Xhiro e parashikuar për vitin nga data _____ *(shih shënimin B3)*

4. Fitimi i parashikuar *(shih shënimin B4)*

5. Adresa të tjera ku kryhet biznesi *(shih shënimin B5)*

Rruga	Nr	Qyteti/Fshati	Rrethi	Nr. certifikatës

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ **në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.**

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

☐ **Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.**

Nënshkrimi i aplikantit

_____ Data Muaji Viti

Emër, mbiemër, nënshkrim

PËR PËRDORIM ZYRTAR

Verifikuar nga inspektori

_____ _____ Data Muaji Viti

Emër, mbiemër, nënshkrim *Kodi*

Ky formular është standardizuar nga ADISA

ADISA VËMENDJA JONË.TI | AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA / AGENCY FOR THE DELIVERY OF INTEGRATED SERVICES ALBANIA

SHËNIME

Disa subjekteve iu kërkohet të regjistrohen në Organet Tatimore dhe të pajisen me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS). Kërkesa për regjistrim duhet të bëhet përpara se veprimtaria ekonomike të fillojë. Cilido person që është i detyruar të regjistrohet dhe nuk regjistrohet, ka kryer një shkelje dhe për këtë do të zbatohen gjobat sipas ligjit përkatës.

Plotësimi i formularit.

SEKSIONI A: INFORMACION MBI SUBJEKTIN

A1 - Duhet të jepni emrin e plotë të tatimpaguesit, siç tregohet në dokumentin e regjistrimit në Gjykatë ose e përcaktuar në akte të tjera ligjore. Ky do të jetë emri juaj në rast se jeni ambulant apo kryefamiljar.
A2 - Numri unik i identifikimit të subjektit. Kjo fushë plotësohet nga organet tatimore.
A3 - Jepni emrin tregtar të subjektit.
A4 - Zgjidhni vetëm njërën nga kutitë për të treguar pozicionin e subjektit tuaj.
A5 - Zgjidhni vetëm njërën nga kutitë për të treguar pozicionin e subjektit tuaj.
A6 - Jepni datën e regjistrimit në gjykatë, ndërsa për ambulantët dhe kryefamiljarët datën e plotësimit. Vendosni numrin e dokumentit.
A7 - Jepni adresën në të cilën drejtoni apo ushtroni veprimtarinë tuaj. Nëse keni më shumë se një vendodhje të veprimtarisë ekonomike, duhet të caktoni njërën prej tyre si adresë kryesore. Nëse jeni ambulant, apo kryefamiljar jepni adresën tuaj private. Jepni numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike nëse keni, në mënyrë që të mund t'ju njoftojmë për ndryshimet e mundshme që mund të ndikojnë mbi ju.
A8 - Jepni përshkrimin me fjalë të aktivitetit tuaj të përcaktuar nga gjykata ose nga i vetëpunësuari në rastin e ambulantit. Për kryefamiljarin jepni llojin e punës së personit të punësuar nga ju.
A9 - Kjo fushë plotësohet nga zyra e Drejtorisë Rajonale Tatimore, mbi bazën e "Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike".
A10 - Jepni emrin dhe mbiemrin e pronarit/administratorit/drejtorit të tatimpaguesit të përcaktuar në dokumentin përkatës. Nëse jeni një person fizik (ambulant apo kryefamiljar) ky do të jetë emri juaj.
A11 - Jepni numrin e identifikimit personal të pronarit/administratorit/drejtorit të tatimpaguesit. Nëse jeni një person fizik (ambulant apo kryefamiljar) ky do të jetë numri juaj personal i identifikimit.
A12 - Jepni numrin e telefonit të pronarit/administratorit/drejtorit të tatimpaguesit. Nëse jeni një person fizik (ambulant apo kryefamiljar) ky do të jetë numri juaj i telefonit.
A13 - Jepni adresën personale të pronarit/administratorit/drejtorit, emri i të cilit është paraqitur më lart në pikën A10.

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

B1 - Zgjidhni të gjitha kutitë për tatimet që jeni të detyruar të paguani. Në rast vështirësie kërkoni ndihmën e inspektorëve të regjistrimit në Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse.
B2 - Zgjidhni vetëm njërën nga kutitë për të treguar pozicionin e subjektit tuaj.
B3 - Jepni xhiron që parashikoni të realizoni në vitin e parë të aktivitetit tuaj ekonomik. Kjo pikë vlen për OJF, jo për ambulantët dhe kryefamiljarët.
B4 - Këtë fushë duhet ta plotësoni vetëm nëse kërkoni të regjistroheni për këtë tatim.
B5 - Nëse subjekti juaj (përjashtuar ambulantët) operon në më shumë se një adresë, duhet që në këtë tabelë të jepni të dhënat e secilës adresë, me përjashtim të adresës kryesore. Për secilën nga adresat ju do të pajiseni me certifikatën e regjistrimit.

KLAUZOLA DEKLARATIVE - Plotësoni klauzolën deklarative për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në formular. Deklarimi duhet të bëhet nga pronari, administratori ose personi i autorizuar që vepron në emër të subjektit. Ligji parashikon dënime në rastet e deklarimit të pasaktë apo dezinformues.

Detyrimet në të ardhmen:
Për çdo ndryshim në të dhënat e raportuara në këtë formular duhet të njoftoni Drejtorinë Rajonale Tatimore ku jeni regjistruar, dhe të plotësoni formularin e ndryshimeve në regjistrim, që do ta gjeni pranë kësaj drejtorie. Për çdo ndihmë apo informacion shtesë kontaktoni me DRT përkatëse ose lexoni www.tatime.gov.al.

FORMULAR APLIKIMI

PËR NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE TË REGJISTRIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Tel: E-mail: Web: www.tatime.gov.al	
***Shënim**: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.*	

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

a) Plotësohet vetëm nga tatimpaguesi i regjistruar në administratën tatimore për të ushtruar veprimtari ekonomike.

1. Tatimpaguesi		**Forma ligjore**	
NID *Nr. i identifikimit personal*		**Nr.Tel**	
Adresa			

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Kujdes, duhet të plotësoni vetëm ndryshimet. Zgjidhni kutinë e duhur dhe vazhdoni sipas udhëzimit

Ndryshim në detajet e regjistrimit	☐ **Shko në seksionin B1 më poshtë**
Ndryshim i përgjegjësisë për tatimet	☐ **Shko në seksionin B2, në faqe 2**
Mbyllje aktivitetit	☐ **Shko në seksionin B3, në faqe 3**
Ndryshim i kategorizimit për sigurimet shoqërore	☐ **Shko në seksionin B4, në faqe 3**

SEKSIONI B1: NDRYSHIM NE DETAJET E REGJISTRIMIT

2. Emri i ri i tatimpaguesi (shënim 2)				
Emri i ri tregtar				
3. Emri i drejtuesit të ri (shënim 3)				
NID (Nr. unik i identifikimit të subjektit)				
4. Adresa e drejtuesit të ri (shënim 4)				
Qyteti		**Rrethi**		
Nr. Tel		**E-mail**		
5. Pronësia	☐ **Shqiptare Private**	☐ **Shqiptare shtetërore**	☐ **E huaj**	☐ **E përbashkët**
Forma Ligjore (shënim 5)	☐ **SHKP**	☐ **Anonime**	☐ **Kolektive**	☐ **Org.Politike**
	☐ **Njësi. Zbat. Projekt**	☐ **Komandite**	☐ **Trup Diplomaktik**	☐ **Ortakeri**
	☐ **SHBR**	☐ **Shoq.kursim-kredi**	☐ **P.Bujqësor**	☐ **Person Fizik**
	☐ **OJF**	☐ **Ent publik**	☐ **Perf.Tatimor**	☐ **Ambulant**
	☐ **Kryefamiljar**	☐ **Org.Fetare**		

6. Adresa kryesore e biznesit (shënim 6)

Qyteti | **Rrethi**

Nr. Tel | **E-mail**

7. Aktiviteti i ri (shënim 7)

8. Kodi i ri ekonomik (shënim 8)

9. Nëse biznesi juaj vepron në më shumë se një adresë dhe detajet kanë ndryshuar, Ju lutem jepni informacionin më poshtë. Ju duhet të ktheni certifikatën e NIPT-it për adresën që është mbyllur. Për adresën ekzistuese mund të shënoni vetëm numrin e ri të telefonit ose llojin e ri të veprimtarisë.

Ndryshime në adresë ekzistuese (shënim 9)

Numri ekzistues i certifikatës

Lloji veprimtarisë ekzistuese

Adresë e mbyllur

Qyteti | **Rrethi**

Nr. Tel | **E-mail**

Certifikata bashkëngjitur ☐ | **Numri ekzistues i certifikatës**

Adresa e re

Qyteti | **Rrethi**

Nr. Tel | **E-mail**

SEKSIONI B2: NDRYSHIM I PERGJEGJESISE PER TATIMET

10. Zgjidhni tatimin për të cilin jeni tani përgjegjës (shënim 10)

☐ **Tatim fitimi** ☐ **Tatimi/të ardhurat nga punësimi** ☐ **Renta Minerare**

☐ **TVSH** ☐ **Tatim në burim** ☐ **Tarifat**

☐ **Sigurimet shoqërore** ☐ **Lojrat e fatit** ☐ **Akciza**

☐ **Tatim i thjeshtuar mbi fitimin** ☐ **Taksat Nacionale** ☐ **Të tjera**

Jepni tatimin dhe qarkullimin e parashikuar më poshtë:

Qarkullimi i parashikuar

Nga data (Data / Muaji / Viti) | **deri me datë** (Data / Muaji / Viti)

Fitimi i parashikuar

SEKSIONI B3: NDRYSHIM I STATUSIT TE TATIMPAGUESIT

11. Data e mbylljes (shënim 11) (Data / Muaji / Viti)

Arsyeja e mbylljes ☐ **Mbyllur** ☐ **Përthithur** ☐ **Aplikim për mbyllje** ☐ **Të tjera**

Kur veprimtaria përthithet, emri i shoqërisë përthithëse, NIPT-i dhe adresa:

Emri i shoqerisë | **NUIS** *Nr. unik identifikimit të subjektit*

Adresa

Qyteti | **Rrethi**

12. Kalim në pasiv (shënim 12)
☐ **Kalim pasiv me kërkesë të subjektit**
☐ **Kalim në pasiv nga administrata**

Data *Data Muaji Viti*

13. Riaktivizim nga pasivi (shënim 13)
☐ **Riaktivizim me kërkesë të subjektit**
☐ **Riaktivizim nga administrata**

Data *Data Muaji Viti*

SEKSIONI B4: NDRYSHIM I KATEGORIZIMIT PER SIGURIMET SHOQERORE

14. Kategoria për efekt sigurimesh (shënim 14)

☐ **Punëdhënës**
☐ **I vetëpunësuar (i vetëm)**
☐ **I vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes**
☐ **I vetëpunësuar me punëmarrës**
☐ **I vetëpunuesuar pa punëmarrës me punonjës të papaguar të familjes**

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr.9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

☐ **Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.**

Nënshkrimi i aplikantit

Data Muaji Viti

Njoftim i ndryshimeve ne regjistrim

Këtë formular duhet t'a përdorni për të njoftuar organin tatimor për ndonjë ndryshim që ndikon në regjistrimin tuaj. Duhet të njoftoni vetëm ndryshimet në të dhënat që keni raportuar në kërkesën për regjistrim. Për të bërë këto njoftime ekzistojnë disa kufinj kohorë. Nëse kryeni blerje ose shitje të tërë subjektit apo pjesë të saj duhet të njoftoni menjëherë organin tatimor. Për ndryshi-met e tjera, njoftimi duhet bërë brenda 15 ditësh nga momenti i kryerjes së ndryshimit.
Tatimpaguesi që janë subjekt I QKR do të deklarojë dhe kryejë ndryshimin e përgjegjësive tatimore dhe kategorisë për sigurime në organet tatimore

Plotesimi i formularit

Shenim 1 : Shkruani NIPT-i dhe dhe emrin e tatimpaguesit.

Shenimi 2 : jepni emrin e ri të tatimpaguesit (vetëm për ata që janë subjekt i organeve tatimore).

Shenimi 3 : Nëse kemi një ndryshim në ortakun kryesor apo drejtorin, apo një tjetër person është tashmë i autorizuar të veprojë në emër të subjektit, shënoni të dhënat e personit të ri, duke përfshirë emrin dhe adresën e plotë postare të banesës private.

Shenimi 4: Nëse kemi një ndryshim në adresën e banimit të drejtuesit jepni adresën e re të banimit dhe nr. telefonit.

Shenimi 5 : Tregoni pronësinë dhe formën e re ligjore të tatimpaguesit.

Shenimi 6: Nëse kemi një ndryshim në adresën kryesore të biznesit jepni adresen e re dhe nr. telefonit.

Shenimi 7 : Nëse veprimtaria ekonomike kryesore e subjektit ndryshon, shënoni këtu hollësitë.

Shenimi 8. Kjo fushë plotësohet nga inspektori tatimor kur saktësohet ose kur ka ndryshuar veprimtaria ekonomike.

Shenimi 9 : (vetëm për ata që janë subjekt i organeve tatimore). Për çdo degë të subjektit lëshohet një çertifikatë NIPT-i e re. Numri i Identifikimit të Personi të Tatueshëm (NIPT-i) me të cilin jeni i pajisur nuk ndryshon, por çertifikatat do të kenë të gjitha nga një numër të ndryshëm.
Nëse një degë ekzistuese mbyllet **ju duhet të ktheni çertifikatën e NIPT-it ne DRT.** Anasjelltas, kur hapet një degë e re, organi tatimor do të lëshojë një çertifikatë NIPT-i në lidhje me atë degë.

Pasi të keni hapur degën e re, jepni të dhënat e veprimtarisë së biznesit që ushtrohet aty. Nëse nuk keni hapësirë të mjaftueshme për të gjithë informacionin, përdorni Shtojcën A.

Shenimi 10 : Spontoni kutinë përkatëse për të gjitha tatimet per te cilat cilin detyroheni të deklaroni dhe/ose paguani **tani,** dhe shënoni të dhënat lidhur me tatimin e parashikuar dhe qarkullimin.

Nëse qarkullimi për vitin e fundit kalendarik e tejkalon vlerën prej 8 milion lekë, ju duhet të bëni kërkesë për t'u regjistruar për Tatimin mbi Fitimin. Nëse qarkullimi për vitin e fundit tejkalon vlerën mbi 2 milionë lekë për profesionet dhe mbi 5 milionë lekë për aktivitetet e tjera, pavarësisht se jeni në Biznes të Vogël, ju duhet të kërkoni për tu regjistruar në TVSH. Mos vononi, në të kundërt do të penalizoheni me gjobë. Nëse keni Biznes i Vogël dhe qarkullimi vjetor parashikohet në vlerën 2-8 milionë lekë atëherë ju duhet të regjistroheni për Tatimin mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël.

Shenimi 11 : Nëse veprimtaria ekonomike është shitur, mbyllur , perthithur, ose eshte kryer aplikimi per mbyllje prane QKR , Gjykates etj, shënoni datën dhe spontoni kutinë përkatëse për të dhënë arsyen e mbylljes së veprimtarisë. Ne rastin e aplikimit per mbyllje spontimi i kutise perkatese do te kete si efekt nderprejen e gjenerimit te deklaratave tatimore.

Shenimi 12. Nëse janë plotësuar kushtet për kalim në pasiv spontoni kutine dhe vendosni datën.

Shenimi 13. Nëse janë plotësuar kushtet për riaktivizim nga pasivi spontoni kutinë dhe vendosni datën.

Shënimi 14 : Nëse kategorizimi juaj për efekt të sigurimeve shoqërore apo TAP ka ndryshuar, zgjidhni vetëm njërën nga kutitë përkatëse për kategorinë që ju keni tashmë.

Shenimi 15: Nese informacioni i dhënë është i saktë dhe i plotë, nenshkruani formularin dhe plotësoni datën.

Shenimi 16. Kjo pjesë plotësohet nga inspektori i DRT.

Detyrimet ne te ardhmen
Per cdo ndryshim ne te dhenat e raportuara në këtë formular duhet të njoftoni DRT ku jeni regjistruar, dhe të plotësoni formularin e Ndryshimeve në Regjistrim, që do ta gjeni në zyrën e tatimeve. Per cdo ndihmë apo informacion shtesë kontaktoni drejtorinë rajonale të tatimeve ose lexoni *www.tatime.gov.al*.